

THEOFANIS MALQIDHIS

**MINORITETI ETNIK GREK
NË SHQIPËRI**

FEDERATA PANEPIROTE E AMERIKËS

FEDERATA PANEPIROTE E AMERIKËS
MINORITETI ETNIK GREK NË SHQIPËRI
2007

Teksti u hartua nga doktor profesor Theofanis Malqidhis në Universitetin Demokriteion të Thrakës për Federatën Panepirote të Amerikës (2007).

Përktheu: Ilektra Qiqi
Faqja e jashtme: APOLONIA

PËRMBAJTJA

Parathënie	7
Kronologji.....	9
1. Vorioepirotët. Minoriteti autokton grek në Shqipëri ..19	
2. Vorioepiri në kohën e pushtimit turk	24
3. Krijimi i shtetit shqiptar dhe minoriteti etnik grek	26
4. Politika shqiptare dhe minoriteti etnik grek gjatë Luftës së Dytë Botërore	37
5. Vendosja e sistemit komunist, Lufta e Ftohtë dhe minoriteti etnik grek	40
6. Marrëdhëniet greko-shqiptare në periudhën 1944-1974 dhe minoriteti etnik grek	47
7. Marrëdhëniet greko-shqiptare pas rivendosjes së demokracisë në Greqi	59
8. Heqja e gjendjes së luftës	62
9. Minoriteti etnik grek dhe marrëdhëniet greko-shqiptare që nga krijimi i shtetit shqiptar deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë	62
10. Çështja e arsimit të minoritetit etnik grek	73
11. Liria fetare e minoritetit etnik grek dhe marrëdhëniet greko-shqiptare	75
12. Minoriteti etnik grek pas ndryshimit të sistemit në Shqipëri	81
13. Pasiguria në Shqipëri dhe fryma e terrorit	89
14. Arsimimi i minoritetit etnik grek dhe problemet	91

15. Liria fetare e minoritetit etnik grek	99
16. Kisha e Shqipërisë	101
17. Shteti shqiptar dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit etnik grek	102
18. Konsolidimi i të drejtave të minoritetit etnik grek	110
18.1 Mbrojtja ndërkombëtare	112
18.2 Kuadri ligjor i Evropës	115
19. Konkluzione	123
Shtojcë	127

PARATHËNIE

Libri është një vështrim i përgjithshëm mbi çështjen Vorioepirote, çështjen e minoritetit grek që jeton në Shqipëri dhe synon evidentimin e kësaj teme sa në mjedisin grek aq edhe në atë ndërkombëtar.

Libri përbën një ndihmesë të Federatës Panepirote të Amerikës për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit grek që jeton në Shqipëri dhe, së bashku me të gjitha nismat që kanë ndërmarrë përfaqësuesit e tij, synon të nxjerrë në pah çështjen.

Përmban një vështrim historik të ecurisë së Grekëve që jetojnë në shtetin shqiptar, si një grup etnik autokton, i cili ka përballuar shumë sfida (periudha e krijimit të shtetit shqiptar, periudha e regjimit komunist të Enver Hoxhës) por edhe sfida moderne (periudha kalimtare), përpiqet të konsolidojë të drejtat e tij dhe t' i ndërkombëtarizojë ato në rast se nuk zbatohen ose shkelen.

Probleme të mëdha si arsimimi i anëtarëve të minoritetit grek, liritë fetare, kthimi i pronave private, zonale dhe fetare atyre që u takojnë, obligimet për të drejtat e njeriut dhe ato minoritare, si dhe terrori jo vetëm nuk janë zgjidhur nga pala shqiptare por janë bërë më të mprehta. Madje në frymën nacionaliste që kultivohet në Shqipëri, një sërë aktesh të qeverisë shqiptare janë drejtuar kundër minoritetit grek duke synuar largimin përfundimtar të tij.

Në Federatën Panepirote të Amerikës besojmë se çështja e minoritetit grek, duhet të jetë tema zotëruese në marrëdhëniet greko-shqiptare, në negociatat e Shqipërisë me Evropën e Bashkuar, si gur prove për zhvillimin ose jo të marrëdhënieve midis të dy palëve dhe ecurinë me organizmat e tjerë evropianë

dhe ndërkombëtare (OKB, NATO, OSBE). Si rrjedhojë, synimi kryesor duhet të jetë respektimi dhe ushtrimi i plotë i të drejtave politike, kulturore dhe arsimore i minoritetit grek. Minoritetet etnike, dhe më konkretisht minoriteti grek nuk është element i aneksuar i shteteve të gadishullit Ballkanik dhe i Shqipërisë, por është pjesë krijuese e saj. Në këtë prizëm është i domosdoshëm respektimi i të drejtave të njeriut të minoritetit grek sikundër i garantojnë organizmat ndërkombëtare, konventat dhe marrëveshjet, por edhe legjislacioni shqiptar. Në këtë kuadër përfshihet edhe nisma jonë për botimin e këtij libri, nisëm e cila besojmë se do të gjejë përkrahës të shumtë dhe të rëndësishëm.

Mihalis Servos
Kryetar i Federatës Panepirote të Amerikës
Florida, mars 2007

KRONOLOGJI

Prezenca e Grekëve Epirote në Shqipëri regjistrohet që nga lashtësia deri sot si grup popullsie autoktone, duke patur veprimtari me vlera të veçanta kulturore të një rëndësie botërore.

28 nëntor 1912

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë

7 dhjetor 1912

Çlirimi i KORÇËS nga ushtria greke

20 dhjetor 1912

Njohja e pavarësisë së Shqipërisë nga ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Londër.

21 shkurt 1913

Çlirimi i JANINËS nga ushtria greke

3 mars 1913

Marrja e GJIROKASTRËS dhe KËLCYRËS nga ushtria greke.

6 mars 1913

Çlirimi i TEPELENËS dhe i HIMARËS, KURVELESHIT, PËRMETIT dhe LESKOVIKUT.

17 maj 1913

Nënshkrimi i paqes midis shtetit Otoman dhe Aleatëve të Ballkanit.

30 maj 1913

Nënshkruhet në Londër Konventa e Paqes. Në bazë të nenit 3, ngarkohen gjashtë (6) Fuqitë e Mëdha, ANGLIA, FRANCA, AUSTROHUNGARIA, GJERMANIA, ITALIA

dhe RUSIA, të përcaktojnë kufijt e shtetit Shqiptar të porsakrijuar. Fatkeqësisht, Shtetit Shqiptar të porsakrijuar iu dha i tërë Vorioepiri, d.m.th. HIMARA, GJIROKASTRA, KORÇA, PËRMETI, DELVINA, SARANDA etj., krahina në të cilat shumica e popullsisë ishte greke **dhe madje autoktone**.

Krahina u quajt Vorioepir dhe Grekët Vorioepirotë.

29 korik 1913

Nënshkruhet në Londër nga gjashtë Fuqitë e Mëdha protokoli për pavarësinë e Shqipërisë.

8 gusht 1913

Nënshkruhet Protokoli i Londrës, me të cilin njihet se kufijt veriorë të Shqipërisë me Greqinë do të përfshinin nga njëra anë zonën e Korçës dhe nga ana tjetër bregdetin deri në Ftele. Midis këtyre dy vendosjeve, kufijt do të përcaktoheshin nga një komision në bazë të të dhënave gjeografike dhe etnologjike. Për këto të fundit si bazë do të merrej gjuha që fliste popullsia.

17 dhjetor 1913

Komisioni shpall vendimin e tij, i njohur si Protokoli i Firencës.

13 shkurt 1914

Fuqitë e Mëdha i bëjnë të ditur Greqisë vijën kufitare Greqi-Shqipëri dhe e ftojnë që të tërheqi ushtrinë e saj.

28 shkurt 1914

Shpallet Republika Autonome e Vorioepirit me Kryeministër politikanin grek Jeorjio Hristaqi Zografon. Kryengritësit Vorioepirote me notë të tyre drejtuar Fuqive të Mëdha shprehin zhgënjimin dhe dhimbjen e tyre për mospërfilljen e të drejtave të tyre.

17 maj 1914

Nënshkruhet Protokoli i KORFUZIT i cili siguronte

autonominë e Vorioepirit. Teksti i Protokollit të Korfuzit theksonte sa më poshtë:

1. Vorioepiri është i pavarur.
2. Njih mbretërinë e Gulielm Vidit si mbretërinë e saj të ligjshme.
3. Dërgon deputetë në Parlamentin Shqiptar.
4. Gjuha zyrtare e Vorioepirit është greqishtja.
5. Gjuha e detyruar në shkolla është greqishtja, por do të mësohet edhe shqipja në mënyrë fakultative.
6. Epirotët kanë të drejtë të kenë forcë ushtarake të tyre, me oficerë të tyre, forcë të cilën qeveria shqiptare nuk mund ta përdorë jashtë kufijve të Vorioepirit.

20 qershor 1914

Fuqitë e Mëdha detyrohen të miratojnë Protokollin e Korfuzit.

23 qershor 1914

Merret edhe qarku i KORÇËS. Kryetari i Komisionit Ndërkombëtar i bën të ditur qeverisë së Republikës Autonome të Vorioepirit se prijësi suprem i Shqipërisë Gulielm Vidi dhe qeveria e tij pranojnë tërësisht Protokollin e Korfuzit.

Tetor 1914

Fuqitë e Mëdha i japin porosi Greqisë të rimarrë Vorioepirin për arësye sigurie.

26 prill 1915

Italisë i jipet VLORA dhe toka në brendësi për mbrojtje dhe Greqisë i jipet Virioepiri, 16 përfaqësues të së cilës do të marrin pjesë në Parlamentin Grek që prej 15.12.1915.

17 tetor 1918

Nënshkruhet në MUDRO nga pjesëmarrësit e luftës armëpushimi. Fundi i Luftës së Parë Botërore. Ambasadori anglez në Athinë propozon që Greqia përveç Vorioepirit të

marrë edhe Dodekanisin dhe QIPRON.

29 qershor 1919

Italia pranon kufijt e rinj Shqipëri-Greqi të cilat i kishin pranuar më parë edhe Shqiptarët. Marrëveshja Venizelo-Titoni.

13 janar 1920

Miratohet nga Këshilli i Lartë i Aleatëve marrëveshja Venizelo-Titoni (Ministër i Jashtëm i Italisë), të cilën ia bëri të ditur këshillit Venizellos, marrëveshje të cilën më 10 dhe 25 shkurt 1920 e pranon edhe Presidenti i SHBA-së Uilson.

14 janar 1920

Sekretaria e Këshillit i komunikon Notiosllavisë (vend i Jugosllavisë së vjetër) midis të tjerash se Vorioepiri i jipet Greqisë.

15 maj 1920

Nënshkruhet marrëveshje midis Greqisë dhe Shqipërisë në Kapshticë. Shqiptarët marrin përsipër detyrime deri sa fuqitë e mëdha të marrin vendimet përfundimtare.

17 maj 1920

Senati Amerikan votoi se Vorioepiri pa përjashtuar KORÇËN duhet t' i jipet Greqisë si dhe Dodekanisi dhe ana perëndimore e Azisë së Vogël.

2 tetor 1921

Përfaqësuesi i Shqipërisë në Komunitetin e Kombeve (respektivisht O.K.B. pas Luftës së Parë Botërore në Gjenevë) paraqet një deklaratë përmes së cilës Shqipëria merr përsipër detyrimin që të respektojë të drejtat fetare dhe arsimore të Grekëve të Vorioepirit.

Prill 1935

Vorioepirotët detyrohen t' i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare

të Hagës për shkeljen e të drejtave arsimore dhe fitojnë.

7 prill 1939

Gjendja e Grekëve keqësohet shumë pasi Shqipëria bashkohet me fuqitë e Aksit dhe lufton si aleate e tyre gjatë gjithë periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

28 tetor 1940

Italia pretendon nga Greqia t' i lejojë ta pushtojë. Pasi Greqia nuk pranoi, ushtria italiane e përforcuar me batalione shqiptare sulmon ushtrinë Greke por nur prapset. Ushtria Greke kundërsulmon dhe përseri merr dhe çliron Vorioepirin. Greqia është i vetmi vend që 1940-1941 mund Aksin.

6 prill 1941

Gjermania sulmon Greqinë përmes Bullgarisë dhe e pushton atë. HITLERI, ngaqë i bëri shumë përshtypje ushtria greke, urdhëroi të mos arrestohen ushtarët grekë që ishin zënë robë, ndërsa oficerat të kthehen në shtëpitë e tyre së bashku me armët që kishin.

Qershor 1942

Qeveria greke e internuar në Egjipt, kërkon marrjen e Vorioepirit.

12 tetor 1944

Qeveria greke shpall se Vorioepiri përbën pjesë të pandarë të Greqisë.

Qershor 1945

Komisioni kushtetues për çështjet e jashtme të Greqisë i propozon qeverisë që ushtria greke të marrë Vorioepirin, që të mos humbasin të drejtat tona.

Janar 1946

Shpallet Republika Popullore e Shqipërisë. Persekutimi i minoritetit grek. Shumë minoritarë grekë pushkatohen,

përcillen në kampe për punë të detyruar, burgosen, ndërsa prona e tyre konfiskohet. Vijon gryerja sistematike dhe e vazhdueshme e minoritetit grek me shpërndarjen e tij në zona të tjera dhe njëkohësisht vendosja e Shqiptarëve në zonat minoritare, si dhe krijoi kushte për shkëputje nga tradita kulturore greke. Internimi i Grekëve kombinohej me internimin e gjithë familjes apo izolimin e saj në mjediset e vendbanimit të saj. Zhdukje demografike përmes regjistrimesh të falsifikuara të popullsisë.

Dhënia tek grekët emra shqiptarë, krijimi i vendbanimeve të reja me banorë shqiptarë të fesë myslimane brenda zonave të pastra minoritare. Në krahinat minoritare u vendos regjimi i zonave në përgjim, i ndalimit të qarkullimit dhe frenimeve (p.sh.tela me rymë elektrike në kufijt me Greqinë, etj.), gjithashtu qenia e minoritetit faktor miqësie dhe urrë midis dy popujve, pa pëlqimin e Greqisë. Kufizimi i prezencës së minoritetit grek vetëm në 99 fshatra.

26 mars 1946

Komisioni për çështjet e jashtme të Senatit Amerikan voton se Vorioepiri dhe Dodekanisi duhet t' i jipen Greqisë. Po ngjallet një shpresë. Veç kjo përbënte një urim që nuk ishte i detyrueshëm për Konferencën e Paqes.

15 maj 1946

Ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe, BEBIN pozicionohet pozitivisht ndaj kërkesës së Greqisë në kongresin e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të shteteve fituese.

29 qershor 1946

Senati Amerikan voton dhënien e Vorioepirit dhe Dodekanisit Greqisë.

21 korrik 1946

Në Paris fillon konferenca e 21 shteteve fituese.

30 gusht 1946

Në Rendin e Ditës regjistrohet kërkesa e Greqisë për Vorioepirin, por, me gjithë se u pranua, nuk u diskutua dhe anulohet që të diskutohet në mbledhjen e ardhshme.

28 shtator 1946

Shtrohet përsëri çështja e Vorioepirit që nuk ishte diskutuar. Me ndërhyrjen e BRSS dhe Jugosllavisë, përcillet që të diskutohet në Këshillin e Ministrave të Jashtëm.

Nëntor 1946

Risillet çështja dhe BRSS bie dakort me ANGLINË, SHBA dhe FRANCËN, por e përcjell për t' u zgjidhur përfundimisht pas zgjidhjes së çështjes Gjermane. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes me Italinë, Greqia ruan të drejtat e saj në lidhje me Shqipërinë, derisa të vendosin Ministrat e Jashtëm.

Nëntor 1967

Shqipëria bëhet shteti i parë ateist. Përndjekje të reja ndaj minoritetit grek.

Maj 1971

Me nismë të Greqisë arrihet rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mes Greqisë dhe Shqipërisë.

1984-1988

Prej vitit 1984 dhe deri më 1988 Komisioni i Posaçëm për të Drejtat e Njeriut i OKB-së dënon Shqipërinë për shkelje të të drejtave të njeriut të minoritetit grek. Analoge ishte edhe fryma e raporteve të Ministrisë së Jashtme të SHBA-së, të Parlamentit Evropian (rezoluta e datës 9.4.1983 dhe 9.10.1985) dhe i Amnistisë Ndërkombëtare.

Gusht 1987

Qeveria greke, duke shprehur dëshirën e mirë heq gjendjen e luftës me Shqipërinë, me gjithë atë kushtet e jetesës së minoritetit grek nuk përmirësohen.

Shkurt 1990 - Mars 1991

Rënia e regjimit në Shqipëri. Përndjekje e minoritetit grek dhe ikje drejt Greqisë.

1991-1995

Përndjekje të reja të minoritetit grek duke burgosur udhëheqës të partisë së Omonias, ndjekje, marrje peng kryetarësh këshillash të rretheve etj.

Mars 1996

Marrëveshje Miqësie, Bashkëpunimi, Fqinjësie të Mirë dhe Sigurie që Greqia nënshkroi me Shqipërinë në vitin 1996. “Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të rëndësishëm në jetën e shoqërisë shqiptare dhe është faktor për zhvillimin e miqësisë midis dy vendeve”.

Janar 1997

Përndjekje të reja të komunitetit Grek me pretekst skandalin ekonomik të bankave piramidale.

1997-deri sot

1. Shpërbërja demografike e popullsisë dhe nxitja e emigrimit të brendshëm nga Veriu drejt Jugut,

2. pasiguria përbën për komunitetin Grek një nga arësyet kryesore të largimit drejt Greqisë,

3. venitja e veprimtarisë ekonomike. Rrëmbimet dhe vjedhja e gjësë së gjallë, vjedhja e pajisjeve, pengmarrjet dhe kërcënimet e afaristëve Grekë, nuk lejojnë zhvillimin e sektorit ekonomik të zonës.

4. paralizimi i veprimtarisë së organizmave të minoritetit grek, përjashtimi nga pjesëmarrja në mekanizmat shtetërore. Falsifikim në zgjedhje për përfaqësimin e komunitetit Grek në organet shtetërore.

5. Shkelje e të drejtave speciale që kanë të bëjnë me deklarinimin dhe zhvillimin e identitetit etnik, si arsimimi në gjuhën amtare,

vetpërcaktimi në lidhje me kombësinë, hallkat penguese lidhur me ripërfitimin e kombësisë greke, etj., shkelje të cilat lidhen me shpërbërjen e minoritetit grek si autokton.

6. Shkelja e të drejtave të minoritetit grek, e drejta e vetpërcaktimit, përzgjedhja në administrim, komunikimi i lirë ndërkufitar, ushtrimi i të drejtave speciale nga individit dhe komuniteti, krijimi i shoqatave, pjesëmarrja në jetën e vendit, pjesëmarrja në vendimarrje lidhur me minoritetet, respektimi i përbërjes së popullsisë dhe kufijve të zonave minoritare, krijimi i partive politike, autonomia, të drejtat etnike/kulturore, të drejtat fetare, të drejtat gjuhësore dhe arsimore.

Moszbatimi nga Shqipëria i obligimeve të saj që rrjedhin nga Karta e OKB-së (1945), Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut (1948), si dhe dy Konventat Ndërkombëtare të vitit 1966, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që hyri në fuqi në vitin 1976 dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit (1948), Deklaratën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1963), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965) dhe Deklarata për të Drejtat e Personave që u Takojnë Minoriteteve Etnike, Fetare dhe Gjuhësore (1992), Kartën Evropiane të Gjuhëve Periferike dhe Minoritare (1992) dhe Konventa-Bazë për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike (1995) të Këshillit të Evropës, Akti Final i Helsinkit (1975), Rezoluta Finale e Vjenës (1989), Rezoluta e Kopenhagës për Dimensionin Njerëzor (1990), Karta e Parisit për Një Evropë të Re (1990) dhe Rezoluta e Helsinkit (1992) e OSBE-së, kuadri institucional për mbrojtjen e minoriteteve të Bashkimit Evropian (BE ka nënshkruar me Shqipërinë më 12 qershor 2006, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, si fazë e parë për integrimin e saj).

Shkeljeve të të drejtave të minoritetit grek u referohen edhe raporte të qeverive të huaja (SHBA) dhe të organizmave ndërkombëtare (Amnistia Botërore).

1. Vorioepirotët. Minoritetet autokton grek në Shqipëri

Grekët e Epirit të Veriut ndoshta janë çështja kryesore rreth së cilës u zhvilluan marrëdhëniet greko-shqiptare që nga krijimi i shtetit shqiptar deri më sot. Epeiros ose Apeiros, që është edhe treva e jetesës së minoritetit autokton grek, do të thotë tokë dhe ndoshta është emërtimi që i dhanë zonës banorët e lashtë të ishujve të Jonit¹. Kufijt e Epirit që nga lashtësia mitologjike shtrihen sipas Strabonit nga gjiri i Ambrakisë në Jug deri në lumin e Shkumbinit në Veri, ndërsa Tukididi i vendos në Epidamno², koloni e Korintit (Durrësi i sotëm) dhe nga Deti Jon në Perëndim deri në vargmalin e Pindit në Lindje.

Sipas shkrimtarëve të lashtë dhe atyre Bizantinë Epiri –në mitologji përmendet si motra e Penteas, mbesë e Kadmos dhe e Harmonisë, dhe se mbreti i Tebës, Kadmos, lë frymën e tij të fundit në lumin Drino³, – përbënte trevën e Helenizmit të lashtë. Aristoteli e quan “*Hellada e lashta*”, ndërsa gjeografi më i madh i lashtësisë, Straboni, thotë lidhur me të: “Duke ndjekur dikush këtë rrugë e cila kalon nga Epidamnos dhe Apolonia, në të djathtë të saj janë kombet Epirote që lagen nga deti i Siçelisë deri në gjirin e Ambrakisë, dhe në të majtë malet e Ilirisë, të cilat përshkruam më lart edhe kombet përreth”⁴. Rruga të cilës i referohet Straboni është Egnatia

1. *Odiseja e Homerit*, f. 83, kënga XIV 100, kënga XXI 109.

2. K. Nikollaidhis, *Historia e Epirit të lashtë*, Janinë 1995.

3. K. Dhimitropoulos, *Çështja Epirote*, Selanik, Këshilli i Helenizmit të Diasporës.

4. Straboni *Gjeografika* 7.74.

që ndjek drejtimin e luginës së Shkumbinit. Stefanos Bizantios në veprën e tij “Ethnika” përmend se “Hekateos Milisios liman quan Orikumin e Epirit (koloni eubease në gjirin e Vlorës) në Evropë”, ndërsa Klaudios Ptolemeu “Fillimi i Helladës është në Orikum dhe Hellas e lashtë është Epiri”. Prokopios përmend se “Grekë janë, të quajturit Epirotë, deri në qytetin e Epidamnosit, i cili laget nga deti”⁵. Prokopios (shek. i 6-të), përmend se “Helenët e parë janë të quajturit Epirote deri në qytetin e Epidamnosit, i cili shtrihet në bregdet”⁶.

Sipas Teopombos (shek. i 4-t) fiset epirote ishin 14, Straboni bën fjalë për 11 të tilla, me shumë nëndarje, të gjitha Helene, të cilat morën pjesë edhe në luftën e Trojës⁷. Fiset Epirote ishin Moloset dhe Seloj-Elopaioi (Dodonë)⁸. Tesprotët dhe Kasopet (nga lumi Kalama deri në Ambraki), Kaonet dhe Kestrinët (nga Vlora deri në Kalama), Atamanet, Driopet, *Paravaioi*, *Ambrakiasit*, Atintanët dhe *Parauaioi* (lugina e Vjosës), Timfeasit, Paroraioi, Aitekët, Talarët (Pindo), Agraioi, Apodotitët, Orestët dhe Eordaitët (Voskopojë)⁹.

Mbretërit Epirote mendonin se origjina e tyre ishte nga Eakosi dhe nipi i heroit mitik të Iliadës Akili.

Sipas traditës së tyre lokale, nga i biri i këtij të fundit Pirros (Neoptolemit), lindi Molosi, prijësi i fisit me të njëjtin emër. Në shekullin e 5-të, mbretërit Admitos dhe Taripas bënë

5. Klaudios Ptolemeos Rrëfim Gjeografik, libri C', kap. 13.

6. Prokopios libri V, kap. 15, nr. 24.

7. Iliada e Homerit B 747-750, Odiseja par. 417.

8. Selloi ishin banorët e Dodonës, ku ndodhej edhe Orakulli i famshëm i lashtësisë. Nga fisi Selloi kishin prejardhjen edhe hierofantët e Zeusit. Ky vend i ishte kushtuar kultit të Perëndeshës Gjea dhe më vonë, së bashku me të, edhe kultit të Zeusit dhe Perëndeshës Dionë.

9. Dh. Evangjelidhis, Banorët e lashtë të Epirit dhe studime të tjera, Janinë, botim i Eterisë së Studimeve Epirotë, 1962.

Molosët fis mbizotërues, duke bashkuar rreth e tij të gjitha fiset. Konsiderohet se që këtej e tutje vetëm Molosët kishin mbretëri, ndërsa fiset e tjera kishin “Mbrotjtës të një viti”. Nga fisi i Molosëve kishte prejardhjen Myrtali, e cila më vonë u quajt Olympiada, u martua me mbretin e Maqedonisë Filipo, ndërsa bir i tyre ishte Aleksandri i Madh.

Nga Grekët Jugorë, të parët Heleioi dhe më vonë Korintët në shekullin e 8-të themeluan koloni në brigjet e Epirit, duke ndërtuar qytetet e Apolonisë, Anaktorion, Epidamnos (Durrësi i sotëm), Ambrakinë, ndërkohë që qytete të rëndësishëm konsiderohen Nikopoli, Antigoneia, Apolonia, Butroti, Antipatreia, etj. Gjatë Luftërave Persike, Ambrakiasit dërguan 7 anije dhe 500 ushtarë në Pllataies.

Në shekulin e 6-të, Korinti kishte arritur të siguronte kontrollin ekonomik mbi fiset epirotë. Kjo gjendje u ruajt e pandryshueshme deri në fillimet e luftës së Peloponezitet (431-404 p.K.), kur Molosët me mbretin Taripa u bënë aleatë me Athinasit. Duke qenë faktorë kryesorë Molosët dhe Taripa, nga fundi i shekullit të 5-të u bënë ndryshime rrënjësore si krijimi i vendbanimeve më të mëdha, vendosja e prijësve dhe Kuvendit, prerja e monedhës lokale, hyrja e alfabetit attikas dhe shkrimit. Me nismë të Molosëve më 330 u krijua “Koinon i Molosëve”, lidhja e parë politike e krahinës. Pas largimit me dhunë edhe të Aikidëve të fundit (232 p.K.) dhe vendosjes gjerësisht të Demokracisë, me nismë të Kaonëve u krijua Koinon e Epirotëve (232-168), një lidhje e re, më e gjerë, në të cilën bënë pjesë të gjitha fiset epirotë. Personalitet i madh i Epirit ishte mbreti i Molosëve Pirroja, i njohur për fushatën e tij (shek. i 3-të) në ndihmë të Helenëve të qyteteve greke të Italisë së Jugut. Me daljen në skenë të Pirros dhe mbretërisë së tij, Epiri i lashtë fitoi për herë të parë rrezatim shumë më të gjerë se kufijt e saj. Pirroja bashkoi të gjitha fiset epirote dhe nxori Epirin nga izolimi dhe zgjeroi influencën e tij në

Greqi, u drejtua kundër Romakëve, ndërtoi qytete, urra, tempuj dhe teatro. Fushata e Pirros në Itali dhe më vonë dobësimi i atdheut të tij për sa i përket popullsisë së aftë për luftë, u bë arsyeja e shkatërrimeve të mëdha në të, kur mbritën Romakët fitimtarë pas betejës së përgjakshme të Pydnas¹⁰.

Qytetet e lashta greke më të zhvilluara të Epirit të Veriut ishin Epidamnos, Foiniki dhe Butroti (afër Sarandës), Apolonia (Pojan-Fier), Amantia (Vlorë), Orikumi etj. Madje, sipas mitologjisë, katër të fundit ishin themeluar prej Argonautëve. Grekët e Epirit të Veriut, sikundër edhe Epirotët e tjerë, kishin si qendër fetare Orakullin e Dodonës (buste të Zeusit të Dodonës janë gjetur në të gjithë Epirin e Veriut. Burime të shumta arkeologjike dhe historike tregojnë gjithashtu se merrnin pjesë në Lojërat Olympike, ishin përkushtuar kultit të Dodekatheit, jeta e tyre publike ishte e njëjtë me atë të Grekëve të tjerë –gjimnaze, stadiume, teatro, agore– dhe flisnin gjuhën greke. Më 167 m.K. Epiri u pushtua nga Romakët, me shkatërrime të pallogaritshme të qyteteve dhe kulturës së tij, por pas një shekulli qytetet e tij njohën përsëri lulëzim deri në Antikitetin e Vonët ku shumica u shuan si rrjedhojë e sulmeve. Gjatë periudhës së pushtimit romak, Epirotët pranuan predikimin e Krishterizmit. Deri në shek. e 2-të m.K. i gjithë Epiri pranoi fenë e re dhe shtoi në listën e shënjtoreve të krishterë shënjtoret e tij, midis tyre edhe Vorioepirotë, si Shën Asteios, Shën Dhonatos, Shën Ermias etj.

Më vonë, kur Epiri i Veriut u përfshi në sundimin bizantin, filloi të lulëzojë arti fetar, me ndikime të dukshme në ndërtimin e kishave dhe në ikonografi, ku mbishkrimet në të gjitha rastet janë greke. Pas pushtimit të Konstandinopolit prej Latinëve,

10. K. Vakallopoulos, *Historia e Helenizmit të Veriut Epiri*, Selanik, bot. Adhelfi Qirjaqidhi 1992.

më 1204, prej Mikael Angjello Komninoit u krijua Despotati i Epirit, duke u bërë rojë e Perandorisë Bizantine dhe bazë për dëbimin e Latinëve. Despotati përfshinte edhe Epirin e Veriut deri në Durrës.

2. Epiri i Veriut gjatë pushtimit turk

Rreth mesit të shek. të 15-të Epiri pushtohet nga Otomanët. Në të njëjtën periudhë Otomanët përpiqen të pushtojnë edhe Shqipërinë. Prijësi i shquar i rezistencës së popullsisë ishte Gjergj Kastrioti ose Skënderbeu, i cili është heroi kombëtar i Shqipërisë. Ndërkohë, nuk është e sigurt në se origjina e tij është shqiptare, pasi ekzistojnë shumë të dhëna se është Grek. Biografi i Ali Pashës, Ahmet Myfiti, shkruan se “më 1443 dezertoi nga kampi otoman i Moravës prijësi Grek Kastriotis”. Marin Barleti, biografi i parë i heroit, e quan “Princ Epirot” dhe “Prijës të Epirotëve”. Vet Kastrioti ka thënë se “Paraardhësit tanë ishin Epirotë, prej të cilëve rrjedh ai Pirroja, hovin e të cilit Romakët po saqë munden ta përballojnë”¹¹. Gjatë nënshtrimit shumëshekullor tek Otomanët-Turq, mbështetja e Grekëve ishin Manastirët, të cilat funksionuan jo vetëm si qendra fetare, por edhe si shkolla për mësimin dhe artet. Për të mbijetuar popullsia greke dha ndihmesën e vet edhe kleri, i cili u përpoq shumë për të penguar islamizimin masiv, nënshtrimin, vjedhjet, rrëmbimet dhe krijimin e vendbanimeve përmes lëvizjeve të popullsisë me synim ndryshimet demografike. Gjatë sundimit turk u zhvillua veprimtari intelektuale në shumë qytete të Epirit të Veriut, ku funksionuan biblioteka, shkolla dhe institucione kulturore. Mes tyre shquhet Voskopoja, e cila në shek. e 18-të u zhvillua si qendër kulmore e kulturës helenike. Në atë “Athinë të Veriut”, siç u quajt, u themelua “Mësonjëtorja Greke” (Elinikon Frondistirion), që më vonë ndryshoi emrin

11. N. Hamod, *Epiri*, Athinë 1985.

në “Akademia e Re” (p.sh., Nea Akadhimia). Gjithashtu, aty funksionoi shtypshkronjë greke, e dyta në territor grek pas asaj të Konstandinopolit. Së fundi, banorët e Voskopojës morën pjesë aktive në lëvizjen e vitit 1770, e quajtura “Orlofike” dhe përjetuan egërsinë e hakmarrjes.

Gjatë periudhës së pushtimit otoman, numërohen 30 lëvizje kryengritëse në Epirin e Veriut. Gjithashtu, Vorioepirote morën pjesë në betejën detare të Nafpaktos (1571), në lëvizjen e Dhionisiut Filozofit (1611) dhe në Orlofika (1770). Së fundi, në pragun Revolucionit të 1821-it ishin regjistruar në Filiki Eteria 30 anëtarë nga Epiri i Veriut.

Me shpërthimin e Revolucionit Grek të vitit 1821, Vorioepirotët erdhën në ndihmë të vëllezërve të tyre Grekë dhe njëkohësisht të luftojnë për lirinë e tyre. Përpjekja e parë për mobilizim të përgjithshëm dhe për revolucionin kundër sundimit turk u bë në vitin 1821 kur banorë të Himarës u përpoqen të nxisin të gjithë Epirotët për të luftuar edhe ata sikundër luftëtarët e tjerë të 1821-it. Përmasa të tilla masive kishte edhe lëvizja e vitit 1854 kur Epirotët u përpoqen të shfrytëzojnë luftën rusoturke, që të fitojnë lirinë e tyre duke patur si perspektivë të afërt bashkimin me Greqinë.

Qeveria e parë greke dhe më vonë udhëheqësi i saj i parë Ioanis Kapodhistrias, nuk veçonin Epirin e Veriut nga Greqia sikundër e ëndërronte. Por Vorioepirotët, me gjithë burimet e tyre të pakta, vazhdojnë të luftojnë për lirinë e tyre, duke derdhur gjak (1854, 1878). Në të njëjtën kohë, Vorioepirotë të pasur kontribuojnë pa mëdyshje shtetin grek të sapoformuar dhe ndihmojnë në mëkëmbjen e tij (Ap. Arsaqis, vëllezërit Sina dhe vëllezërit Zapa, etj.).

3. Formimi i shtetit shqiptar dhe minoriteti etnik grek

Shteti Otoman në rënie në pamundësi për të ruajtur zotërimet e tij në Ballkan dhe për të penguar ndarjen e tyre midis shteteve ortodokse ballkanike sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Shën Stefanit (Mars 1878), synoi formimin e shtetit Shqiptar duke i dhënë për herë të parë dimension kombëtar faktorit shqiptar. Një ditë para Kongresit të Berlinit, me nxitjen dhe tolerimin e Turqve por edhe me ndihmën e Italisë, u krijua në Kosovë “Lidhja Shqiptare për të Drejtat e Kombit Shqiptar”. (“Lidhja e Prizrenit”) me në krye familjen Frashëri¹² me qendër Konstandinopolin e cila shkallë shkallë zgjeroi veprimtarinë e saj deri në Janinë dhe në Prevezë. Në Kongresin e Berlinit (Korrik 1878) që u zhvillua menjëherë pas saj, përfaqësuesit e Lidhjes u paraqiten për herë të parë si vëzhgues. Në kuadrin e politikës së përkruar më lart, Lidhja e Prizrenit kërkoi nga shteti otoman bashkimin e të gjitha “tokave shqiptare” që deri atëhere ishin të ndara në Vilaetet (rrethe) e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës në një Vilaet “të pavarur” nën sundimin e Portës së Lartë. Në këtë fazë konkretizohet tash më edhe “nacionalizmi shqiptar” dhe shprehen më së pari pretendimet për krijimin e kombit dhe shtetit shqiptar.

Humbja e Perandorisë Otomane më 1912 prej lidhjes Ballkanike çliroi Epirin e Veriut (dhjetor 1912 - mars 1913).

12. *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, Athinë, bot. Botime Historike, 1976, f. 123.

Memorandumi i Ministrisë së Jashtme të Greqisë më¹³ qershor 1912, thekson se i takojnë Epirit dhe më gjerë Greqisë gjithë trevat e Prevezës, Igumenicës, Janinës, pjesa më e madhe e qarkut të Gjirokastrës dhe gjysma e qarkut të Vlorës, nisur nga vija e Kurveleshit dhe Këlcyrës deri në Vjosë. Sipas memorandumit Shqipërisë i takonin të plota krahina e Shkodrës dhe zona e Beratit.

Synimet e Greqisë hasën në reagimin e fortë të Italisë dhe Austrohungarisë, dy fuqi me synime në Ballkan, të cilat nuk ishin dakort me krijimin e shteteve të mëdha dhe të fuqishme në rajon, të cilat do të binin ndesh me realizimin e synimeve të tyre. Me mbështetjen e Austrisë por edhe të Italisë, në dhjetor të vitit 1912, pasi më parë ishte formuar në Vlorë “Asambleja Kombëtare” me në krye deputetin e parlamentit otoman, Ismail Qemalin¹⁴, Fuqitë e Mëdha njohën shtetin Shqiptar dhe më 1913 (17-30 maj) Fuqitë e Mëdha nënshkruan në Londër vendimin për krijimin e shtetit të pavarur Shqiptar¹⁵, duke e patur nën mbrojtjen dhe mbikqyrjen e tyre të ngushtë¹⁶. Gjatë diskutimeve përgatitore (Konferenca e Ambasadorëve) përfaqësuesit Shqiptarë të qeverisë së përkohshme paraqiten

13. S. Laskari, *Historia Diplomatike e Evropës, 1814-1914*, Athinë, 1936, f. 335 dhe P. Pipineli, *Historia e Politikës së Jashtme të Greqisë, 1923-1941*, Athinë, bot. Saliveru, 1948, f. 57-74. Shih edhe veprën e po këtij autori për Shqipërinë, P. Pipinelis, *Europe and the Albanian question*, Chikago, Argonautic inc, 1963.

14. Castellan G., *Historie des Ballkanas*, Paris, Librairie Artheme Fayard, 1991, f. 425.

15. I. Dimitrakopulos, *Kufijt tokësorë të Greqisë*, Selanik, Instituti i Studimeve të Gadishullit Ballkanik, 1991, f. 63. Për krijimin e shtetit Shqiptar dhe çështjen vorioepirote shih edhe H. Pituli - Kitu, *Marrëdhëniet greko-shqiptare dhe çështja vorioepirote gjatë periudhës 1907-1914*, Athinë, bot. Olkos, 1997.

16. A. Korandi, *Historia diplomatike e Evropës*, Selanik, 1968, f. 97-2006.

pretendime që përfshinin gjithë Kosovën, zonat e Shkupit dhe të Manastirit që zotëroheshin nga Serbia dhe në Jug, zonën në veriperëndin të Kosturit, në lindje të Mecovos deri në gjirin e Ambrakisë, d.m.th. zonën e “Vilaetit të Janinës”, kërkesa që ishin paraqitur nga Lidhja e Prizrenit më 1878¹⁷. Kufijt e shtetit të ri u vendosen me protokollin e Firencës (17 dhjetor 1913)¹⁸, përmes të cilit Vorioepiri u përfshi në Shqipëri. Që atëhere termi Vorioepir përmendet për zonën nga lumi Shkumbin deri në kufijt greko-shqiptarë, me drejtin nga veriu në jug. Absurditeti i këtij vendimi nuk konsiston thjesht në faktin se iu dha Shqiptarëve një krahinë (Vorioepiri) duke injoruar plotësisht të dhënat demografike. Kur Epiri i Veriut iu dha Shqipërisë, shumica e banorëve ishin Grekë dhe madje autoktonë. Të dhënat numerike paraqesin interes. Afërsisht pas 500 vjetësh pushtimi shqiptaro-turk dhe islamizimi, Epiri, Verior dhe Jugor, në fillimet e shekullit të 20-të, ende ishte grek. Në një regjistrim turk të popullsisë më 1908, nga 500.000 banorë të Epirit 380.000 deklaruan se janë të Krishterë Grekë. Nga një statistikë tjetër rezultoi se më 1907 në të gjithë Epirin banonin 452.000 banorë prej të cilëve 297.000 ishin të krishterë dhe 155.000 myslimanë¹⁹. Disa vjet më vonë, më 1914, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit Etnologjik, paraqiti të dhëna që vërtetnin epërsinë numerike –dhe madje dërrmuese– të

17. A. Puto, *L' independance Albanaise et la diplomatie des grandes puissances*, Tiranë 1982, f. 268.

18. S. Pollo - A. Puto, *Historia e Shqipërisë*, (përkth. M. Akcoglu), Selanik, bot. “Ekdotiçi Omadha”, x.x., f. 210, A. Tunda-Fergadhi, *Çështje të historisë diplomatike (1912-1934)*, Selanik 1989, f. 53-54, V. Kondis, “Çështja epirote dhe vendosja e kufijve”, në Procesverbale të Kongresit, Marrëveshja e Bukureshtit dhe Greqia, Selanik, bot. Instituti i Studimeve të Gadishullit Ballkanik, 1990, f. 64.

19. *Geografica de Agostini*, Roma 1907.

popullsisë greke në Epirin e Veriut. Paraqesim vetëm katër prej zonave që inspektoi Komisioni për Grekët dhe Shqiptarët e regjistruar, përkatësisht: Korça 12.500/3.000, Himara 1.000/0, Delvina 1.700/600, Voskopoja 1.500/0. Akoma edhe në ato pak zona ku mbizotëronte elementi shqiptar (Tepelenë, Ohër, Elbasan), grekët përbënin 35% të popullsisë.

Me gjithë këtë, Protokollit i Firencës u zbatua. Ushtria Greke u detyrua të braktisë Epirin e Veriut dhe u obligua se nuk do t' u lë armë Voriepirotëve dhe nuk do të nxisë reagime kryengritëse²⁰. Greqia, sipas protokollit, u detyrua të tërheqi (fillim 1914) ushtrinë e vet nga Vorioepiri brenda një afati kohor të përcaktuar. Kryeministri i Greqisë Eleftherios Venizellos nuk kishte rrugëzgjdhje tjetër veçse të pranonte vendimet e Fuqive të Mëdha, pasi do të rregulloheshin njëkohësisht kufijt e Epirit dhe çështja e ishujve të Egjeut, të cilat do t' i merrte Greqia, përveç Imvros dhe Tenedos. Por këta ishuj do t' i zotëronte realisht, vetëm kur ushtria greke do të largohej nga Vorioepiri. Kundërshtimi i Greqisë ndaj shtetit të ri dhe krijesve të tij konsistonte në faktin se Fuqitë e Mëdha përfshinë në të Vorioepirin. Duke përballuar këtë fakt, Greqia synonte që shteti i ri të përfshijë sa më pak Grekë dhe në vijim të jipeshin garanci për dimensionin e Grekëve të përfshirë në të. Duhet theksuar se faktorë vendimtarë për përcaktimin e kufijve të Epirit ishin: mospranimi i Austrisë që Serbia të ketë dalje në Adriatik dhe këmbëngulja e Rusisë të marrë Beogradin si shkëmbim për Kosovën. Kështu, që në momentin që Kosova iu dha Serbisë, ishte e pamundur që Greqia të merrte Vorioepirin, pasi Fuqitë e Mëdha besonin se pa të ishte e dyshimtë nëse Shqipëria do të bëhej shtet i qendrueshëm.

20. V. Kondis, *Helenizmi i Vorioepirit dhe marrëdhëniet greko-shqiptare: vëllimi 1 (1897-1918)*, vëll. 2 (1919-1921), Athinë, bot. Estia, 1995.

Ndërkaq, pa u realizuar ende largimi i ushtrisë greke nga Vorioepiri, përfshi gadishullin e vargmalit Akrokerauna (p.sh., Malet e Vetetëtimës), Vlorën, zonat e Gjirokastrës dhe Korçës (13 shkurt 1914), Konferenca Panepirote në Gjirokastrë formoi qeveri të përkohshme me kryeministër ish Ministrin e Jashtëm të Greqisë Jeorjio Hr. Zografon dhe vendosi që të kërkojë nga Fuqitë e Mëdha dhe nga Shqipëria autonomi vendore. Kështu Grekët e krahinës formuan bashkësinë e pavarur të Epirit Autonom (17 shkurt 1914)²¹. Bashkësia e pavarur u ligjërue me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit (17 maj 1914), i cili jipte autonomi të plotë (arsimore, fetare, gjyqësore, administrative) rretheve të Gjirokastrës dhe Korçës, njihte helenizmin e Vorioepirit, përcaktonte se banorët e tij do të quhen Epirote dhe jo Shqiptarë dhe u nënshkrua nga Shqipëria dhe gjashtë Fuqitë e Mëdha (Sh.B.A., Franca, Anglia, Austro-Hungaria, Gjermania dhe Rusia)²².

Ndërkohë, mbreti Gulielm von Vid (Wilhem von Ved), të cilin e zgjodhën Fuqitë e Mëdha për Shqipërinë²³, braktisi vendin dhe si pasojë u krijua anarki. Në këtë kohë ushtria Greke, me kërkesë që Venizellos u drejtoi Fuqive të Mëdha, në Tetor të vitit 1914 rimori Vorioepirin. Aty nga mesi i tetorit 1914 ushtria Greke hyri në Përmet, në Gjirokastrë dhe në

21. A. Papatheodoru, *Lufta e Vorioepirit për autonomi 1914*, Athinë, bot. Tinos, 2004, K. Skënderi, *Lufta e Vorioepirit (1914)*, Athinë 1929, P. Dhelia, *Lufta e Vorioepirit 1914-1915*, Athinë 1933, G. Dhrinu, *Kronikë e Luftës së Vorioepirit 1914*, Athinë 1966.

22. V. Papadhakis, *Historie Diplomatique Nord-Epirote, 1912-1957*, Thesaloniki 1958, f. 37.

23. Konturimi kushtetues dhe ekonomik i shtetit të ri u krye nga një komision i Fuqive të Mëdha dhe nga një përfaqësues Shqiptar. Ushtrinë e organizuan oficerë Hollandezë dhe princi Gjerman Gulielm de Vid (Wilhem de Ved) u caktua mbret i ri, i cili dha shpejt dorëheqje. M. Nystazopullu-Peleqidhu, *Popujt e Ballkanit*, Selanik, bot. Vnias, f. 294.

Korçë. Më 24 tetor 1914 u kurorëzua dorëzimi i Vorioepirit tek ushtria Greke dhe qeveria e Jeorjiu Zografos dha dorëheqje.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Londrës (prill 1915) udhëheqja e Shqipërisë paraqiti synimet e saj politike: sigurimin e pavarësinë së Shqipërisë sikundër ishte shpallur në nëntor të vitit 1912, ruajtjen e integritetit tokësor të shtetit shqiptar sikundër ishte përcaktuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës dhe përfshirjen në kufijt e shtetit e të gjitha krahinave shqiptare që ishin lënë jashtë, si rezultat i vendimeve të Fuqive të Mëdha.

Athina pasi vendosi sigurinë, rendin dhe bashkëpunimin me popullsinë e Vorioepirit, lejoi grekët Vorioepirotë të dërgojnë më 11 janar 1916 përfaqësues në Parlamentin Grek. Ndërkaq, kur qeveria Greke në mars të vitit 1916 me Dekret Mbretëror shpalli zyrtarisht bashkimin e vorioepirit me mbretërinë Greke, Roma shprehu pakënaqësinë dhe reagoi në mënyrë të tillë që Fuqitë e Mëdha të detyrojnë Athinën të ndalojë pjesëmarrjen e mëtejshme të Vorioepirotëve në parlamentin Grek.

Tërheqja e ushtrisë greke i dha rastin ushtrisë italiane që të kontrollojë gjithë Shqipërinë përveç Korçës, e cila u vu nën komandën franceze. Në kuadrin e negociatave të vazhdueshme midis fitimtarëve të luftës për ndarjen e tokave, Venizellos mposhti kundërshtimet italiane për synimet e Greqisë ndaj Vorioepirit dhe më 29.07.1919 u nënshkrua Marrëveshja Venizellos-Titoni, sipas së cilës Korçën dhe Gjirokastrën i merrte Greqia²⁴, fakt të cilin e pranoi me rezolutë (17.05.1920) edhe Senati i Sh.B.A., të cilën e paraqiti Senatori Andrew Loge. Por përmbajtja e marrëveshjes u përmbys shumë shpejt. Më 28.05.1920 u nënshkrua Protokollin i Kapshticës sipas të cilit Greqia dhe Shqipëria ranë dakort për përcaktimin e

24. E. Rukunas, *Politika e Jashtme, 1914-1923*, Athinë 1983, f. 303.

menjëhershëm dhe përfundimtar të vijës kufitare, ndërsa Shqipëria obligohej për respektimin e të drejtave arsimore të minoritetit grek²⁵.

Kongresi i Lushnjës më 1920 shpalli përfundimisht pavarësinë e Shqipërisë me kryeqytet Tiranën. Në dhjetor 1920, Shqipëria u bë anëtare e Ligës së Shteteve dhe anëtarësia e saj u lidh me obligimin e njëanshëm të saj për mbrojtjen e minoriteteve në territorin e saj, obligim ky që përfshihej në kuadrin më të gjerë të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve që përcaktonte Liga e Shteteve. Përfaqësuesi i Shqipërisë, Fan Noli (Theofanis Mavromatis), paraqiti Deklaratën e njëanshme të datës 2.10.1921 me të cilën Shqipëria u obligua për mbrojtjen e minoriteteve në territorin e saj, deklaratë të cilën e miratoi parlamenti shqiptar më 17 shkurt 1922. *Deklarata e njëanshme e vitit 1921 përbën themelin për njohjen ligjore të minoritetit grek dhe dhënien e të drejtave*²⁶. Greqia nga ana e saj pas rregullimit të kufijve²⁷, synoi me të gjitha mënyrat bashkëpunimin greko-shqiptar. Më 1926 u nënshkruan marrëveshje tregtare, marrëveshje të tjera për çështje kombësie dhe një Traktat për ekstradimin e personave të shpallur në kërkim. Qeveritë shiptare në vitet që pasuan nuk ishin të fuqishme dhe për këtë nuk ndërmerrnin reforma, deri sa më 1924 erdhi në skenë Ahmet Bej Zogoli (Zogu), i cili me ndihmën e forcave serbe dhe bjelloruse përmbysi qeverinë e

25. V. Kondis, "The Albanian question at dhe beginning of dhe 1920 and dhe Grec Protocol of Kapestica", *Balkan Studies*, 20, (1979), f. 393-416.

26. K. Ciceliqis, D. Kristopullos, (përmb.), *Minoriteti grek në Shqipëri*, Athinë, bot. Kritiqi, 2003, f. 25.

27. Në nëntor të vitit 1921 në Konferencën e Ambasadorëve kur u përcaktuan kufijt greko-shqiptare sipas vijës së Protokollit të Firencës (1913), përfaqësuesi i Shqipërisë deklaroi se respektonte të drejtat e popullsisë Greke.

Fan Nolit, më 1925 u shpall President i Republikës Shqiptare dhe më 1928 Mbret i vendit me emrin Zogu A' ²⁸. Gjatë viteve të Ahmet Zogut u vendosen marrëdhënie të ngushta me sistemin fashist të Musolinit në Itali²⁹. Për sa u përket marrëdhënieve me Greqinë, Shqipëria, me gjithë obligimet e saj ndërkombëtare, që në momentet e para filloi të zbatojë sistematikisht një program antihelen dhe ndjekjesh. Si rezultat i kësaj politike gjatë periudhës 1920-1938 u shtua emigrimi jashtë Shqipërisë me destinacion kryesor SH.B.A.

Qeveria shqiptare lejoi të funksionojnë shkolla greke vetëm në zonat ku u njoh zyrtarisht ekzistenca e popullsisë greke dhe ndaloi mësimin e gjuhës greke në të gjitha zonat e tjera shqipfolëse. Deri atëhere arsimit nuk ishte i qendrueshëm ngaqë iu nënshtrua ndikimeve të arsimit grek, italian dhe otoman³⁰. Synimi ishte të ndalohet arsimit privat dhe të imponohet monopoli absolut shtetëror, fakt i cili përbënte shkelje flagrante të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Në kundërshtim me shkollat e shumta greke që funksiononin në fshatrat ortodokse të Shqipërisë së Jugut, shkolla e parë shqipe në jug filloi të funksionojë më 1887 në Korçë. Shkollat ortodokse greke u ruajtën edhe pasi Shqipëria fitoi pavarësinë më 1913. Ndërkaq, me gjithë përpjekjet e qeverisë greke, pala

28. B. Fischer, *Kiing Zog and dhe struggle for stability in Albania*, New York, 1984.

29. E. Manta, "Peciprocal Relationship between politics and economics: the renewal of the 1926 Treaty of Tirana", *Balkan Studies*, 37, 1996, 309-330. E. Manta, "The economic recession in Albania and Italian infiltration: The loan of 1931", *Balkan Studies*, 36 (1995), f. 265-296. P. Milo, "The Balkan Entente", *Balkan Studies*, 39, (1998), f. 91-122.

30. Duhet theksuar se Shqipëria deri më 1908 nuk kishte alfabet kombëtar dhe gjuha shqipe shkruhej me shkronja greke ose latine. Poeti kombëtar i Shqipërisë N. Frashëri shkruante greqisht dhe vetëm më 1926 u përkthye në gjuhën shqipe.

shqiptare, duke shkelur marrëveshjet ndërkombëtare, mori një sërë masash kufizuese për funksionimin e shkollave greke³¹. Në shkresën e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë drejtuar Ligës së Shteteve (22 gusht 1922) thuhej se zbatimi i detyrimeve të Shqipërisë ka të bëjë, përveç minoriteteve fetare, me minoritetin ortodoks grekofon. Në atë periudhë shteti shqiptar me shpenzimet e veta mban 36 shkolla minoritare grekofone të cilat kishin 2.614 nxënës. Ndërkohë, në shumicën e rasteve, administrimi i shkollave rëndon vet minoritetin (shkolla komunitare), të cilin Greqia e mbështet drejtpërsëdrejti. Në vijim qeveria shqiptare pushoi mësues Grekë që nuk dinin gjuhën shqipe dhe i zëvendësoi me shqipfolës të emëruar nga shteti dhe kufizoi orët e mësimit të gjuhës greke. Gjithashtu të gjitha godinat e shkollave greke që ndodheshin në zona që nuk u njohën si minoritare u shndërruan në shkolla shqipe. Në kushtetutën e vitit 1928 parashikohej se arsimit fillor do të merrej vetëm në shkollat shtetërore dhe do të ishte i detyruar, ndërsa komunitetet fetarë do të kishin të drejtë të çelnin³² shkolla vetëm me leje të Ministrit të Arsimit. Që në vitin 1930 shkollat greke fillojnë të përballojnë vështirësi në funksionimin e tyre, pasi qeveria shqiptare ndalon komunitetet fetare të pranojnë ndihmë ekonomike nga shtetet e huaja. Në vitin 1914 shkollat ishin 160, më 1927 mbeten 70, më 1931 ishin 40, më 1933 vetëm 10 dhe më 1934 u ndaluan të gjitha³³.

Në prill të vitit 1933 Ministria e Arsimit e Shqipërisë vendosi

31. A. Lekkas, *Histori e shkurtër e Vorioepirit*, botim i 2-të, Athinë, bot. PASIBA, 1991 dhe G.Gjizelis, *Çështja Vorioepirote. Analizë dhe kritikë e ngjarjeve historike dhe e politikës së jashtme greke*, Athinë, bot. K.E.B.A., 1992.

32. B. Gorxi, “Greqia është e detyruar të mbrojë Vorioepirotët nga shovinizmi shqiptar”, *Hepeiros*, 1.11.1927.

33. D. Mihallopoulos, *Çamët*, Athinë, bot. Arsenidhis, 1992, f. 125.

që arsimi fillor të jetë i detyruar dhe falas për të gjithë shtetasit e saj, por edhe të mbyllen të gjitha shkollat private/komunitare (të fesë heleno-ortodokse, katolike sunite dhe bektashiane, si dhe shkolla private shqiptare, gjithsej 67 shkolla, prej të cilave 10 greke) duke zbatuar dispozitat përkatëse të Kushtetutës së vitit 1928. Këto masa shkaktuan reagimin e minoritetit grek, ndërsa Greqia paraqiti notë proteste në Ligën e Shteteve. Këshilli i Ligës së Shteteve përcolli çështjen për gjykim në Gjykatën e Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare. Gjykata shqyrtoi përmbajtjen “e administrimit dhe dhënien e garancive juridike dhe reale”, të cilat Shqipëria ishte e detyruar t’u siguronte anëtarëve të minoriteteve dhe u shpreh se përdorimi i diferencuar ofrohet si zgjidhje alternative dhe se nuk duhet t’u imponohet minoriteteve, të cilat duhet të kenë në fund të fundit mundësinë për të zgjedhur midis masave të ndryshme³⁴. Gjykata Ndërkombëtare gjatë shqyrtimit të çështjes gjykoi se Shqipëria shkeli detyrimet e saj që rridhinin nga Deklarata e Njëanshme³⁵. Nga ana tjetër, Shqipëria u përpoq të justifikojë masat që mori për sistemin arsimor, duke paraqitur pretendime të ndryshme³⁶. Këshilli i Ligës së Shteteve përcolli çështjen në Gjykatën e Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare dhe kërkoi mendimin e saj. Gjykata shqyrtoi përmbajtjen “e administrimit dhe dhënien e garancive, juridike dhe reale” që Shqipëria ishte e detyruar t’u siguronte anëtarëve të minoriteteve dhe u shpreh se përdorimi i diferencuar ofrohet si zgjidhje alternative dhe se nuk duhet t’u imponohet minoriteteve, të

34. Permanent Court of International Justice, *Minority Schools in Albania*, Advisory Opinion of 6 April 1935, Series A/B, No. 64, f. 20.

35. Më 1939 funksiononin 74 shkolla greke me 5.254 nxënës dhe 141 mësues.

36. Teksti i plotë, G. Papadhopullos, *Minoriteti etnik grek në Shqipëri dhe çështja e saj arsimore*, Janinë 1981, f. 89-96.

cilat duhet të kenë në fund të fundit mundësinë për të zgjedhur midis masave të ndryshme³⁷. Gjykata Ndërkombëtare gjatë shqyrtimit të çështjes gjykoi se Shqipëria shkeli detyrimet e saj që rridhinin nga Deklarata e Njëanshme dhe u shpreh se minoriteti grek ka të drejtë të çelë lirshëm dhe të ketë shkollat e tij dhe për rastet që nuk ka fonte të japi shteti shqiptar³⁸. Atëhere, kryeministri i Shqipërisë, M. Frashëri, më 23 gusht 1935 i deklaroi Ligës së Shteteve se pranon kushtet dhe merr përsipër detyrimin që t' i respektojë ato. Që atëhere filloi përsëri funksionimi i shkollave greke të Vorioepirit, veçanërisht në zonën e Gjirokastrës dhe të Himarës, por në shkallë shumë të kufizuar.

Në fund të kësaj periudhe Italia ndërhyr edhe ushtarakisht në Shqipëri, kur në prill të vitit 1939 forca ushtarake italiane zbarkuan në Shqipëri dhe e pushtuan. Ahmet Zogu iku në Greqi, ndërsa një vit e gjysëm më vonë Lufta Italo-Greke (1940-1941) çoi përsëri forcat ushtarake Greke në Vorioepir, nga ku u tërhoqen në prill të vitit 1941 pas sulmit gjerman kundër Greqisë.

37. Permanent Court of International Justice, *Minority Schools in Albania*, Advisory Opinion of 6 April 1935, Series A/B, No. 64, f. 20.

38. Më 1939 funksiononin 74 shkolla greke me 5.254 nxënës dhe 141 mësues.

4. Politika shqiptare dhe minoriteti etnik grek gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore

Pas ikjes së Mbretit Zog dhe pushtimit e vendit nga Italianët dhe Gjermanët, në brendësi të Shqipërisë krijohet situatë e re. Një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare aspiron realizimin e synimeve kombëtare dhe bashkëpunon për pushtimin e Kosovës, të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Greqisë, ndërsa një pjesë tjetër lufton për krijimin e kushteve për rrezistencë. Të parët mbledhen rreth Ballit Kombëtar, ndërsa të tjerët rreth grupeve të ndryshme me orientim komunist³⁹. Në këtë kuadër vihen re edhe shumë kontradikta midis dy fiseve zotëruese në Shqipëri, ku rrezistenca kundër fuqive të Aksit merr karakter fisnor dhe jo ideologjik. Për shembull shumica absolute e anëtarëve të Partisë Komuniste ishte nga Jugu, Toskë, ndërsa shumica e Gegëve, të cilat krijuan organizatën antikomuniste Balli Kombëtar, në fillim mbështetnin Italianët dhe Gjermanët dhe, në vijim, deshen të thyejnë monopolin e Komunistëve, duke organizuar veprimtarinë e tyre të rrezistencës⁴⁰.

Me forcimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, grupet

39. M. Vickers, *Shqiptarët*, Athinë, bot. Odysseas, 1997, f. 45 dhe B. Zogu, *Pozicioni i Shqipërisë në këtë luftë*, Athinë 1945, f. 18-25.

40. Lidhur me Partinë Komuniste Shqiptare shih P. Lendvai, *Eagles in Cobwebs, Nationalism and Communism in the Balkans*, London, 1969, f. 180-190. Lidhur me qëndrimin e Gegëve duhet theksuar se përplasja e tyre me Partinë Komuniste nuk kishte karakter antimarksist por karakter shovinist e përfshirë në kontradiktat Veri-Jug. M. Hasluk, "The Muslims of Albania", *Contemporary Review*, (cxxvii), (1925), f. 54-65.

komuniste të Shqipërisë –grupi i Shkodrës i themeluar nga Ali Kelmenti dhe i Korçës nën drejtimin e Enver Hoxhës⁴¹– shkrihen në një organizatë të vetme, tek Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH), e cila u themelua më 8 nëntor 1941, me synim “pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe qeverinë demokratiko-popullore në një Shqipëri të lirë nga fashizmi”⁴². E. Hoxha zgjidhet sekretar i komitetit të përkohshëm prej shtatë anëtarësh dhe në shtator 1942 (Konferenca e Pezës) P.K.SH. organizon Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar. Deri në fund të korrikut 1944 Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Ushtria Nacionalçlirimtare⁴³ mbizotëruan dhe bashkëpunojnë me lëvizje të tjera ballkanike me orientin komunist⁴⁴. Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar zgjedh (Kongresi i Përmetit) Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar me attribute të qeverisë së vendit, dhe E. Hoxha bëhet Kryetari i Këshillit dhe Komandant Suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Më 23 tetor 1944 Këshilli Antifashist shndërrohet në Qeveri të Përkohshme të Shqipërisë dhe E. Hoxha bëhet kryeministër. Më 17 nëntor 1944 çlirohet Tirana dhe njëmbëdhjetë ditë më vonë në fjalën e tij drejtuar popullit të kryeqytetit, E. Hoxha i referohet domosdoshmërisë së reformës agrare⁴⁵ dhe shtetëzimit

41. E. Dules, *Shëmbja e tiranisë, A' -B'*, Athinë, bot. Euklidhis, 1994, f. 78.

42. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, f. 72. Gjithashtu duhet theksuar se një pjesë e popullsisë shqiptare mori pjesë dhe përkrahu marrjen e Kosovës, një pjesë të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë, duke u përpjekur për realizimin e synimit të Shqipërisë së Madhe. Madje në Kosovë Gjermanët krijuan Divizionin Skënderbeu, i cili veproi në atë krahinë jugosllave.

43. E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 2-të, Tiranë, 1973, f. 416.

44. E. Hoxha, *Dy popuj miq*, f. 316.

45. Reforma Agrare u mbështet në ligjin e datës 29 gusht 1945, i cili u jipte ish pronarëve të tokës të drejtën për grumbullimin e taksave. Me ndryshimin e kryer në maj të 1946 u krye shpronësimi i detyruar i përgjithshëm

të burimeve dhe infrastrukturës, dhe nënvizon se “qeveria demokratike do t’ i sigurojë minoritetit grek liritë dhe të drejtat demokratike dhe etnike për të cilat djemtë e minoritetit luftuan heroikisht në brigadat nacionalçlirimtare”⁴⁶. Por këto obligime nuk u bën asnjëherë realitet.

dhe dhënia 50 dynym tokë çdo familjeje. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se kooperativa e dytë bujqësore në Shqipëri u formua më 1946 në Zervat, fshat minoritar grek.

46. E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 2-të, bot. i 2-të, Tiranë, 1984, f. 4612.

5. Vendosja e sistemit komunist, Lufta e Ftohtë dhe minoriteti etnik Grek

Në dhjetor të vitit 1944 u zhvilluan zgjedhjet për në Kuvendin Popullor, por në to mund të merrnin pjesë vetëm kandidatët e Frontit Nacionalçlirimtar, tani Fronti Demokratik. Paralelisht komunistët veprojnë shpejt që të konsolidojnë forcën e tyre, ndërsa mijëra kundërshtarë të tyre përballojnë akuzën e kriminelit të luftës apo të armikut të popullit dhe pushkatohen, midis tyre edhe dhëndri i E. Hoxhës, Bahri Omari. Madje, gjatë dy javëve të para të qeverisë së re u pushkatuan më shumë se 600 antikomunistë ose të akuzuar si të tillë, ndërsa deri në gusht të vitit 1945 ishin burgosur 1.600 kundërshtarë të sistemit, u dënuan me vdekje 115 dhe 125 me burgosje shumëvjeçare. Shumë dënoheshin me punë të detyruar në vepra brenda vendit, midis tyre edhe shumë nga minoriteti grek, ndërsa prona e kundërshtarëve politikë dhe e shtetasve të huaj u shtetëzua. Në shkurt të vitit 1946 dënohen me vdekje iniciatorët e organizatës Bashkimi Shqiptar që drejtohej kundër politikës së Enver Hoxhës, e organizuar një vit më parë me synim të vetëm bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Rolin kryesor e ka policia sekrete, Sigurimi, dhe përveç Partisë Komuniste, të gjitha partitë politike ndalohen me ligj dhe komunistët monopolizojnë pushtetin, pasi në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, Fronti Demokratik i mbështetur nga Partia Komuniste Shqiptare mori 93% të votave, fitore që sipas vlerësimeve të Greqisë, bëri Enver Hoxhën arrogant. Më 11 janar 1946, hiqet mbretëria dhe Konferenca Kushtetuese shpalli Republikën Popullore të Shqipërisë, ndërkohë hartohet dhe votohet Kushtetuta e

re, që ishte kopje e asaj jugosllave⁴⁷. Të gjitha këto inkuadrohen në domosdoshmërinë e Enver Hoxhës që të konsolidohet dhe të përballojë rreziqe eventuale ose jo për rrëzimin e tij. Këtu përfshihet edhe ndërpreja e marrëdhënieve diplomatike me SHBA dhe Britaninë e Madhe⁴⁸.

Enver Hoxha bëhet Kryeministër, Ministër i Jashtëm dhe i Mbrojtjes, Komandant i Ushtrisë dhe Sekretar i Parë i Partisë Komuniste Shqiptare dhe përcakton ndërtimin e socializmit si misionin më të rëndësishëm⁴⁹. Ushqehet kulti i individit dhe buste të tij ngrihen në të gjithë vendin⁵⁰. Për kryerjen e reformave Shqipëria kërkoi ndihmën e Jugosllavisë, por gjendja ndryshon kur më 28 qershor Jugosllavia përjashtohet nga Kominform⁵¹.

-
47. Universiteti i Tiranës, Shqipëri. Tridhjetë vjet pushtet popullor. Zhvillimi ekonomiko-social, Selanik, bot. Erevna, 1977, f. 13.
 48. Balli Kombëtar ishte shndërruar në Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar me qëllim që të përmbysë Enver Hoxhën, ndërsa kundërbulimi anglez u përpoq për përmbysjen e Enver Hoxhës dhe risjelljen e Zogut. Shih L. Gardiner, *The Eaglespreads his claws. A history of dhe Corfu chanel dispute and of Albania's relations with the west 1945-1965*, London 1966 dhe S. Dajos, *Dimensioni ndërkombëtar i konfliktit E. Hoxha-J.B. Tito dhe fundi i luftës civile greke*, Selanik, bot. Paratiritis, 2003, f. 56. Me britaninë e Madhe ishte krijuar incidenti në Kanalin e Korfuzit në fund të vitit 1945 kur ishin fundosur me mina dy anije britanike. Çështja u paraqit në OKB dhe Shqipëria u dënua nga Gjykata Ndërkombëtare me dëmshpërblim, ndërsa floriri i vendit i vjedhur nga fuqitë e aksit që u morr prej aleatëve nuk u kthye.
 49. A. Sherman, *Shqipëria. Shqiponja e thyer e Ballkanit*, Athinë, bot. Indiktos, 2000, f. 70.
 50. Parrullat kryesore që zotërojnë në këtë periudhë janë Rroftë shoku Enver Xoxha dhe Partia mbi të gjitha.
 51. Kominformi ishte zyra e informacionit të Lëvizjes Ndërkombëtare Komuniste. Për marrëdhëniet e Jugosllavisë me Kominform-in shih S. Stathi, *Jugosllavia dhe Titoja 1919-1953*, Athinë, bot. Estia, 1983. Për përplasjen Shqipëri-Jugosllavi shih veprat e E. Hoxhës, *Marksizmi*

Shqipëria i afrohet Bashkimit Sovjetik, i cili pranon që ta ndihmojë. Ndërkohë, E. Hoxha i përforcuar fillon pastrimet në Parti dhe 14 nga 31 anëtarë të Komitetit Qendror dhe 32 nga 109 të Asamblesë Kombëtare ekzekutohen si mbështetës të Titos dhe si anëtarë të “fraksionit projugosllav”. Gjithashtu afërsisht 25% e anëtarëve të PKSH përjashtohen dhe internohen⁵².

Në vitin 1949 qeveria nxjerr një “urdhër lidhur me komunitetet fetare” që kërkonte të respektonin ligjet (e reja) e shtetit. Komunitetet fetare që kishin qendrën jashtë vendit urdhërohen të ndërpresin veprimtaritë në Shqipëri, u ndalohet institucioneve fetare të kenë pjesëmarrje në arsim, në shëndetësi dhe në kujdesin social, dhe të gjitha komunitetet fetare humbasin pronat e tyre, me qëllim që të ndërtohet Shqipëria e re⁵³. Sulmi më i madh drejtohet kundër kishës ortodokse dhe minoritetit grek.

Në shtator të vitit 1952 del ligji që parashikon dënimin me vdekje për qytetarët që janë fajtorë për konplot kundër shtetit, për shkatërrim të pronës shtetërore ose për sabotim.

Në maj të vitit 1955 Shqipëria bëhet shtet themelues i

dhe Leninizmi, Teori dhe Praktikë, Athinë, bot. Na ipiretουμε to llao, 1975, f. 6, *Titistët*, Athinë, bot. Poreia, 1983, e Tëra si dhe Imperializmi dhe Revolucioni, Athinë, bot. Poreia, 1979, f. 40-50.

52. Atëhere ekzekutohen edhe shumë bashkëpunëtorë të ngushtë të E. Hoxhës si Sekretari Organizativ i Komitetit Qendror të PK Shqiptare me origjinë jugosllave, përfaqësuesi i tij në diskutimet me Partinë Komuniste të Greqisë dhe Jugosllavisë, Koçi Xoxe, i cili u akuzua për bashkëpunim me Titon dhe si “agjent i imperializmit” dhe u ekzekutua më 1948.
53. E. Hoxha, *Kur u vendosen themelet e Shqipërisë së re*, Athinë, bot. Planitis, 1984, f. 23-24. Sipas Komitetit Kombëtar për një Shqipëri të lirë, nga 93 klerikë katolikë që ishin në vitin 1945, vetëm 10 ishin të lirë, 24 u ekzekutuan, 35 u burgosen, 10 vdiqen apo u zhduken, 11 u dëbuan nga vendet e tyre dhe 3 ikën jashtë shtetit. Shih S. Skëndi, *Albania*, New Zork, Praeger, 1958, f. 299.

Traktatit të Varshavës, ndërkaq vdekja e Stalinit më 1954 dhe akuzat e Niqita Hrushovit në Kongresin e 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, çojnë në një situatë të re marrëdhëniet sovjetiko-shqiptare. Zelli i ndjekjeve nga E. Hoxha intensifikohet, sikundër edhe dyshimet për bashkëpunimin e Sovjetikëve dhe Jugosllavëve për përmbyshjen e tij. Në vitin 1959 kur Hrushovi vizitoi Shqipërinë dhe nxiti Shqiptarët që të rivendosin marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe kur po atë vit specialistët Sovjetikë këshilluan Shqiptarët që t' i mëshojnë sektorit të prodhimit të lëndëve të para dhe jo sektorit të dytë të përpunimit të tyre, propozimet u rrefuzuan nga qeveria shqiptare⁵⁴ dhe për këtë u ndërpre në marrëdhëniet ekonomike Shqipëri-Bashkim i Republikave Socialiste Sovjetike. E. Hoxha deklaroi se “populli shqiptar dhe Partia e tij Komuniste do të jetojnë edhe më bar po të nevojitet, por kurrë nuk do të shiten për ‘30 të argjendta’, sepse është më mirë të vdesin në këmbë sesa të rrojnë të turpëruar dhe të gjunjëzuar”⁵⁵.

Pra, Shqipëria u detyrua të mbështetet plotësisht në ndihmën ekonomike dhe politike të Kinës. Paralelisht dhe në të njëjtën periudhë që Mao Ce Duni fillon “Revolucionin e Madh Kulturor të Proletariatit” në gjirin e popullit kinez, E. Hoxha fillon “revolucionin e tij kulturor dhe ideologjik” për formimin e njeriut të ri⁵⁶. Forcohet kulti i individit përmes programeve

54. J. Halliday, *The artful Albanian. The memoirs of Enver Hoxha*, London 1986, f. 219.

55. E. Hoxha, Fjala më 7 nëntor 1961, vepra, vëll. 22, Tiranë, 1978. Gjithashtu sikundër thekson G. Mury, f. 78, E. Hoxha vazhdonte të ngacmonte Sovjetikët që të respektojnë marrëveshjet dypalëshe pasi vështirësitë pas prishjes së marrëdhënieve me ta ishin të mëdha.

56. K. Sbollopoulos, *Politika e jashtme Greke, 1945-1981*, vëll. A', Athinë, bot. Estia, 2003, f. 74. Shih edhe librin përkatës të G. Mury, f. 135 e në vazhdim.

mësimore shkollore, zgjerohet kolektivizimi, ndalohen udhëtimet jashtë shtetit dhe nis një program ndërtimi veprash fortifikuese (400.000 bunkerë) përgjatë kufijve të Shqipërisë për mbrojtje në rast sulmi⁵⁷. Në vitin 1967 si pjesë e revolucionit kulturor dhe ideologjik, E. Hoxha i bën thirrje popullit për pjesëmarrje në luftën kundër “paragjikimeve (besëtytnive) fetare”⁵⁸. Deklaron se “feja e Shqipërisë është shqiptarizmi” dhe deri në maj të po këtij viti mbi dymijë kisha, xhami, manastire dhe institucione të tjera fetare u mbyllen apo përdoren për destinacione të tjera. Klerikët burgosen ose detyrohen të kërkojnë punë në industri apo në bujqësi, krijohet në Shkodër muzeu ateist dhe sipas Kushtetutës së vitit 1967 Shqipëria bëhet i pari vend ateist në historinë botërore. Më tej E. Hoxha i dha shtysë zhvillimit të identitetit të përbashkët kombëtar shqiptar, bashkimit të Toskëve dhe Gegëve, për zhvillimin e identitetit dhe ndërgjegjës së përbashkët kombëtare shqiptare, veç kjo për çelnikosjen dhe mbrojtjen e modelit politiko-ekonomik dhe shtresëzimin social. Gjithashtu sulmoi minoritetin grek me përndjekje të reja.

Më 1976 kur vdiq Mao Ce duni, E. Hoxha kritikon sistemin kinez dhe marrëdhëniet që zhvillohen midis Kinës dhe Perëndimit⁵⁹. Kinezët kundërpërgjigjen duke afruar Jugosllavinë

57. E. Hoxha në atë periudhë fliste për “pretendime të monarko-fashistëve Grekë për Vorioepirin, të cilin do ta marrin nga Shqipëria vetëm po të mos mbetet gjallë asnjë Shqiptar”. E. Hoxha, *Kur u vendosën ...*, f. 178.

58. Th. Beremis, Th. Koulloumbis, I. Nikollakopoulos, *Grekët e Shqipërisë* (Athinë: Universiteti i Athinës, Institucioni Grek i Politikës Evropiane dhe të Jashtme, 1995, f. 23.

59. E. Hoxha, *Shënime për Kinën 1962-1972. Nga ditari politik*, Athinë, bot. Poreia, 1979 dhe E. Biberaj, *Albania and China. A study of unequal alliance*, Boulder/San Francisko/Oxford, 1986.

dhe ftojnë Titon për vizitë zyrtare në korrik të vitit 1978, ndërpresin ndihmën ndaj Shqipërisë, si dhe marrëdhëniet ekonomike dhe ushtarake midis dy vendeve. Që në atë moment Shqipëria vazhdon e vetme përpjekjen e saj politike dhe ekonomike. E. Hoxha thekson nevojën që vendi të mbështetet në forcat e veta⁶⁰ dhe në dhjetor të vitit 1976 vendi bëhet demokraci socialiste, E. Hoxha nënvizon se marksizëm-leninizmi është ideologjia zyrtare e vendit⁶¹.

Në vitin 1981 vdes Mehmet Shehu, kryeministër i vendit për më shumë se tre dhjetëvjeçarë⁶², për të cilin zyrtarisht thuhet se u vetvra, ndërkaq e vrau sistemi. Vdekja e M. Shehut pasohet nga dënime në ushtri dhe në shërbimet sekrete. E. Hoxha, i cili që në vitin 1973 përballon probleme shëndeti të cilat në vitin 1983 shtohen, vdes në vitin 1985. Vendin e tij në udhëheqje të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të vendit⁶³ e zë Ramiz Alia, i cili përpiqet të krijojë kushte për të mbajtur në këmbë vendin, duke bërë hapje në Perëndim⁶⁴, veçse ritmet

60. Përmirësimet ekonomike të periudhës 1951-1980 përmblihen si më poshtë: Shqipëria u industrializua shpejt me pjesëmarrje në fitimin mbi prodhimin e materialeve nga 19% më 1951 në 40% më 1980. Ndonëse prodhimi bujqësor në vija të përgjithshme në këtë periudhë u dyfishua, duke bërë krahasime dhe duke e parë atë në plan më të gjerë, u ul nga 80% në 36%, ndërsa ndërtimet, transportet dhe komunikacionet mbeten afërsisht në 10% të të Ardhurës Kombëtare Bruto.

61. E. Hoxha, *Kur u vendosen ...*, f. 378-379.

62. M. Shehu ishte Ministër i Jashtëm në periudhën 1948-1953 dhe Kryeministër nga viti 1953 deri më 1981.

63. E. Biberaj, *Albania, A socialist maverick*, Boulder/San Francisco/Oxford, 1990, f. 36.

64. R. Alia lindi në Shkodër më 1921, në vitin 1941 u përfshi në rininë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe më 1943 u bë anëtar i saj. Në vitin 1948 u zgjodh anëtar i Komitetit Qëndror dhe më 1949 u bë Sekretar i Parë i Rinisë. Studioi në Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike

janë shumë të ngadalta. Ndërkaq, i ndodhur përpara nevojave të mëdha të ekonomisë shqiptare, vendos marrëdhënie me Gjermaninë Perëndimore (të atëhershme), Francën dhe Italinë, të cilat luajtën rol parësor në ndryshimet që ndodhen në vend. Në vitin 1990 pas grevave të mëdha, R. Alia pranon reformat demokratizuese, përfshi sistemin pluralist, dhe në mars të vitit 1991 zhvillohen zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri që nga 1920-a, të cilat i fitoi Partia e Punës e Shqipërisë, por brenda një viti si pasojë e problemeve të mëdha rrëzohet duke ia dorëzuar pushtetin Partisë Demokratike.

dhe në vitin 1956 u zgjodh anëtar plotësues i Byrosë Politike dhe më 1961 anëtar. Ngjitja e tij në Partinë e Punës të Shqipërisë konsiston në marrëdhëniet e tij të mira me E. Hoxhën dhe bashkëshorten e tij Nexhmije Hoxhën. N. Pano, "The process of democratization in Albania", in K. Dawisha - B. Parrit, (ed) *Politics power and the struggle for democracy in South-East Europe*, Cambridge University Press, 1997, f. 285-352.

6. Marrëdhëniet greko-shqiptare në periudhën 1944-1974 dhe minoriteti etnik grek

Në kohën që Italia i shpalli luftë Greqisë, Shqipëria ishte pjesë e Mbretërisë Italiane. Greqia u vu në gjendje lufte me Shqipërinë⁶⁵, duke përcaktuar si shtete armiqësore Italinë së bashku me tokat e pushtuara prej saj, tokave të perandorisë dhe kolonive, si dhe Shqipërinë⁶⁶. Gjendja e luftës u bë elementi kryesor në zhvillimin e marrëdhënieve greko-shqiptare. Konkretisht deri më 1971, kur u rivendosen marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve përmes shkëmbimit të ambasadorëve⁶⁷, por edhe më vonë deri në vitin 1987, kur Greqia vendosi heqjen e gjendjes së luftës me Shqipërinë, nga ana formale për Greqinë vazhdonte të ishte në fuqi kjo gjendje lufte. Greqia pas luftës, meqënëse kishte përqendruar të gjitha përpjekjet në plotësimin e pretendimeve të saj për Vorioepirin⁶⁸ dhe sigurimin e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri, nuk lidhi marrëveshje paqeje e cila do të përfundonte gjendjen e luftës me Shqipërinë.

65. S. Valden, *Greqi-Jugosllavi. Lindja dhe zhvillimi i një krize dhe ndryshimet në Ballkan, 1961-1962*, Athinë, bot. Themelio, 1994.

66. Ligji Emergjent 2636/10.11.1940, “Mbi legjitimitetin e pronave të armiqve dhe garancisë së pronave të armiqve”. Në bazë të Ligjit Emergjent përmendur më sipër u shpall Ligji Mbretëror “Mbi përcaktimin e Italisë dhe Shqipërisë si shtete armiq sipas kuptimit të Ligjit Nr. 2636/1940 dhe zbatimit për këto shtete të dispozitave të këtij ligji”.

67. G. Vallinakis, *Hyrje në politikën e jashtme greke, 1949-1988*, Selanik, bot. Paratiritis, 1989, f. 116-117.

68. A. Qiru, *Fqinjët tanë Ballkanikë*, Athinë, 1962.

Brenda dhe jashtë vendit Greqia u përpoq me relacione dhe memorandume të vazhdueshme të arrijë reralizimin e objektivave të saj për minoritetin grek. Më 18 tetor 1944 në deklaratën e kryeministrit të unitetit kombëtar theksohej se “Vorioepiri përbën pjesë të pandarë të Greqisë dhe u bekua tani vonë nga varret e heronjve tanë”, deklaratë e cila shkaktoi reagimin e palës shqiptare⁶⁹. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore qeveria greke i dha rëndësi të posaçme çështjes së Vorioepirit, ku komuniteti grek rrezikohej me shfarosje. Në gusht të vitit 1945, zëvendësministri i jashtëm F. Dhragumis përsëriti se Greqia pretendonte Vorioepirin⁷⁰, ndërsa në nëntor 1945 qeveria greke i dërgoi shkresë Ministrisë së Jashtme të SH.B.A për t’i kujtuar asaj se e drejta e Greqisë për Vorioepirin mbetet e pacënueshme⁷¹. Ministri i Jashtëm, K. Rendi duke folur në fund të shkurtit 1946 në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, cilësoi Shqipërinë vend armik, duke rrëzuar kërkesën e Shqipërisë për të hyrë në Organizatë, kërkesë që ishte paraqitur më 12 shkurt⁷², ndërsa kryeministri grek përsëriti se Greqia pretendonte Vorioepirin⁷³.

Në Konferencën e Paqes në Paris, e cila u zhvillua në vitin 1946, qeveria greke përmes ministrit të jashtëm K. Rendi, me memorandumun e saj të datës 15 shkurt 1946 kërkoi hartimin e planit të paqes me Shqipërinë për ta paraqitur në Konferencën e Paqes. K. Rendi tërhiqte vëmendjen se Shqipëria i kishte shpallur luftë Greqisë dhe nuk përligjej pjesëmarrja e saj pasi “kreu realisht akte armiqësore kundër Greqisë, duke u bërë bashkëpunëtorë në krimet e kryera nga Hitleri dhe Musolini”.

69. Dajos vepra përmendur më lart (op. cit.), f. 84.

70. Xydis, op. cit., f. 123-125.

71. Arshiva e Ministrisë së Jashtme të Republikës Greke, Ambasada Greke në Uashington, Memorandumi 1.11.1945.

72. Dajos, op. cit., f. 129 dhe E. Hoxha, *Dy popuj miq...*, op. cit, f. 20-21.

73. Xydis, op. cit. 196-197.

Në mbyllje të memorandumit Ministri i Jashtëm Grek theksonte se pretendimet greke ndaj Vorioepirit “mbështeten në shkaqe historike, etnologjike dhe ligjore”. Më 25 mars qeveria greke paraqiti memorandum tjetër drejtuar Këshillit të Ministrave të Jashtëm, me të cilin kërkonte hartimin e projektit të marrëveshjes së paqes me Shqipërinë⁷⁴. Ditën tjetër Komisioni për Çështje të Jashtme të Senatit të SHBA-së me vendim të tij unanimit (RESOLUTION) numër 82 (26.03.1946) theksonte sa më poshtë: “VEDNOSET që, sipas gjykimit të Senatit, Vorioepiri (përfshi edhe Korçën), Dymbëdhjetë Ishujt e Egjeut, të njohura me emrin Dodekanisi, ku zotëron një popullsi e fuqishme Greke, duhet që Konferenca e Paqes t’ ia japi Greqisë dhe të përbëjnë pjesë të territorit të Greqisë”. Më 11 prill 1946 qeveria greke paraqiti memorandum të ri me të cilin kërkonte nga Këshilli të shqyrtonte pretendimin për Vorioepirin, “me vete dhe si trup”, por në këtë rast pa përmendur kërkesën mbi hartimin e tekstit të marrëveshjes së paqes me Shqipërinë⁷⁵. Gjatë Mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Jashtëm dhe më konkretisht në mbledhjen e datës 15 maj 1946, Ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe, Ernest Bevin, theksonte se u parashtruan nga qeveria greke pretendimet e saj për Vorioepirin dhe se Këshilli duhet t’ i shqyrtojë⁷⁶.

74. S. Xydis, *Greece and the great powers, 1944-1947*, Thessaloniki, 1962.

75. V. Kondis-E. Manda, (ed) *The Greek minority in Albania*. Selanik, Institute of Balkan Studies, 1994, Disa ditë më vonë (17 prill) edhe Ambasada e Greqisë në Uashington paraqiti memorandum në Ministrinë e Jashtme të SHBA-së, ku së bashku me pretendimet etnike parashtrohej edhe çështja e shkëljes së kufijve greko-shqiptare (dhe greko-bullgare) për shkak të luftës civile dhe domozdoshmërinë e rregullimit të tyre. V. Kondis, “The Greek minority in Albania”, *Balkan Studies*, 36, 1995, 85-92 dhe V. Kondis, *Politika anglo-amerikane dhe çështja greke, 1945-1959*, Selanik, f. 157-1999.

76. V. Kondi, *Ekulibre sensible. Greqia dhe Shqipëria në shekullin e 20-të*. Selanik 1994.

Konferenca e Paqes me pjesëmarrjen e 21 shteteve, fitues në Luftën e Dytë Botërore, më 29 qershor 1946 pranon propozimin e qeverisë greke për asamblenë, me të cilin kërkonte nënshkrimin e çështjes vorioepirote. Më 30 gusht 1946 pas ndërhyrjes së F. Dhragumit kërkesa e Greqisë për Vorioepirin regjistrohet në Rendin e Ditës, kërkesë e cila u pranua me 12 vota pro, 7 kundër dhe dy abstenime (Belgjika-Norvegjia), por anulohet që të diskutohet në seancën tjetër. Synimet greke hasin reagimin e ashpër të përfaqësishë Shqiptare, Jugosllave dhe Sovjetike, të cilat mbrojnë tezën se duhet të përcillet në Këshillin e Ministrave të Jashtëm të katër Fuqive të Mëdha (SHBA, BRSS, Britani e Madhe, Francë).

Në nëntor të vitit 1946, Greqia parashtrroi sërish kërkesën e saj në Këshillin e Ministrave të Jashtëm, por nuk u mor asnjë vendim, pasi “çështjen e përcaktimit të kufijve greko-shqiptare” e përcolli për diskutim dhe zgjidhje në Këshillin e katër Fuqive Garantuese, kur do të firmosej Marrëveshja e Paqes me Austrinë (u nënshkrua më 15 maj 1955), ndërsa problemi në fjalë qëndron deri sot pezull. Këtë çështje e mbrojti edhe përfaqësuesi i Britanisë së Madhe Berns duke theksuar (dhjetor 1946) se çështja Vorioepirote do të regjistrohej në rendin e ditës të Këshillit të Ministrave të Jashtëm.

Duke ratifikuar Traktatin e Paqes të Parisit të datës 10 shkurt 1947, Greqia shprehu rezervat e mëposhtme, të cilat nuk u përfshinë në shkresën ratifikuese të Traktatit⁷⁷:

1. Sipas diskutimeve dhe votimeve në Konferencën e Paqes, neni 27 nuk shqyrton fare çështjen e kufijve me Shqipërinë që paraqiti përfaqësia greke.

2. Përfaqësia greke pranoi transferimin e çështjes në

77. V. Kondis, *Equilibre sensible. Greqia dhe Shqipëria në shekullin e 20-të*. Selanik 1994.

mbledhjen e të katërve vetëm për të mos vonuar ecurinë e punimeve të konferencës.

3. Greqia beson për zgjidhjen pozitive nga mbledhja e të katërve të çështjes vorioepirote që mbeti pezull gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së paqes me Italinë.

4. Neni 88 nuk bie aspak ndesh me rregullimin e drejtë të kësaj çështjeje.

Politikanët Grekë kujdeseshin të mbanin aktuale çështjen e Vorioepirit dhe të Virioepirotëve brenda dhe jashtë Greqisë. Në këtë kuadër përfshihen deklaratat dhe veprimtaritë e herëpashershme. Kështu p.sh. Konstandinos Caldharis, si nënkryetar i qeverisë greke dhe kryetar i delegacionit grek në OKB më 1948, theksonte në Asamblenë e Përgjithshme, se “për të shmangur çdo dyshim, delegacioni i Greqisë deklaroi se qeveria greke, e cila ka nënshkruar integritetin dhe pavarësinë e Shqipërisë, nuk do të braktisë në asnjë rast dhe me asnjë kusht të drejtat e saj shumëshekullore dhe të panegociushme për një krahinë greke, të cilën gjaku i fëmijëve të saj e bashkoi me atdheun mëmë, duke ruajtur të plota rezervat e saj, deri sa çështja vorioepirote të zgjidhet me drejtësi dhe mirëkuptim”⁷⁸.

Gjatë periudhës 1950-1961, kur BRSS luante ende rolin kryesor në politikën e Shqipërisë, marrëdhëniet greko-shqiptare përshkoheshin nga një klimë ftohtësie dhe dyshimi⁷⁹. Ndonëse u zgjidhen disa çështje të vogla, siç ishte p.sh. lirimi në vitin 1953 i Grekëve të marrë peng dhe fëmijëve të vegjël nga koha

78. N. Andonopoulos, “Gjendja e luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë”, Procesverbale A’ të Konferencës Shkencore Vorioepiri-Shën Kozmas Etollos, f. 706-738 dhe E. Hoxha, Raport në Kongresin e Parë të Partisë Komuniste Shqiptare, Tiranë 1948, f. 35.

79. V. Kondis, “The Greek minority in Albania”, *Balkan Studies*, 36, 1995, 85-102. Për gjykimin shqiptar lidhur me marrëdhëniet me SHBA dhe Britaninë e Madhe shih E. Hoxha, *Rreziku Angloamerikan për Shqipërinë*, Athinë, bot. Allaji, 1982.

e luftës civile në Greqi, si dhe hapja e Kanalit të Korfuzit më 1958 për lundrim të lirë, marrëdhëniet dypalëshe mbeten mjaft të tensionuara - u ndërморr një nismë nga pala shqiptare në vitin 1955 në OKB për marrëdhënie diplomatike, nismë e cila u përserit më 1956⁸⁰ dhe më 1957⁸¹, ndërsa qeveritë greke mbanin aktuale çështjen vorioepirote⁸². Në vitin 1960 S.Venizellos i kujton udhëheqësit të BRSS, Hrushovit, çështjen Vorioepirote dhe thekson se me Shqiptarët do të merremi vesh vetëm po të shtrohet, të diskutohet dhe të zgjidhet kjo çështje me një formë autonomie. Më konkretisht, përmend se “u referohem kushteve në të cilat jetojnë Grekët e Vorioepirit dhe nuk parashtroj në asnjë mënyrë çështje ndryshimi territorial, theksoj nevojën që qeveria shqiptare t’i japë minoritetit grek të drejtën e vetqeverisjes brenda kuadrit të shtetit shqiptar, në formën e autonomisë së krahinës, deri sa çështja të zgjidhet nga Ministrat e Jashtëm të katër Fuqive të Mëdha, duke qenë se qëndron ende pezull⁸³. Hrushovi u përgjigj se në Korçë pa Grekë dhe Shqiptarë që punonin si vëllezër, këto çështje duhet të zgjidhen në mënyrë paqësore dhe se kërkesën do t’ia transmetojë palës shqiptare⁸⁴. Marrëdhëniet e BRSS dhe

80. E. Hoxha, *Raport në Kongresin e Tretë të Partisë së Punës të Shqipërisë*, Tiranë 1956, f. 25.

81. Intervistë e E. Hoxhës tek M. Glezos, *Gazeta Avji*, 22.11.1957. Udhëheqësi i Partisë së Punës të Shqipërisë i jipte më shumë rëndësi zhvillimit të marrëdhënieve tregtare midis dy vendeve, ndërkaq konsideronte se ky zhvillim do të çonte, me heqjen paralele të “pengesave artificiale dhe pa bazë”, në normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve.

82. Në vitin 1953 dështoi edhe një përpjekje tjetër për “piramidat” kufitare, të cilën E. Hoxha e paraqiti si dështim të përsëritjes së marrëdhënieve diplomatike. A. Qiru, *Politika e jashtme Greke*, Athinë 1955, f. 200.

83. *Gazeta To Vima*, 28.6.1960.

84. Andonopullu, *Shqipëria dhe marrëdhëniet greko-shqiptare, 1912-1994*, Athinë, bot. Oqeanidha 1999, Hrushovi i deklaroi Sofokli Venizellos se “kuptonte pretendimin e Greqisë për Voriopirin, sepse ai vet kishte

Shqipërisë do të ndërpriten pak më vonë dhe çështja nuk do të diskutohet më. Në këtë periudhë në vijim të deklaratave të politikanëve grekë për marrëdhëniet greko-shqiptare dhe lidhjen e tyre me kushtet e jetesës së minoritetit grek dhe me çështjen “Vorioepirote”, Jeorjios Papandhreu duke folur në Parlamentin Grek (Seanca e 106-të datë 31 maj 1960) thekson: “Ajo që qeveritë greke duhet të dinë është se çështja (e Vorioepirit) ekziston. Dhe ajo që nuk duhet lejuar në këtë shekull, pavarësisht nga arësyet, është mohimi i kësaj kërkeseje të shënjtë. Ajo që nuk do të lejohet të përsëritet kurrë për Vorioepirin është ajo që, fatkeqësisht, ndodhi me Qipron, mohimi i bashkimit. Për sa i përket çështjes së Vorioepirit, për çështjen e parë, pretendimi është i shënjtë dhe i pashmangshëm. Por trajtimi, mënyra dhe koha janë çështje të qeverive. Janë çështje të koniunkturave ndërkombëtare. Janë çështje të historisë. Dhe koniunkturat ndërkombëtare janë të përshtatshme sepse vjet u zgjidh përfundimisht çështja gjermane përmes bashkimit të të dy Gjermanive, kështu ne mund t’i rikthehemi dhe të realizojmë marrjen e Vorioepirit sikundër kishin vendosur të mëdhenjtë në vitin 1946⁸⁵”. Në Konferencën për “Mirëkuptimin Ballkanik”, e cila u zhvillua në vitin 1961 në Athinë ku morën pjesë, përveç Greqisë, Rumania, Jugosllavia dhe Bullgaria,

takuar Grekë në Korçë”. Kishte paraprirë një deklaratë e ambasadorit të BRSS në Athinë S. Ivanov që këshillonte Shqipërinë të çojë çështjen në OKB dhe në Gjyqin Ndërkombëtar të Hagës për gjendjen e luftës me Greqinë dhe pretendimet territoriale me qëllim që të përmirësojë marrëdhëniet me vendin fqinj, deklaratë e cila hasi në reagimin e madh të palës shqiptare. Shih E. Hoxha, *Dy popuj miq...*, op. cit., f. 96-106, 115-118, po atij, *Shqipëria përballë...* op. cit, f. 63, dhe G. Gastellan, *L’Albanie*, Paris 1980.

85. Procesverbale të gazetës Helenizmi Vorioepirot. Trajtimi Etnologjik-historik-juridik-diplomatik i çështjes Vorioepirote, Athinë, bot. SFEVA-PASIVA, 2002, f. 100-106.

Shqipëria nuk mori pjesë, duke thënë se vendi organizator nuk u dha vizë zyrtarëve Shqiptarë.

Në vitin 1962, megjithëse dështoi përpjekja për rivendosjen e marrëdhënieve dypalëshe në kohën që ishte ministër E. Averof⁸⁶, u lejua riatdhesimi nga Shqipëria i Grekëve që dëshironin të riatdhesoheshin –gjithsej 123– si përgjigje e deklaratës “së dëshirës dhe fqinjësisë së mirë të qeverisë greke”, u pastrua Kanali i Korfuzit dhe u bënë propozime për zgjidhjen e çështjeve kufitare dhe për shkëmbime tregtare⁸⁷. Duhet theksuar se në maj të vitit 1962 vizitoi Tiranën deputeti i EDA-s St. Merkuris si kryetar i lëvizjes greke për Mirëkuptimin Ballkanik⁸⁸. Merkuri testoi qeverinë shqiptare për çështjen e

86. E. Averof përmendi se “sot nuk e fsheh se gjatë shtatë viteve që jam ministër u realizuan kontakte të ndryshme indirekte për normalizimin e marrëdhënieve tona me Shqipërinë, të cilat sipas meje përplaseshin kurdoherë tek pengesa e pakapërcyeshme ngaqë Shqipëria fillon me kusht që pas rivendosjes së marrëdhënieve çështja qëndron në stadin në të cilin është sot”. Gazeta *Apojevmatini*, 4.11.1964, në S. Valden, op. cit. f. 43. E. Hoxha thekson lidhur me këtë në fillimet e vitit 1962 gjatë dorëzimit të Grekëve që dëshironin të riatdhesoheshin, se delegacioni grek kërkoi të diskutohet vendosja e marrëdhënieve diplomatike. E. Hoxha, *Dy popuj miq...*, op. cit., f. 69.

87. Janë dezertorët e ushtrisë greke të cilët ikën në Shqipëri gjatë periudhës së luftës civile greke (mbi 400 persona). Ata meqënëse ishin nën mbikqyrjen e agjentëve Shqiptarë u grumbulluan në fshatin Valias pranë Tiranës. Shih E. Hoxha, *Dy popuj miq...*, op. cit. f. 112 dhe po atij, Raport në Kongresin e 4-t të Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë 1961, f. 23. S. Agapitidhis thekson se pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore erdhen në Greqi 6500 qytetarë shqiptarë. S. Agapitidhis, “Deplacements de population en Grece”, *Balkan Studies*, vol. 18, 2, 1977, f. 273-283. Shih akoma I. Andonopulos, *Shqipëria dhe marrëdhëniet greko-shqiptare 1012-1949*, Athinë, bot. Okeanidha, 1995. Akoma shih E. Hoxha, *Raport në Kongresin e 4-t të Partisë së Punës të Shqipërisë*, Tiranë 1961, f. 23 dhe A. Kaludhiotis, *Robëria ime në Shqipërinë e Hoxhës*, bot. Zaharopulos, 2003.

88. G. Hristidhis, *Ballkani Komunist*, Selanik, bot. Vanias, 2003, f. 55.

rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike dhe kur u kthye në Athinë, u shpreh se Shqipëria dëshironte. Kjo përpjekje nuk pati vazhdim të mëtejshëm sepse Greqia nuk ishte e predispozuar të braktiste çështjen vorioepirote. Më 11 shtator 1963 kryeministri i atëhershëm dhe ministër i jashtëm P. Pipinelis deklaronte se “përmirësimi i klimës ndërkombëtare përmes përballimit dhe zgjidhjes së emancipuar të mosmarrëveshjeve ekzistuese, mjerisht sjell në tryezë edhe çështjen pezull të Vorioepirit... Një çështje e tillë nuk është e mundur të parashkruhet... Arësye diplomatike, ushtarake, kombëtare, ekonomike përcaktojnë ekzistencën e kësaj çështjeje të cilat imponojnë gjetjen e zgjidhjes së përshtatshme”⁸⁹.

Më 7 dhjetor 1963 S. Venizellos me cilësinë e tij të Nënkryetarit të Qeverisë dhe të Ministrit të Jashtëm, deklaroi se Greqia shqetësohet për fatin e Vorioepirotëve, duke thënë se ne do të merreshim lehtë vesh nëse ai vend do të pranonte t’i jipte autonomi administrative minoritetit grek⁹⁰. Me gjithë përpjekjet e bëra në OKB (1961-1966) prej përfaqësuesve të përhershëm të të dy vendeve, marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë mbeten të tensionuara, pasi propozimi grek për rivendosjen e marrëdhënieve dhe në vijim për zgjidhjen me dialog të çështjeve pezull, gjeti të papredispozuar palën shqiptare⁹¹. Kështu, përpjekjet për përmirësimin e klimës dhe që patën sukses filluan me marrjen e pushtetit në Greqi nga diktatura ushtarake më 1967, e cila rivendosi marrëdhëniet diplomatike.

89. M. Lambrinidhu, *Shqipëria sot*, Athinë, f. 36.

90. Gazeta, *To Vima*, 17.12.1963.

91. L. Zanga, “Albanian Foreign Policy in the Wake of 7th Party Congress”, R. King/J. Braun, *Eastern’s Europe’s uuncertain future*, New Zork 1977, f. 88-89. Kërkesat e palës greke u parashtruan më 27 mars në OKB përmes përfaqësuesit të përhershëm Shqiptar, ndërkohë që më parë, më 25 mars, ishte paraqitur kërkesë nga Ambasadori Grek në Rumani.

Në tetor të vitit 1969 përfaqësuesi i përhershëm i Greqisë në OKB i propozoi homologut të vet Shqiptar Halim Bunto shkëmbime tregtare midis dy vendeve, por ai iu përgjigj se për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike duhet të hiqet ligji i luftës. Në janar të vitit 1970 u takuan në Paris përfaqësitë tregtare të të dy vendeve, ndërsa më 10 shkurt u nënshkrua marrëveshja përkatëse⁹².

Më 14 dhjetor 1970 përfaqësuesi i Greqisë në OKB Dhimitris Bicios duke diskutuar me homologun e vet Shqiptar (Sami Baholli) theksoi se qeveria greke do të përpiqet të përmirësojë marrëdhëniet deri në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike⁹³.

Në mars të vitit 1971 u paraqit propozimi i qeverisë greke për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike të cilit qeveria shqiptare iu përgjigj më 28 prill⁹⁴.

Qeveria e atëhershme greke në përgjigjen e saj nënvizonte: “Qeveria shqiptare me të drejtë vlerësoi këmbënguljen e qeverisë greke për dhënien e garancive në lidhje me minoritetin grek në Shqipëri. Shpreh mirëkuptimin e saj për mendimin e

92. Gazeta e Juntës ushtarake *Eleftheros Kozmos* në numrin e datës 11.2.1970 për këtë midis të tjerash shkruante: Është e domosdoshme që Shqipëria të konsiderohet ajo që është. Shqipëria nuk është nën ndikimin e asnjë vendi ballkanik apo evropian që të mund të përdoret kundër nesh. Greqia nuk e shtron çështjen (e pretendimeve territoriale), por nuk e ka lënë aspak në harresë dhe ka të drejtë të kërkojë nga Tirana të merren masa efikase për Grekët që banojnë aty”. Artikulli i mësipërm ka frymën e kohës ku botoheshin artikuj miqësore ndaj Shqipërisë, sikundër nënvizon E. Hoxha. Artikullit miqësor të gazetës *Eleftheros Kozmos* gazeta e Partisë së Punës të Shqipërisë Zëri i Popullit më 17.02.1970 iu përgjigj po me ton miqësor, duke lënë të nënkuptohet se iniciativa për nisim të mëtejshme i takon palës greke.

93. E. Hoxha, *Dy popuj miq...*, op. cit., f. 115.

94. Ministria e Jashtme 1112/γ.57/26.4.1984, f.4 dhe raporti shoqërues i datës 26..4.1984, f.2.

qeverisë shqiptare se kjo këmbëngulje nuk paragjykon thelbin e problemit. I jep rëndësi reale qëndrimit të Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj minoritetit grek. I referohet deklaratës së Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në të cilën theksohet: “Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë nuk lejuan kurrë që të mos respektohen të drejtat e minoritetit. Kjo vlen edhe për të ardhmen”⁹⁵.

Pas këtyre nismave, të cilat u realizuan kryesisht në OKB prej përfaqësuesve të të dy vendeve –sikundër përmendem kishte paraprirë lidhja e një marrëveshjeje tregtare në nivel jo qeveritar midis dhomave të tregtisë së Athinës dhe Tiranës – më 6 maj 1971 u shpall njoftim në Athinë dhe në Tiranë, sipas të cilit qeveritë e të dy vendeve ranë dakort të rivendosin marrëdhëniet diplomatike dhe të shkëmbejnë përfaqësues në rang ambasadorësh, pa përballuar asnjë prej problemeve pezull, për të cilat të dy vendet ruajtën pozicionet e tyre⁹⁶.

Në vijim të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, në tetor të vitit 1972⁹⁷ u nënshkrua marrëveshja e parë tregtare, vizitat e para të ambasadorit Grek në zonat e njohura minoritare,

95. Ministria e Jashtme 1112/γ.57/26.4.1984, f. 4-5.

96. Ministria e Jashtme, raport i datës 26.4.1984, f. 2 Dekreti 947/26 korrik 1971 “Mbi vendosjen e ambasadës në Tiranë dhe përcaktimi i organikës së saj”. Ambasadori i parë (pas vitit 1939) Grek paraqiti letrat e tij kredenciale në Tiranë më 25 tetor 1971 dhe respektivisht më 16 nëntor 1971 ambasadori Shqiptar në Athinë.

97. Ndërkaq në të njëjtën kohë nuk kishte marrëveshje për çështjet kufitare, pasi pala greke propozoi si zgjidhje modelin e marrëveshjes së vijës kufitare greko-jugosllave, që do të merrte si të dhënë vijën ekzistuese kufitare, duke shmangur referimin në marrëveshjet e mëparshme. Pala shqiptare propozoi t’ i referohen Protokollit të Firencës që të njihet menjëherë vija kufitare, e cila përcaktohej nga Protokollit. Për pasojë palët nuk ranë dakort.

ndërsa në vitin 1972 u krijua një komision i përbashkët për çështjen e kufijve i cili nuk konkludoi në marrjen e vendimeve sepse, sikundër u vërtetua, pala shqiptare kishte si synim zgjidhjen e problemeve politike, ndërsa pala greke zgjidhjen e problemeve kufitare. Kështu deri në rënien e diktaturës në Greqi, rruga e vetme përmes së cilës u përgatit vendosja dhe përmirësimi i marrëdhënieve dypalëshe mbeten marrëdhëniet ekonomike.

7. Marrëdhëniet greko-shqiptare pas rivendosjes së demokracisë në Greqi

Pas rënies së diktaturës, marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë mbeten të qëndrueshme dhe zhvilloheshin në kuadrin e politikës së distancave të barabarta në Ballkan të qeverisë së atëhershme (Demokracisë së Re) greke⁹⁸, pavarësisht nga fakti se më 23 shtator 1975 qeveria shqiptare detyroi minoritarët grekë të ndryshojnë emrat e tyre të krishtere greke si dhe toponimet e vendbanimeve të tyre me emra dhe toponime shqiptare. Në maj të vitit 1976 u nënshkrua edhe një marrëveshje e dytë tregtare me afat pesëvjeçar, marrëveshja për tregti dhe pagesa, më 16 korrik 1977 të dy vendet vendosin lidhjen e Tiranës dhe Athinës me aeroplan. Në vitin 1978 E. Hoxha tentoi hapje me Greqinë me vizitën e tij në fshatrat minoritare, që u shoqërua me fjalë të mira për marrëdhëniet e popullit shqiptar dhe atij grek dhe për gjuhën amëtare të minoritetit,

98. Kryeministri i atëhershëm K. Karamanlis përcaktonte parametrat kryesore të politikës së tij në rajon: “Politika e vendit tim mbështetet në qëndrime të njëjta me të gjithë popujt dhe veçanërisht me fqinjët. Në kuadrin ballkanik kjo politikë synon në zhvillimin e gjithëanshëm të marrëdhënieve tona sa në kuadrin dypalësh aq edhe në atë shumëpalësh. Jemi të bindur se, pavarësisht nga disa vështirësi, ideja e bashkëpunimit ndërballkanik duhet të zhvillohet me qëllim që kjo fuçi e dikurshme baruti e Evropës duhet të bëhet model për bashkëpunimin paqësor midis shteteve me sisteme të ndryshme socialo-politike”. Ndërkaq Shqipëria nuk pranoi ftesën e qeverisë greke për Bashkëpunimin Ballkanik (1975-1976), gjithashtu nuk mori pjesë në Konferencën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (Elsinki 1975). K. Sbollopoulos, op. cit., vëll. B’, f. 227.

e cila duhet të ruhej përmes arsimit. Ndërkaq këto deklarata nuk u zbatuan.

Qeveria greke që erdhi në fuqi pas vitit 1981 filloi të komunikojë me shtetin shqiptar me predispozitë të mirë, por mospranimi i Shqiptarëve për të marrë pjesë në samitin e Athinës me temë Ballkani pa Raketa (1983), indinjoji kryeministrin Grek i cili në shkurt të vitit 1984 në një fjalim të tij në Janinë nënvizoi mizerjen në të cilën jetojnë Grekët e Shqipërisë⁹⁹. Në të njëjtën kohë u publikuan raportet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së të cilat ranë si rrufe mbi regjimin shqiptar për shkëljen e të drejtave të njeriut. Nga viti 1984 deri në vitin 1988 Komisioni i Posaçëm për të Drejtat e Njeriut të OKB-së dënonte Shqipërinë për shkëljen e të drejtave të njeriut të Grekëve të Shqipërisë dhe një zëri rendiste Shqipërinë në “listën e zezë” të anëtarëve të OKB-së¹⁰⁰. Midis të tjerash thuhej se “Komisioni shqetësohet seriozisht për masat kushtetuese dhe ligjore që zbaton Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, të cilat ndalojnë ushtrimin i të drejtës së lirisë së ndërgjegjës dhe fesë për të gjithë banorët e saj dhe beson se masat në fjalë përbëjnë kërcënim kundër dimensionit njerëzor, shkelje flagrante dhe sistematike të të drejtave të njeriut, nënvleftësim të parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe pengesë për marrëdhënie miqësore dhe paqësore midis kombeve ... Komisioni këshillon qeverinë e Republikës Popullore Socialiste

99. Gazeta, *Kathimerini*, 22.2.1984.

100. Raporti referohej kamuflimit që u bëhej të burgosurve politikë në vend, kufizimet e lirisë së fjalës, ndërgjegjës dhe fesë, kufizimeve të liturgjikëve fetare dhe lëvizjes së qytetarëve, keqtrajtimit dhe torturave, mënyrës së trajtimit të të akuzuarve, burgosjeve, kushteve të jetesës në tre kampe riedukimi (Spaç, Ballsh, Burrel) dhe përfundonte me thënie të minoritarëve grekë të arratisur. Th. Millonas, op. cit., f. 190-206.

të Shqipërisë të marrë masa të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore, në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për shfuqizimin çdo lloj mostolerance dhe dallimi fetar apo besimi, me qëllim që të sigurohet liria fetare dhe e besimit dhe dallimet mbi baza fetare apo besimi të shpallen të paligjshme dhe të parashikohen garanci të mjaftueshme si dhe terapia e këtyre dallimeve...”. Vendimi i parë në këtë drejtim është ai me numër 1503 i vitit 1984 i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së, të cilin madje votuan përfaqësuesit e BRSS, të Kinës dhe Bullgarisë. Analoge ishte edhe fryma e raporteve të Ministrisë së Jashtme të SHBA-së, të Këshillit të Evropës (Deklarata e datës 9.4.1983 dhe 9.10.1985), si edhe i Amnitisë Ndërkombëtare (raporti i datës 12.12.1984)¹⁰¹.

101. Ekdhotiqi Athinon, *Epiri, 4000 vjet histori dhe kulturë greke*, Athinë 1997, f. 212.

8. Heqja e gjendjes së luftës

Heqja e gjendjes së luftës më 28 gusht të vitit 1987 me akt të Këshillit të Ministrave do të përbënte një nga gurët themeltarë të politikës së qeverisë greke ndaj Shqipërisë, por pa rezultate esenciale për minoritetin grek. Heqja e gjendjes së luftës kishte në thelb të bënte me rregullimin e aspektit politik të gjendjes së luftës, kurse çështja e pronave (status sekuestrimi) mbetet deri më sot e pazgjidhur, ashtu si edhe përcaktimi i shelfit detar (pjesës bregdetare të nënujshme) midis Greqisë dhe Shqipërisë.

9. Minoriteti kombëtar etnik grek dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke që nga themelimi i shtetit shqiptar deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë

Grekët përbëjnë grupin më të madh etnik në Shqipëri, ata përbëjnë një popullatë autoktone¹⁰² që lidhet me një sërë përpjekjesh qoftë për bashkimin e V. Epirit me Greqinë qoftë për vetëvendosjen e tyre brenda suazës së shtetit shqiptar –një periudhë shumë e rëndësishme është ajo e Luftës së Dytë Botërore – por kryesisht për mbrojtjen edhe respektimin e të

102. Ekdhotiqi Athinon, *Epiri, 4.000 vjet histori edhe kulturë greke*, Athinë 1997, f. 212.

drejtave të njeriut edhe atyre sociale që në fillim të shekullit të 20-të me krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Deklarata e njëanshme e vitit 1921 përbën gurin themeltar të njohjes juridike të minoritetit grek dhe ofrimit të të drejtave ndaj tij duke paraqitur njëkohësisht angazhimet e Shqipërisë ndaj qytetarëve të saj që u përkasin minoriteteve kombëtare, fetare dhe gjuhësore. Statusi i mbrojtjes ka të bëjë me lirinë fetare dhe të drejtat gjuhësore, duke garantuar njëkohësisht parimin e mos dallimeve edhe të barazisë para ligjit. Deklarata u pranua nga Këshilli i ... ditën e paraqitjes së saj dhe u vu qartë nën garancinë e organeve kompetente. Të drejtat e minoritetit grek u respektuan vetëm formalisht në kohën e Hoxhës, pasi Kushtetuta e vitit 1946 përmendte se minoritetet kombëtare gëzojnë të gjitha të drejtat në lidhje me mbrojtjen e zhvillimit të tyre kulturor dhe përdorimin e lirë të gjuhës së tyre (neni 39), kurse Kushtetuta e vitit 1977 u jepte garanci minoriteteve kombëtare për mbrojtjen edhe zhvillimin e kulturës edhe traditës së tyre popullore, përdorimin e gjuhës amtare edhe mësimin e saj në shkollë, si edhe barazinë në të gjitha fushat e jetës sociale (neni 42). Ndërkaq edhe pse të dy Kushtetutat u referoheshin barazisë së qytetarëve pavarësisht nga përkatësia e tyre kombëtare, racore apo fetare si edhe të drejtave të minoriteteve, nuk përcaktonin grupe konkrete¹⁰³, kurse Kushtetuta e vitit 1946 administrimin e të gjitha shkollave ia kaloi shtetit, duke u hequr të drejtën që gëzonin para luftës komunitetet greke. Sigurisht, siç pranohet nga të gjithë, regjimi i Hoxhës dëmtoi arsimin e minoritetit në masën që dëgradonte

103. Në Librin e N. Sallakut, Gjeografia e Shqipërisë për klasën e katërt të shkollës 8-vjeçare, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980. f. 62, thuhet se “në Shqipëri përveç shqiptarëve jeton edhe një minoritet shumë i vogël me Kombësi Greke edhe Maqedonase. Në Republikën Socialiste Popullore të Shqipërisë minoritetet kombëtare gëzojnë të njëjta të drejta me popullin shqiptar”.

nga ana e tij nivelin e jetesës së grekëve dhe kufizonte ndjeshëm të drejtat e tyre. Pjesëtarët e minoritetit grek përballeshin me probleme shtesë. Arsimi minoritar u ruajt pasi u vu nën kontrollin e drejtpërdrejtë të shtetit dhe degradoi për shkak të mungesës së infrastrukturës edhe të kualifikimit të posaçëm. Në rastin e Himarës, shteti mbylli shkollën greke si masë ndëshkimore ndaj qëndrimit negativ të banorëve të zonës në zgjedhjet e vitit 1946. Regjimi i Hoxhës krijoi të ashtuquajturat “zona minoritare” ku u përfshinë 99 qendra banimi gjuha amtare e të cilave ishte greqishtja duke përjashtuar vetëm fshatrat grekofone të Himarës –në vitin 1959 iu hoq edhe kombësia greke– dhe Artës së Vlorës, si edhe zona me popullsi greke kompakte (Gjirokastra, Përmeti e tj.).

Dy çështje kanë të bëjnë me minoritetin grek në këtë periudhë dhe që janë të një rëndësie të madhe për politikën greke. Çështja e parë ka të bëjë me numrin e popullsisë së tij. Një regjistrim i vitit 1930 bën fjalë për 37.000 grekë dhe që me katërfishimin e popullsisë shqiptare deri në dekadën e viteve '80-të respektivisht duhej të rriste edhe popullsinë greke-greqishtfolëse në rreth 150.000 vetë. Përkundrazi, regjistrimi i vitit 1961 bënte fjalë për 40.000 grekë edhe ai i vitit 1989 për 58.758 grekë¹⁰⁴ pa u përfshirë këtu popullsia e Himarës. Me sa duket, bëhet fjalë për të regjistruarit me “kombësi greke”. Regjistrimi shqiptar bënte fjalë për 56.000 grekë për zonat e Sarandës, Delvinës edhe Gjirokastrës, kurse ai i vitit 1992 për 59.700 vetë. Shuma e banorëve të zonave rurale, së bashku me grekët e tre qyteteve të zonës –duke pasur këtu parasysh edhe vlerësimet e vetë grekëve të Shqipërisë– duke përlogaritur të gjithë popullsisë e fshatrave greke, e kapërcente shifrën e

104. Zanga L., “Albania. Minorities: An overview”, *Report on eastern Europe*, vol. 2, Bo 50, 1991, f. 3.

60.000-61.000 të grekëve në rajonin e zonave minoritare¹⁰⁵. Diferenca me regjistrimin shqiptar të vitit 1989 arrin shifrën e 4.000 deri 5.000 vetëve brenda hapësirës së “zonave minoritare”¹⁰⁶. Përveç “zonave minoritare”, vlerësimet për popullsinë e minoritetit grek është e qartë se bëhen më të vështira. Përpos çështjes së privimit të të drejtave minoritare si rezultat i shpërnguljes, shtrohen edhe vështirësi të tjera që kanë të bëjnë me ripërcaktimin e identitetit të vërtetë të këtyre njerëzve por edhe të gjuhës së tyre jashtë “zonave minoritare”¹⁰⁷. Problemi

105. Minoriteti Kombëtar grek gjatë regjistrimeve nga viti 1945 deri më 1989 shfaq përmasat e mëposhtme:

	Popullsia totale	Minoriteti grek
30.09.1945	1.122.044	26.535 (2.4%)
3.09.1950:	1.128.943	35.345 (2.5%)
2.10.1955:	1.391.499	35.345 (2.5%)
2.10.1960:	1.626.318	40.000 (2.4%)
1-15.04.1969:	2.068.155	mungesë të dhënash
7-16.1.1979:	2.590.600	49.307 (1.9%)
2-8.04.1989:	3.182.417	48.758 (2.4%)

Burimi: Schmidt-Neke M. Sjoberg O. “Bevolkerungsstruktur”, K-D. Grothusen, Albanien, Gottingen 1993, f. 465 (Schukalla K. J., “Nationale Minderheiten in Albanien und Albaner im Ausland”, Grothusen K.D., f. 506).

106. Te 26.000 grekët që jep regjistrimi i vitit 1945, në qoftë se mbahet parasysh koeficienti mesatar shqiptar i shtimit të popullsisë në periudhën e pasluftës (16.05 për çdo 1.000 banorë) do të duhej të numëronin 74.000 vetë në vitin 1989. Berholli A., “The Greek Minority in the Albanian Republic. A demographic Study”, *Albanian Catholic Bulletin*, vol. XV, San Francisco, 1994, faqe 87-93 dhe Kalivretaqis L., “Komuniteti grek i Shqipërisë nga këndvështrimi i gjeografisë historike edhe demografisë”, te Th. Veremis e tj. (shtesë) *Helenizmi i Shqipërisë*, faqe 25-58.

107. Zonat e izoluar të veriut shqiptar, jo familjare për grekët edhe shqiptarët e jugut, si Kuksi dhe Hasi i Shqipërisë së Veriut, numri i grekëve që jep regjistrimi i vitit 1989 nuk duhet të konsiderohet pa bazë, në një kohë që i njëjti regjistrim jep për rrethin e Përmetit 442 grekë.

evidentohet kryesisht në Tiranë, ku regjistrimi bën fjalë vetëm për 610 grekë, dhe së dyti në Vlorë ku evidenton 200 vetë. Numri i grekëve si në Tiranë po kështu edhe në Vlorë e Durrës ka qenë edhe është i tejfishhtë në krahasim me numrin që japin regjistrimet shqiptare dhe kjo është rezultat i shpërnguljes edhe i eksodit të detyrueshëm nga jugu shqiptar rural drejt qendrave urbane.

Asimilimi gradual i grekëve që banonin jashtë zonave minoritare, largimi i pjesëtarëve të shumtë të minoritetit drejt Greqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, përmasat e konsiderueshme të diasporës me prejardhje nga minoriteti, janë faktorë që kontribuojnë në reduktimin e konsiderueshëm të numrit të përlllogaritur maksimal fillestar poshtë nivelit të 100.000 vetëve. Nga ana tjetër politika greke pretendonte se grekët e Shqipërisë arrinin në 400.000 vetë, kurse një studim i Departamentit Amerikan të Shtetit bënte fjalë për 266.800 grekë¹⁰⁸.

Çështja e dytë ka të bëjë me atë se cilët janë grekët e Shqipërisë. Evidentimi i vështirë i minoritetit grek jashtë “zonës minoritare”¹⁰⁹ është gjithashtu rrjedhojë e shkallës së lartë të integritimit të tyre në shoqërinë shqiptare kurse vllëhtë grekë u konsideruan si shqiptarë.

108. Sherman A, faqe 120.

109. Winniffrith T., *Vlachs of Albania*, London 1995, f. 58-59. Shiko Kahl Th., *Ethnizitat und raumliche Verteilung der Aromunen in Sudosteuropa*: Munster: 1999. Schwandner-Sievers St., “The Albanian Aromanian’s Awakening: Identity Politics and Conflicts in Post-Communist Albania”, European Center for Minority Issues to 1999 Council of Europe, Report submitted by Albania pursuant to art. 25 parag. 1 of the Framework Convention for the Protection of National Minorities, ACFC/SR (2001)5. π. 16. Përpos kësaj për vllëhtë e Shqipërisë gjatë shekullit të 19-të dhe 20-të shiko Kakudhis A., *Mitropolitë edhe Diaspora e vllëhëve*, Selanik, bot. I Institutit të Studimeve Mbrojtëse-Yitros, 2000.

Në fillimet e dekadës së viteve '60-të, regjimi i Hoxhës zhvendosi këtu në mënyrë të dhunshme të 5.000 vllehtë grekë me banim në zonën bregdetare nga Ksamili deri në Vrinë. Popullsia në fjalë bënte jetë nomade në zonën bregdetare të Sarandës së Tesprotisë. Me mbylljen e kufirit mbeti në territorin shqiptar. Vazhdonte të mbetej jashtë regjistrave themeltarë dhe as dinte gjuhën shqipe. Në regjistrimin e një pjese të vlllehëve grekë të zonës së Kolonjës në vitin 1945 regjistrohej si gjuhë amtare vllahishtja dhe greqishtja si gjuhë e huaj, kurse shqipja as që përmendej fare¹¹⁰.

Vllehtë grekë të shpërngulur u vendosen në zonat e Lunxherisë, Zagorisë edhe Pogonit, zona nga të cilat regjimi kishte hequr me mënyrat e sipërpëmendura një pjesë të madhe të popullsisë vendase. Në mesin e tyre edhe ata që ishin bartës të ndërgjegjes greke ose me sens grek. Në Lunxhëri vllehtë grekë ngritën edhe fshatrat e tyre si Andon Poçi. Por u përfshinë nëpër shkolla shqipe edhe në mënyrë arbitrare kombësia e tyre u kthye në shqiptare. Regjimi hapi shkolla shqipe edhe për vllehtë grekë në zonën e Pogonit, duke u ndaluar të hyjnë nëpër shkolla greke.

Nga ana tjetër në mesin e vlllehëve grekë pasuan arrestimet masive edhe dënimet e rënda me akuzën e rëndomtë "Bashkëpunëtorë të monarkofashistëve grekë"! 65 vllhë grekë u pushkatuan, kurse ndëshkimet edhe dënimet e tyre arrijnë në 1850 vjet burg. Brenda pak dekadash gjuha greke mbeti një gjuhë potenciale edhe e pavlefshme dhe si e tillë vetëm në radhët e të moshuarve. Bile edhe vllahishtja kaloi në plan të dytë në fshatrat me popullsi shqiptaro-vllahe mikse duke ia lënë gjithë terrenin shqipes¹¹¹. Përsa i përket vendosjes së sotme vllehtë mund të evidentohen

110. S. Poçi, Studime shkencore 5, Universiteti i Gjirokastrës, faqe 139.

111. Shiko të njëjtin studim, faqe 139-140.

në dy njësi topo-geografike. E para banon në rajonet e Pogradecit, Korçës edhe Ersekës, të Përmetit dhe në shkallë më të vogël në rajonet e Gjirokastrës edhe të Sarandës. Përqendrimi i dytë i rëndësishëm evidentohet në veri të vijës Vlorë-Berat deri në Kavajë. Pas vitit 1991 Partia e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut (PBDNJ) jepte një shifër prej 150.000 vetësh përsa u përket vllëhëve me ndërgjegje greke.

Progresi social i grekëve të Shqipërisë ishte e mirëpritur nga regjimi në masën që shoqërohej me distancimin nga ideologjia kombëtare greke¹¹² dhe mbështetjen ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila ndoqi rrugën e trajtimit konform dogmës leniniste në lidhje me minoritetet¹¹³ dhe asimilimi gradual i grekëve të Shqipërisë ishte premisa e integritit të tyre në indin kombëtar edhe social. Regjimi ndoqi rrugën e një erozioni sistematik edhe të vazhdueshëm të komunitetit grek të diasporës në zona të tjera në një kohë që disa pjesëtarë të favorizuar të komunitetit zinin poste të rëndësishme brenda sistemit¹¹⁴, nëpunës partiakë edhe shtetërorë me origjinë greke emëroheshin në poste jashtë zonave minoritare¹¹⁵,

112. Është me interes të shënohet se Fjalori Enciklopedik i Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk pranonte karakterin autokton dhe prezencën shumëshekullore të minoritetit grek duke përmendur se “banorët e Dropullit erdhën këtu në shekullin e 18-të si çifçinj nëpër çifliqet e latifondistëve shqiptarë”. Himara përmendej si një qytet ilir, kurse zona të Sarandës dhe Delvinës as përmendeshin fare si zona me popullsi greke. Shiko Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, *Fjalor enciklopedik*, Tiranë 1985, f. 270, 345-346.

113. Kofos Ev., *Minoritetet ballkanike në regjimet komuniste*, Selanik 1960, f. 27.

114. Petifer T., Vikers M., ref. i mësipërm f. 311.

115. Gjatë dhjetëvjeçarit të viteve 80-të vetëm në veriun shqiptar u emëruan më shumë se 300 kadro nga minoriteti grek. Barkas P., “Minoriteti grek gjatë regjimit të Hoxhës”, në Ciceliqis-Kristopulos, f. 225-264.

aplikoi shpërnguljen e detyruershme, internimin edhe burgimin e grekëve që shpalleshin disidentë të regjimit¹¹⁶ dhe paralelisht ngulitjen e shqiptarëve në zonat e minoritetit, duke krijuar njëkohësisht kushte shkëputjeje nga tradita kulturore greke¹¹⁷. Internimi i grekëve shoqërohej edhe me internimin e gjithë familjes apo marginalizimin e saj në vendet ku banonte. Internimi i grekëve fillimisht bëhej në kalanë e Gjirokastrës dhe më vonë në kampet e Spaçit, Burrelit dhe Vloçistit por edhe në fshatra të largëta, ku u privohej trajtimi shëndetësor edhe farmaceutik, furnizimi ushqimor, u nënshtroheshim torturave sistematike dhe rreth 10-12% e grekëve u dëbuan nga zonat e pastra greke.

Rezultat i kësaj politike që synonte në integrimin e grekëve në shoqërinë shqiptare është edhe numri i konsiderueshëm i martesave mikse¹¹⁸. Fëmijët që vijnë nga martesat mikse në

116. Cakas A., *Kronika e tragjedisë shumëvjeçare të Vorio Epirit. Martirologu i Vorioepirotëve*, Janinë, botim i Institutit të Studimeve Vorioepirote, 1999.

117. Shoqata i mësuesve grekë pensionistë të Minoritetit Kombëtar Grek të Vorio Epirit. *Potpuri folklorike të Minoritetit Kombëtar Grek të Vorio Epirit*, Gjirokastrë 2004. Kacalidhas Gr., *Identiteti i Helenizmit të Vorio Epirit*, Janinë, botim i Institutit të Studimeve Voreioepirote, 2004. Dajos St., *Komb i privuar nga trashëgimia. Letërsia popullore e grekëve të Shqipërisë*, Selanik, bot. Kuromanos, 1997, f. 18. I të njëjtit autor *Arsimi gjuhësor grek edhe kultura e Minoritetit Kombëtar Grek në Shqipëri gjatë kohës së totalitarizmit komunist*, Selanik 1995, f. 67. Përsa u përket veprave të minoritarëve grekë që propagandonin regjimin shiko librat e P. Çukës, *Jetë e lirë*, Tiranë 1953, Fjalë zemre, Tiranë 1981 dhe Këngët e kurbetit, Tiranë.

118. Pagesat denigruese detyronin grekët të gjejnë me çdo mënyrë edhe çdo kusht (kryesisht me martesat mikse) strehim në qytete edhe në qendrat e tjera urbane. Këtu duhet të mbahet parasysh njëkohësisht edhe emërimi i inteligjencës greke në të gjithë territorin shqiptar ose për nevoja të shtetit ose për arsëye se profesioni i tyre nuk kishte asnjë

qendrat urbane shqiptare kishin njohje të mangët ose mosnjohje të plotë të gjuhës greke dhe ishin plotësisht të integruar në një identitet kombëtar shqiptar.

Një metodë tjetër për degradimin e komunitetit grek ishte dhënia e emrave shqiptare ose ilire të grekët apo emrave të rinj –p.sh. Mareglen si rezultat i bashkimit të emrave Marks,

lidhje me zhvillimin ekonomik shoqëror të zonave minoritare. 50 % e tyre në qytetet e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës i përkasin kategorisë së martesave mikse. Gjithashtu, popullsia e qytetit të Himarës më 1990 arrinte në 8.5 mijë vetë. Numri i të burgosurve në kohën e regjimit komunist për shkaqe politike arrin në 2.700 vetë me dënime burgimi 12-15 vjet, pesë vetë u ekzekutuan dhe 3 vetë u dënuan më nga 101 vjet. 100 familje u zhvendosen. Njëkohësisht, sipas të dhënave të shoqatës së Himarës në Tiranë, numri i Himariotëve në territorin e Shqipërisë, kryesisht në qytetet Tiranë, Durrës. Vlorë, Fier dhe Lushnjë, përllogaritet në 10.000 vetë. Kurse numri i himariotëve që kanë mbaruar studimet universitare në Shqipëri arrin shifrën e 380 vetëve. Në Dhrovjan në periudhën e Hoxhës janë burgosur 29 vetë edhe 8 u ekzekutuan. Nga 18 mësues grekë që studiuan në Greqi, 7 janë burgosur edhe 9 të tjerë janë arratisur në Greqi për të shpëtuar. Ndërkohë 122 Dhrovjanitë kanë mbaruar universitetin në Shqipëri. Nga ata vetëm 14 kanë punuar në zonën e tyre kurse të tjerët në pjesën tjetër të territorit shqiptar. Për shkak të përndjekjeve dhe kushteve të vështira të jetesës janë larguar nga fshati 135 familje. Për rrjedhojë, në qoftë se fshati në vitin 1913 numëronte 1.630 banorë, në vitin 1990 kishte vetëm 780 banorë.

Poliçani në vitin 1913 numëronte 1.650 banorë. Në vitin 1985 në fshat banonin 585 vetë ose 136 familje grekësh dhe 23 familje oficerash shqiptarë. Fshati kishte 19 të burgosur ose 680 vjet burg dhe 95 familje të përndjekura. Nga Poliçani u larguan 250 familje dhe vetëm në Vlorë numërohen 156 familje poliçanjote.

Në Dhivër popullsia në vitin 1989 arrinte në 1.100 vetë. Në vitin 1990 në 700 vetë. Deri në vitin 1967 kishin përfunduar në burg 35 Dhivriotë, pesë prej tyre gra. Totali i viteve të burgut arrin në 268 vjet. Katër u dënuan me vdekje edhe dy vdiqën në burg. Në të njejtën periudhë, 25 vetë u arratisen në Greqi. Si ndëshkim 17 familje u internuan.

Engels, Lenin—por edhe ndryshimi i emrave grekë të vendbanimeve (p.sh. Theollogos i Sarandës në Partizani, Shën Nikollaos në Drita, Mavropullo në Buronja)¹¹⁹. Kjo u kombinua edhe me krijimin e vendbanimeve të reja me banorë shqiptarë të besimit fetar mysliman brenda zonave të pastra të minoritetit. Për shembull, që nga dekada e vitit 1950 u krijuan fshatra të reja, të ashtuquajturat “fshatra socialiste” në qarqet e Gjirokastrës (Valare, Vrisera, Asim Zeneli, Andon Poçi, Bulo e t.j.) edhe Sarandës (Fitorja, Davera, Gjashta e t.j.)¹²⁰. Gjithashtu u vu në efikasitet statusi i zonës së survejuar në zonat e minoritetit, të ndalim qarkullimit edhe të masave represive (p.sh. tela të elektrizuara në kufirin me Greqinë e t.j.), me gjithë dëshirën e Greqisë që ekzistenca e minoritetit të jetë një komponent miqësie edhe ure lidhëse midis popujve¹²¹.

Por më pas në vitin 1991 dhe me ndryshimet e regjimeve numri i pjesëtarëve të minoritetit grek u reduktua akoma më tepër, pasi një pjesë e madhe e grekëve emigroi në drejtim të Greqisë¹²². Gjithashtu regjistrimi i vitit 2001 nuk përfshiu kombësinë edhe për këtë arsye pjesëtarët e minoritetit nuk morën pjesë. Përlllogaritet se sot minoriteti grek përbëhet nga 400.000 vetë¹²³. Sot minoriteti konsiderohet “përherë i njohur

119. Numër 225/23.09.1975, vendim i kryesisë së Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë.

120. Papadhopullos G.H., referim i mësipërm, f. 190.

121. Ministri i jashtëm grek Karollos Papulias pas vizitës së tij në Shqipëri (nëntor 1987) Andonopullos H., Referim i mësipërm, f. 42.

122. Fekrat B., *Ethnik-Greeks in Albania*, Update Jonathan Fox (1995), Lyubov Mincheva (1999), f. 8.

123. Në një intervistë të tij në revistën *Der Spiegel* më 30 mars të vitit 1992, kryetari i Partisë Demokratike Sali Berisha deklaronte se minoriteti grek në Shqipëri nuk i kalon të 45.000 vetët.

si kombëtar”¹²⁴, diçka që tregon peshën e veçantë ideologjike të ekzistencës së një minoriteti grek në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri, kurse është njohur edhe ekzistenca e një minoriteti “maqedonas”¹²⁵, e një minoriteti “kombëtar malazez”, vllah, Roma, egjiptian e tj.

124. Është sinjifikativ vendi që i kushton *Raporti i Parë i Zbatimit të Konventës Kuadër për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare në Shqipëri, duke e konsideruar si minoritetin kombëtar më të rëndësishëm në Shqipëri*.

125. Gjatë kohës së regjimit të Hoxhës është njohur minoriteti “maqedonas” me popullsi 4.697 vetë sipas regjistrimit të vitit 1989. Poulton H., *The Balkans. Minorities and states in conflict*, London 1993, f. 195, 201-2002.

10. Çështja e arsimit të minoritetit grek

Çështja e arsimit të minoritetit grek përbën njëkohësisht një element të rëndësishëm në të gjithë problematikën në lidhje me ecurinë e marrëdhënieve shqiptaro-greke gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Pas dominimit të regjimit të Hoxhës arsimit u orientua drejt ndërtimit të shoqërisë socialiste.

Veçanërisht trajtimi i arsimit të minoritetit grek nga regjimi i Hoxhës, i cili në vitin 1996 bënte fjalë për 79 shkolla edhe një lice në gjuhën greke¹²⁶, karakterizohet nga përcaktimi (arbitrar) i zonave minoritare dhe të drejtën e fshatrave që ndodheshin brenda “zonave minoritare” të kenë shkolla, me përjashtim të zonës së Himarës. Në shkollat ekzistuese të arsimit bazë mësimi i gjuhës greke bëhet kryesisht deri në klasën e katërt¹²⁷. Në fshatrat e mëdha edhe në qytezat e jugut të vendit, siç është Gjirokastra, Saranda, Përmeti, Korça, Vlora, Himara, si edhe Fieri edhe Tirana, ku gjithashtu numri i grekëve është mjaft i konsiderueshëm, nuk lejohet ekzistenca e shkollave të arsimit të shkallës së parë pasi nuk përfshihen në zonën minoritare¹²⁸.

Objektivin e përcaktonte partia në kongreset e saj të ndryshme¹²⁹, si edhe Kushtetutat e vitit 1946 edhe 1976¹³⁰

126. E. Hoxha, *Dy popuj miq* referim i mësipërm, f. 39.

127. Wahling S., “Die Grechen in Albanien”, *Das Parlament*, 8.11.1991.

128. Procesverbale të Kongresit të 2të Shkencor Panhelenik, *Çështja Vorioepirote (E shkuara-e tashmja-e ardhmja)*, Athinë, botim Mitri. I Dropullit, Pogonit edhe Konicës, 1991.

129. M. Shehu, Raport në lidhjen me planin e gjashtë 5-vjeçar (1976-1980), Tiranë 1976.

130. Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Athinë, bot. Poria, 1977.

edhe ndryshimet e tyre (1955, 1967), si edhe ligji për sistemin arsimor¹³¹. Në raportin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë për ligjin 4623 –statuti i Arsimit që u përpilua në vitin 1969– ndër të tjera shënohet si më poshtë: “Sistemi arsimor bazohet mbi parime demokratike socialiste, përshkohet plotësisht nga boshti ideologjik marksist-leninist... Arsimi 8-vjeçar ka për synim që në bazë të moshës së nxënësve... të përgatiten për të marrë pjesë në jetën sociale edhe në prodhimin socialist... Arsimi i mesëm ka për detyrë që në bazë të moshës të pajisë nxënësit me formim të shëndoshë marksist-leninist, shkencor edhe politeknik... Arsimi i lartë realizon këto detyra në bazë të forcimit të boshtit ideologjik marksist-leninist edhe unitetit organik të mësimin me punën prodhuese edhe me edukimin fizik edhe ushtarak”¹³².

Objektiv i arsimit ishte krijimi i një qytetari të tipit të ri, të orientuar drejt marksizëm-leninizmit, i përkushtuar ndaj Hoxhës edhe shtetit shqiptar, që nuk do të ketë lidhje me fetë edhe origjinat kombëtare¹³³.

131. Gazeta *Llaiko Vima*, Gjirokastër 28.10.1969

132. Papadhopollos, f. 108.

133. Gazeta *Zëri i Omonias*, 24.09.1993, Papadhopollos J., *Minoriteti Kombëtar Grek në Shqipëri edhe çështja e saj shkollore*, Janinë 1981, f. 127-170 (sipas raportit analitik të inspektorit shqiptar Kol Koçi) dhe Wissenschaftlicher Dienst, 1953, f. 16, 24. Kapsalis J., *Arsimi i minoritetit grek të Shqipërisë. Tekste shkollore. Kualifikimi gjuhësor. Përspektiva*, Athinë, shtëpia botuese Gutenberg, 1996 edhe Paskalis A., *Leximet letrare të pas luftës të minoritetit grek të Shqipërisë. Trajtim gjuhësor edhe ideologjik*, Athinë, shtëpia botuese Gutenberg, 1998.

11. Liria fetare e minoritetit grek edhe marrëdhëniet shqiptaro-greke

Liria fetare e minoritetit grek ishte një kapitull i rëndësishëm në marrëdhëniet midis Greqisë edhe Shqipërisë në periudhën e Luftës së Ftohtë, kurse veçanërisht Kisha Ortodokse e Shqipërisë qëmoti përbënte një faktor vendimtar në ecurinë e marrëdhënieve greko-shqiptare¹³⁴. E gjithë historia e Kishës Ortodokse Shqiptare është e lidhur në mënyrë të pandashme me shkallën e influencës greke në zhvillimin edhe në përpjekjen e saj për t' u distancuar nga Patrikana Ikumenike e Stambollit. Qe nga koha e themelimit të shtetit shqiptar, shqiptarët kultivonin idenë e krijimit të Kishës Autoqefale Shqiptare si mjetin për eliminimin e influencës së Patrikanës edhe të Greqisë mbi ortodoksët e Vorio Epirit. Nismëtar i lëvizjes së shqiptarizimit ishte Fan Noli. Më 10 shtator të vitit 1922 u mbajt në Berat (Berat-Antipatria e lashtë) një Kongres Fetar-Laik, i cili shpalli si autoqefale Kishën Ortodokse të Shqipërisë edhe emëroi Këshillin e Lartë Kishtar Tetë Anëtarësh¹³⁵. Por me që Patrikana

134. Gllavinas, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*, Selanik 1989, Angjellopulos A., *Njerëzit e Ortodoksisë sot në Ballkan*, Selanik 1992, f. 19-114 dhe Gllavinas A., *Çështja Autoqefale e Kishës Ortodokse në Shqipëri në bazë të shkresave të pabotuara*, Janinë, Firma botuese e Studimeve Epirote-Instituti i Studimeve të Jonit edhe Hapësirës së Adriatikut, 1978.

135. Metalinos J., "Gjendja Kishëtare në Vorio Epir si Autoqefale", Procesverbale të Kongresit të 2-të Shkencor Panhelenik, Konicë, 1990, f. 305-339. Duhet njëkohësisht të shënojmë se kryeministri i vendit në vitin 1924 Fan Noli edhe përfaqësues i nacionalistëve shqiptarë

Ikumenike nuk e njohu aktin në fjalë, qeveria shqiptare në fillimet e vitit 1929 vendosi që të zgjidhë në mënyrë definitive problemin kishëtar pa aprovimin e Patrikanës. Kështu më 11 shkurt të vitit 1929 mbreti Zog shpalli sërish Kishën Ortodokse Shqiptare si Autoqefale dhe krijoi Sinodin e Shenjtë. Kjo shkaktoi reagimin e përgjithshëm të të krishterëve të Shqipërisë, që e detyroi Zogun të kërkojë nga Patrikana e Stambollit njohjen e Kishës Ortodokse Shqiptare si Autoqefale (Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare), gjë që Patrikana e bëri më në fund më 12 prill të vitit 1937 pas shumë konfliktesh edhe negociatash.

Me marrjen e pushtetit nga Hoxha u krijua për Kishën Ortodokse (ashtu si edhe për fetë e tjera)¹³⁶ një kuadër shumë negativ¹³⁷ me përndjekje edhe ekstradime të funksionarëve kishëtarë, sekuestrim të pronave, mbyllje të kishave edhe manastireve, që u shndërruan në banesa, magazina, qendra kulturore e tj. –Kryepeshkopi i fundit ishte Kristoforos (Kissis), i cili vdiq në vitin 1958–, një kuadër që veproi kështu në mënyrë frenuese në kursin e saj për evoluimin e brendshëm edhe kontaktin me shoqërinë shqiptare.

Në vitin 1949 me dekretin numër 743/26.11.1949 “lidhur me komunitetet fetare” u sekuestrua edhe u shtetëzua prona e tundshme edhe e patundshme e kishave edhe manastireve

-
- me largimin e tij nga vendi krijoi organizatën Vatra dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u muar me “krijimin edhe organizimin e kishës ortodokse shqiptare”, e cila ekziston akoma sot, kurse vetë ai u konsiderua “peshkop i Bostonit” dhe pak më vonë kryepeshkop.
136. Në vitin 1945 në totalin e popullsisë së Shqipërisë prej 1.180.500 vetesh përllogaritej se ekzistonin 826.000 myslimanë –600.000 sunitë edhe pjesa tjetër bektashinj– si edhe 212.500 të krishterë ortodokse dhe 142.00 katolikë, refer. i mësipërm f. 94.
137. Akroqeravnios, *Perëndimi i diellit të Perëndive në Shqipëri*, bot. Paniprotikos Agonas, 1976.

edhe u forcua më tej kontrolli i shtetit mbi kishën. Pasojat nga zbatimi i dekretit në fjalë ishin më së të rënda për minoritetin grek. Kjo për shkak se në kohën e sundimit turk të krishterët e Shqipërisë në përpjekjen e tyre për të shpetuar pronat e tyre nga sekuestrimet otomane ia kalonin ato kishës si institucion i njohur nga Perandoria Otomane. Kisha kishte atëherë pozicion institucional edhe status grek. Për rrjedhojë, së pari me Kishën Ortodokse si Autoqefale në shtetin shqiptar të porsakrijuar dhe në vazhdim me dispozitat e këtij lloji, pronat në fjalë direkt apo indirekt i kaluan shtetit shqiptar duke ua privuar ato (pasuritë e patundshme) grekëve.

Në bazë të dekretit lidhur me “komunitetet fetare” u përpilua karta e re statuore, që u aprovua nga Kongresi i Tretë Klerikolaik i Tiranës (1950), e cila në nenin 4 shënonte se “Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare kishte për detyrë t’ u kultivonte besimtarëve ndjenjat e besimit ndaj pushtetit të popullit dhe Republikës Demokratike të Shqipërisë, si edhe të dashurisë për atdheun dhe forcimit të unitetit kombëtar”¹³⁸. Në vazhdim polemika kundër Kishës Ortodokse u intensifikua. Në vitin 1963 Hoxha theksoi se “lufta kundër botëkuptimeve fetare ishte një luftë afatgjatë, e ndërlikuar edhe e vështirë”¹³⁹ dhe shtonte se “rreziku bazë të cilin duhet ta ndalojmë është çështja e liturgjisë së krishterë ortodokse. Duhet të bëjmë përpjekje të vazhdueshme që t’ u neveritet njerëzve, në mënyrë që të mos shkojnë në kishë. Detyra jonë është që kur bie këmbana e kishës njerëzit të mos shkojnë atje. Atje ku ekziston mundësia kishat të shëmben, natyrisht jo me fushata por në vartësi të rasteve të ndryshme. Ajo çka është e drejtë edhe duhet bërë është që nga ana e administratës të bëhen përpjekje të vazhdueshme

138. Xorxatu B., *Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare edhe institucionet bazë të administrimit të saj*, Athinë 1975, f. 45.

139. Hoxha E., *Raporte edhe fjalime 1967-1968*, Tiranë 1969, f. 207.

që të mos i akordohet asnjë ndihmë materiale kishës së krishterë për kultivimin e ideologjisë së saj. Me mënyra edhe metoda të ndryshme të ndalohet rënia e këmbanave, të mos zhvillohet mësimi i fesë e t.j. Kështu që do të vijë ora që feja do të falimentojë plotësisht. Duhet të dimë se frekuentuesit e kishës përbëjnë detashmentin potencial të armikut. Kështu po bëhet e qartë për ne se sa janë forcat që duhet të përballojmë”¹⁴⁰. Gjithashtu pretendonte se kurorëzimi i përpjekjes kundër kishës “do të çlironte popullin nga regresi, nga prangat e modeleve patriarkale, të paragjytimeve, të bindjeve edhe ndasive fetare dhe të kalbëzimit të së kaluarës”¹⁴¹.

Në vitin 1967 me dekretin 4337/13.11.1967 në lidhje me “atoninë (fiktivitetin) e disa dekreteve” dhe me sanksionimin që u bë me Kushtetutën e vitit 1977 u vendos ateizmi në Shqipëri, e cila shpallet si shteti i parë ateist në rruzullin tokësor duke nisur kështu periudhën e likuidimit të plotë të Kishës Ortodokse (edhe të dogmave edhe feve të tjera). Në vitin 1967 burgoset edhe kreu i Kishës Ortodokse Dhamianos (Kokonessis), i cili do të vdesë në burg në vitin 1973¹⁴² edhe mbyllen rreth 630 kisha.

Është fakt se feja është e lidhur ngushtë me të gjithë jetën zakonore të minoritetit kombëtar grek (Lindja, martesat dhe akoma më shumë vdekja, punët e përditshme apo Krishtlindjet, Pashkët, Festa e Shënmerisë). Bile në kushtet e izolimit nga trangu kombëtar, institucioni në fjalë ishte veçanërisht i vendosur në ruajtjen e identitetit kombëtar. Hoxha nuk u mjaftua vetëm me kaq, por synoi në zëvendësimin e këtyre festave me ato të ideologjizuara qartë veçanërisht përsa i përket

140. E. Hoxha, *Veprat*, Tiranë 1964, f. 89-98.

141. E. Hoxha, *Simbol i luftës për liri edhe socializëm*, Tiranë 1985, f. 107.

142. Mitropolit i Dropullit Sevastianos, *Vorio Epiri i kryqëzuar*, Konicë 1984, f. 44.

minoritetit kombëtar grek si: Në Vrisera të Dropullit të Sipërm, në prag festës së 15 gushtit Hoxha trilloi festën e krijimit të një njësie partizane komuniste të minoritarëve dhe lejonte, në një zonë ku ndalohej qarkullimi i lirë i përditshëm, për shkak të afërsisë me kufirin greko-shqiptar, grumbullimin e mijëra njerëzve, duke e afirmuar festën në fjalë si më të madhen për minoritetin grek dhe duke e vënë në të njëjtin plan me atë të 15 gushtit. Manastiri i Pepelit, në kujtesën historike të zonës më gjerë, si në Greqi po kështu edhe në Shqipëri, bile edhe në zona myslimane, ishte qendra fetare kombëtare edhe bamirëse. Në vitin 1959, pikërisht ditën e Frymës së Shenjtë, Hoxha vizitoi një fshat fqinj me Pepelin. Disa vite më vonë dita e vizitës së tij në këtë fshat u shndërrua në një “festë të re socialiste”, jo vetëm për këtë fshat por për të gjitha fshatrat e zonës përreth.

Në këtë kuadër nuk mund të harrojmë se regjimi i Hoxhës dislokoi në 22 manastire dhe kisha të zonës së Mitropolisë së Gjirokastrës reparte ushtarake, kurse pjesën tjetër të kishave edhe manastireve ose i shembi ose i shndërroi në vatra kulture për edukimin komunist të brezit të ri, ose në magazina edhe stalla. Vetëm një numër të vogël, 10 nga 400 institucione fetare në Mitropolinë e Gjirokastrës, i ruajti si monumente kulture për t’ ia paraqitur Perëndimit si dëshmi të prejardhjes së krishterë të vendit të tij (Hoxha kurrë nuk i kishte paraqitur Perëndimit material propagandistik me xhami).

Në veprimet e regjimit kundër Kishës Ortodokse, që u njëjtësua me komunitetin grek, u shtuan edhe ndalimet e panairëve fetare të cilat u zëvendësuan nga dita e ndërtuesve, e metalurgëve, e topografëve e tj¹⁴³. Mbajtja e simboleve fetare,

143. Prifti P., *Socialist Albania since 1944. Domestic and foreign developments*, Massachusetts, The MIT press, 1978, f. 162.

zhvillimi i riteve fetare dënoheshin me burg edhe internim, kurse me dekretin 5339 u imponua ndryshimi i emrave të krishterë edhe grekë me emra të tjerë në bazë të listës së aprovuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, konform standarteve politike, ideologjike edhe morale të shtetit. Grekët morën urdhër që të ndryshojnë menjëherë emrat si edhe mbiemrat e tyre, kurse në këtë periudhë, siç e përmendem, ndryshuan emrin edhe më shumë se 90 fshatra edhe qytete ku banonin minoritarë grekë. Ndërkaq ndryshimi i emrave nuk iu imponua gjithë popullsisë pasi u përjashtuan ata që mbanin emra myslimane, midis tyre edhe vetë Hoxha¹⁴⁴. Kushtetuta e vitit 1976 kodifikoi veprimet kundër fesë përderisa konsiderohej si i jashtëligjshëm çdo lloj veprimi apo propagande fashiste, fetare, luftënxitëse, antisocialiste dhe çdo lloj prodhimi dhe shpërndarje apo posedim të letërsisë fetare dënohej me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Këtu duhet të shënohet edhe fakti se në fushatën kundër Kishës Ortodokse merrnin pjesë edhe minoritarë grekë, pjesëtarë ose jo të aparatit të partisë, duke treguar zell të tepruar në imponimin e ateizmit. Paralelisht ndalimi i çdo aktiviteti fetar që nga viti 1967 goditi drejtpërdrejt edhe Kishën Ortodokse të Shqipërisë duke neutralizuar ndjeshëm ndërgjegjën fetare si nyje lidhëse tipike midis ortodoksëve shqiptarë, vllahëve edhe grekëve.

Rehabilitimi i Kishës Ortodokse filloi të realizohet në vitin 1991, kur Patrikana e Stambollit emëroi, pas kërkesës së drejtuar ndaj saj nga ana e qeverisë shqiptare, peshkopin e Andruses Anastasios Janullatos si mitropolit edhe ekzark të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, por Shqipëria nxjerr vazhdimisht pengesa ndaj Kishës Ortodokse.

144. Poulton H., refer. i mëspipërm, f. 199.

12. Minoriteti grek pas ndryshimit të regjimit komunist në Shqipëri

Regjimi shqiptar, megjithëse ishte nga regjimet më të rrepta të socializmit ekzistues edhe populli nuk informohej veçse në mënyrë fragmentare për zhvillimet ndërkombëtare, kryesisht përmes televizionit italian në veri edhe atij grek në jug, po jepte shenja se nuk do t' u rezistonte ndryshimeve që po shënoheshin në vendet e Evropës Lindore. Vdekja e Hoxhës (1985) tronditi regjimin. Ndërkaq rënia e Murit të Berlinit ishte sinjali për aktivitete masive nëpër vatra, si ato studentore edhe intelektuale, me kërkesë të përbashkët demokratizimin e vendit. Atëherë shkrimtari i njohur Ismail Kadare kërkoi azil politik në Francë duke dënuar regjimin e Partisë së Punës. Në mars të vitit 1990 realizohet lirimi i të burgosurve politikë si ofrimi i parë i lirive demokratike nga lidërshipi i Partisë së Punës së Shqipërisë, kurse nga shtatori i të njëjtit vit filluan diskutimet për organizimin e minoritetit grek (“OMONIA”) në Tiranë, Sarandë edhe Gjirokastër, me gjithë goditjen e rëndë që kishte pësuar nga burgimi i S. Dhe F. Qirjazatit, V. Kromidhes, B. Karathanos, Gr. Qirushit dhe K. Zotos, të cilët ishin orvatur t' i dërgojnë letër kryeministrit grek për shkëljen e të drejtave të tyre. Shqipëria kalon situata të vështira me ekonominë e saj të rrënuar plotësisht. Në pjesën e tyre dërmuese qytetarët shqiptarë, pas mungesave të mëdha të artikujve bazë, përballeshin tani me makthin e urisë. Me mundësimin e qytetarëve nga ana e regjimit për të udhëtuar jashtë shtetit edhe hapjen e kufirit, ishte më se e qartë se nuk funksiononin as mekanizmat represivë edhe imazhi i shpërbërjes së vendit

përftonte thekse më të mëdha në zonat kufitare me Greqinë, zona ku dyndeshin me qindëra shqiptarë edhe grekë¹⁴⁵. Hordhi qytetarësh shqiptarë të raskapitur përshkonin kufirin edhe kalonin në territorin grek duke kërkuar ndihmë, një gjendje që pati si rezultat rritjen e indeksit të vdekshmërisë foshnjore në 8%¹⁴⁶. Hyrja e refugjatëve nga Shqipëria pas vitit 1991 ishte fillimi i një rruge të re për ta si në Shqipëri po kështu edhe në territorin helen, por me emigrimin në Greqi të moshave prodhuese dhe të fëmijëve u krijua një boshllëk i madh në zonat minoritare të Shqipërisë, që u bë akoma më i madh me fluksin e dytë të emigrimit të vitit 1997.

Pas rënies së regjimit të Partisë së Punës së Shqipërisë Bashkimi Demokratik i Minoritetit Kombëtar Grek (“OMONIA”) në një peticion të tij drejtuar Konferencës Për Sigurinë edhe Bashkëpunimin në Evropë (Moskë 1991) pretendonte se minoriteti grek numëron 300.000 vetë, duke bërë njëkohësisht fjalë për “ndarje arbitrare gjeografike të minoritetit edhe genocid statistikor”. Një eksponent i Organizatës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut në një studim të tij në Shqipëri thekson se numri i vërtetë i grekëve të Shqipërisë arrin në 300.000 vetë edhe është i shpërndarë në të gjithë vendin, duke deklaruar se vetëm në Tiranë jetojnë rreth 15.000 vetë¹⁴⁷. “OMONIA” në peticionet e saj pas vitit 1991 drejtuar organizmave ndërkombëtare (KSBE, OSBE, B.E. e tj.) bënte fjalë për përcaktim arbitrar gjeografik të minoritetit, genocid statistikor, tjetërsim të dhunshëm etnologjik të fshatrave greke, dëbimin

145. Dhodhos Dh., *Gjeografia elektorale e minoriteteve. Partitë minoritare në Ballkanin Jugor, Greqi, Bullgari, Shqipëri*, Athinë, shtëpia botuese Eksandas, 1994, f. 126.

146. Fondacioni Kombëtar i Pritjes edhe Rehabilitimit të Homogjenëve Grekë të Rikthyer, *Raport veprash 1991-1995*, Athinë, 1996, f. 23.

147. Sylvia Waehling, gazeta *Zëri i Omonias*, 3.12.1991.

e grekëve nga e ashtuquajtura “zonë minoritare”, çhelenizim kulturor, shtypje edhe asimilim, ndalimin e përdorimit të emrave nëpër pagëzimet, ndalimin e aktiviteteve fetare edhe në esencë denonconte fenomenet negative që vërrehen veçanërisht në aspekte që kanë të bëjnë me çështje esenciale të ekzistencës dhe të së ardhmes së minoritetit¹⁴⁸.

Nga ana tjetër, në korrik të vitit 1991 parlamenti shqiptar aprovoi ligjin në bazë të të cilit nuk lejohej krijimi i partive mbi “baza kombëtare, fetare apo lokale”, një veprim që drejtohej drejtpërdrejt kundër organizatës së grekëve të Shqipërisë. Më në fund, në shkurt të vitit 1992, gjatë aprovimit të ligjit elektoral në bazë të të cilit do të zhvilloheshin zgjedhjet e marsit të vitit 1992, u përfshi një dispozitë që ndalonte pjesëmarrjen e “Omonias” në zgjedhjet, një veprim që pati si rrjedhojë largimin në shënjë proteste të 5 deputeteve të organizatës “Omonia” nga parlamenti.

Si zgjidhje alternative që lejonte pjesëmarrjen e grekëve në procedurën zgjedhore, u krijua “Partia e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut” me shtrirje mbarëshqiptare. Një parti e cila bashkoi rreth vetes kryesisht grekët por edhe disa minoritete të tjera (Serbët, malazezët) përmes së cilës u bë e mundur që të gjejë shprehjen e saj politike “OMONIA”, qoftë edhe në mënyrë indirekte. Në zgjedhjet e vitit 1992 PBDNJ zgjodhi vetëm 2 deputetë.

Më 27 korrik të vitit 1992 u zhvilluan zgjedhjet për pushtetin vendor. Kishte paraprirë ndarja e qarkut të Sarandës dhe krijimi i qarkut të Delvinës. Ishte një tjetër përpjekje për restriktimin e përfaqësimit dhe të drejtave politike të minoritetit, një përpjekje që solli rezultat tjetër pasi u zgjodhën mjaft grekë si prefektë edhe kryetarë bashkish.

148. Kondis V. - Manda E., 1994, referim i mësipërm.

Në maj të vitit 1993 paraqiten tezat bazë të “Omonias” me “Rezolutën për të Drejtat e Minoritetit Kombëtar Grek të Shqipërisë” që i dërgohet presidentit Sali Berisha dhe kryetarit të parlamentit Pieter Arbnori si edhe kryeministrit Aleksandër Meksi. Në rezolutë paraqiteshin të drejtat themelore që organizata rivendikonte në emër të gjithë minoritetit grek. Veçanërisht “Omonia” bënte fjalë për:

A. Të drejtën e mësimdhënies, arsimimit edhe edukimit në gjuhën amtare në të gjitha nivelet edhe instancat e arsimit, atje ku pjesëtarët e minoritetit përbëjnë shumicën apo një pjesë të konsiderueshme të popullsisë.

B. Mësimin e gjuhës amtare, e drejta e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, ushtrimi i obligimit të të drejtave të tyre fetare.

C. Krijim të lirë edhe pjesëmarrje në çdo lloj skeme politike, të drejtën e garantimit të pjesëmarrjes së anëtarëve të komunitetit në të gjitha nivelet edhe instancat e pushtetit si edhe të drejtën e emigrimit edhe të kthimit pas. E fundit.

Ç. Kërkohej që identiteti kombëtar të përcaktohet në bazë të deklaramit të lirë të çdo qytetari, momentin e regjistrimit të popullsisë¹⁴⁹.

Vitet 1993 edhe 1994 shënojnë një periudhë kritike në marrëdhëniet greko-shqiptare me ekstradimin nga Gjirokastra të arkimandritit Krisostomos Aidhonis me akuzën e veprimeve antishqiptare, një akt që shkaktoi episode të dhunshme midis grekëve të minoritetit edhe autoriteteve shqiptare.

Në qershor të vitit 1994 burgosen 5 kuadro të “Omonias” Theodoris Bezhanis, Vangjelis Papakristos, Iraklis Sirmos, Konstandinos Qirjaku, Panajotis Martos. Mbahen në izolim dhe u ndalohet të zgjedhin këshilltarin e tyre juridik. Ministria e Drejtësisë do të caktojë datën e gjyqit më 15 gusht të vitit

149. Rezolutë për të Drejtat e Minoritetit Kombëtar Grek në Shqipëri, Sarandë, maj 1993.

1994 me akuzën e veprimtarisë agjenturore edhe të tradhëtisë së lartë, një “akuzë” siç theksoi atëherë kryeministri grek në letrën e tij drejtuar liderëve të huaj “që ka formën e një teksti politik të paqartë... në një kohë që qëndrimi i autoriteteve shqiptare ka si pasojë që një numër i madh i grekëve të Shqipërisë të detyrohet të vendoset në Greqi pasi të drejtat e tyre politike edhe arsimore si edhe liritë e tyre fetare kufizohen në mënyrë sistematike. Kultivon në mënyrë të vazhdueshme një klimë përndjekjeje kundër minoritetit grek duke synuar në dekurajimin e minoritetit edhe në inkurajimin e tij për të braktisur Shqipërinë”¹⁵⁰.

Kushtet në të cilat u zhvillua gjyqi në fjalë u konsideruan të papranueshme dhe shkaktuan reagimin e përgjithshëm edhe denoncimin e sistemit shqiptar të drejtësisë. Gjatë zhvillimit të saj u shënuan bile edhe episode në kurriz të gazetarëve grekë edhe të huaj, avokatëve edhe personave të tjerë që ishin prezentë në gjykatën shqiptare, ndërsa nga pala greke nuk munguan edhe reagimet tejet të veçanta që arriten kulmin me fluturimin e një togeri të forcave ajrore mbi Vlorën edhe Sarandën edhe hedhjen e trakteve me përmbajtje antishqiptare.

Në shtator të të njëjtit vit dënohen të “5 kuadrot drejtuese të Komunitetit Grek, me dënime të rënda që pasuan parodinë e fazës hetimore edhe procedurës juridike, siç konstatuan edhe vëzhguesit e paanshëm të organizmave ndërkombëtare”, kurse paralelisht do të vazhdohet edhe vala e terrorizimit të komunitetit grek të Shqipërisë “me qëllim që pjesëtarët e tij të detyrohen të braktisin vatrat e tyre amtare”¹⁵¹.

150. Papandreu A., Deklaratë më 8/08/1994 Fondacioni Grek për Politikën e Mbrojtjes edhe atë të Jashtme, Vjetar i Politikës së Mbrojtjes edhe asaj të Jashtme, Athinë 1995, f. 229.

151. Papulias K., Fjalim në sesionin e 49-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Nju Jork 28 shtator 1994, Fondacioni Grek, referim i mësipërm, f. 310.

Përballë zhvillimeve të tilla edhe pala greke nga ana e saj mbajti qëndrim të rreptë. Duke ndërprerë që nga momenti i arrestimit të kuadrove të “Omonias” çdo dialog me palën shqiptare dhe duke vendosur si kusht për rifillimin e tij lirimin e të burgosurve. Njëkohësisht bëri kujdes që të mbajë aktiv interesimin e komunitetit ndërkombëtar duke denoncuar aktet shqiptare pranë të gjithë organizmave ndërkombëtare dhe duke bllokuar ofrimin e ndihmës prej 35 milionë ECU, që Bashkimi Evropian kishte programuar në mbështetje të Shqipërisë.

Më 6 nëntor të vitit 1994 qeveria shqiptare mori një goditje të rëndësishme në frontin e brendshëm me refuzimin nga ana e popullit shqiptar të projekt-Kushtetutës që i ishte nënshtruar plebishitit, një projekt që akuzohej se në shumë aspekte nuk siguronte respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe nuk ishte konform standarteve ndërkombëtare. Bile në projekt-Kushtetutë përfshihej edhe një dispozitë për Kishën Ortodokse të Shqipërisë që theksonte veçanërisht se kreu i saj duhej të ishte shtetas shqiptar, dispozitë e cila drejtohej kundër kryepeshkopit Anastasios Janullatos. Në nenin 7 paragr. 4 të projektit parashikohej se “krerët e komuniteteve të mëdha fetare duhet të jenë shtetas shqiptarë, të lindur në Shqipëri edhe me banim të vazhdueshëm në të gjatë 20 viteve të fundit”. Dispozita në fjalë ishte në fakt e pamundur të realizohej duke marrë parasysh ndalimin e fesë që ishte vendosur në Shqipëri. Në thelb rregullimi në fjalë kishte për synim largimin e Anastasios nga froni i kryepeshkopit, një zhvillim që u evitua me hedhjen poshtë nga votuesit të projekt-Kushtetutës.

Me ndërhyrjen edhe të komunitetit ndërkombëtar të “pestët” do të lirohen, njëri prej tyre ishte liruar më parë për arsye shëndetësore. Vendimi hapi rrugën për afrimin e të dy vendeve, që u kurorëzua me udhëtimin e ministrit të jashtëm grek në Tiranë më 13 mars të vitit 1995. Kjo vizitë shënoi rifillimin e

dialogut dhe inagurimin e një sërë vizitash të delegacioneve të të dy vendeve për avancimin e çështjeve bilaterale. Në këtë kontekst u vendos ngritja e komisioneve të posaçme që do të ngarkoheshin me zgjidhjen e çështjeve më të rëndësishme si të arsimit grek, të bashkëpunimit ekonomik, të kufirit edhe të bashkëpunimit ushtarak, të rendit publik, të autoriteteve konsullore e tj. Interesimi i palës greke u përqendrua veçanërisht në çështjen e respektimit të të drejtave të minoritetit grek dhe të heqjes së zonave minoritare, kurse pala shqiptare shtroi kryesisht çështjen e rregullimit të problemit të emigrantëve klandestinë. Kështu u duk se normalizimi i marrëdhënieve greko-shqiptare ishte vendosur mbi baza të reja dhe se problemet ekzistuese do të përbënin tashmë objekt të një shqyrtimi sistematik edhe të përgjegjshëm dhe jo fushë ballafaqimi.

Kushtetuta postkomuniste në nenin 20 thotë: “Personat që u përkasin minoriteteve kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit liritë e tyre. Kanë të drejtë të shfaqin lirshëm, pa pengesa dhe pa ndalime originën e tyre kombëtare, kulturore, fetare edhe gjuhësore. Kanë të drejtën e ruajtjes edhe kultivimit të tyre, të mësimdhënies dhe mësimi në gjuhën e tyre amtare, si edhe të bashkohen në organizata edhe shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre”. Ndërkaq Shqipëria nuk respekton dispozitat kushtetuese në lidhje me të drejtat e minoritetit grek.

Nga ana e saj Greqia mbështet Shqipërinë në forma të larmishme. Objektivi i politikës greke, pas ndryshimit të regjimit të Shqipërisë më 1991, është sigurimi i stabilitetit, zhvillimit edhe begatisë së Shqipërisë, kursi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (edhe në NATO), me kusht sigurisht respektimin e kritereve edhe kushteve që vendos B.E. Një akt i rëndësishëm që shënoi zhvillimin edhe zgjerimin e bashkëpunimit bilateral ishte nënshkrimi më 21 mars të vitit 1996 i Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë edhe Sigurisë

nga ministrat e jashtëm të të dy vendeve në Tiranë, që pasoi periudhën e përndjekjeve të grekëve për arësye politike (“gjiyqi i të pestëve”) edhe fetare (kryepeshkopi Anastasios). Traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë edhe Sigurisë që nënshkroi Greqia me Shqipërinë më 1996 tregon kujdes të veçantë për minoritetin grek si më poshtë: *“Minoriteti Kombëtar Grek në Shqipëri kontribuoi dhe vazhdon të kontribuojë në një shkallë të konsiderueshme në jetën e shoqërisë shqiptare edhe përbën faktor për zhvillimin e miqësisë midis të dy vendeve*¹⁵².

152. Gazeta Zyrtare A. Nr. 8.

13. Pasiguria në Shqipëri edhe klima e terrorit

Një çështje shqetësuese është ajo e sigurisë edhe jetesës. Qe në vitet e para të ndryshimit të regjimit vihet re një valë vjedhjesh në rritje, sulmesh edhe lëndimit të Komunitetit Grek që arriten kulmin me aktet e dhunshme kundër shoqëruesit të kryetarit të seksionit të “Omonias” së Gjirokastrës edhe prefektit të Delvinës (28.07.1993). “Minoritarë” grekë mendojnë se aktet në fjalë drejtohen direkt kundër mbijetesës ekonomike por edhe vetë ekzistencës së komunitetit¹⁵³. Rritja e rasteve të dhunës edhe për rrjedhim shqetësimi i komunitetit grek nënvizohet edhe në raportin e komisarit të lartë të K.S.B.E. Maks Van der Stul së bashku me urimin-sugjerimin për mbrojtje më efikase të popullsisë¹⁵⁴.

Çështjet e sigurisë së minoritetit grek kanë proekupuar edhe organizma ndërkombëtare edhe përfaqësuesit e tyre në Shqipëri përderisa “pasiguria edhe mungesa e rendit pezullojnë çdo përpjekje të rigjallërimit ekonomik në hapësirën e Minoritetit Grek, rastet janë shumë më të shumta se në çdo zonë tjetër. Minoriteti grek jo vetëm që nuk gëzon mbrojtje të veçantë si i tillë edhe përsa u tha më sipër nga shteti, por shpesh bëhet objekt aktesh të përfqësuesve të rendit edhe të shtetit. U

153. Bashkimi Demokratik i Minoritetit Kombëtar Grek OMONIA “Komuniteti Kombëtar Grek në Shqipëri në një klimë Pasigurie edhe Terrori”, Gjirokastër, gusht 1993.

154. Letter from the C.S.C.E. High Commissioner on National Minorities, to the Minister of Foreign Affairs of Albania, 19/09/1993.

theksua gjithashtu se gjithë këto vite Minoriteti Kombëtar Grek ishte objekt destabilizimi të ekuilibrit midis dy komuniteteve kryesore në jug të vendit, gjë që nuk u realizua. Përpjekjet ishin të karakterit fetar, politik dhe ekonomik e tj. Por ajo që u vu re ishte se nga fërkimet e vazhdueshme në fjalë pjesëtarët e Minoritetit Kombëtar Grek zgjodhën rrugën e largimit, që do të thotë se në mënyrë indirekte u dëbuan nga vendi i tyre”.

Greqia, nga ana e saj, ka theksuar klimën e terrorit që ekziston në fshatrat minoritare me raste të njëpasnjëshme rrëmbimesh edhe shantazhesh që përforcojnë ndjenjën e pasigurisë të grekëve të zonës. Greqia gjithashtu ka ndërhyrë pranë vendeve anëtare të Bashkimit Evropian duke kërkuar rritjen e asistencës komunitare ndaj Shqipërisë fqinje, me synim përmirësimin e infrastrukturës edhe zhvillimin e zonave ku banon minoriteti grek. Bile herë pas here, në përpjekjen për mbrojtjen e pjesëtarëve të minoritetit, Greqia, Bashkimi Evropian edhe organizmat ndërkombëtare kanë dërguar ekspertë në zonën e minoritetit me qëllim forcimin e sigurisë.

14. Arsimi në minoritetin grek edhe problemet e tij

Pas Luftës së Ftohtë arsimimi i grekëve vazhdon të përballet me probleme përderisa pala shqiptare vazhdon të nxjerrë pengesa, për rrjedhojë arsimi në gjuhën amtare për grekët e mbetur vazhdimisht po vështirësohet.

Me njohjen si zonë minoritare të 99 fshatrave të qarqeve të Gjirokastrës edhe Sarandës nga Partia e Punës e Shqipërisë edhe vazhdimin e të njëjtit status të komunitetit nga regjimi shqiptar i “ndryshuar”, grekët për rrjedhojë u privuan nga arsimi grek por edhe ata që ndiqnin shkollat greke, atje ku funksiononin, përballeshin me vështirësitë e mëdha të Shqipërisë moderne.

Në shtator të vitit 1991, me fillimin e vitit shkollor 1991-92, grekët e Shqipërisë, prindër, mësues edhe nxënës, bënë grevë të përgjithshme 15-ditore duke pezulluar mësimet me katër kërkesa bazë. Ndër to përmendim: Arsim në gjuhëm amtare, arsim në gjuhën amtare tek zonave të njohura minoritare në mënyrë arbitrare (atje ku ekziston një numër i konsiderueshëm grekësh), mësim të historisë edhe kulturës së kombit, zgjerim të mësimin të gjuhës amtare edhe në shkollat e mesme. Objektivat u realizuan pjesërisht. Kështu u vendos nga qeveria që të gjitha mësimet në arsimin e detyruar të shkallës së parë të bëhen në gjuhën amtare. Dy vitet e ardhshme me qarkore të veçanta u rregulluan pjesë konkrete të mësimëve në gjuhën greke edhe shqipe, me pretekst nevojën e integritit në shoqërinë shqiptare.

U hapen shkolla në gjuhën amtare në shtatë shkolla mikse që kishte krijuar regjimi komunist brenda zonave me popullsi

të pastër greke. Pas një viti u lejuan shkolla në gjuhën amtare edhe në qytetet e Sarandës edhe Delvinës. Nuk u lejua në Gjirokastrë, kurse për vitin e ardhshëm shkollor 1993-94 do të mbyllen shkollat edhe në Sarandë e Delvinë. Në të tre qytetet do të rihapen në vitin 1996 si klasa minoritare të varura nga drejtori shkollash shqipe. Kështu mbeten deri më sot, megjithëse kanë plotësuar ciklin e 9 klasave të arsimit të shkallës së parë dhe megjithëse përbëjnë shkollat minoritare me nxënësit më të shumtë.

Shtojmë gjithashtu se në shkollat konkrete nuk lejoheshin nxënësit prindërit e të cilëve nuk kishin të sanksionuar me ligj të regjimit komunist kombësinë greke.

U hap kështu gjithashtu de jure rruga për mësimin e historisë së kombit grek, por kjo nuk u arrit kurrë, përderisa orvajtja që u bë në vitin 1998-99 ndeshi në reagimin e mësuesve edhe prindërve grekë për shkak se programi i mësimin të historisë greke ishte përpiluar nga autoritetet shqiptare edhe mjaft çështje delikate trajtoheshin nga pozita nacionaliste shqiptare.

Ndërkaq, tekstet shkollore si në gjuhën greke po kështu edhe në gjuhën shqipe, në total në 17 tekste shkollore të arsimit të shkallës së parë edhe të dytë, nuk janë qëmtuar akoma nga nacionalizmi shqiptar në dëm të Greqisë, duke bërë kështu të pamundur mësimdhënien e tyre po të mbajë dikush parasysh traumat që shkakton te grekët e vegjël nacionalizmi në fjalë. Gjithashu presioni edhe shantazhimi që u bëhet mësuesve për humbjen e vendit të punës u përcjell atyre mentalitetin e regjimit komunist: përshtatjen edhe bashkërendimin me interesat e shtetit shqiptar, duke lënë mënjanë çdo përpjekje të përcimit të kulturës edhe dijes greke.

Një argument i fortë i tendencës së degradimit edhe shpërbërjes së shkollave në gjuhën amtare përbën fakti se gjatë gjithë periudhës së tranzicionit qeveritë shqiptare gjenin pengesa për mos sigurimin në kohë të teksteve shkollore për mësimet

në gjuhën amtare. Për rrjedhojë, në vitin shkollor 2005-2006 edhe në vazhdim nxënësit grekë të arsimit të detyruar të shkallës së parë nuk disponojnë asnjë tekst në gjuhën amtare edhe marrin mësimet me shënime edhe në bazë të aftësive përkthyesë të çdo mësuesi nga shqipja, si në fillimet e shekullit të kaluar. Autoritetet zyrtare përdoren si pretekst koston e botimit të teksteve shkollore që, sipas tyre, për shkak të numrit të vogël rezultojnë mjaft e lartë. Argumentimi në fjalë bëhet në momentin që 75 % e të ardhurave shqiptare në qarqet ku është i përqëndruar numri kryesor i grekëve të Shqipërisë sigurohet nga taksat e grekëve.

Në vitet 1993-94 u hap në Universitetin e Gjirokastrës Seksioni i Gjuhës edhe Letërsisë Greke për përgatitjen e mësuesve grekë për shkollat minoritare. Por shpejt përfitoi karakter formal që nga momenti që nuk mund të përgatiste mësues për të gjitha mësimet në gjuhën greke, përveç atyre të gjuhës edhe letërsisë.

Gjithashtu nuk mundej edhe nuk mund të përgatisë kuadro të arsimit të lartë për nevojat e tjera të infrastrukturës në minoritetin grek të Shqipërisë.

Nuk u realizua gjithashtu konkretizimi i kërkesave të minoritetit grek për hapje shkollash në gjuhën amtare kudo ku ekziston numri i duhur i nxënësve. Epiqendër është hapja e shkollës publike në gjuhën amtare në Himarë.

Problemi kryesor me të cilin ftohet të përballet arsimit grek në Shqipëri është mungesa e çfarëdolloji kuadri ligjor ku të përcaktohen qartë konditat por edhe kushtet e funksionimit të tij.

Shembja e regjimit për pasojë çoi në një përpjekje për çlirim nga prangat e së kaluarës edhe në këtë kuadër u propozuan mjaft projektligje, por pa arritur ndërkohë që ndonjëri prej tyre të bëhet ligj i shtetit. Për rrjedhojë mbetet i njëjti boshllëk, që mbulohet me vendime qeveritare dhe

dispozita që i japin mundësinë qeverisë të trajtojë çështjen me kritere politike dhe jo me kritere të rrepta arsimore.

Dekreti i parë, që shënonte njëkohësisht edhe përpjekjen e parë të rregullimit të statusit të funksionimit të arsimit minoritar, u botua që në vitin 1991. Dekreti në fjalë parashikonte që mësimi në shkollat 8-vjeçare të minoritetit grek të zhvillohej në gjuhën greke, sipas programit të përcaktuar nga ministria e Arsimit, kurse shqipja do të mësohej si gjuhë e huaj. Megjithëse nuk bëhej fare fjalë për mësimin e greqishtjes në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare dhe në arsimin e shkallës së lartë, përveç funksionimit të Akademisë Pedagogjike të Gjirokastrës, rregullimi në fjalë i krijoi ndërkaq elementit grek të Shqipërisë një klimë optimizmi përsa i përket arsimit, pasi shënonte qartë një hap të parë për përmirësimin e gjendjes në lidhje me të kaluarën.

Në vijim nuk munguan ndërkohë problemet që nxirreshin vazhdimisht në funksionimin e shkollave greke. Vështirësie ekonomike edhe problemeve të infrastrukturës që duhet të përballoheshin iu shtuan refuzimi i qeverisë shqiptare për të hequr statusin e zonave minoritare, brenda të cilëve vetëm lejohej funksionimi i shkollave greke, edhe ndalimi i mësimi të historisë edhe kulturës nëpër shkolla.

Vështirësitë përmanente bënë që “Omonia” më 7 mars të vitit 1993 t’ i drejtohet qeverisë shqiptare me një rezolutë me kërkesat e saj kryesore në lidhje me arsimin. Kërkesat në fjalë përqendroheshin kryesisht në mësimin edhe edukimin në gjuhën amtare edhe instancat e arsimit atje ku pjesëtarët e minoritetit përbënin shumicën ose një kontigjent të konsiderueshëm të popullsisë edhe jashtë zonave minoritare, si edhe në të drejtën e funksionimit të shollave edhe kurseve private në gjuhën greke. Bëhej fjalë gjithashtu për të drejtën e përdorimit të teksteve të njëjta shkollore me ato të qendrës kombëtare edhe mësimi të historisë edhe kulturës greke, si edhe për të

drejtën e ruajtjes edhe zhvillimit të mëtejshëm të trashegimisë së veçantë kulturore të elementit minoritar.

Kërkesave në fjalë qeveria shqiptare iu përgjigj me dekretin numër 19 të datës 13 shtator të vitit 1993, i cili e solli sërish arsimin minoritar në kuadrin e statusit të Partisë së Punës së Shqipërisë. Sipas rregullimeve, mësimdhënia në gjuhën greke do të bëhej vetëm në katër klasat e para të shkollave 8-vjeçare, kurse në katër klasat e tjera do të bëhej në gjuhën shqipe edhe greqishtja do të mësohej si gjuhë e huaj. Kërkesat e “Omonias” as që përmendeshin fare edhe as mbaheshin parasysh. Pas një viti, me vendimin numër 396 të datës 22 gusht të vitit 1994, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë vendosi kufizime më të shumta në funksionimin e arsimit 8-vjeçar minoritar, pasi neni 6 sanksiononte si premisë ekzistencën e numrit të mjaftueshëm të nxënësve (30 në të vërtetë), në mënyrë që të jepej licenca për hapjen e shkollës. Paralelisht kërkonte si të nevojshme paraqitjen e kërkesës nga prindërit e nxënësve të interesuar gjashtë muaj para fillimit të vitit shkollor. Bëhej fjalë sigurisht për një vendim destinacioni i të cilit ishte legalizimi i mbylljes arbitrare nga autoritetet shqiptare të mjaft shkollave greke në Gjirokastrë, në Sarandë e tj., që ishte realizuar që në vitin 1993 me pretekstin e mungesës së numrit të nxënësve¹⁵⁵.

Çështja e madhe e arsimit përbënte pothuajse çdo herë objekt të bisedimeve greko-shqiptare, të paktën sa herë ato zhvilloheshin, edhe u shtrua sërish nga ministri i jashtëm grek gjatë vizitës që zhvilloi në Tiranë në nëntor të vitit 1993. Pika më e rëndësishme për të cilat u arrit marrëveshja, ishte ngritja edhe funksionimi siç përmendem i Seksionit të Gjuhës Greke edhe Letërsisë në Universitetin e Gjirokastrës, i cili ka si

155. Kondis V. - Manda E., “Greqia edhe Shqipëria”, Selanik, shtëpia Botuese Këshilli i Helenizmit të Mërguar, 1988.

objektiv përgatitjen e mësuesve që destinohen për të dhënë mësim në shkollat minoritare greke që nga klasa e pestë e lartë por që akoma sot përballet me probleme serioze në funksionimin e tij.

Më optimist ishte kurorëzimi i vizitës që ministri grek realizoi në mars të vitit 1995 në Tiranë pas lirimit të pesë minoritarëve edhe rifillimin e dialogut greko-shqiptar. Atëherë ndër të tjerash u ra dakort për krijimin e një komisioni të posaçëm greko-shqiptar që do të merrej me çështjen e arsimit grek. Përpjekja e palës greke përqendrohej kryesisht në heqjen e zonave minoritare edhe në hapjen e shollave të reja për mësimin e lirë të gjuhës greke kudo që ndodhet elementi grek.

Arsimi i minoritetit grek përballet me probleme të brendshme, fobi, rezerva edhe mosbesimin e shtetit shqiptar kundrejt arsimit grek. Ndryshimi i kushteve mund të arrihet përderisa shteti shqiptar do të arrijë të bindë me veprimet e tij pjesëtarët e minoritetit se nuk ekziston rreziku i asimilimit të tyre nga komuniteti dominues edhe i tjetërsimit të identitetit të tyre kulturor. Kështu do të ndihmojë me këtë politikë minoritetin të ndjejë nevojën të ndajë me komunitetin dominues më të gjerë disa vlera të përbashkëta dhe të luftojë së bashku për zgjidhjen e problemeve të jetës së tyre të përditshme, të cilat janë akute edhe thellohen gjithnjë e më tepër.

Shkaku kryesor i dështimit të sistemit arsimor të Shqipërisë në lidhje me minoritetin grek në njërin nga objektivat e tij bazë ndërkombëtarë është politika e pamjaftueshme arsimore në çështje që kanë të bëjnë me arsimimin e minoriteteve gjuhësore, sociale kulturore. Realiteti social dhe kulturor por edhe ai ekonomik edhe i zhvillimit të rajonit edhe diversiteti që e karakterizon arsimin për shkak të angazhimeve ndërkombëtare nga njëra anë krijojnë premisat për një trajtim të veçantë edhe të plotë edhe nga ana tjetër kërkojnë një program tjetër. Arsimi minoritar ka nevojë për shanse për bashkëpunim midis

arsimtarëve edhe për programe të përbashkëta. Respektimi i diversitetit nuk përjashton përforcimin e veçorive të përbashkëta. Realizimi i këtij objektivi presupozon arsim që do të mbajë parasysh veçoritë komunitare edhe kulturore të minoritetit, që do të kombinojë kultivimin e elementëve që çojnë në diferencimin me elementë që promovojnë integrimin. Teoria dhe përvoja pedagogjike ofrojnë garancinë për një ndërhyrje të suksesshme atje ku sot arsimi përballet me një krizë të stërgjatur.

Si konkluzion mund të thuhet se është fakt se arsimi i minoritetit grek, një fushë që ka qenë në lulëzim në të kaluarën, u çua drejt tkurrjes nga përpjekjet sistematike për kufizimin e numrit të shkollave greke dhe reduktimin e orëve mësimore të gjuhës greke, gjë që u realizua në periudhën ndërmjet dy luftërave dhe u vazhdua nga regjimi shqiptar i pasluftës deri në ditët e sotme. Objektivat prioritarë të sistemit të ri arsimor ishin zbutja e diversiteteve kombëtare, formimi i një qytetari të tipit të ri të orientuar drejt marksizëm-leninizmit, të përkushtuar ndaj Hoxhës edhe ndaj shtetit shqiptar, që nuk do të ketë lidhje me fe edhe origjina kombëtare¹⁵⁶, më gjerë kultivimi i ndërgjegjës socialiste tek te rinjtë edhe integrimi i plotë i grekëve në modelin social që po krijohet. Në zonat e përcaktuara në mënyrë arbitrare si minoritare mund të funksiononin shkolla fillore 8-vjeçare, në katër klasat e para të të cilave mësimi zhvillohej në gjuhën

156. Gazeta *Zëri i Omonias*, 34.09.1993. Papadhopullos J., *Minoriteti Kombëtar Grek në Shqipëri dhe çështja e tij shkollore*, Janinë 1981, f. 127-170 (sipas raportit analitik të inspektorit shqiptar Kol Koçi) dhe *Wissenschaftlicher Dienst*, 1953, f. 16, 24. Kapsalis J., *Arsimi i minoritetit grek të Shqipërisë Tekste shkollore. Kualifikim gjuhësor. Përspektiva*, Athinë, shtëpia botuese Gutenberg, 1996 dhe Paskalis A., *Leximet letrare të pas luftës të minoritetit grek të Shqipërisë Trajtim gjuhësor edhe ideologjik*, Athinë, shtëpia botuese Gutenberg, 1998.

greke –shqipja mësohej si gjuhë e huaj– por ky raport përmbysesj plotësisht në katër klasat e fundit. Tekstet shkollore ishin përkthime të thjeshta të teksteve shqiptare respektive - mungonte çdo referim në origjinën greke të nxënësve, të historisë edhe kulturës greke. Gjinnaze greke nuk kishte, kurse e vetmja shkollë e lartë që funksiononte në gjuhën greke ishte Akademia Pedagogjike e Gjirokastrës, që përgatiste mësues për shkollat minoritare. E njëjta gjendje vazhdon deri më sot pavarësisht nga retorika shqiptare që ndërkaq nuk sjell asnjë rezultat.

15. Liria fetare e minoritetit etnik grek

Siç përmendëm më lartë me ndryshimin e regjimit u shtrua çështja e zgjedhjes së kryepeshkopit, që më në fund u realizua me gjithë reagimet e mëdha nga parlamenti shqiptar edhe politikanët të lidhur me dogma të tjera fetare. Me vendimin unanimit të Sinodit të Shenjtë të Patrikanës Ikumenike të datës 24 qershor të vitit 1992 u zgjodh si Ekzark i Patrikanës peshkopi i Andhruses Anastasios Janullatos, i cili u vu në fron më 2 gusht të të njëjtit vit.

Me ekstradimin e arkimandritit Hrisostomos Maidhonis, më 25 qershor të vitit 1993, nga Gjirokastra, u acaruan marrëdhëniet greko-shqiptare dhe kriza përfshiu edhe Kishën Ortodokse të Shqipërisë. Ekstradimi i arkimandritit u shkaktua, sipas disa të tjerëve, edhe nga fenomeni i tendencës në rritje të konvertimit të myslimanëve në ortodoksi, veçanërisht në trevën vorioepirote dhe, sipas shumë të tjerëve, nga frika që kishte kapluar pushtetin shqiptar për formimin e ndërgjegjës greke të ortodoksët. Atëherë (29.06.1993), presidenti i Shqipërisë Sali Berisha i dërgon letër sekretarit të përgjithshëm të OKB-së Butros-Butros Gali në të cilën i referohet aktivitetit të arkimandritit “që kapërceu detyrat e tij fetare”, si edhe kundërmasave të marra nga qeveria helene me ekstradimet e rreth 20.000 emigrantëve shqiptarë nga Greqia¹⁵⁷.

Të gjitha këto patën si rezultat organizmin e mitingjeve të mëdha të protestës në Gjirokastrë, në Delvinë, në Dervicjan,

157. Gazeta *Pondiqi*, 1 korrik i vitit 1993.

që u shpërndanë me ndërhyrjen e dhunshme të policisë shqiptare. Klima e luftës edhe dëbimi me mjete të ndryshme të grekëve të Shqipërisë u përshkallëzuan me ekstradimin e shqiptarëve nga Greqia dhe kryesisht me 6 kushtet që shtroi qeveria greke. Klima e përgjithshme influencoi Kishën Ortodokse të Shqipërisë edhe pozitën e kryepeshkopit Anastasios, të cilin presidenti Sali Berisha në letrën e mësipërme e karakterizonte si të “përkohshëm”.

Gjashtë kushtet e qeverisë greke ishin:

- a) Kthimi e arkimandritit në postin e tij fetar.
 - b) Kthimi i pronave të sekustruara nga regjimi i kaluar, çështje të cilën e zvarrit edhe regjimi i sotëm.
 - c) Krijimi i shkollave minoritare në të gjitha instancat e arsimit dhe jo vetëm në zonat minoritare të përcaktuara në mënyrë arbitrare.
 - ç) Funksionimi i lirë i unioneve politike edhe organizatave të tjera.
 - d) Ushtrimi i lirë edhe pa pengesa i detyrave fetare edhe kthimi i gjithë atyre që ishin zhvendosur me dhunë dhe
 - dh) Qytetarët të deklarojnë identitetin e tyre kombëtar.
- Më në fund, acarimi i mëtejshëm i krizës, që u detonua edhe me akte të tjera, u shmang me përpjekje personale të kryepeshkopit që vizitoi presidentin e Shqipërisë edhe kryeministrin grek.

16. Kisha e Shqipërisë

Kisha e Shqipërisë është përballur edhe përballat me probleme dhe pengesa të shumta që nga periudha e ringritjes së saj¹⁵⁸, që mpleksen edhe më tepër në vartësi të ecurisë së marrëdhënieve greko-shqiptare. Sot vihet re mungesa e vullnetit për progres në çështjen e kthimit të pronave kishëtare edhe atyre të manastireve. Në shumë qarqe edhe zyra kopetente për njohjen dhe kthimin e pronave ekzistojnë një sërë çështjesh kritike edhe dosje pa përgjigje. Megjithëse pati shpresa për trajtim më të mirë, më të shpejtë dhe më dashamirës të kësaj çështjeje kritike, jo vetëm për ortodoksët, progresi i arritur ishte dekurajues. Optimizmin bile për hartimin e një ligji të posaçëm, që do të veçonte procedurat dhe do t' i bënte më sinoptike në lidhje me qytetarët ish-pronarë, e pasoi mungesa e gatishmerisë¹⁵⁹. Shembuj karakteristikë në lidhje me problemet e pronave edhe të vendeve të kultit janë rasti i Tempullit të Shenjtë të Përgjumjes së Shënmërisë së Permetit, ku u rah edhe prifti nga “persona të panjohur”, manastiri i afërt i Shënmërisë në Dragot, Tempulli i Shënjtë Evangjelic i Shënmërisë në Libohovë, Tempulli i Shënjtë i Shën Gjergjit në Çukë, Kisha e Profet Ilisë në Xarrë, që përdoret për strehimin e “familjeve nga veriu dhe ngritjen e fshatit në truallin e saj”, kërcënimet për instalimin e 2.000 refugjatëve nga Kosova në livadhin e kishës së Zonarenjve në Llovinë, që sot jepet me qira, kurse prona e Kishës së Profet Ilisë në Jorgucat, që ishte kthyer në kazermë, tani është e përvetësuar.

158. Kisha e Greqisë (1999), *Dyptiqe të Kishës së Greqisë*, botim i Kishës Apostolike të Greqisë, Athinë, f. 1210.

159. *Gazeta Të rejtat e Omonias*, Gjirokastër 27 & 28 shkurt 1999.

17. Shteti shqiptar dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit grek

Pesëmbëdhjetë vjet pas rënies së “socializmit real” edhe hapjes së kufirit me Shqipërinë, Vorio Epiri përjeton një situatë të vështirë. Një rajon banorët e të cilit dekada me radhë në vuajtje prisnin që të ndryshonte situata dhe të komunikonin lirshëm me anën tjetër të kufirit. Tani japin një betejë të vështirë për të qendruar në vatrat e tyre pasi pala shqiptare nga ana e saj bën luftë për të realizuar spastrimin etnik në kurriz të minoritetit kombëtar grek.

Ratifikimi nga Parlamenti shqiptar i Kuadrit të Parimeve të Këshillit të Evropës për Minoritetet Kombëtare nuk u shoqërua edhe nga aktligje që do të siguronin zbatimin e tij. Nismat e autoriteteve lokale për promovimin e Kuadrit nuk u pranuan nga ana e pushtetit qendror. Marrëveshja e Stabilizim Asoçiimit me Bashkimin Evropian nga ana e shtetit shqiptar zbatohet vetëm përsa i përketë njerës anë, asaj të “Rindërtimit Ekonomik, Bashkëpunimit edhe Zhvillimit” edhe injorohet ana tjetër për “Demokratizmin e të Drejtave të Njeriut”.

Përsa i përket sigurisë në zonat ku jeton minoriteti grek, gjendja jo e qëndrueshme nga revolta e vitit 1997 mbetet akoma, e konservuar kështu nga indiferentizmi edhe toleranca e qeverisë shqiptare pasi i shërben tjetërsimit demografik të rajonit. Aktualisht në Sarandë, në Gjirokastrë edhe Himarë përbërja e popullsisë ka ndryshuar në dëm të minoritetit grek. Mënyrat e tjera të tjetërsimit të indit demografik të minoritetit grek edhe shqiptarizimit të zonave me popullsi të pastër greke janë si më poshtë: Stimulimi i shqiptarëve për blerje pronash në pika strategjike të këtyre zonave siç është aksi rrugor

Gjirokastrë-Kakavi. Stimulimi i shqiptarëve për tu zhvendosur në qendrat urbane të minoritetit kombëtar grek siç është Jorgucati, Vriseraja (qarku i Gjirokastrës), Livadhjaja edhe Finiqi i Sarandës.

Politika e regjimit të sotëm shqiptar vazhdon praktikën e regjimit të Partisë së Punës së Shqipërisë e cila lejonte shkolla me mësim në gjuhën greke vetëm brenda “zonave minoritare” të përcaktuara në mënyrë arbitrare, kurse nga ana tjetër përjashtohen zona me popullsi të madhe greke.

Shpërndarja e ndihmës ekonomike nga jashtë shtetit (përfshi edhe atë grekë si edhe të burimeve shtetërore) bëhet në një mënyrë të tillë që konsiston në dallime ndaj minoritetit grek. Në një kohë që rajonet ku historikisht jetojnë në një masë të madhe grekët kontribuojnë më shumë se çdo rajon tjetër, përveç kryeqytetit të Tiranës, në jetën ekonomike të vendit, ndërkaq përfitojnë pjesën minimale të ndihmës ekonomike nga jashtë përsa u përket fondeve për vepra publike.

Në çështjen e pronësisë gjendja është tragjike. Një fushatë e madhe ndodhet në zhvillim e sipër gjithë këto vite, e cila së fundi është intensifikuar, me synim ndryshimin e statusit të pronësisë në zonat ku historikisht banojnë grekët. Në Dropull edhe në Vurg janë rrëmbyer sipërfaqe të mëdha si edhe prona në Shën Sarandë edhe Delvinë.

Sipërfaqe të mëdha në pronësi të grekëve disponohen për rindërtimin e qendrave të banimit me shqiptarë ose të zonave të veriut të Shqipërisë ose të zonave të tjera, si është rasti i Shën Ilisë në zonën e Xarrës apo i gjithë zonës nga Finiqi, Vrioni dhe deri në Metoq afër Sarandës. Gjithashtu një sipërfaqe prej 3.000 dynimesh, nga më të begatat, midis fshatrave Çaus, Aliko dhe Gjashtë, që banohet kryesisht nga Çamët, destinohet për vendosjen e shqiptarëve të ardhur nga fshatrat çame përbri kufirit greko-shqiptar.

Në të njejtën kohë grekët përbëjnë pikën e dobët nëpër

qytete, veçanërisht në Sarandë. Me dhunë të ushtruar nga ana e shqiptarëve dhe me tolerancën e shtetit pronat e tyre kalojnë në duart e shqiptarëve. (Rasti me të 300 sheshet e ndërtimit të grekëve të Sarandës, në periudhën e vitit 1996 e më pas, apo i dhjetëra vendimeve të gjykatave shqiptare në ngarkim të pronave të grekëve).

Kështu që qeveria shqiptare përpiqet me një sërë vendimesh gjyqësore të padrejta edhe të manipuluar shqiptarë të përvetësojnë me mijëra dynym tokë, pyjore apo kullotash, që është ende në pronësinë e fshatrave, të manastireve edhe të vetë shtetit, kurse nga ana tjetër sipërfaqe toke u kthehen pronarëve jo të vërtetë, të cilët në të shumtën e rasteve nuk janë as banorë të këtyre zonave.

Qeveria shqiptare me Reformat Administrative të herë-pashershme ripërcakton caqet administrative në pjesën jugore të vendit në një mënyrë të tillë që të dobësojë forcën e votës dhe përfaqësimin e grekëve (edhe grekëve vllahofonë), në nivel lokal edhe kombëtar. Kështu, zonat minoritare greke në qarqet e Sarandës edhe Delvinës u përfshinë në periferinë e Vlorës, kurse ato të qarkut të Gjitokastrës në periferinë e Gjirokastrës. Për rrjedhojë u shpërbe forca elektorale dhe më gjerë forca politike e minoritetit kombëtar grek përderisa për shembull për zgjedhjen e deputetëve në zonat me një kandidat të qarqeve të sipërpërmendura vendos elementi shqiptar pasi ndarja administrative lejon përbërjen respektive të votuesve.

Me gjithë premtimet e përsëritura autoritetet shqiptare nuk kanë kthyer të gjitha kishat, manastiret, sipërfaqet kishtare, ikonat, enët e shënjtja, arkivat kishtare edhe veprat e artit që regjimi i kaluar i kishte sekuestruar nga Kisha Ortodokse.

Qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare dekadën e fundit kanë mbajtur në mënyrë sistematike të gjithë grekët jashtë vendëve të rëndësishme në të gjitha aspektet e jetës publike, diçka që

nuk e bënë as edhe qeveritë ateiste gjatë qëndrimit të tyre shumëvjeçar në pushtet.

Por krimi më i madh u bë në të drejtën e përcaktimit të identitetit kombëtar edhe fetar. Pothuajse për një shekull me radhë qytetarët me origjinë greke iu nënshtruan përpjekjeve të dhunshme qeveritare për tu privuar identitetin kombëtar me metoda si internimi i detyruar, refuzimi i arsimimit në gjuhën e tyre amtare, shqiptarizimi i emrave të tyre. Regjistrimi përbën një shans për palën shqiptare për rehabilitimin e grekëve nga disa prej vuajtjeve që u shkaktoi politika qeveritare, duke respektuar kështu në procedurën konkrete ato që ka janë të pranueshme si të ligjshme në shkallë ndërkombëtare¹⁶⁰.

Aktet e palës shqiptare kundër minoritetit grek u përqendruan në çështjet gjeografike edhe territoriale, të popullsisë edhe të gjendjes civile, të regjistrimeve, të dhënies së emrave edhe toponimeve, të gjuhës edhe arsimit, të historisë edhe kulturës, të fesë edhe politikës, të çhelenizimit fetar, politik dhe ideologjik.

Akti i parë i kësaj politike më të gjerë të shtetit shqiptar ka

160. Një ide të realitetit të dhumbshëm e krijojmë duke parashtruar ngjarjet më të fundit:

1. Hedhja në erë e një Kryqi-Kambanoreje në Xarrë.
2. Shkatërrim i Kampit Ortodoks Rinor përbri Shën Jorjit në Sarandë.
3. Nxjerrja jashtë e një komuniteti ortodoks nga një ndërtesë e vjetër në Përmet (denoncim i Këshillit Evropian të Feve), 3/10/04 pragë.
4. Shembje e 220 banesave të Vorioepirotëve në Ximarë deri në Sarandë gjoja si ndërtesa të paligjshme (gazeta *Llaiko Vima* e Gjirokastrës 14.11.2004).
5. Shkelje edhe vjedhje e parave të kishës së Shën Harallambit në Sarandë më 26/10/04 dhe të njejtën natë përlyerje dhe vjedhje e kishës së Delvinës (*Gazeta Llaiko Vima* e Gjirokastrës 4/11/2004).
6. Invadim dhe dëmtime në Kopshtin Grek të Himarës 2 herë.
7. Dënim i pesë (5) Vorioepirotëve me nga dy vjet burg për aktivitetin e tyre në favor të kryetarit të bashkisë së Himarës V. Bollano, në zgjedhjet e vitit 2004.

të bëjë me pasigurinë që kultivohet me objektiv minoritetin kombëtar grek, e cila çon në:

1. Reduktimin demografik të popullsisë edhe stimulimin e emigrimit të brendshëm nga veriu në jug.

2. Pasiguri, e cila për grekët përbën një nga arësytet kryesore të largimit të tyre drejt Greqisë.

3. Venitjen e aktivitetit ekonomik. Rrëmbimet edhe vjedhjet e gjesë së gjallë, vjedhjet e armëve edhe shantazimet kundër afaristëve grekë nuk lejojnë lulëzimin e ekonomik në rajon¹⁶¹.

4. Paralizim të aktivitetit të institucioneve të minoritetit, përjashtim nga pjesëmarrja në aparatin shtetëror. Gjatë periudhës 1994-95, nën pretekstin e krijimit të strukturave kombëtare në ushtri, polici edhe shërbimet sekrete, qeveria e Partisë Demokratike pushoi nga strukturat në fjalë më shumë se 300 grekë apo persona me origjinë dhe lidhje greke. Grekët u hoqën në një përqindje të madhe edhe nga strukturat e tjera shtetërore. Bile u shkel shumë ruajtja e raporteve demografike

161. Është tashmë e konfirmuar se grekët në aktivitetin e tyre vetjak janë të detyruar të operojnë në kushte jo të barabarta dhe të dënuar të paguajnë shtrenjtë dhe me mënyra të ndryshme origjinën e tyre greke. Konkretisht, falë origjinës kombëtare dhe kulturës, janë të detyruar të paguajnë me konsequencë detyrimet e tyre fiskale ndaj shtetit dhe të vihen në konkurrencë me shqiptarët që jo vetëm nuk paguajnë por kanë edhe mbështetjen e shtetit. Dy shembuj: Gjatë periudhës 2005-2006 banorët grekë të Gjirokastrës paguanin 115% energjinë elektrike, sado absurde që të duket. Në të njejtën kohë zona të tjera të të njëjtit qark paguanin 0-60%. Zonat e minoritetit paralelisht u nënshtroheshin ndërprerjeve më të mëdha të energjisë për shkak të kolapsit energjistik të vendit. Njëkohësisht ishin të vetmit që paguanin gjoba për gjoja mospagim të faturave të energjisë elektrike. Në vitin 2005 kryeministri i vendit Sali Berisha do të fillojë nga minoritarët grekë “fushatën” e tij kundër evazionit fiskal, në një kohë që autoritetet kopetente deklarorin se afaristët edhe personat privatë me origjinë greke ishin nga më të rregulltit përsa u përket detyrimeve të tyre.

edhe përqindja respektive e kuadrove në aparatën shtetërore gjatë regjimit komunist akoma edhe në zona me popullsi të pastër greke si Gjirokastra, Delvina edhe Saranda. Kështu marrëdhëniet e grekëve me shtetin nëpër gjyqe, polici, trupin diplomatik edhe struktura të tjera shtetërore janë tejet të vështira që nga momenti që në to nuk marrin pjesë grekë.

5. Shkelje të të drejtave të posaçme që kanë të bëjnë me manifestimin edhe zhvillimin e identitetit kombëtar siç është arsimi në gjuhën amtare, vetëpërcaktimi përsa i përket kombësisë, statusi i pengesave përsa i përket rimarrjes së kombësisë greke e t.j., shkelje të cilat lidhen me përpjekjen e tjetërsimit etnologjik të minoritetit autokton duke vazhduar kështu edhe gjatë periudhës së tranzicionit nivelin formal të respektimit të të drejtave të minoritetit grek gjatë periudhës së komunizmit. Është e njohur përpjekja e banorëve të fshatrave minoritare për vendosjen e tabelave me emërtimet e tyre edhe në gjuhën amtare siç përcakton konventa-kuadër e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve. Që nga viti 2000 kanë kaluar shtatë vjet dhe si qeveria shqiptare po kështu edhe opinioni i gjerë shqiptar nuk mund të pranojnë zbatimin në praktikë të kësaj të drejte elementare. Për vendosjen e tabelave u desh ndërhyrja e organizmave ndërkombëtare, por asnjë nuk reagoi kur “persona të panjohur” i fshinë natën.

Gjithashtu, çështja e rimarrjes së kombësisë jo vetëm nuk u shpalos si çështje e deklaramit personal të qytetarëve, por me vështirësi të madhe u dha kjo e drejtë nëpër gjykata, kurse së fundi nëpër gjykata pas një rregullimi të ri ligjor është e pamundur që të veprojnë pa deklaratën e përbashkët të prindërve ku të duket vendimi i përbashkët për deklaramin e kombësisë të trashëgimtarët e tyre. Ndërkaq greqishtja nuk njihet si gjuhë zyrtare as në komunitetet me popullsi të pastër greke as shkresat e grekëve në gjuhën amtare kanë fuqi ligjore.

Shqipëria as në kohën e regjimit komunist as sot ka njohur

anën autoktone të minoritetit grek, duke fallsifikuar historinë pretendojnë se harta historike e Shqipërisë shtrihet deri në Prevezë edhe Artë dhe se kultura në rajonin e epirit, kryesisht në pjesën e saj veriore, i takon Shqipërisë¹⁶². Me të njëjtin mentalitet rivendikimesh trajtohet nga ana historike, gjeografike edhe demografike nga Shqipëria pjesa veriore edhe jugore e Epirit në të gjitha tekstet shkollore të gjeografisë edhe historisë që nga klasa e katërt fillore deri në universitet¹⁶³.

Shqipëria si para po kështu edhe pas vitit 1990 ruan të njëjtin qëndrim përsa i përket origjinës së elementit grek në Shqipëri. Pretendon se u vendos në territoret ku ndodhet sot gjatë shekullit të 18-të. Të dhënat historike edhe gjuhësore, shkruan Fjalori Enciklopedik i Akademisë së Shkencave të Tiranës në kapitullin “Dropulli”¹⁶⁴, “tregojnë se banorët e Dropullit me kombësi greke erdhën këtu shekullin e 18-të si çifçinj në çifliqet e latifondistëve shqiptarë”, kurse Himara përmendet si “qytet ilir i Kaonisë që nga shekulli i 5-të p.Kr.”. Zonat e tjera me popullsi të pastër greke si ajo e Vurgut, Finiqit, Theollogos, Gravës, Mesopotamit edhe Livadhjasë, Rrëzës së Zezë në qarkun e Gjirokastrës thjesht përmenden si njësi administrative të territorit shqiptar pa u përmendur origjina greke e popullsisë.

Nga ana tjetër, që kur u krijua shteti shqiptar nuk është

162. Akademia Shqiptare e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Tiranë 2003.

163. Në mënyrë indikative përmendim librin “Të njohim historinë e popullit tonë” të autorëve Kuri, Gjini, Bishqemi, Papajani, bot. Tiranë 2003 ku përmendet çështja e origjinës së Epirotëve nga një fis ilir (f. 7-8), e përvetësimit të mbretit Piro (f. 12), bëhet një analizë për Luftën e Dytë Botërore (f. 98) dhe afirmohet çështja nacionaliste e Çamërisë (f. 127).

164. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori enciklopedik*, Tiranë 2001.

kryer kurrë një regjistrim realist i popullsisë pa makinacione, pa kufizime gjeografike dhe me të drejtën e vetëpërcaktimit të kombësisë.

Megjithëse në legjislacionin shqiptar (duke filluan nga Kushtetuta) parashikohet në mënyrë të prerë sanksionimi i të drejtave në bazë të origjinës kombëtare dhe kombësisë, është konstatuar se legjislacioni shqiptar i bazuar në standartet evropiane në lidhje me të drejtat e njeriut edhe ato kombëtare nuk zbaton ato që vetë parashikon kur autoritetet shqiptare shquhen nga një defiçit i madh vullneti për zbatimin e parimeve evropiane për të drejtat e njeriut edhe ato kombëtare, për rrjedhojë mendojmë se jo që janë të përligjura kërkesat për shënimin e kombësisë në çdo dokument zyrtar identifikimi të personit.

Insistimi i grekëve që ndodhen në Shqipëri edhe të përfaqësuesve të të gjitha niveleve në çështje që kanë të bëjnë me kombësinë siç është përfshirja e saj në regjistrimin e popullsisë së Shqipërisë edhe shënimi i saj si një e dhënë personale si në regjistrat themeltarë po kështu edhe në pashaportat krijon përshtypjen se minoriteti kombëtar grek po shfaq qëndrime që nuk pajtohen me standartet evropiane.

Në thelb minoriteti grek në qoftë se nga njëra anë beson se integrimi i Shqipërisë në Evropë përbën edhe për atë vetë zgjidhjen më të mirë përse i përket respektimit të të drejtave të njeriut edhe atyre kombëtare, nga ana tjetër shprehë rezervat për synimet e vërteta të autoriteteve shqiptare në këtë drejtim. Beson se autoritetet shqiptare duke u referuar rregullimeve ligjore të bazuara në standarte evropiane krijon premisa vijmësie të së njëjtës politikë të ushtruar deri më sot përse i përket reduktimit sasior edhe cilësor demografik edhe kombëtar.

18. Sanksionimi i të drejtave të minoritetit grek

Të drejtat e minoritetit grek, në nivel protokollesh me Shqipërinë edhe Fuqitë e Mëdha, rrjedhin nga dokumente ndërkombëtare (shiko shtesën) si edhe nga tekstet mbrojtëse që janë në fuqi. Do të mund të ndahen në dy pjesë, atë të përgjithshme edhe atë specifike¹⁶⁵. Në pjesën e përgjithshme përfshihen të drejtat që gjejnë zbatim në të gjithë pjesëtarët e të gjitha minoriteteve. Me një fjalë falë origjinës kombëtare ekzistojnë disa të drejta, të cilat, për shkak të natyrës dhe amplitudës së tyre, mund të zbatohen kudo që ekzistojnë minoritete. Të drejta të tilla janë: e drejta e vetëpërcaktimit¹⁶⁶, varianti i trajtimit¹⁶⁷, komunikimi i lirë ndërkufitar¹⁶⁸, ushtrimi personal edhe i përbashkët i të drejtave specifike¹⁶⁹, krijimi i shoqatave¹⁷⁰, pjesëmarrja në jetën e vendit¹⁷¹, pjesëmarrja në vendimet që kanë të bëjnë me minoritetin¹⁷², respektimi i

165. Shiko Dhjakofotaqis J., *Në lidhje me minoritetet sipas së Drejtës Ndërkombëtare*, Universiteti Pantio, doktoraturë, Athinë 1999.

166. Shiko KSBE/Kopenhagen, paragr. 32, neni 2 edhe Konventa-Kuadër, neni 3.1.

167. Shiko Deklaratën e OKB-së (1992), neni 3.2.

168. Shiko KSBE/Vjenë, paragr. 31 dhe Deklarata e OKB-së, neni 2.5.

169. Shiko Deklaratën e OKB-së, neni 3.1, neni 3, Konventa-Kuadër, neni 3.2.

170. Shiko Deklaratën e OKB-së, neni 2.4 KSBE/Kopenhagen, paragr. 32.6 edhe Konventa-Kuadër, nenet 7, 17.

171. Shiko Deklaratën e OKB-së, nenet 2.2, 4.5, neni 20

172. Shiko KSBE/Kopenhagen, paragr. 35, Deklarata e OKB-së, neni 22 edhe Konventa-Kuadër, neni 15.

përbërjes kombëtare edhe i caqeve të zonave minoritare¹⁷³, krijimi i partive politike¹⁷⁴, policia e minoriteteve¹⁷⁵.

Në pjesën e posaçme të mbrojtjes së minoriteteve përfshihen të drejtat që gjejnë zbatim te pjesëtarët e minoriteteve me karakteristika të pjesshme. Nuk bëhet fjalë pra për zbatim të përgjithshëm të këtyre të drejtave në çdo minoritet por për zbatim të çdonjerës prej tyre sipas rastit të ndjekur në çdo minoritet. Të drejta të tilla janë: të drejta etnike/kulturore¹⁷⁶, të drejta fetare¹⁷⁷, të drejta gjuhësore¹⁷⁸ dhe të drejta arsimore¹⁷⁹. Por dokumentet e mësipërme kanë fuqi ligjore të ndryshme ose aspak dhe dallohen nga një terminologji jo të unifikuar. Pjesa më e madhe mbetet në nivelin e parimeve, drejtimeve, angazhimeve politike, stimulimeve edhe sugjerimeve. Akoma edhe në rastet e pakta për të cilat mund të ketë angazhime ligjore paqartësia e teksteve komplikon interpretimin e tyre. Përmbajtja e përgjithshme, paqartësia, ana komplekse, ana kontradiktore edhe interpretimi tendencioz i dokumenteve ligjore do të afirmohet në një shkallë më të madhe në kapitullin që vijon që shqyrton të drejtën e vetëvendosjes.

173. Shiko KSBE/Helsinki, 1992, vendime, titulli VI, paragr. 27, neni 9 edhe Konventa-Kuadër neni 16

174. Shiko КЕП, neni 21

175. Shiko KSBE/Kopenhagen, paragr. 35 edhe КЕП, neni 22

176. Shiko KSBE/Vjenë, paragr. 59 dhe KSBE/Kopenhagen, paragr. 32.

177. Shiko KSBE/Vjenë, paragr. 16, KSBE/Kopenhagen, paragr. 32.3 edhe Konventa-Kuadër, neni 8.

178. Shiko KSBE/Kopenhagen, paragr. 32, 34, Deklarata e OKB-së, neni 3.1, КЕП, nenet 10, 11, 12, 13, 14, 15, 18, 19, Konventa-Kuadër nenet 10, 11 dhe Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale ose Minoritare.

179. Shiko Konventën e UNESCO, neni 5, KSBE/Kopenhagen, paragr. 32.3, 34, Deklarata e OKB-së, neni 4.4, КЕП, nenet 17, 18 dhe Konventa-Kuadër, neni 13.

18.1 Mbrojtja ndërkombëtare

Mbrojtja e minoriteteve si objekt i rregullimeve përmes konventave u shfaq menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, por jo veçse me dokumente të karakterit ikumenik por me konventa *ad hoc* për mbrojtjen e minoriteteve konkrete që rezultuan nga krijimi i shumë shteteve të reja dhe rikonfigurimet e kufijve me përfundimin e luftës. Pas Luftës së Dytë Botërore qëndrimi i komunitetit ndërkombëtar në lidhjen me njohjen e të drejtave të minoriteteve ishte veçanërisht negativ, pasi nazistët kishin përdorur minoritetet e shumta gjermanofone që jetonin në vende të ndryshme evropiane (Poloni, Çekosllovakia, Republikat Balltike) për promovimin e objektivave të tyre ekspansioniste.

Tek e fundit, dëbimi nga ana e vetë aleatëve e rreth 12-14 milionë gjermanofonëve nga territoret e çliruara¹⁸⁰ nuk linte shumë hapësirë për proekupimin me çështje të kësaj natyre.

Përsa i përket mbrojtjes ligjore të minoriteteve, duhet theksuar e drejta bazë ndërkombëtare nuk njeh të drejta minoritetesh.

Në dokumentet e para të mbrojtjes ikumenike të të drejtave të njeriut nuk kishte asnjë referim të minoritetet¹⁸¹ Parashikohen të drejta të personave që u përkasin minoriteteve si pjesë të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, njihen të drejta personale dhe jo të drejta grupi apo të drejta

180. De Zayas A.: *International Law and Mass Population Transfers*, 16 Harvard ILJ 207 (1975), faqe 227-242.

181. Deklarata Ikumenike e të Drejtave të Njeriut (UNGA) Res. 217A (III) të 10 dhjetorit 1948 nuk bën ndonjë referencë të veçantë për minoritetet, edhe pse Nënkomisioni për Minoritetet i Komisionit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së kishte përgatitur një draft neni që do të bënte fjalë për mbrojtjen e minoriteteve (Un Doc. E/CN.4/52 të 6 dhjetorit).

kolegjale¹⁸². Ndërkaq lejohet edhe e drejta e ustrimit të përbashkët me të tjerët të të drejtave të njohura.

Në OKB kemi referime kryesisht indirekte në Kartën Statutore (1995), në Deklaratën Ikumenike të të Drejtave të Njeriut (1948) si edhe në dy Konventat Ndërkombëtare të vitit 1966, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Personale edhe Politike që u vu në fuqi në vitin 1976 edhe Konventen Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale edhe Politike që është në efikasitet akoma sot në kuadrin e Komisionit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Dokumentet më të rëndësishme të Organizmit që u referohen disi më konkretisht minoriteteve konsiderohen Konventa për Parandalimin edhe Ndëshkimin e Krimit të Genocidit (1948), Deklarata për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1963), Konventa Ndërkombëtare për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965) si edhe Deklarata për të Drejtat e Personave që u Përkasin Minoriteteve Kombëtare, Fetare edhe Gjuhësore (1992).

Në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Personale edhe Politike të vitit 1966¹⁸³ në nenin 27 parashikohet si më poshtë: *“Në ato shtete ku ekzistojnë minoritete kombëtare, fetare apo gjuhësore, personat që u përkasin minoriteteve në fjalë do të kenë të drejtën, së bashku me pjesëtarët e tjerë të grupit, e kulturës së tyre, të ushtrojnë detyrat e tyre fetare apo të përdorin gjuhën e tyre”*. Dispozita në fjalë në të vërtetë nuk ka të bëjë me minoritetet si entitete kolegjale por personat që u përkasin atyre, duke përfshirë kështu çdo formë të aktivitetit

182. E drejta e vetme kolegjale që mund t' i njihet një grupi (populli) në kushte të caktuara është e drejta e vetëvendosjes, e cila do të analizohet në kapitullin që vijon.

183. International Covenant on Civil and Political Rights, 999 UNTS 171, 6ILK 368 (1967).

kolegjal që nuk do të përbënte një shumë aktivitete personale të “lejueshme”¹⁸⁴ Ndër dizavantazhet e dispozitës në fjalë është se nga formulimi del se është në vullnetin e vetë shteteve të përcaktojnë nëse ekzistojnë apo jo minoritete në territoret e tyre, kurse mungesa e një përkufizimi të pranueshëm në lidhje me minoritetin përbën pengesë për aplikimin esencial jo vetëm të dispozitës konkrete por të çdo lloj dispozite mbrojtëse për minoritetet.

Këtu duhet të përmendim edhe Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhdukjen e Diskriminimit Racor¹⁸⁵ me nenin 5 të sëcilës shtetet anëtare marrin përsipër të ndalojnë dhe të zhdukin dallimet racore dhe “të garantojnë të drejtën e gjithsecilit, pa dallim raceje, ngjyre apo origjine kombëtare për barazi para ligjit” duke specifikuar sa më sipër në lidhje me të drejtën e trajtimit të barabartë para autoriteteve gjyqësore edhe administrative, mbrojtjen nga dhuna shtetërore dhe të drejtat politike. Në dokumentet ikumenike të mbrojtjes së minoriteteve duhet akoma të shtohet edhe *Deklarata për të Drejtat e Personave që u përkasin Minoriteteve Kombëtare, Fetare dhe Gjuhësore*¹⁸⁶, por që nuk njeh minoritetet si subjekte, vetëm sa i përfshin si të drejta personash që u përkasin minoriteteve. Nga ana tjetër, e adoptuar me rezolutë të

184. Millennium Summit Multilateral Treaty Framework: An Invitation to Universal Participation, United Nations, 2000, faqe 15-18, Human Rights Committee, General Comment No. 23 (50) on Article 27, 15 HRLJ 233 1994. Nowak M.: The Activities of the UN Human Rights Committee: development from August 1, 1992 to July 31, 1995, 16 HRLJ 377 (1995), faqe 379.

185. International Convention on the Elimination of all Forms of Racial Discrimination (1996), 660 UNTS 195.

186. Declaration on the Rights of Persons belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities, UNGA Res. 47/135 të 18 dhjetorit 1992, 32 ILM 911 (1993).

Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nuk ka angazhimin e duhur juridik¹⁸⁷ në mënyrë që të përbëjë një dokument referimi për mbrojtjen ikumenike të minoriteteve.

18.2 Kuadri ligjor i Evropës

Mungesën e dispozitave mbrojtëse në nivel ikumenik erdhen për ta mbuluar dokumentet e konventave në nivel rajonal.

Nismëtar në këto veprime ishte kontinenti evropian, i cili shumë shpejt u aktivizua në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

A. Këshilli i Evropës

Një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar Këshillit të Evropës përse u përket të drejtave të minoriteteve edhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përbën modelin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel rajonal edhe ikumenik. Konkretisht parashtron me radhë të drejtat në fjalë si edhe një procedurë për drejtimin në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastin kur mendohet se këto të drejta janë shkelur. Të përmendim gjithashtu edhe Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale apo Minoritare (1992) dhe Konventën-kuadër shumë të rëndësishme për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (1995).

Adoptimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)¹⁸⁸, që vazhdimisht po evoluon me përpilimin e Protokollëve Shtesë, u ofron të gjithë qytetarëve evropianë

187. Sipas nenit 10 të Kartës së OKB-së, rezoluatat e Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë fuqi ligjore kundrejt anëtarëve ose organeve të tjera të OKB-së, por përbejnë thjesht rekomandime. Brownlie I.: *Principles of Public International Law*, Clarendon Press, Oxford, faqe 14.

188. ETS No 5, Strasbourg, 1948.

një kuadër efikas për ruajtjen edhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore¹⁸⁹. Edhe pse Konventa nuk u referohet qartë minoriteteve. Neni 14 parashikon se “Përfitimi i të drejtave edhe lirive të fiksuara në këtë Konventë do të sigurohet pa dallime për arsye si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindje politike apo bindje të tjera, origjinë kombëtare ose shoqërore, lidhja me një minoritet kombëtar...”, duke siguruar në këtë mënyrë se minoritetet apo grupet e popullsisë në kushte pakicash të çdo lloji nuk do ti nënshtrohen një trajtimi diskriminues në ushtrimin e të drejtave të tyre. Një zhvillim më i fundit, që duhet të përmendet, është Protokollin e 12-të të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që e shtrin ndalimin e dallimeve të Nenit 14 në çdo të drejtë –dhe jo vetëm në të drejtat e sanksionuara nga KEDNJ– por ende nuk ka hyrë në fuqi.

Ndërkaq dokumenti më analitik në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve që është paraqitur deri më sot në shkallë ndërkombëtare është Konventa-kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare¹⁹⁰ që është adoptuar në vitin 1995. Konventa është dokumenti i parë angazhues nga ana ligjore me origjinë evropiane që ka të bëjë me mbrojtjen e minoriteteve kombëtare. Përfshin një regjistrim dhe analizë të zgjeruar të të drejtave edhe lirive të minoriteteve, por që përmes një formulimi shumë të kujdesshëm u ofrohen personave që u përkasin minoriteteve kombëtare dhe jo vetë minoriteteve. Në thelb dokumenti në fjalë analizon të drejtat e KEDNJ në

189. Peraqi S.: *Përmasat e Mbrojtjes Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut*, vll. A, *Kombet e Bashkuara-Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, bot. And. N. Sakulla-Komotini, 1998, faqe 88.

190. Framework Convention for the Protection of National Minorities, ETS No 157, Strasburg, 1-2-1995.

prizmin e minoriteteve kombëtare duke i plotësuar me disa të tjera të reja me të cilat përballen praktika të shkëljes së të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve (për shembull mundësia e përdorimit të mbiemrit në gjuhën amtare edhe njohja zyrtare e tij që parashikohet nga neni 11, paragr. 1). Edhe pse Konventa nuk përmban njohjen e minoriteteve si subjekte kolegjale edhe ofrimin ndaj tyre të të drejtave kolegjale, nuk duhet ndërkaq të injorohet regjistrimi i zgjeruar i të drejtave personale minoritare shumë prej të cilave ushtrohen në mënyrë kolegjale. Përpos kësaj, në nenin 1 të Konventës theksohet se mbrojtja e minoriteteve kombëtare përbën pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, kurse edhe në parathënie përmendet se parimet që mbrohen edhe detyrimet që rrjedhin prej tyre kanë për objektiv sigurimin e mbrojtjes efikase të minoriteteve kombëtare (paragrafi 12). Nga sa më sipër rezulton se megjithëse mungon referimi i minoriteteve si të tilla, të drejtat personale të ofruara kanë për synim edhe mbrojtjen e minoriteteve si subjekte kolegjale.

Një dokument tjetër i rëndësishëm për mbrojtjen e minoriteteve që u adoptua në kuadrin e Këshillit të Evropës, i kufizuar ndërkaq përsa i përket objektit të tij, është Karta Evropiane e Gjuhëve Lokale dhe Minoritare¹⁹¹, por që ndërkaq nuk detyron shtetet e Detit të Zi pasi vetëm Armenia e ka ratifikuar.

Sot minoriteti konsiderohet si “përherë i njohur si kombëtar”¹⁹² nga Këshilli i Evropës, diçka që tregon peshën e veçantë ideologjike të ekzistencës së një minoriteti grek në marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë.

191. European Charter for Regional or Minority Languages, ETS No 148, Strasbourg, 5 November 1992.

192. Është indikativ vendi që i kushton Raporti i Parë i zbatimit të Konventës-Kuadër për Mbrojtjen e minoriteteve kombëtare të Shqipërisë minoritetit grek si minoriteti më i rëndësishëm kombëtar i Shqipërisë.

B. Organizmi për Sigurinë edhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE)

Veçanërisht aktive në mbrojtjen e minoriteteve u tregua Konferenca për Sigurinë edhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), e cila evoluoi në Organizëm (OSBE). Megjithëse nuanca juridike e dokumenteve të aprovuara në kuadrin e OSBE-së është shumë e rreptë dhe siç theksojnë të gjithë të kimplikuarit, detyrimet që marrin përsipër shtetet anëtare janë të karakterit politik dhe jo juridik¹⁹³, ndërkaq në kuadrin e Organizmit janë adoptuar dokumente që funksionuan si pikë referimi në mbrojtje të të drejtave të njeriut brenda dhe jashtë Organizmit. Kështu kemi sipas radhës kronologjike Aktin Përfundimtar të Helsinkit (1975), Dokumentin Përfundimtar të Vjenës (1989), Dokumentin e Kopenhagenit për Anën Njerëzore (1990), Kartën e Parisit për Një Evropë të Re (1990) edhe Dokumentin e Helsinkit (1992). Në dokumentet e OSBE-së në lidhje me minoritetet, duhet tu referohemi veçanërisht konkluzioneve të Komisioneve të Posaçme që janë marrë me çështjet e minoriteteve dhe ndahen në dy kategori: Ato që kanë të bëjnë me çështje të përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe ndalimit të dallimeve dhe ato që u referohen konkretisht minoriteteve. Përsa i përket kategorisë së parë duhet t' i referohemi veçanërisht Aktit Përfundimtar të Helsinkit¹⁹⁴ që shpall respektimin e të drejtave të njeriut duke iu referuar veçanërisht të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve kombëtare. Gjithashtu Dokumentit Përfundimtar të Vjenës¹⁹⁵

193. Pikëpamjen e mungesës së angazhimit juridik shiko Buergenthal T.: *The CSCE Rights System*, 25 Geo. Wash. JIL & Econ. (1991), faqe 375-378.

194. *Final Act of the Conference on Security and Co-operation in Europe*, Helsinki 1-8-1975, Principle No. VII.

195. *Vienna Concluding Document of 15 January 1989*, 10 HRLJ 270 (1989), Principles 16-21.

që i kushton një vend mjaft të gjerë regjistrimit të parametrave bazë të lirisë fetare dhe të detyrimeve respektive që rrjedhin për shtetet në lidhje me sjelljen e tyre kundrejt komuniteteve fetare edhe besimtarëve.

Në kategorinë e dytë gjejmë dokumente specifike që kanë të bëjnë në mënyrë shumë më të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e minoriteteve. Kështu, në Dokumentin e Kopenhagenit të Komisionit të Ekspertëve për Anën Njerëzore të KSBE-së¹⁹⁶ ekzistojnë dispozita të zgjeruara për të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare të cilat kanë karakter shumë më të avancuar në lidhje me dokumentet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Karakteristike është se Konventa Kuadër e mëvonshme për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare përmend dokumentin e mësipërm në parathënien e saj dhe dispozitat e saj janë të influencuara qartë prej tij. Novacioni më i rëndësishëm i dokumentit është se njeh –indirekt– minoritetet si subjekte kolegjale duke nxitur shtetet të mbrojnë dhe të krijojnë kushtet e nevojshme për promovimin e identitetit të minoriteteve kombëtare *inter alia* përmes diskutimeve me subjektet kolegjale të përfaqësimit të minoriteteve (Seksioni IV, paragr. 33). Shumë i rëndësishëm është edhe raporti i Komisionit të Ekspertëve për Minoritetet Kombëtare¹⁹⁷ të Gjenevës, që në esencë përsërit formulimin e dokumentit të Kopenhagenit, por që i referohet ekskluzivisht personave që u përkasin minoriteteve, duke vazhduar kështu të konsiderojë të drejtat minoritare si të drejta personale dhe jo kolegjale. Një pikë veçanërisht e rëndësishme e dokumentit është se çështjet që kanë të bëjnë me minoritetet kombëtare i konsideron

196. Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE, 29 June 1990, 11 HRLJ 232 (1990).

197. Report of the CSCE Meeting of Experts on National Minorities, Geneva, 19 July 1991, 12 HRLJ 332 (1991).

si çështje të interesimit të ligjshëm ndërkombëtar dhe jo ekskluzivisht si pjesë të kopetencës së brendshme të çdo shteti (II, paragr. 3).

Megjithëse shtetet e Detit të Zi në tërësinë e tyre janë anëtarë të OSBE-së, siç u tha më sipër, dispozitat e të gjitha dokumenteve të mësipërme janë të karakterit politik dhe jo juridik në shkallën që nuk janë përfshirë në një dokument të detyrueshëm nga ana ligjore dhe për rrjedhim nuk ndryshojnë detyrimet ligjore të shteteve në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve.

C. Bashkimi Evropian

Në pamje të parë Bashkimi Evropian (B.E.) nuk duket se ka ndonjë rol të veçantë në formimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve në shtetet e Detit të Zi. Ndërkaq, në esencë pozita e saj është shumë e rëndësishme. Kriteret politike që vendos Bashkimi Evropian për vendet kandidatë (Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asoçiimit në qershor të vitit 2006)¹⁹⁸ përmbajnë çështje të trajtimit të minoriteteve, të zhdukjes së dallimeve në kurriz të tyre dhe kushtin e përmbushjes së gjithë premisave të shtruara për integrimin e një vendi në B.E. Kështu të gjitha shtetet që kishin probleme minoritetesh u detyruan të përshtasin legjislacionin

198. Gjatë takimit të Troikës Ministrore të Bashkimit Evropian me Shqipërinë (Tiranë 13.01.2003) u konfirmua angazhimi i B.E. për perspektivën evropiane të Shqipërisë duke e ftuar njëkohësisht të marrë përsipër me përgjegjësi përmbushjen e të gjitha kushteve (conditionality) të Procesit të Stabilizim Asoçiimit, ndër të cilat përfshihet edhe respektimi dhe mbrojtja e plotë e të Drejtave të Minoritetit Kombëtar Grek. E njëjta gjë u konfirmua edhe në “Axhendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Kursi drejt Bashkimit Evropian” (The Thessaloniki Agenda for Western balkans-Moving towards European Integration), e cila u adoptua gjatë Samitit të Selanikut (19-20.06.2003).

dhe praktikat administrative si edhe praktika të tjera me standartet evropiane. Në aspektin praktik Bashkimi Evropian ka përpiluar shumë programe, përfitues të të cilave janë edhe minoritetet në Bashkimin Evropian dhe që përforcojnë në një shkallë të madhe identitetin gjuhësor edhe kulturore të këtyre grupeve të popullsisë.

B.E. vendos kritere të rrepta për vendet kandidate, kritere të cilat përmbajnë çështje të trajtimit të minoriteteve, të zhdukjes së dallimeve në kurriz të tyre dhe për integrimin e një vendi kandidat në Bashkimin Evropian është e nevojshme që të përmbushë të gjitha premiset që shtrohen. Bashkimi Evropian ka nënshkruar me Shqipërinë më 12 qershor të vitit 2006 Marrëveshjen e Stabilizim Asoçiimit (MSA) me Bashkimin Evropian, si fazën e parë për integrimin e saj. MSA, një organ i ushtrimit të politikës së Bashkimit Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me objektiv qendror integrimin e shteteve në strukturat evropiane. Dy janë boshtet e veprimtarisë të MSA-së: a) përafrimi i vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe b) përafrimi të bëhet me kushte (i kushtëzuar), si respektimi i së drejtës ndërkombëtare, të shtetit të së drejtës, të parimeve demokratike, të të drejtave të Njeriut dhe të Drejtave të Minoriteteve. Shqipëria me nënshkrimin e MSA-së nga njëra anë do të përfitojë asistencë të madhe ekonomike dhe nga ana tjetër angazhohet për ndryshime përsa u përket të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave të Minoriteteve. Përpos kësaj që në vitin 2003 Bashkimi Evropian ka ftuar Shqipërinë të marrë përsipër përmbushjen e të gjitha kushteve të MSA-së, ndërmjet të cilave përfshihet edhe respektimi i plotë dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit kombëtar grek, duke theksuar se progresi në negociatat dhe përafrimi i Shqipërisë me Bashkimin Evropian do të varet ekskluzivisht nga aftësia e saj për t'iu përgjigjur detyrimeve që ka marrë përsipër.

Minoritetet përfshihen në kuadrin më të gjerë të të drejtave

të njeriut në Bashkimin Evropian që mbrohen nga organet institucionale, kurse në dokumentet komunitare shpesh bëhet fjalë për organizma të tjerë si OKB-ja edhe Këshilli i Evropës.

Në Axhendën 2000 të Komisionit Evropian bëhet fjalë për respektimin e minoriteteve, kurse Marrëveshja e Stabilitetit për Evropën Juglindore konsiderohet nga shumica si aktine vetëm komunitar që pati për objekt kryesor të saj minoritetet¹⁹⁹.

Së fundi, çështjet e minoriteteve kanë proekupuar në një shkallë të madhe Nismën e Evropës Qendrore në kuadrin e sëcilës është krijuar një grup pune me objekt ekskluziv mbrojtjen e minoriteteve kombëtare (Working Group on Minorities). Ky grup përpiloi një draft marrëveshje me objekt mbrojtjen e minoriteteve kombëtare që u adoptua nga Sesioni i Ministrave të Jashtëm të Nismës (Torino 1994) duke i dhënë emrin “Organ për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve”.

199. Malqidhis Th., *Bashkimi Evropian edhe Treva e Detit të Zi*, Athinë, bot. Gordhios 2004.

19. Konkluzionet

Problemet e minoriteteve janë padyshim reale. Pjesa më e madhe e vendeve, veçanërisht vitet e fundit, gjatë të cilave vihet re një aktivitet intensiv për çështjet e minoriteteve përmes trajtimeve shkencore edhe politike, rivendosin çështjen e minoriteteve si një pikë kryesore referimi të historisë sociale, politike edhe kulturore por nuk kalojnë në zgjidhjen esenciale të problemeve të tyre. Një rast të tillë përbën edhe Shqipëria, e cila sillet ndaj minoritetit grek, këtu e shumë vjet, në mënyrë antidemokratike.

Që nga periudha e formimit të shtetit shqiptar edhe veçanërisht nga vendosja e regjimit komunist, shteti shqiptar e dinte se minoriteti grek duke rivendikuar identitetin e saj të veçantë do tu rezistonte me forcë mekanizmave të tij të homogjenizimit drejt një sheshimi kulturor. Shqipëria në makinacionet e saj kundër minoritetit grek, megjithëse njohu formalisht ekzistencën edhe të drejtat e Minoritetit Kombëtar Grek në Shqipëri, regjimi ka shkelur në mënyrë sistematike të drejtat e njeriut edhe ato të minoriteteve të njohura dhe të sanksionuar në planin ndërkombëtar duke kultivuar një sistem vetëekzistues ndërgjegjeje minoritare në vend të Ndërgjegjes Kombëtare Greke.

Sabotoi ndërgjegjën edhe kompaktësinë e traditës kulturore edhe unitetin shpirtëror të popullsisë së minoritetit grek me trashëgiminë e përbashkët kulturore të kombit grek, duke injektuar një traditë edhe kulturë që bastardonin autenticitetin e identitetit të tij edhe e largonin nga tradita e tij.

Masat që regjimi shqiptar ndërmori në kurriz të Minoritetit Grek ishin përjashtimi i tij nga çdo komunikim me Greqinë,

fallsifikimi i historisë, përcaktimi arbitrar i “zonës së minoritetit”, përndjekja e kishës, kultivimi i mentalitetit që çonte në çkombëtarizim, ristrukturimi i indit social me tendencën e qartë të tjetërsimit edhe asimilimit, terrorizimi, shpërngulja masive, pushkatimi, burgimi, internimi, vdekja.

Pas vitit 1991 dhe ndryshimeve të regjimit në Shqipëri, numri i pjesëtarëve të minoritetit Grek u reduktua përderisa një pjesë e madhe e grekëve emigroi ose u detyrua të emigroi në drejtim të Greqisë, për rrjedhojë u reduktua në mënyrë dramatike numri i grekëve.

Situata e re që krijohet në Shqipëri në periudhën e tranzicionit përbën në thelb konfirmimin e efikasitetit të tjetërsimit të identitetit të minoritetit grek gjatë regjimit komunist.

Probleme të mëdha si arsimimi i pjesëtarëve të minoritetit grek, liria e saj fetare, dhënia pronarëve e pronave private, komunitare dhe kishëtare, mos materializimi nga ana e palës shqiptare e angazhimeve për të drejtat e njeriut edhe ato minoritare, terrorizimi mbeten edhe intensifikohen më tej. Në kontekstin e klimës nacionaliste që kultivohet në Shqipëri, një sërë veprimesh të qeverisë shqiptare u drejtuan kundër minoritetit grek me objektiv largimin përfundimtar të popullsisë greke. Çështja e minoritetit grek duhet të përbëjë një çështje dominuese në marrëdhëniet greko-shqiptare në kuadrin e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, si një çështje avancimi ose jo të marrëdhënieve midis të dy palëve edhe progresi me organizmat evropiane edhe ndërkombëtare (OKB, NATO, OSBE).

Për rrjedhojë, objektivi kryesor duhet të jetë respektimi edhe ushtrimi i plotë i të drejtave të Minoritetit Grek. Minoritetet kombëtare dhe veçanërisht Minoriteti grek nuk janë një element anësor të shteteve të Ballkanit dhe të Shqipërisë, por një pjesë e tyre krijuese. Me këtë kusht, është i nevojshëm respektimi i të drejtave të njeriut siç ato garantohen nga organizmat

ndërkombëtare, konventat ndërkombëtare edhe legjislacioni shqiptar, kurse komuniteti ndërkombëtar duhet të kuptojë se ekziston çështja e minoritetit grek që jeton në Shqipëri, e cila përbën njëkohësisht një çështje demokracie, dinjiteti edhe lirie.

AKTE NDËRKOMBËTARE

**QË U REFEROHEN TË DREJTAVE TË
NJERIUT DHE MINORITETEVE ETNIKE**

Traktati i Londrës i vitit 1913 dhe protokollit i Firencës i vitit 1913

TRAKTATI I LONDRËS 17 MAJ 1913

Neni 1

Nga shkëmbimi i miratimit të këtij traktati duhet të ekzistojë kurdoherë paqe dhe miqësi ndërmjet Lartmmadhërisë së Tij Perandorit të Otomanëve nga njëra anë si dhe të Pasardhësve të tij dhe Trashëgimtareve, nga ana tjetër shteteve dhe nënshtetasve të afërm.

Neni 2

Lartmadhëria e Tij Perandori i Otomanëve u jep Lartmadhërive Sundimtarëve Aleatë të gjitha trojet e Perandorisë së Tij që shtrihen në kontinentin Evropian nga perëndimi përgjatë vijës nga Eno i Egjeut dhe deri në Midhia të Detit të Zi, duke përfshirë Shqipërinë.

Neni 3

Lartmadhëria e Tij Perandori i Otomanëve si dhe Lartmadheritë e Tyre Sundimtarët aleatë deklarojnë se u besojnë Lartmadhërisë së Tij Perandorit të Gjermanisë, Lartmadherisë së Tij Perandorit të Austrisë, Mbretit të Boemisë etj. Dhe Mbretit Apostolik të Hungarisë, Zotit President të Republikës Franceze, të Lartmadhërisë së Tij Mbretit të Britanisë së Madhe dhe Irlandës dhe të Trojeve Britanike përtej Deteve, Perandorit të Indisë, Lartmadhërisë së Tij Perandorit të Rusëve kujdesin për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë dhe të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me Shqipërinë.

Neni 4

Lartmadhëria e Tij Perandori i Otomanëve deklaroi se u

jep Lartmadhërive të Tyre, Sundimtarëve Aleatë ishullin e Kretës si dhe heq dorë nga të gjitha të drejtat që kishte fituar në lidhje me këtë ishull.

Neni 5

Lartmadhëria e Tij Perandori i Otomanëve si dhe Lartmadhëritë e Tyre Sunduesit Aleatë deklarojnë se u besojnë Lartmadhërisë së Tij Perandorit të Gjermanisë, Lartmadhërisë së Tij Perandorit të Austrisë, Mbretit të Boemisë etj dhe Mbretit Apostolik të Hungarisë, Presidentit të Republikës Franceze, Lartmadhërisë së Tij Mbretit të Britanisë së Madhe dhe Irlanndës dhe të Trojeve Britanike përtej Deteve, Perandorit të Indisë, Lartmadhërisë së Tij Mbretit të Italisë, Lartmadhërisë së Tij Perandorit të Rusëve të drejtën për të vendosur në lidhje me ishujt e Otomaneve të Egeut, përveç Kretës dhe përreth Gadishullit Athonos.

Neni 6

Lartmadhëria e Tij Perandori i Otomaneve si dhe Lartmadhëritë e Tyre Sundimtarët Aleatë deklarojnë se i besojnë kujdesin për rregullimin e çështjeve ekonomike të dala nga gjëndja e luftës si dhe nga rregullimi i dhënies së trojeve, Komisionit Ndërkombëtar I mbledhur në Paris dhe Përfaqësuesve të Tyre.

Neni 7

Problemet në lidhje me robërit, të drejtat gjyqësore, kombësinë dhe tregëtinë do të rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme.

Neni Fundit

Ky traktat të miratohet dhe ratifikimet të shkëmbehen në Londër sa më shpejt.

Për mirëbesim të Plotfuqishmit e Palëve të Larta që kontribuan nënshkruan dhe vulosen këtë Traktat.

U bë në Londër më 17 Maj 1913

Mesditë 35 (ora Grinuic).

PROTOKOLLI I FIRENCËS 17.12.1913

Përshkrimi i kufirit. Kufiri fillon nga vendi (lartësia 1.738 në hartën austriake, në verilindje të Mandra Nikolica) ku kufiri jugor Kazasë së Korçës takon vijën malore të Gramozit. Drejtohet nga jugu duke ndjekur vijën malore të Gramozit deri Guri i Zi, pastaj kalon nga lartësitë 2.536 dhe 2.019 dhe arrin tek Golo. Që atje, duke pas ndjekur ndarjen e ujrave deri tek lartësia 1.740 kalon ndërmjet fshatrave Radat dhe Kursaca (K. I drejtohet kodrës që gjendet në verilindje të K dhe ulet për të takuar Sarandaporon. Ndjek shtratin e këtij lumi deri tek takimi i tij me lumin Vjosë dhe që atje takon majën e malit Tumba duke kaluar ndërmjet fshatrave Zipulica dhe Mesaria dhe nëpërmjet lartësive 956 dhe 2.000. Nga maja e malit Tumba kufiri i drejtohet perëndimit tek lartësia 1.621 duke kaluar në veri të Dhermiut. Më pas ndjek vijën ndarëse të ujërave deri tek lartësia që gjendet në verilindje të fshatit Episkopi. Andej drejtohet për nga jugu duke ndjekur vijën malore ndërmjet Radatit, i cili i lihet Shqipërisë dhe Gaidohori i cili i lihet prapë Greqisë, ulet në luginën e Drinos dhe duke përdhkruar këtë lum ngrihet tek kodra e Kakavisë, fshat i cili i lihet Shqipërisë. Ndjek prapë vijën ndarëse të ujërave, duke lënë Valtistan dhe Kastanjanin tek Greqia si dhe Koshovicën tek Shqipëria dhe takon Murganën, lartësia 2.124. Që andej takon Shtugarën si dhe nëpërmjet Vertop dhe lartësisë 750 lë Janjarin dhe Verven Shqipërisë, kalon lartësitë 1.014, 675, 839, i drejtohet veriperëndimit dhe duke lënë Konispolin Shqipërisë ndjek vijën malore të lartësive të Stillos dhe para se të arrijë tek lartësia 254 kthehet për nga jugu dhe takon gjirin e Ftelasë.

PROTOKOLLI I KORFUZIT (17 maj 1914)

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, për të menjanuar përsëritjen e përlëshjeve të armatosura, konsideroi detyrë të tij të mbledh, në rast se është e mundur, mendimin e popullsisë Epirote, që kanë lidhje me dispozitat e posaçme të cilat kërkohen, ndaj synimeve të Qeverisë Shqiptare.

Nën prizmin e këtyre ideve ra dakort që tu parashtrojë fuqive që përfaqëson si dhe Qeverisë Shqiptare, zarfin e mbyllur me përfundimet e bisëdimeve ndërmjet këtij Komisioni dhe përfaqësuesve të Epirit.

Korfuz, me 17 maj 1914

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit

Llab (i Plotfuqishëm Anglez), Vigel (Konsulli i Përgjithshëm i Gjermanisë), Kral (Kons. i Pergj. i Austrisë), Krazefski (Kons. i Pergj. i Francës), Sahtain (Nënkonsull i Austrisë), Petrof (Kons. i Pergj. i Rusisë), Lauro (Kons. i Pergj. i Italisë), Mehdi (përfaqësues i posaçëm i Shqipërisë).

Me rezervimet tona për sa i përket miratimit të për tone.

Jeorjios Zografos, Aleksis Karapanos

DISPOZITAT E PROTOKOLLIT TË KORFUZIT

1. 1. Organizimi. Zbatimi dhe qendrueshmëria e dispozitave për organizimin e dy Rretheve jugore tani për tani i ngarkohet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit i cili do të organizojë Administratën, Drejtësinë dhe Financat.

2. 2. Qeveria Shqiptare bashkë me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit do të caktojë dhe do të shkarkojë nënpunësit e lartë, duke marrë parasysh, nëse është e mundur, rëndësinë numerike të pasuesve të çdo besimi fetar.

3. 3. Këshillat Vendore. Numri i të zgjedhurve në Këshillat Drejtuese do të jetë sa trefishi i numrit të anëtarëve të përcaktuar.

4. 4. Përcaktimi dhe nëndarjet administrative. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit do të kujdeset gjithashtu për përcaktimin dhe nëndarjet administrative të dy këtyre Rretheve dhe nuk do të bëhet asnjë ndryshim pa miratimin e Fuqive.

5. 5. Territoret. Të gjitha dispozitat e lartpërmendura zbatohen tek popullsitë e territorëve të pushtuar më parë nga Greqia dhe që i janë aneksuar Shqipërisë.

6. 6. Xhandarmëria. Për kontrollin e rendit në rrethet jugore do të krijohet nga oficerë dhe xhandarë xhandarmëri vendore që përbëhet nga elemente e besimeve të ndryshme, në bazë të numrit të besimtarëve që banojnë në ato Rrethe. Kjo xhandarmëri nuk do të mund të shërbejë jashtë këtyre Rretheve, përveç një periudhe të përcaktuar dhe kjo për arsye të një nevoje të lartë dhe të njohur nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ky kufizim do të zbatohet për përdorimin e këtyre Rretheve jugore të Trupave të Xhandarmërisë të përbëra po nga këto Rrethe.

7. 7. U rekomandohet oficerave të Xhandarmërisë që të mos përdorin në vende të ndryshme, veçse trupa të përbëra nga elemente të të njëjtit besim, ndaj besimit të banuesve të këtyre vendeve.

8. 8. Në rast të mungesës të elementeve vendore për krijimin përpjestimor të Xhandarmërisë, do tu drejtohet elementeve të interesuar nga Rrethe të tjera të Shqipërisë.

9. 9. Në bazë të këtyre parimeve oficerët hollandeze duhet të fillojnë veprimet e tyre të rekrutimit.

10. 10. Vetëkuptohet se dispozitat e mëparshme në asnjë mënyrë nuk prekin unitetin e Xhandarmërisë Shqiptare, siç ajo u shpreh në Konferencën e Londrës.

11. 11. Forcat e armatosura. Përveç rasteve lufte ose kryengritjeje, në Rrethet e Jugut asnjëherë, nuk do të ndodhë dislokimi ose përdorimi në këto Rrethe njesi ushtarake të përbëra nga jo autoktone.

12. 12. Komunitetet Ortodokse. Komunitetet e Krishtera Ortodokse njihen si Persona Juridike si gjithë të tjerët.

13. 13. Do të kenë në pronësi pronën dhe do ta japin atë lirshëm. Lidhjet e Komunitetëve Ortodokse me udhëheqësit e tyre do të jenë të njëjta si në të kaluarën. Nuk mund të preken të drejtat e trashëguara si dhe organizimi hierarkik, veçse në rast se arrihet marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Patriarkanës Ikumenike të Stambollit.

14. 14. Shkollat. Arsimimi është i lirë. Në shkollat e Komunitetëve Ortodokse arsimimi bëhet në gjuhën greke. Në tri klasat e shkollës Filllore mbas greqishtes do të zhvillohet edhe gjuha shqipe. Por arsimimi fetar do të bëhet vetëm greqisht.

15. 15. Liria e gjuhës. Në bazë të memorandumit dërguar Greqisë nga Fuqitë i datës 11/24 prill 1914 përdorimi i gjuhës shqipe dhe greke do t' u sigurohet Jugoreve para te gjitha instancave, duke përfshirë Gjykatat deri tek Këshillat e zgjedhura.

16. 16. Zotërimi. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit do të marrë në zotërim territoret në fjalë, duke shkuar në vend.

17. 17. Oficerët e misionit Hollandez duhet të angazhohen menjëherë për krijimin e Xhandarmërisë vendore. Provizorisht, deri në krijimin e Xhandarmërisë vendore oficerët Hollandeze me ndihmën e elementeve vendas do të angazhohen në ruajtjen e rendit publik.

18. 18. K.N.K. do të angazhohet në krijimin e komisioneve të përbashkëta, të përbëra nga të Krishterë dhe Myslimanë, në raport me rëndësinë numerike të çdo feje. Provizorisht dhe deri në organizimin e institucioneve vendore këto Komisione do të ushtrojnë detyra administrative nën vëzhgimin e K.N.K., i cili do të përcaktojë dimensionin e tyre. Para dislokimit të oficerëve Hollandeze duhet të merren të gjitha masat nga Qeveria Provizore e Gjirokastrës për largimin nga ky territor i të gjithë elementeve të armatosur të huaj.

19. 19. Këto dispozita duhet të zbatohen edhe në Rrethin e Korçës, që në këtë çast është pushtuar ushtarakisht nga Qeveria Shqiptare, si në zonat e tjera të Jugut.

20. 20. Ndihma. Qeveria Shqiptare bashkë me K.N.K. duhet të marrë masat e nevojshme për të ndihmuar popullsitë e lënduara vitet e fundit nga Trupat.

21. 21. Amnistia. U jipet amnisti e plotë të gjithë Epirotëve për të gjitha veprimet e tyre të para pushtimit të Rretheve nga përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare. Të gjithë njerëzit me origjinë nga Epiri për këtë periudhë do të ndiqen vetëm për krimë të së drejtës së përbashkët.

22. 22. Garancitë. Fuqitë që nëpërmjet Konferencës së Londrës garantuan ndertimin e Shqiperisë dhe që vendosen K.N.K. janë garant për zbatimin dhe mbajtjen e dispozitave të lartpërmendura.

23. 23. Dispozita që kanë të bëjnë me Himarën. Duke dëgjuar udheheqësin e Himarës bashkë me përfaqësuesit e Epirit dhe duke shënuar kërkesat e tyre dhe që kanë lidhje me privilegjet e hershme, si dhe propozimet e reja që u bënë në interes të Himarës dhe të komunikimit të përgjithshëm, teksti i të cilave po pritet të vijë, K.N.K. do ti parashtojë këto siç edhe dispozitat e tjera që kanë lidhje me Epirin, në kontrollin dhe miratimin e Fuqive të Mëdha, si dhe të Qeverisë Shqiptare.

Administrativisht prefektura e Himarës do ti bashkangjitet Rrethit të Gjirokastrës. Por kërkohet që Himara të jetë seli gjykate dhe që gjykatësit e paqit, të cilët duhet të zgjidhen nga Epirotët e Krishterë Ortodoksë, të kenë të drejta të zgjeruara, veçanërisht për sa i përket pushtetit penal gjyqsor, në zbatim të ligjit në vend. Që të mund të mundin zakone të dhimbshme dhe të parandalojnë dëbimin e kësaj popullsie, kaq krenare për të shkuarën e saj të lavdishme, në vende të largëta (e vështirë në gjëndjen që ndodhet komunikacioni) në rast akuzash për krime apo faje.

DEKLARATË E PËRFAQËSUESVE TË EPIRIT

Përfaqësuesit e Epirit deklarojnë se do të këmbëngulin:

1. 1. Që Xhandarmëria vendore në asnjë rast dhe rrethanë, të mos shërbejë jashtë kufijve të dy rretheve jugore.

2. 2. Që për një dhjetvjeçar komandantet të jenë nënshtetas të huaj të një Shteti neutral, me origjinë nga ky ose të pakten të krishterë orthodhoksë.

Jeorjios Zografos, Al. Karapanos

SHQIPËRIA NJEH PA KUSHTE PROTOKOLLIN E KORFUZIT

(12 qershor 1914)

– Zotit Zografos, i është dërguar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit të Shqipërisë telegrami i mëposhtëm-Shkelqësia e Tij Mbreti i Shqipërisë pranoi në tërësi dhe pa kushte marrëveshjen e Korfuzit dhe i la Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit liri të plotë të rregullojë mbas shqyrtimit në vend të problemit të Himarës si dhe problemin e nënndarjen administrative. Për sa u përket deklaratave të tjera të shkruara për ne, janë bashkëngjitur tekstit të marrëveshjes, u morrën parasysh dhe u rregulluan nëpërmjet nenëve 1 dhe 5 të kësaj marrëveshjeje.

Në këtë mënyrë zgjidhja përfundimtare e problemit është kompetence e plotë e F. të Mëdha, të përfaqësuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.

Pasi të marrim përgjigje përfundimtare, do t'iu komunikojmë zyrtarisht vendimin e F. të Mëdha dhe ditën e mbrictjes sonë në Shën Saranda.

August Kral

Kryetar i Komisionit Ndërkombëtar të Shqipërisë

**FUQITË E MËDHA KOMUNIKOJNË ATO QË U ARRITEN
NE KORFUZ**

(19 qershor 1914)

**KOMUNIKATË DREJTUAR SHKELQËSISË SË TIJ
MINISTRIT TË JASHTËM TË GREQISË**

Të nënshkruarit kanë nderin të komunikojnë Shk. Së Tij Ministrin të Jashtëm, se Qeveritë e Gjermanisë, Austrohungarisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë, Ruisë miratuan marrëveshjen e arritur në Korfuz ndërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe Përfaqësuesve Fuqiplotë të Epirotëve, për sa i përket formës së qeverisjes së ardhshme të Epirit.

*Kuat. Sillasy, Dovill, Erakins,
Dosdhari, Princ Kurusov*

PROTOKOLLI I KAPSHTICËS

Të nënshkruarit,

Nga njëra anë Komandanti i Përgjithshëm i Maqedonisë Lindore M. Iliaskos dhe Str. Z. N. Trikupi si përfaqësues i Qeverisë Greke.

Nga ana tjetër Estref, Drejtor i Përgjithshëm i Veprave Publike të Qeverisë së Tiranës, Gj. Raxi, kryetar i Këshillit të Pavarësisë, P. Cali, ish ministër shqiptar. I. Disnika, anëtar i Këshillit, N. Zoi. Drejtor i Financave dhe kapiteni Sel. Dosme, përfaqësues i Qeverisë së Shqipërisë.

Të mbledhur sot më 15 maj 1920 në Kapshticë ramë dakort për sa vijon:

Në mënyrë që ushtria greke të përparojë për pushtimin e Korçës për të zëvendësuar forcat franceze që tërhiqen, mbas lutjes së palës së dytë, pala e parë merr përsipër përgjegjësinë të ndaloj përparimin për të lehtësuar mirëkuptimin ndërmjet Qeverive të Greqisë dhe të Shqipërisë me qëllim që të rruhen

marrëdhëniet e mira të fqinjësisë së mirë ndërmjet dy popujve vëllezër dhe që të shmanget gjakderdhja.

Mbas kësaj dhe deri sa problemi të zgjidhet ose nëpërmjet Konferencës së Paqes ose nëpërmjet marrëveshjeje ndërmjet dy qeverive, pala e dytë detyrohet si më posht.

1. Asnjë nga Grekët të cilët banojnë në territorin i cili nuk do të pushtohet nga ushtria greke nuk do të pesojë asgjë për shkak të ndjenjave të tij.

2. Shkolla greke dhe kishat do të funksionojnë lirshëm.

3. Nuk do të bëhet asnjë përparim përtej vijës së pushtuar nga ushtria greke para luftës së fundit dhe që fillon nga fshati Slimerika në Gramoz, ndjek vijën e ndarjes së ujërave Devoll dhe Aliakmonos (Vistica)-e Sipërme dhe duke kaluar në perëndim të fshatit Kapshtic drejtohen për në veri duke kaluar në perëndim të fshatit Vernik. Nga ky vend drejtohet për në Perëndim, kalon nëpërmjet majave 858, 1.309 dhe 1.090, që andej drejtohet djathtas drejt Veriut, ndjek majën e malit Melisa dhe përfundon në liqenin e Prespës. Vijat e përparuara nuk lejohet të vendosen përgjatë vijës së mësipërme të vendosur nga të dyja palet.

Xhandarët shqiptare, të cilët mund të ndodhen përtej kësaj vije në drejtim të tokës greke, duhet të tërhiqen brënda një periudhe tri ditore duke filluar nga sot.

Të dyja palet premtojnë se do ti binden vendimit të Konferencës, e cila do të përcaktojë një herë e përgjithmonë vijën e kufirit.

Ky protokoll nënshkruhet në dy kopje dhe nënshkruhet nga të dyja palet dhe nga ata që ishin prezent në këtë marrëveshje Mitropolitit të Durrësit.

Palet kontribuese

Iliaskos - Trikupis

Shqiptarët Estref Frasheri, G. Raxi, P. Cali

Ata që ishin prezent. Mitr. Durrësit Iakovos, Riza Hursit.

**PROTOKOLLI I PËRCAKTIMIT TË KUFIRIT
GREKO-SHQIPTAR
FIRENCËS 27. 1. 1925
PROTOKOLLI PËRFUNDIMTAR**

Neni 1

Krijimi i Komisionit

Në bazë të vendimit të 1 shkurti dhe të 10 nëntorit 1922 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris, nënshkruesit e mëposhtëm dhe të autorizuar nga qeveritë përkatëse të tyre si anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë të parashikuar nga vendimi për përcaktimin e kufijve i marrë në 9 nëntor 1921 nga qeveritë e Perandorisë Britanike, të Francës, të Italisë dhe të Japonisë, u ngarkuan të përcaktojnë në vend kufijtë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.

Neni 2

Dokumente për përcaktimin e kufijve

Vija ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë u përcaktua në Konventën e Londrës 1913.

Përcaktimi i Pjesës Veriore nga tripalesh Shqipërisë, Greqisë, Jugosllavisë deri në Bandaros u përcaktua në mënyrë të saktë me vendimin e konferencës së Ambasadorëve më 27 korrik 1923. Përcaktimi i pjesës së mbetur nga Mandaros deri në gjirin e Ftelasë, u përcaktua saktësisht me Protokollin e Firencës më 17 dhjetor 1913, të Komisionit Ndërkombëtar të përcaktimit të kufijve jugor të Shqipërisë, në Procesverbalet e Mbledhjes së saj të 15-të.

Neni 3

Nëndarjet e kufirit

Për përcaktimin në terren, vija kufitare greko-shqiptare u nda nga Komisioni Ndërkombëtar i përcaktimit të kufirit

shqiptar më 1923-24 në tre sektore. Sektori i parë kalon, nga dokumenti tripalësh, brënda liqenit të Prespës, në majën e lartësisë 2.036 të Bandaros. U përcaktua në terren më 69 shënja kufitare (piramida) duke numëruar nga 1.1 deri 1.69.

Sektori i dytë kalon nga maja e lartësisë 2.036 të Bandaros tek bashkimi uJOR I Sarandaporos me Vjosën. Edhe kjo u përcaktua në terren më 29 shënja kufitare, duke numëruar nga 11.1 deri tek 11.29.

Sektori i tretë kalon nga bashkimi uJOR i Sarandaporos me Vjosën në gjirin e Ftelasë. U përcaktua në terren me 79 shënja të rregullta kufitare, duke numëruar nga 111.1 deri tek 111.79.

Që të hiqet diagrami i vijës kufitare ndërmjet dy shenjave të njëpasnjëshme, u ndërtuan piramida të vogla pa numër në shumë vende.

Të dhënat që kanë të bëjnë me ndërtimin e shenjave të kufirit janë të përmbledhura tek shtojca nr. 1.

Neni 4

Dokumente që përcaktojnë saktësisht diagramin e kufirit
Diagrama e kufirit përcaktohet:

1) Nga ndërtimi i 117 fletëve një për çdo shënjë me përshkrimin e saj dhe përshkrimin e hollësishëm të vijes kufitare nga njëra shënjë deri tek shënja pasardhëse (Shtojca 11).

2) Me anë të përshkrimit të përgjithshëm të kufirit (Shtojca 111).

3) Me anë të shtatë fletëve të hartës së kufirit me shkallë zvogëlimi 1:50.000 të përpiluara nën kujdesin e Komisionit Ndërkombëtar të Përcaktimit të kufijve të Shqipërisë 1923-24 (Shtojca Iv).

Përshkrimet e dokumenteve të mësipërme i referohen kësaj harte të fundit, e cila zëvendëson ose hartat përmbledhëse me shkallë 1:100.000, që u hartuan më 1913 nga gjeneralet King dhe Grabo, që iu bashkuan Protokollit të Firencës i 17 dhjetorit 1913, të cilat Komisioni i konsideroi si jo të saktë, ose skica

me shkallë 1:50.000 që u morrë parasysht provizorisht më 1923 nga Komisioni dhe mbi bazën e të cilit Konferenca e Ambasadorëve kishte marrë vendimin e saj për sektorin e parë. Në rast të ekzistencës së ndryshimeve ndërmjet hartës dhe tekstit, sigurisht që do të merret parasysht teksti me përshkrimin e hollësishëm, i cili ndodhet tek fletët e par. 1.

Neni 5

Rrjedhjet e ujërave që ndjekin vijën e kufirit

Çdo herë që vija kufitare ndjek rrjedhjen e ujit, ngelet e përcaktuar se në qoftë se këto rrjedhje pesojnë ndryshime për shkak të energjisë së vazhdueshme të ujërave, vija kufitare do të ndjekë këto ndryshime.

Por në qoftë se këto ndryshime janë bërë për arsye teknike ose për shkak të veprimit të befasishëm të forcave të natyrës, nuk do të sjellin ndryshimin e vijës kufitare, e cila në këto raste do të mbetet e pandryshuar.

Neni 6

Monopate ose kalime te ngushta që ndjekin vijën kufitare

Në qoftë se vija kufitare ndiqet nga monopate apo kalime të ngushta, banorët e dy vendeve fqinjë do të kenë të drejtë të kalimit të lirë nga këto monopate ose kalime të ngushta.

Neni 7

Objekte ushtarake në afërsi të vijës kufitare

Asnjë objekt ushtarak nuk duhet të ekzistojë, as nuk duhet të ndërtohet në të ardhmen në një rip me gjerësi 20 metra në ëdo anë te vijës kufitare.

Neni 8

Mirëmbajtja e vijës kufitare

a) Mirëmbajtja e shënjave kufitare, i piramidave të vogla dhe i prerjes së pemëve në një sipërfaqe me gjerësi 3 metra nga të dy anët e vijës kufitare do të përbëjë objekt të një marrëveshjeje të posaçme ndërmjet dy Qeverive të interesuara.

b) Deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje mirëmbajtja

ndahet si më poshtë: Nga liqeni i Prespës deri në bashkimin ujqor (duke përfshirë edhe këte) të Sarandaporos me Vjosën tek Shqipëria.

Nga bashkimi ujqor (duke e përjashtuar këtë) të Sarandaporos me Vjosën deri tek gjiri I Ftelasë tek Greqia.

Përveç kësaj, një Komision, i përbërë nga një oficer të secilit vend, ka për detyrë të kalojë vijën kufitare dhe të përpilojë një raport rreth gjëndjes së saj. Është e arësyeshme që ky Komision të mbledhet në Kapshticë më datën 1 korrik të çdo viti.

Neni 9

Mirëmbajtja e urës së Peratit

Mirëmbajtja e urës prej betoni e cila ekziston mbi lumin Sarandaporos në Perat, do të përbëjë objekt i një marrëveshjeje të posaçme ndërmjet dy shteteve fqinjë.

Neni 10

Probleme të ndryshme

Problemet e ndryshme të ngritura për përcaktimin e vijës së kufirit dhe që nuk parashikohen në këtë Protokoll, do të përbëjnë objekt të marrëveshjeve të drejtpërdrejta ndërmjet dy Qeverive të interesuara.

Neni 11

Deklarata të Komisionit në lidhje me vijën kufitare

Komisioni i përcaktimit të vijës kufitare, pasi u bind:

a) Se diagrami në terren është konform vendimeve baze, të rekomanduara nga neni 11,

b) Se dokumentet hartografike të përpiluara përputhen me ato të terrenit,

c) Se të tre kopjet e bashkëngjitura të dokumenteve, që kanë destinacion përkatësisht Konferencën e Ambasadorëve për Shqipërinë dhe Greqinë, janë të njëjta.

Pasi u realizua dorëzimi në terren i vijës kufitare në të dy Qeveritë e interesuara, duke marrë parasysh deklaratimet e

përfaqësuesve të të dy Shteteve të interesuara, që përfshihen në Shtojcën 5.

Deklaron unanimisht se vija kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë nga tripaleshja Shqipërisë, Greqisë, Jugosllavisë deri tek gjiri i Ftelasë është përcaktuar në mënyrë të vërtetë dhe të rregullt (nenët III dhe iv i këtij Protokolli).

Neni 12

Fërfundimi i punimeve

Me nënshkrimin e këtij Protokolli punimet e Komisionit Ndërkombëtar të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë mbi vijën kufitare Greko-Shqiptare përfunduan.

U perpilua në Firencë në Tri Kopje Origjinale të destinuara:

Për Konferencën e Ambasadorëve

Për Qeverinë e Shqipërisë

Për Qeverinë e Greqisë.

SHTOJCA V

Deklarata të Përfaqësuesve të Shqipërisë dhe Greqisë para Komisionit Ndërkombëtar të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë.

Nënshkruesit e poshtëshënuar, Përfaqësues të Qeverive të Shqipërisë dhe Greqisë, të autorizuar, para Komisionit Ndërkombëtar të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë paraqesin deklaratat e mëposhtme në emër të Qeverive respektive.

1) Përfaqësuesi Shqiptar nuk ka për të shprehur asnjë vërejtje të natyrës teknike në lidhje me vijën kufitare që sapo u përcaktua në terren, nga kufiri tripalesh Shqipëri, Jugosllavi, Greqi deri tek gjiri i Ftelasë.

Përfaqësuesi Grek konsideron si të panevojshme një deklaratë rreth këtij problemi, për arsye se Qeveria Greke i bëri të njohur në një kohë të përshtatshme kundërshtimet e saj Konferencës së Ambasadorëve dhe iu nënshtrua në vazhdim vendimeve të Konferencës.

2) Të dy përfaqësuesit nuk kanë asnjë vërejtje të natyrës

teknike për të shprehur në lidhje me përpilimin, nga Komisioni Ndërkombëtar të përcaktimit të vijës kufitare, të dokumenteve hartografike, domëthënë për 177 fletët e shënjave kufitare dhe për shtatë fletët me numerimet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 të hartës së vijës kufitare me shkallë zvogëlimi 1:50.000.

3) Të dy përfaqësuesit janë dakort se mirëmbajtja e shënjave të vijës kufitare, të piramidave të vogla dhe të prerjes së pemëve të sipërfaqes prej 3 metra gjerësi në të dy anët e vijës kufitare do të bërëjnë objekt të një marrëveshjeje të posaçme, e cila do të nënshkruhet ndërmjet dy Qeverive.

Për sa i përket planit të Komisionit se deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, mirëmbajtja të jetë si më poshtë:

- Nga liqeni i Prespës deri në bashkimin uJOR (duke përfshirë edhe këtë) ndërmjet Sarandaporos dhe Vjosës Shqipëria,

- Nga bashkimi uJOR (duke e përjashtuar këtë) ndërmjet Sarandaporos dhe Vjosës deri tek gjiri i Ftelasë Greqia,

- Si dhe qe një Komision i përbërë nga një oficer për çdo vend, të mblidhet më 1 korrik të çdo viti në Kapshticë që të shkel vijën kufitare dhe të përpilojë raport rreth gjëndjes së saj

Përfaqësuesi Shqiptar është dakort me planin e Komisionit,

Përfaqësuesi Grek deklaroi se kurdoherë problemet që lidhen me mirëmbajtjen e saj të rregullohen nëpërmjet marrëveshjes së sipërmendur ndërmjet të dy Qeverive.

Firencë, më 27 janar 1925.

Përfaqësuesi Shqiptar
MEDHI FRASHERI

Përfaqësuesi Grek
n/kolonel HR. AVRAMIDHIS

REZOLUTË E SENATIT TË SHBA (1946)

Komisioni i Çëshjeve të Jashtme të Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Rezolute Nr. 82 i 27 marsit 1946. RESOLVED that it is the sense of the Senate that Northern Epirus (including Koritsa) and the twelve islands of the Aegean Sea, known as the Dodecanese Islands where a strong Greek Population predominates, should be awarded by the peace Conference to Greece and become incorporated in the territory of Greece.

KONFERENCA E PAQES Paris (1946)

Konferenca e Paqes me pjesëmarrjen e 21 shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore, pranon më 29 qershor 1946 propozimin e qeverisë greke drejtuar seancës plenare, që kërkonte rregjistrimin e çështjes vorioepirote.

Në nëntor të 1946, Këshilli i Ministrave të Jashtëm, pa u marrë asnjë vendim, pasi ia kaloi “çështjen e përcaktimit të kufijve greko-shqiptare” për diskutim dhe zgjidhje Këshillit të Katër Fuqive Garantuese, kur të zgjidhet nënshkrimi i traktatit të paqes me Austrinë –u nënshkrua më 15 maj 1955– nga ku qëndron pezull deri sot.

1. DEKLARATA E PËRGJITHSHME E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Paris, më 10 dhjetor 1948 (Kombet e Bashkuara)

Neni 2

Çdo njeri ka të drejtë t’u referohet të gjitha të drejtave dhe të gjitha lirive që shpall kjo Deklaratë, pa asnjë dallim dhe në veçanti për sa i përket racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit, bindjeve politike, origjinës etnike, pasurisë, lindjes ose çdo gjëndjeje tjetër.

Akoma, nuk mund të behet asnjë dallim për shkak të sistemit politik, juridik ose ndërkombëtar të vëndit nga i cili e ka prejardhjen çdokush, qoftë kur është fjala për një vend ose krahinë e pavarur, nën kujdestari ose nënqeverisje, qoftë kur ndodhet nën kufizim të çfarëdoshëm sovraniteti.

Neni 3

Çdo individ ka të drejtën e jetës, të lirisë dhe të sigurisë së personit.

Neni 4

Asnjë nuk mund të mbahet nën skllavëri ose nënshtrim dhe tregtimit i skllavërve ndalohet për të gjitha format e saj.

Neni 9

Asnjë nuk mund të arrestohet, të ndalohet ose të internohet në mënyrë arbitrare.

Neni 13

Çdo person ka të drejtë të largohet nga çdo vend duke përfshirë edhe vendin e tij dhe të rikthehet në vendin e tij.

Neni 17

Asnjëri nuk mund ti mohohet arbitrarisht prona e tij.

PJESË NGA DEKLARATA PËR HEQJEN E ÇDO LLOJI TË DISKRIMINIMIT RACOR

Neni 1

Diskriminime ndërmjet qenieve njerëzore të bazuara në racën, ngjyrën ose prejardhjen etnike, janë fyerje për personalitetin e njeriut dhe denohen sikur të përbëjnë mohim të parimeve të Kartës së Kombëve të Bashkuara, shkelje të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore që shpallen në Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, pengesë në marrëdhëniet miqësore dhe paqësore ndërmjet kombeve, dhe ngjarje që mund të prish paqen dhe sigurinë e popujve.

Neni 2

1. Shtete, institucione ose private, nuk duhet të bëjnë asnjë diskriminim për sa u përket të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në trajtimin e personave, grupeve ose institucioneve për shkak të racës, të ngjyrës ose të prejardhjes etnike.

2. Shtetet nuk duhet të inkurajojnë, mbrojnë ose mbështesin nëpërmjet policisë ose me mënyra të tjera, asnjë diskriminim të bazuar tek raca, ngjyra ose prejardhje etnike nga çfarëdo grup, institucion ose privat.

3. Masa specifike duhet të merren në situata të përshtatshme që të garantohet zhvillimi I mjaftueshëm dhe mbrojtja e privateve të cilën i përkasin grupeve të caktuara racore me qëllim që këta private të mund të përfitojnë në mënyrë të plotë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Këto masa në asnjë rast nuk duhet të kenë si rrjedhojë ruajtjen e të drejtave të pabarabarta dhe të veçanta për grupe të ndryshme racore.

Neni 3

1. Duhet të bëhen në mënyrë të veçantë përpjekje për parandalimin e diskriminimeve të bazuara tek raca, ngjyra dhe origjina etnike. Në veçanti në sektorin e të drejtave civile, në të drejtën për nënshtetësi, arsim, fe, punësim, ushtrimin e profesionit dhe strehimin.

2. Çdo njeri duhet të pranohet në të gjitha vendet dhe të përfitojë të gjitha lehtësirat në vendet që destinohen për përdorim nga publiku, pa dallim raceje, ngjyre ose origjine etnike.

**KONVENTË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE
DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT**

Romë, 4 nëntor 1950, siç u ndryshua nga Protokollin
Nr. 11 (Këshilli I Evropës)

Neni 14 - Ndalimi i diskriminimeve

Përdorimi i të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Konventë

duhet të sigurohen pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike e bindjet e tjera, origjina etnike ose sociale, marrja pjesë në një minoritet, pasuria ose ndonjë gjëndje tjetër.

PJESË NGA KARTA E ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Neni 55

Duke synuar krijimin e kushteve stabiliteti dhe mirëqënieje, të cilat janë të nevojshme në mënyrë që ndërmjet kombëve të ekzistojnë marrëdhënie paqësore dhe miqësore, të bazuara në parimin e të drejtave të barabarta dhe të vetvendosjes së popujve, Kombet e Bashkuara do të favorizojnë,

a. ngritjen e nivelit të jetesës, punë për të gjithë dhe kushte për përparim dhe zhvillim ekonomik e social.

b. zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare, ekonomike, sociale, shëndetit publik dhe të tjera që kanë lidhje me to, bashkëpunimin kulturor dhe arsimor ndërkombëtar dhe

c. respektimin ndërkombëtar dhe të sukseshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut pa dallim race, seksi, gjuhe ose feje.

Neni 56

Të gjithë Anëtarët përfitojnë detyrimin të veprojnë për realizimin e qëllimeve që paraqiten në Nenin 55, ose të tëra së bashku ose në veçanti, në bashkëpunim me Organizatën.

KONVENTË KUNDËR DISKRIMINIMEVE NË ARSIM

Paris, më 14 dhjetor 1960 (UNESCO Kombet e Bashkuara)

Konferenca e Përgjithshme I NE8I (Organizatës të Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën), që u mbajtë në Paris nga 14 deri në 15 dhjetor 1960, në seancën e saj të njëmbëdhjetë,

Duke marrë parasysh se Deklarata e Përgjithshme të të

Drejta të Njeriut konfirmon parimin e mos diskriminimit dhe shpall se çdo person ka të drejtë për arsimim, duke konsideruar se diskriminimet në arsimim përbëjnë cenim të të drejtave që shpallen në atë Deklaratë,

Duke konsideruar se sipas kushteve të Statutit të saj, UNESCO synon në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet kombeve me qëllim sigurimin për të gjithë të respektimit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut dhe të barazisë së shanseve në arsimim, Duke njohur kështu që UNESCO ka për detyrë, duke respektuar ndryshueshmërinë të sistemeve arsimore kombëtare, jo vetëm të mohojë çdo formë diskriminimi e arsim, por dhe të shtyjë barazinë e shanseve dhe të trajtimit për të gjithë në arsimim.

Duke patur para saj propozime që kanë të bëjnë me format e ndryshme diskriminimi në arsim, të cilat përbëjnë Temën 171.4 të rendit të ditës së seancës.

Duke marrë vendimin gjatë seancës së dhjetë të saj se kjo çështje duhet të përbënte objekt të një konvente ndërkombëtare, si dhe rekomandimesh për Shtetet-Anëtare,

Miraton këtë Konventë më 14 dhjetor 1960.

Neni 1. - 1.

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “diskriminim” përbën çdo diferencim, përjashtim, kufizim ose preferim e cila duke u nisur nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, bindjet politike ose bindje të tjera, origjina etnike ose sociale, gjendja ekonomike ose origjina familjare, ka si qëllim ose si rrjedhojë zhdukjen ose zbutjen e trajtimit të barabartë në arsim dhe më konkretisht

a) Privimin e çdo personi ose grupi nga e drejta e futjes në çdo formë ose shkallë të arsimit,

b) Kufizimin e çdo individi ose grupi nga arsimimi i shkallës së ulët,

c) Nën rezervat e kushteve të nenit 2 të kësaj Konvente,

ngritjen ose mbajtjen e sistemeve të veçanta arsimore ose institucioneve për individë ose grupe,

d) Imponimin tek çdo individ ose grup të kushteve që nuk përputhen me dinjitetin e çdo njeriu.

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “Arsim” u referohet te gjitha formave dhe niveleve te arsimit dhe perfshin marrjen pjesë në të, nivelin dhe cilësinë si dhe kushtet në të cilat jepet.

Neni 2 - Përderisa lejohen në një Shtet, rastet e mëposhtme nuk konsiderohet se rekomantojnë diskriminime nën kuptimin e nenit 1 të kësaj Konvente

a) Themelimi ose ruajtja të sistemeve ose institucioneve të veçanta për nxënës të të dy sekseve, përderisa këto sisteme ose institucione ofrojnë hyrje të barabartë në Arsim, kanë personel arsimor me virtyte të të njëjtit nivel si dhe institucione shkollore dhe pajisje të së njëjtës cilësi mund të japin mundësinë e ndjekjes të të njëjtave ose programeve mësimore të barasvlershme.

b) Themelimi ose ruajtja për shkaqe fetare ose gjuhësore të sistemeve ose institucioneve të veçanta arsimore, të cilat japin arsim që përputhet me dëshirat e prindërve ose të kujdestarëve të nxënësve, përderisa marrja pjesë në sisteme të tilla ose ndjekja e mësimave në institucione të tilla është me zgjedhje dhe arsimimi që jepet u korespondon niveleve që mund të jenë përcaktuar ose janë pranuar nga autoritetet kompetente, veçanërisht për arsimin i së njëjtës shkalle,

c) Themelimi ose ruajtja i institucioneve arsimore private, përderisa qëllimi i tyre nuk është të sigurojnë përjashtimin e çfarëdolloj grupi, por të japin lehtësira arsimore nga ato që jep shkolla publike, përderisa këto institucione funksionojnë me një mënyrë që i përshtatet këtij qëllimi dhe arsimit që jepet u përgjigjet niveleve që mund të jenë përcaktuar ose janë pranuar nga autoritetet kompetente, veçanërisht për arsimin e së njëjtës shkalle, janë po kështu të barasvlershme.

Neni 5. - 1. (c). Është e nevojshme që të njihet e drejta tek anëtarët e minoriteteve etnike të ushtrojnë veprimtaritë e tyre arsimore duke përfshirë edhe ruajtjen e shkollave dhe, në raport me politikën arsimore të çdo shteti, të përdorimit ose të mësimi të gjuhës së tyre, por me kusht që,

(I) Kjo e drejtë nuk ushtrohet me qëllim që të pengojë anëtarët e këtyre minoriteteve të kuptojnë kulturën dhe gjuhën e shumicës së komunitetit dhe të marrin pjesë në veprimtaritë e tij ose me mënyrën që do të vë në rrezik sovranitetin kombëtar.

(II) Niveli i arsimit nuk është më i ulët nga niveli i përgjithshëm që është vendosur ose që është pranuar nga autoritetet kompetente dhe

(III) Ndjekja e mësimëve në këto shkolla është me zgjedhje.

TRAKTAT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT INDIVIDUALE DHE POLITIKE

Nju Jork, 16 dhjetor 1966 (Kombet e Bashkuara)

Neni 2

1. Shtetet kontribuese në këtë Traktat marrin pësipër detyrimin që të respektojnë dhe të garantojnë tek të gjithë personat që ndodhen brenda kufijve të shtetit të tyre dhe ndodhen nën juridiksionin e tyre, të drejtat që njihen nga ky Traktat, pa asnjë dallim dhe veçanërisht për nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, bindjeve politike ose bindjeve të tjera, origjina etnike ose sociale, pasuria, lindja ose çdo gjëndje tjetër.

2. Shtetet kontribuese në këtë Traktat marrin përsipër angazhimin që të krijojnë kushtet e nevojshme në bazë të procedurave të tyre kushtetuese si dhe dispozitat e këtij Traktati, që do të lejojnë marrjen e masave të karakterit legjislativ ose të një karakteri tjetër për realizimin e të drejtave që njihen nga ky Traktat, në rastet kur dispozita të tilla ose masa nuk janë parashikuar.

3. Shtetet kontribuese në këtë Traktat marrin përsipër detyrimin,

a) të garantojnë se çdo individ, të cilit i shkelën të drejtat dhe liritë që njihen nga ky Traktat, do të ketë në dispozicion të tij një apelim të përshtatshëm, është në rast se kjo shkelje është bërë nga persona që veprojnë nën cilësinë e tyre zyrtare shtetërore,

b) të garantojnë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ, legjislativ ose çdo autoritet tjetër kompetent sipas legjislacionit të Shtetit, vërtet do të vendosë në lidhje me të drejtat e tij dhe të ndjekin mundësinë e apelimit gjyqësor,

c) të garantojnë zbatimin, nga autoritetet kompetente, të çdo vendimi që do të miratojë apelimin përkatës.

Neni 13

Shtetet kontribuese njohin të drejtën e edukimit të çdo personi. Bien dakort se edukimi duhet të synojë në zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe të ndjenjës së personalitetit të tij dhe të forcojë respektimin e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore. Bien dakort akoma se edukimi duhet të bëjë çdo person të aftë që të luajë një rol të vlefshëm në një shoqëri të lirë, të favorizojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, të grupeve etnike ose fetare dhe të inkurajojë zhvillimin e veprimtarisë së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

Neni 27

Në shtetet në të cilat ekzistojnë minoritete etnike, fetare ose gjuhësore, personave që u përkasin atyre nuk mund tu mohohet e drejta që të kenë, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, jetën e tyre kulturore, të shfaqin dhe të ushtrojnë fenë e tyre ose të përdorin gjuhën e tyre.

Neni 28

Shtetet kontribuese njohin se që të realizohet qëllimi i garantimit të ushtrimit të plotë të këtij qëllimi:

a) Arsimi bazë duhet të jetë i detyrueshëm dhe të jepet falas për të gjithë,

b) Arsimi i mesëm me format e ndryshme të saj, në të cilin përfshihet edhe arsimi Teknik e Profesional, duhet të përgjithësohet, në mënyrë që të bëhet i mundshëm për të gjithë me të gjitha mjetet e duhura dhe madje me veprimin përparimtar ligjor të arsimimit falas.

c) Arsimi i lartë duhet të jipet në mënyrë të barabartë për të gjithë, në bazë të zotësisë të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme.

d) Arsimimit elementar duhet ti jepet rëndësi ose të intensifikohet sa të jetë e mundur për ata që nuk kanë marrë arsimimin bazë ose nuk e kanë plotësuar.

e) Duhet të synohet në mënyrë aktive zhvillimi i një sistemi shkollash për të gjitha nivelet, të krijohet një sistem i mjaftueshëm bursash dhe të përmirësohet në mënyrë të përhershme gjendja ekonomike e personelit arsimor.

3. Shtetet kontribuese detyrohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, ndoshta edhe të kujdestarëve të ligjshëm, që të zgjedhin për fëmijët e tyre institucione të cilat nuk bëjnë pjesë në institucionet publike, por u përgjigjen kriterëve minimale miratuara ose të vëna nga shteti dhe të garantojnë edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre për bimbjet e tyre.

Neni 29

Asnjë nga dispozitat e këtij neni nuk mund të interpretohet se prek lirinë e personave fizike dhe juridike që të formajnë dhe të drejtojnë institucione arsimore me të vetmen rezerve të respektimit të parimeve të paragraf. I të këtij neni dhe se arsimi që japin këto institucione do të jetë e pajtueshme me caqet minimale dhe modelet e caktuara nga shteti.

KONVENTË NDËRKOMBËTARE PËR HEQJEN E ÇDO FORME TË DISKRIMINIMEVE RACORE

Nju Jork, 7 mars 1966 (Kombet e Bashkuara)

Shtetet pjesëmarrëse, duke patur parasysh se Kombet e Bashkuara dënuan kolonializmin dhe metodat e vecimit dhe të diskriminimeve të çdo forme të lidhura me të dhe kudo që mund të ekzistojnë dhe se Deklarata rreth dhënies së pavarësisë vëndeve dhe popujve koloniale të 14 dhjetorit 1980 (vendim nr. 1514) të Asamblesë së Përgjithshme miratoi dhe në mënyrë solemnisht deklaroi nevojën që tu jepet shpejt dhe pa kushte fund këtyre gjërave.

Duke patur parasysh se Deklarata e Kombëve të Bashkuara, rreth heqjes së çdo formë të diskriminimit racor, të 20-të nentorit 1963 (vendimi 1904 X të Asamblesë së Përgjithshme) konfirmoi solemnisht nevojën e heqjes sa më shpejt të çdo forme dhe të deklarimit të diskriminimit racor në të gjitha vëndet e botës dhe të sigurimit të mirëkuptimit dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor.

Janë të bindura se çdo dogmë rreth epërsisë e bazuar tek ndryshueshmëria racore janë shkencërisht të gabuara, moralisht të denueshme, shoqërisht të padrejta dhe të rrezikshme dhe se nuk ekziston asnjë justifikim i diskriminimit racor, si në teori ashtu edhe në praktikë, kudo.

Rikonfirmojnë se diskriminimi ndërmjet qenieve njerëzore për shkak të racës, të ngjyrës ose të origjinës etnike përbën pengesë për marrëdhëniet miqësore dhe paqësore midis kombëve dhe se është i aftë të prish paqen dhe sigurinë ndërmjet kombëve dhe harmoninë e bashkëjetesës akoma edhe ndërmjet individeve brënda të njëjtit vënd. Janë të bindur se ekzistenca e barrierave racore vjen ndesh me idealet e çdo shoqërie njerëzore.

Të shqetësuara nga shfaqje të diskriminimit racor që ekzistojnë akoma në disa zona të botës, nga politika e qeverisë e bazuar tek epërsia racore ose të urrejtjes, siç është politika e veçimit ose ndarjes.

Të vendosura që të adoptojnë kurdoherë masat e duhura për heqjen sa më shpejtë të diskriminimit racor të çdo forme dhe shfaqjeje dhe të pengojnë e luftojnë dogma dhe metoda raciste, në mënyrë që të inkurajojnë mirëkuptimin ndërmjet racave dhe krijimin e një komuniteti ndërkombëtar të çliruar nga çdo formë të izolimit dhe të diskriminimit racor.

Duke patur parasysh Konventën rreth Diskriminimit në punë dhe profesion që u zbatua në favor të Organizatës Ndërkombëtare të Punës të vitit 1958 si dhe Konventën kundër diskriminimeve në Arsim, që u adoptua nga Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara në vitin 1960.

Duke dashur që të realizojnë parimet e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara rreth heqjes së çdo forme të diskriminimit racor dhe të sigurojnë sa më shpejtë pranimin e masave praktike për realizimin e këtij qëllimi,

Ranë dakort për sa më poshtë:

PJESA E PARË

Neni 1

1. Në këtë Konventë termi diskriminim racor nënkupton çdo diskriminim, përjashtim, pengim ose preferim i bazuar tek raca, ngjyra, origjina ose të prejardhjes etnike apo etnologjike me qëllim ose përfundim zhdukjen ose rrezikimin e njohjes, shijimit apo ushtrimit në kushte të barabarta, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në sektorin politik, ekonomik, social, kulturor ose në çdo sektor tjetër të jetës publike.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet për rastin e dispozitave, përjashtimeve, pengimeve ose preferencave të bëra nga Shtet

Anëtar që merr pjesë në këtë Konventë ndërmjet nënshtetasve dhe jo nënshtetasve të tij.

3. Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se ndikon me çfarëdo mënyrë, dispozitat e ligjshmërisë së Shteteve Anëtarë që marrin pjesë në këtë Konventë dhe që kanë të bëjnë me kombësinë, të drejtat politike ose marrjen e shtetësisë me kusht që këto dispozita përbëjnë diskriminim ndaj një etnie.

4. Masat specifike që u morën me qëllimin e vetëm garantimin e përparimit të grupeve të caktuara racore ose etnologjike ose të personave që mund të kenë nevojë Mbrojtjen, që u japin këtyre grupeve ose personave shijim ose ushtrim të barabartë të të drejtave njerëzore ose të lirive themelore, nuk duhet të interpretohen se përbëjnë diskriminim racor, me kusht që këto masa nuk to të kenë pasojë mbajtjen e të drejtave specifike për grupet racore dhe që nuk duhet të ngelen në fuqi përderisa do të jenë realizuar qëllimet e synuara objektive.

Neni 2

1. Shtetet Anëtarë dënojnë diskriminimin racor dhe detyrohen të ndjekin, me çdo mjet të përshtatshëm dhe pa humbur kohë, një politikë që synon zhdukjen e çdo forme të diskriminimit racor dhe do të favorizojnë ndërmjet të gjitha racave mirëkuptimin dhe për këtë qëllim:

a) Çdo Shtet Anëtar detyrohet që të mos bëjë ansjë veprim të diskriminimit racor ndaj personave, grupeve ose institucioneve dhe do të interesohen në mënyrë që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, të veprojnë sipas këtij detyrimi.

b) Çdo Shtet Anëtar merr përsipër detyrimin që të mos inkurajojë, mbrojë ose nxis diskriminim racor ndaj cilitdo person ose organizatë.

c) Çdo Shtet Anëtar detyrohet të ndërmarrë masa drastike për rishikimin e politikës qeveritare, kombëtare dhe vendore

dhe për modifikimin, heqjen ose anulimin e çdo ligji ose dispozitë, rregulloreje që kanë si qëllim krijimin e diskriminimit racor ose përjetësimin e tij aty ku ekziston.

d) Çdo Shtet Anëtar detyrohet të inkurajojë organizatat dhe lëvizjet multiracore dhe masat e tjera të përshtatshme për heqjen e barrierave midis racave dhe të dekurajojë çdo gjë që synon fuqizimin e ndarjes racore.

2. Shtetet Anëtarë do të ndërmarrin, përderisa kjo duhej përkrahur nga rethanat, në sektorin, social, ekonomik, kulturor etj., masa specifike dhe konkrete për sigurimin e një zhvillimi dhe mbrojtje të mjaftueshme e disa grupeve racore e personave që u takojnë atyre, me qëllim sigurimin e shijimit të plotë dhe të barabartë të të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore. Këto masa në asnjë rast nuk do të kenë si pasojë ruajtjen e të drejtave të pabarabarta ose veçante për grupet e ndryshme racore, përderisa do të jenë realizuar qëllimet objektive për të cilat janë marrë.

Neni 3

Shtetet Anëtarë dënojnë në veçanti izolimin dhe detyrohen të pengojnë, ndalojnë dhe çrrenjosin çdo metodë të kësaj natyre që vepron në territorin e juridiksionit të tyre.

Neni 4

Shtetet Anëtarë dënojnë çdo veprim propagandistik dhe çdo organizatë që e kanë bazën tek ide ose teori rreth supermacisë së një race ose grupi personash, të një ngjyrë ose origjinë etnologjike ose që përpiqen të justifikojnë ose zhvillojnë urrejtjen racore dhe çdo forme diskriminimi dhe detyrohen të zbatojnë masa emergjente dhe pozitive për zhdukjen e çdo inkurajimi ose veprimi për këtë diskriminim dhe për këtë qëllim, duke zbatuar parimet e inkuadruara në Deklaratën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe të të drejtave që në mënyrë kategorike ekspozohen në këtë nen të kësaj Konventë, që ndërmjet të tjerave:

a) Deklaron të denueshem dhe të kundraligjshëm, çdo përhapje idesh, të bazuara tek epërsia racore dhe urrejtja, inkurajim për diskriminim racor, si dhe veprimet e dhunës ose inkurajimin për diskriminim të këtyre veprimeve të çdo race ose grupi personash të një ngjyre tjetër ose origjinë etnologjike dhe po kështu dhënien e çdo ndihme për veprimtari racore, përfshirë edhe financimin e tyre.

b) Denoncon organizatat e paligjshme dhe ndalon këto organizata si dhe veprimtaritë e propagantës së organizuar dhe çdo tipi tjetër veprimtarie propagandistike, të cilat nxisin diskriminimin racor dhe që e inkurajojnë atë si dhe konsiderojnë faj të denueshëm nga ligji pjesëmarrjen në organizata ose veprimtari të tilla.

c) Të mos lejojnë autoritetet publike as institucionet publike, kombëtare ose vendore, të nxisin ose të inkurajojnë diskriminimin racor.

Neni 5

Sipas detyrimeve bazë që përmenden në nenin 2 të kësaj Konvente, Shtetet Anëtarë detyrohen të ndalojnë dhe të zhdukin diskriminimin racor të çdo formë dhe të garantojnë të drejtën e çdonjerit përpara Ligjit pa diskriminim nga raca, ngjyra ose përkatësia etnike ose etnologjike, veçanërisht për sa i përket shijimit të të drejtave të meposhtme:

a) Të së drejtës së trajtimit të barabartë përpara Ghykatës dhe të çdo organi tjetër të Drejtësisë.

b) Të së drejtës së sigurisë personale dhe Mbrojtjes nga Shteti kundër veprimeve ndaj jetës dhe demtimit fizik nga ana e titullareve shtetëror ose nga çdo person, grup ose institucion.

c) Të të drejtave politike dhe veçanërisht të së drejtës së pjesëmarrjes në zgjedhje –të votojë dhe të votohet– sipas sistemit zgjedhor që ekziston botërisht dhe në barazi të së drejtës së pjesëmarrjes në qeveri dhe në administrimin e çështjeve publike të të gjitha niveleve dhe të së drejtës, në

kushte të barabarta, të ngritjes në funksionet publike.

d) Të drejta politike të tjera, veçanërisht:

I) Të së drejtës së lëvizjes së lirë dhe qëndrimit brenda kufijve të Shtetit.

II) Të së drejtës së largimit nga çdo vend duke përfshirë edhe vendin e tij dhe të kthimit në të.

III) Të së drejtës së kombësisë.

IV) Të së drejtës së lidhjes martesore dhe të zgjedhjes së tij ose të bashkëshortes.

V) Të së drejtës së pasurisë si individualisht ashtu edhe kolektivisht me të tjerë.

VI) Të së drejtës së trashëgimisë.

VII) Të së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

VIII) Të së drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes.

IX) Të së drejtës së lirisë së mbledhjes dhe bërës ortakeri paqësisht.

e) Të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore dhe veçanërisht:

I) Të së drejtës së punës, zgjedhjes së lirë të profesionit, të së drejtës së kushteve të drejta dhe të kënaqshme punë, të së drejtës së mbrojtjes kundër papunësisë, të së drejtës së pagimit të barabartë për të njëjtën punë, të së drejtës së shpërblimit të drejtë dhe të kënaqshëm.

II) Të së drejtës së krijimit të pjesëmarrjes në organizatat sindikaliste.

III) Të së drejtës së banimit.

IV) Të së drejtës së shëndetit, të mjekimit mjekësor, të sigurimeve shoqërore dhe të shërbimeve shoqërore.

V) Të së drejtës së arsimimit dhe formimit profesional.

VI) Të së drejtës së pjesëmarrjes në kushte të barabarta në veprimtaritë kulturore.

VII) Të së drejtës së hyrjes në çdo vend ose shërbim që

ka si destinacion përdorimin publik, si mjetet e transportit, hotelet, restorantet, kafet, teatrot dhe parqet.

Neni 6

Shtetet Anëtarë do të sigurojnë për të gjithë ata që ndodhen nën juridiksionin e tyre mbrojtjen e duhur dhe mjetet e duhura ligjore përpara Gjykatave kombëtare dhe çdo organizmi Shtetëror kompetent, kundër çdo veprimi të diskriminimit racor që bie ndesh me këtë Konventë, që do të cenojë të drejtat e tyre individuale dhe liritë themelore, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatat për dhënien e kënaqësisë dhe dëmshpërblimit të drejtë dhe të mjaftueshëm, për çdo dëm që do të pesonte si pasojë e këtij diskriminimi.

Neni 7

Shtetet Anëtarë detyrohen të marrin masa urgjente dhe efikase veçanërisht në sektoret e arsimimit, kualifikimit dhe informimit, për luftimin e predispozitave të gabuara, të cilat çuan në diskriminimin racor dhe të favorizojnë zhvillimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë midis kombeve dhe grupeve racore ose etnologjike si dhe për të shtyrë përpara të qëllimeve dhe parimeve të kartës së Kombëve të Bashkuara, të Deklaratës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për zhdukjen e çdo formë të diskriminimit racor dhe të kësaj Konvente.

**KONFERENCA PËR SIGURINË DHE BASHKËPUNIM
NE EVROPË - ORGANIZMI PËR SIGURINË DHE
BASHKËPUNIM NË EVROPË**

VII. Respektimi I të drejtave të njeriut dhe të lirive baze, përfshirë edhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit.

Shtetet pjesëmarrëse respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë baze, duke përfshirë edhe lirinë e mendimit, ndërgjegjës, fesë dhe besimit për të gjithë, pa dallin race, seksi, gjuhë ose feje.

Favorizojnë dhe inkurajojnë ushtrimin aktiv të lirive politike dhe të drejtave ekonomike, sociale, kulturore etj, që rrjedhin nga vlera e bashkëlindur me individin e njeriut dhe që është esenciale për përhapjen e lirë dhe të tërësishme.

Brënda këtij kuadri, shtetet pjesmarrëse njohin dhe respektojnë lirinë e individëve të ushtrojnë dhe të zbatojnë vetë ose së bashku, një fe ose një besim, duke vepruar sipas detyrimeve të ndërgjegjes së tyre.

Shtetet pjesmarrëse, që në teritorin e tyre ekzistojnë minoritete etnike, respektojnë të drejtat e njerëzve që u përkasin këtyre minoriteteve në barazi përpara ligjit, u japin çdo mundësi të shijojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe, në këtë mënyrë, mbrojnë interesat e tyre të ligjshme në këtë sektor.

Shtetet pjesmarrëse njohin rëndësinë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, ku respektimi i tyre është faktor i qenësishëm për paqe, drejtësi dhe mireqenie, i nevojshëm për sigurimin e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre, si dhe të njëta në të gjitha shtetet.

Respektojnë këto të drejta dhe liritë në marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta dhe përpiqen veç ose me marrëveshje, si dhe me Kombet e Bashkuara të shtyjnë përpara respektimin ndërkombëtar dhe aktiv.

Konfirmojnë të drejtën e njeriut të njohë të drejtat si dhe detyrimet e tij në këtë sektor dhe të veprojnë me konsekuence.

Brenda sektorit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, shtetet pjesmarrëse veprojnë në bazë të qëllimeve dhe të parimeve të Kartës së Kombëve të Bashkuara dhe të Deklaratës Ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Po kështu, pranojnë detyrimet e tyre siç ato janë shpallur në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë Sektor, duke përfshirë ndërmjet të tjerave të Traktateve ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, nga të cilat mund të detyrohen.

VIII. Barazia e të drejtave të popujve dhe e drejta e popujve për vetvendosje.

Shetet pjesmarrëse respektojnë barazinë e të drejtave të popujve dhe të drejtën e tyre për vetvendosje, duke vepruar në çdo çast në bazë të qëllimeve dhe të parimeve të Kartës së Kombëve të Bashkuara dhe në bazë të dispozitave të përshtatshme të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë atyre që karakterizojnë tërësinë territoriale të shteteve.

Në emër të parimit të barazisë të së drejtave të popujve dhe të së drejtës së tyre për vetvendosje, të gjithë popujt kanë të drejtë, me çdo liri, të përcaktojnë, kur e deshirojnë, dhe siç e duan, regjimin e tyre politik të brendshëm dhe të jashtëm, pa ndërhyrje të jashtme dhe të vazhdojnë sipas dëshirës së tyre zhvillimin e tyre ekonomik, social, kulturor. Shtetet pjesmarrëse rikonfirmojnë rëndësinë ndërkombëtare të respektimit dhe të ushtrimit aktiv nga popujt të të drejtave të barabarta dhe të së drejtës së tyre për vetvendosje, për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet tyre dhe ndërmjet të gjitha shteteve, përmendin gjithashtu rëndësinë e largimit nga çdo shkelje të këtij parimi, pavarësisht nga forma që do të marrë.

KONFERENCË PËR DIMENSIONIN HUMAN I OSBE-së - OASÉ

Tekst i Takimit të Kopenhages (5 qershor-29 korrik 1990)

30) Shtetet pjesmarrëse njohin se problemet që kanë lidhje me minoritetet etnike mund të rregullohen në mënyrë të kënaqshme veten në një kuadër politik demokratik të bazuar tek shteti i së drejtës, me drejtësi funksionale të pavarur. Ky kuadër garanton respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të drejta të barabarta dhe regjim barazie për të gjithë qytetarët, shprehje të lirë të të gjithë interesave të tyre të ligjshme dhe ambicjet e tyre, zbatimin e rregullave

të ligjshëm që pengojnë në mënyrë efektive ushtrimin shpërdorues të pushtetit qeveritar, pluralizmin politik dhe tolerancën sociale.

Njohin gjithashtu rolin e rëndësishëm që luajnë organizatat jo-qeveritare, duke përfshirë edhe partitë politike, sindikatat e punëtorëve, Organizmat për të drejtat e njeriut dhe Organizatat fetare, për zhvillimin e tolerancës, të dryshueshmerisë kulturore dhe për rregullimin e problemeve që kanë të bëjnë me minoritetet etnike.

Më tej konfirmojnë se respektimi i të drejtave të njeriut të personave që u takojnë minoriteteve etnike, si pjesë e të drejtave të njeriut të njohura botërisht, përbën faktor të qenësishëm për paqe, drejtësi, stabilitet dhe demokraci tek shtetet pjesmarrëse.

31) Personat që u takojnë minoriteteve etnike kanë të drejtë të ushtrojnë në mënyrë të plotë dhe esencialisht të drejtat e njeriut dhe liritë themelore pa asnjë diskriminim dhe me barazi të plotë para ligjit.

Shtetet pjesmarrëse do të miratojnë, aty ku mendohet e nevojshme, masa specifike me qëllim që të sigurojnë se personat që u takojnë minoriteteve etnike, gëzojnë barazi të plotë në krahasim me qytetarët e tjerë për sa i përket ushtrimit dhe shijimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

32) Marrja pjesë në një minoritet etnik përbën problem zgjedhjeje individuale të personit dhe asnjë rrjedhojë negative nuk duhet të lind nga ushtrimi i kësaj zgjedhjeje. Personat që u takojnë këtyre minoriteteve kanë të drejtë të shprehin lirshëm, të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar dhe të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre në të gjitha shfaqjet e saj, lirshëm nga çdo përpjekje asimilimi kundër vullnetit të tyre. Veçanërisht kanë të drejtë:

32.1) - të përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare si në jetën e tyre private ashtu edhe publikisht,

32.2) - të krijojnë dhe të ruajnë institucionet e tyre arsimore, kulturore dhe fetare, organizma dhe organizata që të mund

të kërkojnë kontribute financiare vullnetare ose edhe kontribute të tjera si dhe ndihmesën shtetërore, sipas legjislacionit kombëtar,

32.3) - të mbrojnë dhe të ushtrojnë fenë e tyre, duke përfshirë edhe gjetjes, mbajtjes dhe përdorimit të materialit fetar dhe të zhvillojnë veprimtari fetare dhe arsimore në gjuhën e tyre amtare,

32.4) - të vendosin dhe të mbajnë pa asnjë pengesë kontakte midis tyre brënda vendit të tyre, po ashtu dhe përtej kufijve të tij me qytetarë të shteteve të tjera të cilët kanë origjinë nga I njëjti komb ose nga e njëjta kombësi, kanë të njëjtin trashëgim kulturor ose bindje fetare,

32.5) - të përhapin, të kenë mundësi kontakti dhe të këmbejnë informacion në gjuhën e tyre amtare,

32.6) - të krijojnë dhe të mbajnë organizma dhe organizata brënda vëndit të tyre dhe të marrin pjesë në organizata jo-qeveritare ndërkombëtare.

Personat qe u takojnë minoriteteve etnike mund të ushtrojnë dhe të shijojnë të drejtat e tyre, si individualisht, ashtu edhe si komunitet me pjesëtarë të tjerë të grupit të tyre. Asnjë disavantazh nuk do të ngrihet kundër personit që i takon një minoriteti etnik për shkak të ushtrimit ose të mos ushtrimit të të drejtave të tilla,

33) Shtetet pjesëmarrëse do të mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të minoriteteve etnike në territorin e tyre dhe do të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e këtij identiteti. Do të marrin masat e nevojshme për këtë qëllim, mbas konsultimeve të duhura, përfshirë kontaktet me organizma dhe organizata të minoriteteve të tilla, sipas procedurave të marrjes së vendimeve të çdo Shteti.

Çdo masë e tillë do të jetë konform parimeve të barazisë dhe të mos diskriminimit në dëm të qytetarëve të tjerë të shtetit të interesuar pjesëmarrës.

34) Shtetet pjesëmarrëse do të bëjnë përpjekje që të sigurojnë që pjesëtarët e minoriteteve etnike, pavarësisht nga nevoja që kanë për të mësuar gjuhën ose gjuhët zyrtare të shtetit përkatës, kanë shanse të mjaftueshme për mësimin ose të mësuarit në gjuhën e tyre amtare, si dhe, aty ku është e mundur dhe e domosdoshme, për përdorimin e saj përpara autoriteteve, sipas legjislacionit kombëtar që zbatohet.

Në kuadrin e mesimdhënies të historisë dhe të kulturës në institucionet arsimore, do të merret parasysh edhe historia dhe kultura të minoriteteve etnike.

35) Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë të drejtën e anëtarëve të minoriteteve etnike që të marrin pjesë efektivisht në çështjet publike përfshirë edhe pjesëmarrjes së tyre në probleme që kanë lidhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të këtyre minoriteteve.

Shtetet pjesëmarrëse theksojnë përpjekjet që u ndërmorrën për mbrojtjen dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të minoriteteve të caktuara me krijimin, si një nga masat e realizueshme për realizimin e këtyre qëllimeve, e autoriteteve administrative të përshtatshme vendore ose autonome, që u përgjigjen kushteve historike dhe territoriale të minoriteteve të tilla dhe sipas politikës të shtetit të interesuar.

36) Shtetet pjesëmarrëse njohin rëndësinë e veçantë të fuqizimit të bashkëpunimit të tyre krijues në çështje që kanë lidhje me minoritetet etnike. Një bashkëpunim i tillë ka si qëllim aprodhimin e mirëkuptimit dhe besimit reciprok, të marrëdhënive të miqësisë dhe të fqinjësisë së mirë, të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, të sigurisë dhe të drejtësisë.

Çdo shtet pjesëmarrës do të inciajojë zhvillimin e klimës së respektit reciprok, mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe solidaritetit e të gjithë personave që jetojnë në territorin e tij, pa diskriminim për shkak të origjinës etnike, origjinës kombëtare

ose fetare dhe do të inkurajojë zgjidhjen e problemëve me anë të dialogut të bazuar në parimet e rregullave të së drejtës.

37) Asnjë nga këto detyrime nuk duhet të interpretohet si aluzion i një të drejtë të ndërhyrjes në veprimtari të çfarëdollojshme ose të ndërmarrjes se çdo veprimtari që shkel qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombëve të Bashkuara, detyrimet e tjera të së drejtës ndërkombëtare ose dispozitat e Aktit Përfundimtar, përfshirë parimit të tërësisë territoriale të shteteve.

38) Shtetet pjesëmarrëse në përpjekjen e tyre për të mbrojtur dhe zhvilluar të drejtat e personave që u takojnë minoriteteve etnike do të respektojnë tërësisht detyrimet e tyre nga konventat ndërkombëtare ekzistuese si dhe akte të tjera ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë dhe do të shqyrtojnë pjesmarrjen e tyre në traktatë analoge, në qoftë se nuk e kanë bërë këtë gjë akoma, duke përfshirë edhe ato që parashikojnë të drejtën e ankimimit individual.

39) Shtetet pjesëmarrëse do të bashkëpunojnë ngusht në kuadër të Organizmave ndërkombëtare kopetente në të cilët marrin pjesë, duke përfshirë Kombet e Bashkuara dhe, ku konsiderohet i përshtatshëm, Këshillin e Evropës, duke pasur paralelisht parasysh punimet e tyre aktuale për problemet e minoriteteve etnike.

Do të shqyrtojnë mbajtjen e një kongresi ekspertesh për një diskutim analitik të problemit të minoriteteve etnike.

40) Shtetet pjesëmarrëse dënojnë në mënyrë të qartë dhe kategorikisht totalitarizmin, urrejtjen racore dhe etnike, antisemitizmin, ksenofobinë dhe diskriminimet në dëm të cilitdo, si dhe ndjekjen penale për arsye ideologjike dhe fetare. Në këtë kuadër njohin gjithashtu problemet specifike të romëve. Deklarojnë predispozicionin e tyre konstant të intesifikojnë përpjekjet e tyre për luftimin e këtyre fenomeneve në të gjitha format e tyre dhe për këtë arsye:

40.1) - do të marrin masa efikase, duke përfshirë adoptimit,

në bazë të sistemeve të tyre kushtetuese dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare, të ligjeve që do të konsiderohen të domosdoshëm për dhënien e mbrojtjes dhe sigurisë nga çdo veprim që nxit dhunën kundër personave ose grupeve për arsye të diskriminimeve racore, etnike, fetare ose të diskriminimeve kombëtare, për arsye të urrejtjes dhe armiqësisë, duke përfshirë edhe antisemitizmin.

40.2) - angazhohen të marrin masa të përshtatshme dhe analoge për mbrojtjen e personave ose grupeve që mund të ndodhen nën kërcënime ose veprime diskriminimi, armiqësie ose dhune si pasojë të identitetit të tyre racor, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar dhe të mbrojnë pasurinë e tyre.

40.3) - të marrin masa efikase, në bazë të sistemeve të tyre kushtetuese, në nivel kombëtar, krahinor ose vendor për çuarjen përpara të mirëkuptimit dhe të tolerancës, veçanërisht në fushat e arsimit, të kulturës dhe të informimit.

40.4) - do të përpiqen të sigurojnë që qëllimet e arsimit të përfshijnë manifestimin e kujdesit të veçantë në problemin e paragjykimit racor dhe urrejtjes si dhe zhvillimin e respektimit të kulturave të ndryshme.

40.5) - njohin të drejtën e personave në mjete efikase ankimi dhe do të ndërmarrin përpjekje për njohjen, në bazë të legjislacionit kombëtar, të së drejtës të personave të interesuar dhe grupeve të depozitojnë dhe të mbështesin ankim kundër veprimeve diskriminuese, përfshirë veprimeve të racizmit dhe ksenofobisë.

40.6) - do të shqyrtojnë futjen e tyre, në qoftë se nuk e kanë bërë deri më sot, në akte ndërkombëtare që i drejtohen problemit të diskriminimit dhe të garantojnë përshtatjen e plotë me detyrimet që burojnë nga këto akte, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me parashtrimin e raporteve periodike.

40.7) - do të shqyrtojnë gjithashtu pranimin e atyre mekanizmave ndërkombëtare që u lejojnë shteteve dhe personave të informojnë

organet ndërkombëtare në lidhje me diskriminimet.

TEKST PËRFUNDIMTAR I KONFERENCËS PËR SIGURINË DHE BASHKËPUNIMIN NË EVROPË

Moskë, 4 tetor 1991 (OSBE)

38) Shtetet pjesëmarrëse pranojnë nevojën që të garantojnë respektimin e të drejtave të emigrantëve punëtorë dhe familjeve të tyre që janë të vendosur në shtetet pjesëmarrëse dhe nënvizojnë të drejtën e tyre të shprehin lirshëm karakteristikat e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore. Ushtrimi i këtyre të drejtave do të kufizohet vetëm nga ligji dhe që është konform rregullave ndërkombëtare.

38.1) Dënojnë të gjitha diskriminimet për arsye race, gjuhe dhe origjine etnike, zemërngushtësinë dhe ksenofobinë ndaj emigrantëve. Do të marrin masat e përshtatshme, sipas së drejtës së brëndshme dhe detyrimeve të tyre ndërkombëtare, për zhvillimin e tolerancës, të mirëkuptimit, të barazisë së shanseve dhe të respektimit të të drejtave themelore të njeriut të emigrantëve dhe do të adoptojnë, në qoftë se nuk e kanë bërë akoma, masa për ndalimin e veprimeve të cilat ndezin dhunën që buron nga diskriminimi etnik, racor, fetar, që ndezin armiqësi dhe urrejtje.

DEKLARATË PËR RACIZMIN DHE KSENOFOBINË

Mastrih. Dhjetor 1991 (Këshilli i Evropës)

Këshilli i Evropës konstaton me shqetësim se shfaqjet e racizmit dhe të ksenofobisë po rriten në mënyrë konstante në Evropë, si në shtetet anëtarë të Komunitetit ashtu edhe në vende të tjera. Këshilli i Evropës thekson se vazhdojnë të jenë

në fuqi angazhimet ndërkombëtare për luftimin e diskriminimeve dhe racizmit, që kanë ndërmarrë shtetet anëtarë në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës dhe të OSBE-së.

Këshilli i Evropës kujton deklaratën kundër racizmit dhe ksenofobisë, të cilën nxorren Këshilli i Europës, Këshilli dhe Komisioni më 11 qershor 1986 dhe duke konfirmuar deklaratën që nxorri në Dublin më 26 qershor 1990, shpreh qeverinë e tij për mendimet dhe veprimet raciste. Këto shfaqje, në të cilat përfshihen edhe paragjykimet dhe veprimet e dhunës kundër emigrantëve, si dhe shfrytëzimi i tyre, janë të papranueshme.

Këshilli i Evropës shpreh bindjen e tij se respektimi i dinjitetit njerëzor është esenciale për Evropën e Komunitetit dhe se luftimi i çdo lloj diskriminimi është i një rëndësie jetike për Komunitetin Evropian si Komunitet shtetësh të së drejtës. Këshilli i Evropës konsideron se qeveritë dhe parlamentet të shtetëve anëtarë duhet të veprojnë në mënyrë të qartë dhe pa medyshe që të përballojnë zhvillimin e mendimeve dhe të shfaqjeve të racizmit dhe ksenofobisë.

Këshilli i Evropës u kërkon ministrave dhe Komisionit që të bëjnë përpjekje akoma më të mëdha për luftimin e diskriminimeve dhe të ksenofobisë dhe të forcojnë mbrojtjen ligjore të nenshtetasve të vendeve të treta në teresinë territoriale të shteteve anëtarë.

Së fundi, Këshilli i Evropës shënon faktin se në ndërvarrësi edhe me rivendosjet në Evropën Lindore, mendime të tilla të papajtueshmërisë dhe të ksenofobisë shfaqen me formën e naciolalizmit të skajshëm dhe të nocentrizmit. Qytetarët e Komunitetit dhe të shtetëve anëtarë kundër Shteteve në fjalë do të kenë si objektiv dekurajimin e vendosur të shfaqjeve të tilla.

KARTA EVROPIANE E GJUHËVE RAJONALE OSE MINORITARE

Strasburg, 2 nentor 1992 (Këshilli i Evropës)

Parathënie

Shtetet Anëtarë të Këshillit të Evropës nënshkruajnë këtë kartë

I. Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Evropës është realizimi i një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve, veçanërisht për qëllim ruajtjen dhe realizimin të idealeve dhe parimeve që përbëjnë trashëgim të përbashkët të tyre,

Duke konsideruar se mbrojtja e gjuhëve historike rajonale të Evropës, disa nga të cilat rrezikohen të zhduken, kontribuon në ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore dhe të trashëgimisë së Evropës.

Duke marrë parasysh faktin se e drejta e përdorimit të një gjuhë rajonale ose minoritare në jetën private dhe publike përbën të drejtë të pamohueshme në bazë të parimeve që janë të inkuadruara në Traktatin Ndërkombëtar të Kombëve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike dhe në bazë të frymës së Konventës për Mbrojtjen të të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të Këshillit të Evropës,

Duke patur parasysh punën që është bërë në kuadër të OSBE-së dhe konkretisht Aktin Final të Helsinkit të vitit 1975 dhe dokumentin e Sesionit të Kopenhagës të vitit 1990,

Duke nënvizuar vlerën e shumllojshmerisë së kulturave dhe të gjuhëve dhe duke konsideruar se mbrojtja dhe inkurajimi i gjuhëve rajonale ose minoritare nuk duhet të jenë të dëmshme për gjuhët zyrtare në nevojën e mësimin të tyre,

Duke u ndërgjegjësuar se mbrojtja dhe zhvillimi i gjuhëve rajonale minoritare në vëndet dhe krahinat e ndryshme të Evropës përbëjnë kontribut të rëndësishëm në ndertimin e një Evrope që do të bazohet në demokraci dhe në shumllojshmerinë

kulturore brënda kuadrit të sovranitetit kombëtar dhe të tërësisë territoriale,

Duke marrë parasysh kushtet specifike dhe trashëgiminë historike të krahinave të ndryshme të Shteteve Evropiane, Ranë dakort për sa më poshtë:

PJESA I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1 - Përcaktim

Për qëllimet e kësaj Karte Statuore:

a. “Gjuhë rajonale ose minoritare” do të thotë gjuhë të cilat:

1. përdoren tradicionalisht në krahina të caktuara të një Shteti nga qytetarë të këtij Shteti, të cilët përbëjnë një grup në numër më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së atij Shteti dhe Dallohen nga gjuha (ose gjuhët) zyrtare e këtij Shteti. Termi nuk përfshin djalektet e gjuhës (ose gjuhëve) zyrtare të Shtetit ose gjuhët e emigrantëve.

b. “Zonë ose krahinë në të cilën përdoret gjuha rajonale ose minoritare” konsiderohet hapësira gjeografike në të cilën kjo gjuhë përbën mënyrë të të shprehurit të një numri njerëzish, duke justifikuar marrjen e masave të ndryshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj që parashikohen në këtë Kartë. “Gjuhë të cilat nuk përputhen me zona ose krahina të caktuara” do të thotë gjuhë të cilat përdoren nga qytetarë të Shtetit dhe dallohen nga gjuha ose gjuhët që përdoren nga pjesa tjetër e popullsisë së Shtetit, por, pavarësisht që përdoren tradicionalisht brënda territorit të Shtetit, nuk mund të përputhen me një zonë të caktuar të këtij territori.

Neni 2 - Angazhime

1. Çdo Vend Kontribues detyrohet të zbatojë dispozitat e Pjesës së dytë në të gjitha gjuhët rajonale ose minoritare që fliten brenda territorit të Tij dhe janë konform përcaktimit të Nenit 1.

2. Në lidhje me çdo gjuhë që do të përcaktohet në momentin e miratimit, aprovimit ose pranimit, në bazë të Nenit 3, çdo Vend Kontribues detyrohet të zbatojë të paktën tridhjetë e pesë paragrafë ose elemente që do të përzgjedhin nga dispozitat të Pjesës së 3-të të Kartës, duke përfshirë të paktën tri që do të përzgjedhin nga secili nga Nenët 8 dhe 12 dhe nga një nga çdonjeri nga Nenet 9, 10, 11 dhe 13.

Neni 3 - Rregullime praktike

1. Çdo Shtet Kontribues do të përcaktojë dokumentin e njohur të miratimit, pranimit ose nënshkrimit të çdo gjuhe rajonale ose minoritare ose gjuhë zyrtare që përdoret më pak në tërësinë ose në një pjesë të tërësisë territoriale të tij, tek të cilat do të zbatohen paragrafet që do të përzgjidhen në bazë të Nenit 2 parag. 2.

2. Çdo Vënd Kontribues mundet që në çdo çast në vazhdim, të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm se pranon detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e çdo paragrafi tjetër të Kartës nga ato që akoma nuk ka përcaktuar në dokumentin e njohur të miratimit, pranimit ose nënshkrimit ose se do të zbatojë paragrafin 1 të këtij neni edhe në gjuhë të tjera rajonale ose minoritare ose gjuhë të tjera zyrtare që përdoren më pak në tërësinë ose në pjesë të tërësisë territoriale të tij.

3. Angazhimet të cilat përmenden në paragrafin e mëparshëm do të konsiderohet se përbëjnë pjesë të pandashme të miratimit, pranimit ose nënshkrimit dhe do të kenë të njëjtën fuqi nga data e deklaramit të tyre.

Neni 4 - Regjime ekzistuese mbrojtëse

1. Asgjë nga ato që përfshihen në këtë Kartë nuk do të interpretohet se kufizon ose cenon secilin nga të drejtat që garanton Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

2. Dispozitat e kësaj Karte nuk do të influencojë tek dispozitat më të favorshme që kanë të bëjnë me regjimin e gjuhëve rajonale ose minoritare ose regjimin juridik të personave që

u takojnë minoriteteve, që mund të ekzistojnë në një vend Kontribues ose që parashikohen nga marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe ose shupalëshe.

Neni 5 - Detyrime ekzistuese

Asgjë nga ato që përfshihen në këtë Kartë nuk mund të interpretohet se nënkupton të drejtën e marrjes së çdo veprimtarie ose zbatimit të çdo veprimi që bie ndesh me qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara ose detyrimet e tjera që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, përfshirë edhe parimit të sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të shteteve.

Neni 6 - Informim

Vendet Kontribuese detyrohen të kujdesen në mënyrë që të informohen autoritetet, organizatat dhe personat përkatëse në lidhje me të drejtat dhe detyrat që përcaktohen nga kjo Kartë.

PJESA II

Parime dhe qëllime të cilat synohen në bazë të Nenit 2
Par. 1

Neni 7 - Synime dhe parime

1. Për sa u përket gjuhëve rajonale dhe minoritare, brenda zonave në të cilat përdoren këto gjuhë dhe në bazë të gjëndjes së çdo gjuhë, Vendet Kontribuese do të bazojnë politikën, ligjshmërinë dhe praktikën e tyre në qëllimet dhe parimet e mëposhtme:

a. njohjen e gjuhëve rajonale ose minoritare si shprehje të pasurisë kulturore

b. respektimin e zonës gjeografike të çdo gjuhë rajonale ose minoritare në mënyrë që të sigurohet se ndarjet administrative ekzistuese ose të reja nuk do të përbëjnë pengë e në zhvillimin e gjuhës rajonale ose minoritare në fjalë.

c) nevojën e veprimit të vendosur për zhvillimin e gjuhëve rajonale ose minoritare me qëllim ruajtjen e tyre.

d) lehtësimin ose dhe inkurajimin e përdorimit të gjuhëve minoritare në gjuhën e folur dhe të shkruar, në jetën publike dhe private.

dh) ruajtjen dhe zhvillimin e lidhjeve, në sektoret që mbrohen nga kjo Kartë Statuore, ndërmjet grupëve që përdorin gjuhë rajonale ose minoritare dhe grupeve të tjera të Shtetit që flasin gjuhë me të njëjtën ose pak a shumë të njëjtën formë, si dhe krijimin e marrëdhënieve kulturore me grupe të tjera të Shtetit që përdorin gjuhë të ndryshme.

e) dhënien e formave dhe mjeteve të përshtatshme për mësimin dhe studimin e gjuhëve rajonale ose minoritare në të gjitha stadet që duhet.

f) dhënien e mjeteve dhe mjedisëve që du japin mundësinë personave që nuk flasin një gjuhë rajonale ose minoritare dhe banojnë në Zonën ku përdoret ajo, ta mësojnë në qoftë se e dëshirojnë.

g) zhvillimin e studimit dhe kërkimit në objekt gjuhët rajonale ose minoritare në universitete ose institucione të barasvlershme.

8. zhvillimin e tipeve të përshtatshme të shkëmbimeve ndërkombëtare, në sektoret që mbulohen nga kjo Kartë, për gjuhë rajonale ose minoritare që përdoren me të njëjtën ose pak a shumë të njëjtën formë në dy ose më shumë Shtete.

2. Vëndet Kontribuese detyrohen të zhdukin, në qoftë se nuk e kanë bërë akoma, çdo diskriminim, kufizim ose preferim të pa justifikuar në lidhje me përdorimin e gjuhës rajonale ose minoritare që kanë si qëllim të dekurajojnë ose të rrezikojnë ruajtjen ose zhvillimin e saj. Adoptimi i masave specifike pro gjuhëve rajonale ose minoritare që kanë si qëllim inkurajimin e barazisë midis përdoruesve të këtyre gjuhëve dhe të pjesës tjetër të popullsisë ose që marrin siç duhet parasysh kushtet e tyre specifike, nuk konsiderohen veprim diskriminimi në dëm të përdoruesve të gjuhëve që përdoren më gjerë.

3. Vendet Kontribuese marrin përsipër detyrimin të çojnë përpara, me masa të përshtatshme, mirëkuptimin e ndërsjelltë midis të gjitha grupeve gjuhësore të vendit dhe veçanërisht të përfshirjes së respektit, të mirëkuptimit dhe të tolerancës në lidhje me gjuhët rajonale ose minoritare në synimet e arsimit dhe të formimit që jepen brenda vëndeve të tyre si dhe inkurajimin e mjetëve të komunikimit masiv të realizojnë të njëjtin synim.

4. Gjatë përgatitjes së politikës së tyre në lidhje me gjuhët rajonale ose minoritare. Vendet Kontribuese do të marrin parasysh nevojat dhe dëshirat që shprehin grupet që përdorin këto gjuhë. Inkurajohen të krijojnë organe, nëse është e domosdoshme, me qëllim dhënien e këshillave tek autoritetet në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gjuhët rajonale ose minoritare.

5. Vëndet Kontribuese detyrohen të sbatojnë, duke respektuar raportet, parimet që numërohen në paragrafet e mësipërm 1 deri 4 në gjuhët që nuk përputhen me zona të caktuara. Sidoqoftë, për sa u përket këtyre gjuhëve, natyra dhe fusha e zbatimit të masave që do të ndërmerren për aktivizimin të kësaj Karte Statuore do të përcaktohen me mënyrë të zhdërvjelltë, duke marrë parasysh nevojat dhe dëshirat dhe shfaqjen e respektit ndaj traditave dhe karakteristikave të grupeve që përdorin gjuhët në fjalë.

PJESA III

Masa për shtyerjen e përdorimit të gjuhëve rajonale ose minoritare në jetën publike sipas detyrimeve që ndërmerren në bazë të Nenit 2 parag. 3.

Neni 8 - Arsimi

1. Për sa i përket arsimit, Vendet Kontribuese marrin përsipër detyrimet e mëposhtme, brënda zonës ku përdoren këto gjuhë, në raport me gjëndjen e secilës nga këto gjuhë dhe

me ezervet e mësimit të gjuhës (gjuhëve) zyrtare të Shtetit:

a. - të japin arsimim parashkollor në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të japin pjesë të konsiderueshme të arsimimit parashkollor në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të zbatojnë një nga masat që parashikohen në elementet e mësipërm dhe të paktën 1 tek nxënësit familjet e të cilëve e kërkojnë dhe që numri i tyre konsiderohet I mjaftueshëm, ose

- në qoftë se autoritetet publike nuk kanë kopetencë të drejtpërdrejtë në sektorin e arsimit parashkollor, të favorizojnë ose edhe të inkurajojnë zbatimin e masave që përmendën tek elementet e mësiperme dhe III.

b. I - Të japin arsimim të shkallës së parë në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të japin një pjesë të konsiderueshme të arsimimit të shkollës së parë në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të kujdesen, brenda kuadrit të arsimit të shkallës së parë, për dhënien e këtyre gjuhëve rajonale ose minoritare, si pjesë përbërëse e programit mësimor, ose

- të zbatojnë një nga masat që parashikohen tek elementet e mësiperme deri III të paktën tek nxënësit familjet e të cilëve e kërkojnë dhe numri i tyre konsiderohet I mjaftueshëm,

c. I - të japin arsimim të shkallës së dytë në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të japin një pjesë të konsiderueshme të arsimimit të shkallës së dytë në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të kujdesen, brënda kuadrit të arsimit, për mësimin e këtyre gjuhëve rajonale ose minoritare si pjesë përbërëse të programit mësimor, ose

- të zbatojnë një nga masat që parashikohen tek elementet e mësipërm të paktën tek nxënësit që, ose ata vetë, ose –ku duhet– familjet e tyre e dëshirojnë dhe numri konsiderohet i mjaftueshëm.

d. I - të japin arsimim teknik dhe profesional në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

II - të japin një pjesë të konsiderueshme të arsimit teknik dhe profesional në gjuhët përkatëse rajonale ose minoritare, ose

- të kujdesen, brenda kuadrit të arsimit teknik dhe profesional, për mësimin e gjuhëve përkatëse rajonale ose minoritare si pjesë përbërëse e programit mësimor, ose

- të zbatojnë një nga masat që parashikohen tek elementet e mësipërm deri III, të paktën tek nxënësit, ose vetë, ose –ku duhet– familjet e tyre e dëshirojnë dhe numri i tyre konsiderohet i mjaftueshëm.

dh. I - të japin arsimim universitar dhe forma të tjera të arsimit të lartë në gjuhë rajonale ose minoritare ose

II. - të japin mjete ose mjedise për studimin e këtyre gjuhëve si lënde të arsimit universitar dhe të lartë, ose

III. - në qoftë se, për shkak të rolit të shtetit në lidhje me institucionet e larta, është I pamundur zbatimi të elementeve I dhe II, të inkurajojnë ose edhe të lejojnë dhënien e arsimit universitar ose formave të tjera të arsimit të lartë në gjuhë rajonale ose minoritare ose dhënien e mjetëve dhe mjediseve për studimin e këtyre gjuhëve si lënde të arsimit universitar ose të lartë.

e. I - të kujdesen për dhënien e programëve arsimore për të rriturit dhe të një arsimimi të vazhdueshëm të tyre që do të arsimohen kryesisht ose në tërësi në gjuhët rajonale ose minoritare, ose

1. të ofrojnë këto gjuhë si lënde arsimimi të të rriturve dhe arsimimi të vazhdueshëm, ose

në qoftë se autoritetet publike nuk kanë kopetencë të drejtpërdrejtë në sektorin e arsimit të të rriturve, të favorizojnë ose edhe inkurajojnë dhënien e këtyre gjuhëve si lënde të arsimit të të rriturve dhe të një arsimimi të vazhdueshëm.

f. të kujdesen për garantimin e mësimit të historisë dhe të kulturës që pasqyrohen nga gjuha rajonale ose minoritare,

g. të japin arsimimin bazë dhe arsimin kualifikues të arsimtarëve që duhen për zbatimin e atyre paragrafeve nga a deri tek g pranojë Vendi Kontribues.

Gj. Të krijojnë një organ (ose organe) mbikëqyrës që do të jetë përgjegjës për vëzhgimin e masave të marra dhe të përparimit që do të arrihet në krijimin ose zhvillimin e mësimit të gjuhëve rajonale ose minoritare dhe përpilimin e raporteve periodike me konstatimet e tyre, që do të publikohen.

2. Për sa i përket arsimit dhe shprehimisht në lidhje me zona përtej atyre që përdoren tradicionalisht gjuhët rajonale ose minoritare, Vëndet Kontribuese detyrohen të lejojnë, inkurajojnë ose japin arsimim në gjuhën rajonale ose minoritare ose me objekt atë në të gjitha stadet e arsimit, në qoftë se ky detyrim justifikohet nga numri i përdoruesve të gjuhës rajonale ose minoritare.

DEKLARATË PËR TË DREJTAT E PERSONAVE QË U TAKOJNË MINORITETEVE ETNIKE, KOMBËTARE, FETARE OSE GJUHËSORE

(Nju Jork, 18 dhjetor 1992, Kombet e Bashkuara)

Asambleja e Përgjithshme,

Duke konfirmuar se një nga qëllimet baze të Kombëve të Bashkuara, siç shkruhet në Kartë, është zhvillimi dhe inkurajimi i respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë, pa asnjë dallim për nga raca, seksi, gjuha ose feja, Duke konfirmuar besimin tek të drejtat themelore të njeriut, tek dinjiteti dhe vlera e personalitetit njerëzor, tek të drejtat e barabarta të burrave dhe të grave dhe të kombeve, të mëdhenj dhe të vegjël,

Duke dashur të shtyjë përpara realizimin e parimeve që përfshihen në Kartën, në Deklaratën e Përgjithshme të të

Drejtvare të Njeriut, në Traktatin për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit, në Konventën Ndërkombëtare kundër të gjitha formave të Diskriminimit Racor, në Traktartin Ndërkombëtar të të Drejtave Individuale dhe Politike, në Traktatin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Deklaratën për Pakësimin të çdo forme Intolerance dhe diskriminimi që bazohet tek feja ose tek besimi, si dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe

Në dokumente të tjera të ngjashme ndërkombëtare të cilat u adoptuan në nivel ndërkombëtar ose rajonal dhe në ato që janë nënshkruar në veçanti nga Shtete Anëtarë të Kombëve të Bashkuara,

E frymëzuar nga dispozitat e nenit 27 të Traktatit Ndërkombëtar të të Drejtave Personale dhe Politike që u referohet të drejtave që u takojnë personave të minoriteteve etnike, fetare ose gjuhësore,

Duke vlerësuar se çuarja përpara dhe mbrojtja e të drejtave të personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare ose gjuhësore kontribuon në stabilitetin politik dhe shoqëror të Shtetëve ku banojnë,

Duke i dhënë rëndësi të veçantë faktit se çuarja përpara dhe realizimi i vazhdueshëm të të drejtave të personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare ose gjuhësore si pjesë e pandashme të zhvillimit të shoqërisë në tërësi dhe në kuadrin demokratik të bazuar në rregullat e së Drejtës do të kontribuojë në forcimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit midis popujve dhe Shtetëve,

Duke çmuar se Kombet e Bashkuara duhet të lozin një rol të rëndësishëm për sa i përket mbrojtjes së minoriteteve,

Duke patur parasysh punën e sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht atë të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, të Nënkomisionit për Parandalimin e Diskriminimeve dhe Mbrojtjen e Minoriteteve dhe të organeve që janë krijuar,

në bazë të Traktateve ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut si dhe me Dokumente të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, për çuarjen përpara dhe mbrojtjen të personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare ose gjuhësore,

Duke marrë parasysh punën e rëndësishme që pealizohet në organizmat ndërshtetëror dhe jo qeveritar për mbrojtjen e minoriteteve dhe për mbrojtjen e personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare dhe gjuhësore,

Duke njohur nevojen që të sigurohet një zbatim më i efektshëm i dokumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut për sa u përket të drejtave të personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare ose gjuhësore,

Shpall këtë Deklaratë për të drejtat e personave që u takojnë minoriteteve etnike, fetare dhe gjuhësore:

Neni 1

1. Shtetet do të mbrojnë ekzistencën dhe identitetin etnik, fetar dhe gjuhësor të minoriteteve dhe të territorit të tyre dhe do të inkurajojnë kushtet e çuarjes përpara të këtij identiteti.

2. Shtetet do të adoptojnë masat e përshtatshme ligjore etj. në mënyrë që të realizojnë këto synime.

Neni 2

1. Personat që u takojnë minoriteteve etnike, fetare dhe gjuhësore (këtëj e tutje persona që u takojnë minoriteteve) kanë të drejtë të shijojnë kulturën e tyre, të deklarojnë publikisht dhe të ushtrojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e tyre, midis tyre ose publikisht lirshëm dhe pa asnjë ndërhyrje dhe lloj tjetër diskriminimi.

2. Personat që u takojnë minoriteteve kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë efektive në jetën kulturore, fetare, shoqërore, ekonomike dhe publike.

3. Personat që u takojnë minoriteteve kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë efektive në vendime të nivelit kombëtar dhe rajonal që kanë të bëjnë me minoritetin të cilit i takojnë

ose rajoneve në të cilët banojnë, me mënyrën që nuk bie ndesh me ligjshmërinë kombëtare.

4. Personat që u takojnë minoriteteve kanë të drejtë të krijojnë dhe të mbajnë organizatat e tyre.

5. Personat që u takojnë minoriteteve kanë të drejtë të krijojnë dhe të mbajnë pa asnjë diskriminim, kontakte të lira dhe paqësore me persona të tjerë të grupit të tyre dhe me persona që u takojnë minoriteteve të tjerë, si dhe kontakte jashtë kufijve të Shtetit ku banojnë me qytetarë të Shtetëve të tjera me të cilët kanë lidhje etnike, fetare ose gjuhësore.

Neni 3

1. Personat që u takojnë minoriteteve mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, përfshirë atyre që shkruhen në këtë Deklaratë, në veçanti si dhe në grup me anëtarë të tjerë të grupit të tyre, pa asnjë diskriminim.

2. Nuk përbën disavantazh për çdo person që i takon një minoriteti ushtrimi ose mos ushtrimi i të drejtave që shkruhen në këtë Deklaratë.

Neni 4

1. Kur kërkohet, Shtetet adoptojnë masa që të sigurojnë se personat që u takojnë minoriteteve mund të ushtrojnë në mënyrë të plotë dhe efektive të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore pa asnjë dallim dhe me barazi të plotë përpara ligjit.

2. Shtetet adoptojnë masa që të krijohen kushte të favorshme në mënyrë që personat që u takojnë minoriteteve të kenë mundësinë të shprehin karakteristikat e tyre dhe të zhvillojnë kulturën e tyre, gjuhën, fenë, traditat dhe zakonet e tyre, përveç praktikave të veçanta që përbëjnë cenim të së drejtës kombëtare dhe bien ndesh me kriteret ndërkombëtare.

3. Shtetet adoptojnë masat e nevojshme që, kur kjo është e mundur, personat që u takojnë minoriteteve, të kenë shanse të përshtatshme të mesojnë gjuhën e tyre amtare ose të edukohen në gjuhën e tyre amtare.

4. Shtetet, kur kjo është e mundur, adoptojnë masa në sektorin e arsimit, me mënyrë që të inkurajojnë njohjen e historisë, të traditave, të gjuhës dhe të kulturës së minoriteteve që banojnë në territorin e tyre. Personat që u takojnë minoriteteve duhet të kenë shanset e përshtatshme të njohin shoqërinë si një e tërë.

5. Shtetet adoptojnë masat e përshtatshme në mënyrë që personat që u takojnë minoriteteve të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë të plotë në përparimin ekonomik dhe zhvillimin e vëndit të tyre.

Neni 5

1. Politika kombëtare dhe programet duhet të mbështesin dhe të zbatohen me referim tek “interesat e ligjshme të personave që u takojnë minoriteteve”.

2. Programet e bashkëpunimit dhe të ndihmës midis Shtetëve duhet të hartohen dhe të zbatohen dhe tu referohen interesave të ligjshëm të personave që u takojnë minoriteteve.

Neni 6

Shtetet bashkëpunojnë në tema që kanë lidhje me persona që u takojnë minoriteteve, ndërmjet të tjerash, duke shkëmbyer Informacion dhe përvojë, me qëllim që të çojnë përpara mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjelltë.

Neni 7

Shtetet bashkëpunojnë për çuarjen përpara e respektimit të të drejtave që shkruhen në këtë Deklaratë.

Neni 8

1. Asnjë dispozitë e kësaj Deklarate të Venecias nuk pengon realizimin e detyrimeve ndërkombëtare të Shtetëve në lidhje me personat që u takojnë minoriteteve. Në veçanti Shtetet duhet të plotësojnë në mënyrë të ndershme detyrimet dhe angazhimet që kanë marrë përsipër në bazë të konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve në të cilat janë Pjesë.

2. Ushtrimi i të drejtave që shkruhen në këtë Deklaratë

nuk çënon zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njohura.

3. Masat që adoptohen nga Shtetet në mënyrë që të shijohen në mënyrë efektive të drejtat që shkruhen në këtë Deklaratë nuk duhet të konsiderohen në parim se bien ndesh me parimin e barazisë që përfshihet në Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut.

4. Asnjë dispozitë e kësaj Deklarate nuk mund të interpretohet se lejon veprimtari që bie ndesh me qëllimet dhe parimet të Kombëve të Bashkuara përfshirë atë të barazisë, të sovranitetit, të tërësisë territoriale dhe të pavarësisë politike të Shteteve.

Neni 9

Organizmat e specializuar dhe organizata të tjera të Kombëve të Bashkuara do të kontribuojnë në realizimin e plotë të të drejtave dhe të parimeve që shkruhen në këtë Deklaratë, në kuadër të fushave përkatëse të juridiksionit të tyre.

DEKLARATA E VJENËS

Vjenë, 9 tetor 1993 (Këshilli i Evropës)

SHTOJCE II

Minoritete etnike

– Ne, Udheheqësit e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve-anëtarë të Këshillit të Evropës vendosen për sa më poshtë në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve etnike:

- Minoritetet etnike, të cilat i krijuan turbullirat e historisë në Evropë duhet të mbrohen dhe të respektohen, në menyrë që të kontribuojnë në stabilitetin dhe paqen.

- Në Evropën të cilën dëshirojmë të ndërtojmë, duhet ti pergjigjemi kësaj sfide: të garantojmë mbrojtjen e të drejtave të personave që u takojnë minoriteteve. Duke respektuar rregullat e së drejtës dhe duke respektuar terësinë territoriale

dhe sovranitetin kombëtar të Shteteve.

Nën këto predispozita, minoritetet në fjalë do të kontribuojnë me vendosmëri në jetën e shoqërive tona.

- Krijimi i një klimë tolerance dhe dialogu është e domosdoshme për pjesmarrjen e të gjithëve në jetën politike. Autoritetet rajonale dhe vendore duhet të ndihmojnë shumë në këtë drejtim.

- Shtetet kanë për detyrim që të sigurojnë me veprimet e tyre respektimin e parimeve të cilat janë themelore në trashëgiminë tonë të përbashkët evropiane: barazi para ligjit, paanësi, shanse të barabarta, liri të bashkimit dhe të mbledhjes, si dhe pjesmarrje aktive në jetën publike.

- Shtetet kanë detyrimin që të krijojnë kushtet e domosdoshme tek personat që u takojnë minoriteteve etnike, në mënyrë që të zhvillojnë kulturën e tyre, duke ruajtur në të njëjtën kohë fenë, traditat dhe zakonet e tyre. Këta persona duhet që të mundën të përdorin gjuhën e tyre si në mënyrë individuale ashtu edhe publikisht dhe duhet që të mundën ta përdorin, me disa kushte, edhe në marrëdhëniet e tyre me autoritetet shtetërore.

- Mbështesim rëndësinë që mund të kenë për stabilitetin dhe paqen në Evropë marrëveshjet dypalëshe midis shteteve, që synojnë sigurimin e mbrojtjes të minoriteteve etnike të mpleksur.

SHTOJCE III

Deklaratë dhe Plan Veprimi për luftimin e racizmit, të ksenofobisë, të antisemitizmit dhe të urrejtjes e zemërngushtësisë

- Ne Udhëheqësit e Shteteve dhe të Qeverive të Shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës

Të bindur së shumëllojshmëria e traditave dhe kulturave përbën në shekuj pasurinë e Evropës dhe se parimi i tolerancës jep garancitë për ruajtjen në Evropë të një shoqërie të hapur,

që do të respektojë shumëllojshmërinë kulturore në të cilën jemi të përqendruar.

Të bindur se krijimi i një shoqërie demokratike dhe pluraliste, e cila respekton barazinë në dinjitetin e të gjitha qënieve njerëzore mbetet një nga qëllimet themelore të ndërtimit evropian.

Të shqetësuar thellë nga rindezja e racizmit, ksenofobia dhe antisemitizmi, të zhvillimit të një klime urrejtjeje dhe zemërgurësie, rritja e veprimeve të dhunës, veçanërisht kundër emigrantëve si dhe nga përballimi poshterues dhe praktikat diskriminuese që e shoqërojnë,

Po kështu të shqetësuar thellësisht nga zhvillimi i një nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, që përbëjnë forma të reja shfaqjeje të ksenofobisë.

Të shqetësuar nga përkeqësimi i gjëndjes ekonomike, që kërcënon unitetin e shoqërive evropiane me krijimin e formave të përjashtimit, të cilat sigurisht që nxisin konfrontime dhe shfaqje të ksenofobisë

Të bindur se shfaqjet në fjalë të urrejtjes dhe të zemërgurësisë kërcënojnë shoqëritë demokratike dhe vlerat e tyre themelore dhe minojnë themelet e ndërtimit evropian.

Duke konfirmuar Deklaratën e 14 majit 1981 të Komisionit të Ministrave, ku kjo e fundit ka denuar në mënyrë solemne të gjitha format e urrejtjes dhe të zemërgurësisë si dhe veprimet e dhunës që i ndjekin.

Duke konfirmuar vlerat e solidaritetit të cilat duhet të frymëzojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë, në mënyrë që të zvogëlohen mënjanimi dhe përjashtimi shoqëror.

Të bindur ende se e ardhmja e Evropës kërkon nga personat dhe grupet jo vetëm tolerancën por edhe vullnet për veprimtari kolektive, duke gërshtuar kontributet e tyre të gjithanshëm,

Denojmë me menyrën më të ashpër racizmin në të gjitha format e tij, ksenofobinë, antisemitizmin dhe urrejtjen e

zemërgurësinë, si dhe të gjitha format e diskriminimit fetar. –Inkurajojmë Shtete– anëtarë të vazhdojnë përpjekjet e ndërmarra deri sot për zhdukjen e këtyre fenomeneve dhe angazhohemi të forcojmë ligjshmëritë kombëtare dhe mekanizmat ndërkombëtarë, si dhe do të marrim masat e duhura në nivel kombëtar dhe evropian.

- Marrim përsipër të luftojmë të gjitha ideologjitë, politikat dhe praktikatat që nxisin urrejtjen sociale, dhunën dhe trajtimin diskriminues, si dhe ëdo veprim ose formulim në të folur që përforcon dyshimet dhe konfrontimet ndërmjet grupeve me prejardhje të ndryshme racore, etnike, fetare ose sociale.

KONVENTË KUADËR PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE ETNIKE

KONVENTA KUADËR PER MPROJTJEN E PAKICAVE KOMPETARE

Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera, nënshkruese në këtë Konventë kuadër.

Duke konsideruar se synimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim që të mbrojnë dhe realizojnë idealet e parimet, që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët.

Duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshëm i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Duke dashur që të zbatojnë Deklaratën e Kryetarëve të shteteve dhe Qeverive të Shteteve Anëtarë të Këshillit të Evropës, miratuar në Vjenë, më 9 tetor 1993.

Të angazhuar për të mbrojtur ekzistencën e pakicave kombëtare në territoret e tyre përkatëse.

Duke pasur parasysh se ndryshimet në historinë e Evropës kanë treguar se mbrojtja e pakicave kompëtare paraqet rëndësi për stabilitetin, sigurimin demokratik dhe paqen në këtë kontinent.

Duke konsideruar se një shoqëri pluraliste dhe e vërtetë demokratike duhet që jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i përket një pakicë kompëtare, por gjithashtu edhe të krijojë kushtet e nevojshme që iu japin mundësi atyre për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar këtë identitet.

Duke pasur parasysh se krijimi i një klimë të tolerancës dhe dialogut është e nevojshme që t' i mundësojë shumëllojshmërisë kulturore që të jetë një burim e faktor i pasurimit të çdo shoqërie, dhe jo i ndarjes.

Duke konsideruar se ndërtimi i një Evropë tolerante dhe të begatuar nuk varet vetëm në bashkëpunimin ndërmjet shteteve, por kërkon gjithashtu edhe bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale, pa cenuar kushtetutën dhe integritetin territorial të çdo shteti.

Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe Protokollet e saj.

Duke iu referuar angazhimeve mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare në konventat dhe deklaratat e Kombeve të Bashkuara, dhe në dokumentet e Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, veçanërisht Dokumentin e Kopenhagenit, më 29 qershor 1990.

Të angazhuar për të përcaktuar parimet që duhen respektuar dhe detyrimet që burojnë prej tyre, me qëllim që të sigurojnë, në shtetet anëtarë dhe shtetet të tjera që mund të bëhen pale në këtë instrument, mbrojtjen efektive të pakicave kombëtare dhe të të drejtave e lirive të personave që iu përkasin këtyre pakicave, në kuadrin e shtetit ligjor, respekt imit të integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar të shteteve.

Të vendosur për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe politikave qeveritare të përshtatshme.

Bien dakord si vijon:

PJESA I

Neni 1

Mprojtja e pakicave kompetare dhe e të drejtave e lirive të personave që i përkasin këtyre pakicave formojnë një pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe si të tilla përfshihen në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Konvente kuadër do të zbatohen në mirëbesim, në frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës, dhe në përputhje me parimet e fqinjësisë së mirë, marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve.

Neni 3

1. Çdo person që i përket një pakicë kombëtare do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht për t' u trajtuar apo jo si i tillë, dhe nuk do të ketë asnjë dizavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që lidhen me këtë zgjedhje.

2. Personat që u përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë që burojnë prej parimeve të parashikuara në këtë Konventë kuadër në mënyrë individuale si dhe në bashkësi me të tjerët.

PJESA II

Neni 4

1. Palet angazhohen t' i garantojnë personave që i përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Lidhur me këtë, do të ndalohet çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare.

2. Palet angazhohen që të miratojnë, kurdoherë që është e nevojshme, masa të përshtatshme me qëllim që të nxisin, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakicë kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, ata do të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

3. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen se janë një akte diskriminimi.

Neni 5

1. Palet angazhohen të nxisin kushtet e nevojshme për personat që iu përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre, dhe për të ruajtur elementet themelore të këtij identiteti, konkretisht besimin fetar, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore.

2. Pa cenuar masat e marra për realizimin e pilitikës së tyre të integritit të përgjithshëm, Palet nuk do të ndërmarrin politika apo praktika që synojnë në asimilimin e personave që iu përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre dhe do të mbrojnë këta persona nga çdo akt që synon një asimilim i tillë.

Neni 6

1. Palet do të inkurajojnë një frymë tolerance dhe dialogun ndërkulturor, dhe do të marrin masa efektive për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë personave që të jetojnë në territorin e tyre, pa dallim përsa i përket identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar të këtyre personave, veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe shtypit.

2. Palet angazhohen të marrin masa të përshtatshme të mbrojnë personat që mund t' i nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, si pasojë e identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.

Neni 7

Palet do të sigurojnë respektimin e së drejtës së çdo personi që i përket një pakicë kombëtare për lirinë e grumbullimeve paqësore, lirinë e organizimit, lirinë e shprehjes, dhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar.

Neni 8

Palet angazhohen të pranojnë se çdo person që i përket një pakicë kombëtare ka të drejtën të manifestojë fenë apo besimin e tij/saj dhe të krijojë institucionet, organizatat dhe shoqatat fetare.

Neni 9

1. Palet angazhohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes se çdo personi që i përket një pakicë kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, dhe për të marrë dhe shpërndarë informacion e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë palet do të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një pakicë kombëtare nuk diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin.

2. Paragrafi 1 nuk do të ndalojë Palet që të kërkojnë, pa diskriminim dhe mbi bazën e kritereve objektive, licensimin, e radiohapjes dhe televizionit, apo ndërmarrjeve të kinemasë.

3. Palet nuk do të pengojnë krijimin dhe përdorimin e shtypit të shkruar nga personat që i përkasin pakicave kombëtare. Në kuadrin ligjor të sistemit të përhapjes së radios dhe televizionit, ata do të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe duke pasur parasysh dispozitat e paragrafit 1, që personat që i përkasin pakicave kombëtare t'iu jepen mundësi për të pasur dhe përdorur shtypin e tyre.

4. Në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, Palet do të miratojnë masa të përshtatshme për të lehtësuar kontaktet me shtypin për personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe për të nxitur tolerancën dhe lejuar shumëllojshmërinë kulturore.

Neni 10

1. Palet angazhohen të njohin që çdo person që i përket një pakicë kombëtare ka të drejtën të përdorë lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij/saj të pakicës, në mënyrë personale dhe publike, me gojë dhe me shkrim.

2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në qoftë se këta persona parashetrojnë kërkesë, dhe kur ajo i përgjigjet një nevojë reale, Palet do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, kushtet që mund të bëjnë të mundur përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative.

3. Palet angazhohen të garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakicë kombëtare për t' u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi arësyet e arrestimit të tij/saj, dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuzë kundër tij/saj, dhe për të mprojtur vetën e tij/saj në këtë gjuhë, dhe në se është e nevojshme me ndihmën pa pagesë të një përkthyesi.

Neni 11

1. Palet angazhohen të njohin se çdo person që i përket pakicave kombëtare ka të drejtën të përdorë mbiemrin (prejardhjen) dhe emrat e parë në gjuhën e pakicës dhe të drejtën për njohjen e tyre zyrtarisht, në përputhje me procedurat e parashikuara në sistemin e tyre ligjor.

2. Palet angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakicë kombëtare ka të drejtën të shfaqë në gjuhën e tij/saj të pakicës shënja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale në mënyrë të dukshme për publikun.

3. Në zonat e banuara tradicionalisht nga një numër thelbësor i personave të pakicave kombëtare, Palet do të përpiqen, në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, përfshirë kur është e përshtatshme, marrëdhëniet me shtetet e tjera, dhe duke marrë parasysh kushtet e tyre të veçanta, të vendosin emra tradicionale vendas,

emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografike për publikun edhe në gjuhën e pakicës, kur ka një kërkesë të mjaftueshme për këta tregues.

Neni 12

1. Palet, kur është e përshtatshme, do të marrin masa në fushën e arsimit dhe studimeve për të nxitur njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare të tyre dhe të shumicës.

2. Në këtë kuadër, Palet do të sigurojnë ndër të tjera mundësi të përshtatshme për kualifikimin e mesuesve dhe pajisjen me tekste shkollore, dhe të lehtësojnë kontaktet ndërmjet studenteve dhe mësuesve të komiteteve të ndryshme.

3. Palet angazhohen të nxisin mundësi të barabarta për ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat që i përkasin pakicave kombëtare.

Neni 13

1. Në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, Palet do të njohin se personat që i përkasin një pakicë kombëtare kanë të drejtë të ndërtojnë institucionet e tyre arsimore dhe kualifikuese private.

2. Ushtrimi i kësaj të drejtë nuk do të sjellë ndonjë detyrim financiar për Palet.

Neni 14

1. Palet angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakicë kombëtare ka të drejtën të mësojë gjuhën e tij/saj të pakicës.

2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në se ka një kërkesë të mjaftueshme, Palet do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat që i përkasin këtyre pakicave të kenë mundësi të përshtatshme për të mesuar gjuhën e pakicës apo për të marrë mesime në këtë gjuhë.

3. Paragrafi 2 i këtij neni do të zbatohet pa cenuar mësimin e gjuhës zyrtare apo mësimin në këtë gjuhë.

Neni 15

1. Palet do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.

Neni 16

Palet nuk do të ndërmarrin masa që ndryshojnë përbërjen e popullsisë në zonat e banuara nga personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe synojnë në kufizimin e të drejtave e lirive që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër.

Neni 17

1. Palet angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përgjatë kufijve me personat që banojnë ligjërisht në shtete të tjera, veçanërisht me ata me të cilat kanë një identitet etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, apo një trashëgimi të përbashkët kulturore.

2. Palet angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave që i përkasin pakicave kombëtare për të marrë pjesë në aktivitetet e organizatave jo-qeveritare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 18

1. Palet do të përpiqen të përfundojnë, kur është e nevojshme, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe me shtetet e tjera, veçanërisht me shtetet fqinjë, për të siguruar mbrojtjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare përkatëse.

2. Kur është me vend, Palet do të marrin masa për të inkurajuar bashkëpunimin ndër-kufitar.

Neni 19

Palet angazhohen të respektojnë dhe zbatojnë parimet e

parashikuara në këtë Konventë kuadër, duke bërë, kur është e nevojshme, vetëm ato kufizime apo shmangie që janë parashikuar në instrumentet juridike ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në masën që ato janë të përshtatshme për të drejtat dhe liritë që burojnë nga këto parime.

PJESA III

Neni 20

Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër, çdo person që i përket një pakicë kombëtare do të respektojë legjislacionin kombëtar dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht atyre të personave që i përkasin shumicës apo pakicave të tjera kombëtare.

Neni 21

Asgjë në këtë Konventë kuadër nuk do të interpretohet se nënkupton ndonjë të drejtë për t' u angazhuar në aktivitete apo për të kryer ndonjë veprim kundër parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare, dhe veçanërisht barazisë sovrane, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve.

Neni 22

Asgjë në këtë Konventë kuadër nuk do të kuptohet se kufizon apo shmang ndonjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që mund të sigurohen sipas ligjeve të ndonjë Pale Kontraktuese, apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër ku ajo është Pale.

Neni 23

Të drejtat dhe liritë që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë kuadër, në masën që ato janë objekt i një dispozite përgjegjëse në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore apo në Protokollin e saj, do të kuptohen në një mënyrë që vjen në përputhje me dispozitat e kësaj të fundit.

PJESA IV

Neni 24

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës do të mbikqyrë zbatimin e kësaj Konvente kuadër nga Palet Kontraktuese.

2. Palet që nuk janë anëtarë të Këshillit të Evropës do të marrin pjesë në mekanizmin zbatues, sipas procedurave që do të përcaktohen.

Neni 25

1. Brenda një periudhe 1 vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër lidhur me një Palë Kontraktuese, kjo e fundit do t' i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës informacion të plotë mbi masat legjislative dhe të tjera, të marra për zbatimin e parimeve të parashtruara në këtë Konventë kuadër.

2. Për periudhën me pas, secila Palë do t' i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm, në një mënyrë periodike dhe kurdoherë që kërkon Komiteti i Ministrave, çdo informacion shtesë përkatës lidhur me zbatimin e kësaj Konvente kuadër.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t' i parashtojë Komitetit të Ministrave informacionin e transmetuar sipas kushteve të këtij Neni.

Neni 26

1. Në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të marra nga Palet për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër, Komiteti i Ministrave do të ndihmohet nga një komitet këshillimor, anëtarët e të cilit do të kenë një kualifikim të njohur në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare.

2. Përbërja e këtij komiteti këshillimor dhe procedurat e tij do të përcaktohen nga Komiteti i Ministrave brenda një periudhe 1 vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër.

PJESA V

Neni 27

Kjo Konventë kuadër do të hapet për nënshkrim nga shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës. Deri në datën kur Konventa hyn në fuqi, ajo do të jetë e hapur gjithashtu për nënshkrim edhe nga ndonjë shtet tjetër i ftuar nga Komiteti i Ministrave. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 28

1. Kjo Konventë kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore pës datës në të cilën 12 shtete anëtarë të Këshillit të Evropës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të pranuar si të detyrueshme Konventën, në përputhje me dispozitat e Nenit 27.

2. Lidhur me secilin shtet anëtar, i cili shpreh më pas pëlqimin e tij për të pranuar si të detyrueshme atë, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 29

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër dhe pas konsultimit të shteteve Kontraktuese, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të ftojë për të aderuar në Konventë, nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar në Nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës, çdo shtet jo-anëtar të Këshillit të Evropës, qe i ftuar të nënshkruajë në përputhje me dispozitat e Nenit 27, nuk e ka bërë këtë akoma, dhe çdo shtet tjetër jo-anëtar.

2. Lidhur me ndonjë shtet aderues, i cili shpreh më pas pëlqimin e tij për të pranuar si të detyrueshme atë, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore pas datës së depozitimit të instrumentit

të aderimit në Sekretarin e Përgjithshëm të këshillit të Evropës.

Neni 30

1. Secili shtet mund të përcaktojë, në kohën e nënshkrimit, apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, territorin apo territoret për të cilat ai është përgjegjës në marrëdhëniet ndërkombëtare ku do të zbatohet kjo Konventë kuadër.

2. Secili shtet mund të zgjerojë, në një kohë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, zbatimin e kësaj Konvente kuadër në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratat. Lidhur me këto territore, Konventa kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore pas datës së marrjes të një deklaratë të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafeve të mesiperm mund të terhiqet, lidhur me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore pas datës së marrjes të një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 31

1. Secila Pale mund të denoncojë në çdo moment këtë Konventë kuadër nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të një periudhe 6-mujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtarë të Këshillit, shtetet e tjera nënshkruese dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë konventë kuadër për:

- a. çdo nënshkrim,
- b. depozitimim e secilit instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit,
- c. secilën datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente kuadër në përputhje me Nenet 28, 29 dhe 30,
- d. secilin veprim, njoftim apo komunikim tjetër lidhur me këtë Konventë kuadër.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë kuadër.

Bërë në Strasburg, më 1 shkurt 1995, në gjuhën franceze dhe angleze, duke pasur të dy tekstet të njëjtën vlerë, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t' i transmetojë kopjet e vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës dhe secilit shtet të ftuar për të nënshkruar apo aderuar në këtë Konventë kuadër.

KARTË E TË DREJTAVE THEMELORE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 21

Ndalimi i diskriminimeve

1. Ndalohet çdo diskriminim veçanërisht për arsye të seksit, racës, ngjyrës, origjinës etnike ose prejardhjes shoqërore, karakteristikave të lindjes, gjuhës, fesë ose bindjeve, të pikpamjeve politike ose i një mendimi tjetër, cilësisë të së qenit anëtar i një minoriteti, pasurisë, lindjes, invaliditetit, moshës ose orientimit të lindur.

2. Ndalohet çdo diskriminim për arsye të shtetësisë, brenda kuadrit të zbatimit të Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian dhe të Traktatit për krijimin e Bashkimit Evropian dhe me rezerva të dispozitave specifike të Traktateve në fjalë.

Neni 22

Bashkimi do të respektojë shumëllojshmërinë kulturore, fetare dhe gjuhësore.

**TRAKTATI I MIQËSISË, BASHKËPUNIMIT,
FQINJËSISË SË MIRË DHE SIGURISË**

që u firmos më 21 mars 1996 (u ratifikua në L. 2568/FEK A 8/13-1-1998)

“Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri kontribuoi dhe vazhdon të kontribuojë në mënyrë të qënësishme në jetën e shoqërisë së Shqipërisë dhe përbën faktor për zhvillimin e miqësisë midis të dy vendeve” (Numër i Gazetës Zyrtare të Greqisë A nr. 8. 1996).

**BASHKIMI EVROPIAN - MARRËVESHJA
E STABILIZIM ASOCIMIT ME SHQIPËRINË**

(Qershor 2006)

Shqipëria me nënshkrimin e Marrëveshjes nga njëra anë do të marrë një ndihmë të madhe ekonomike dha nga ana tjetër angazhohet për ndryshime për sa u përket të drejtave njerëzore dhe minoritare. Bashkimi Evropian i bën thirrje Shqipërisë të marrë përsipër me përgjegjësi plotësimin e të gjitha kushteve të Marrëveshjes, ndërmjet të cilëve përfshihet edhe respektimi i plotë dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit etnik grek, duke theksuar se përparimi i bisedimeve dhe afrimi i Shqipërisë në B.E. do të varet ekskluzivisht nga aftësia e saj tu përgjigjet angazhimeve që ka marrë.

Tabela 1

Numri I nxënësve greke në rrethin e Gjirokastrës të shkollat 8vjecare (Filllore)

	1992- 1993	1995- 1996	1999- 2000	2001- 2002	2003- 2004
Dervicjani	208	173	167	102	75
Goranxi	106	99	79	76	54
Haskovë	25	15	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Banistër	13	13	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Sofratikë	74	67	61	41	31
Dhuvjan	11	4	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Terihat	41	29	mbyllur	12	15
Frashtan	87	661	80	71	45
Lugar	11	3	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Goricë	6	4	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Grapsh	39	36	16	16	9
Jergucat	92	47	16	19	21
Zervat	38	27	9	9	mbyllur
Bularat	52	42	38	9	27
Bodrishtë	100	61	31	27	13
Kërre	31	16	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Vrisera	79	69	64	43	37
Vodhinë	7	4	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Kakavi	35	24	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Shën Nikolla	6	5	3	2	mbyllur
Klishar	41	31	3	2	mbyllur
Pepel	23	11	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Selo	10	2	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Likomil	6	mbyllur	mbyllur	9	mbyllur
Llongo	47	16	3	mbyllur	mbyllur
Llovinë e S.	17	8	mbyllur	2	mbyllur
Llovinë e P.	5	9	mbyllur	3	mbyllur
Sotirë	35	12	4	mbyllur	mbyllur
Krioner	13	2	mbyllur	4	mbyllur

Koshovicë	33	19	19	19	mbyllur
Peshkëpi e P	48	26	16	mbyllur	3
Peshkëpi e S	15	8	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Radat	4	1	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Glinë	49	38	34	28	mbyllur
Vrahogoranxi	14	6	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Polican	74	52	34	18	12
Skorë	37	7	34	mbyllur	mbyllur
Sopik	28	25	23	12	7
Hllomo	32	4	mbyllur	mbyllur	mbyllur
Çatistë	64	22	8	5	6
Gjirokastrë					148
Shuma	1658	1097	652	521	493

Tabela 2

Numri i nxënësve greke në rrethin e Gjirokastrës në shkollat e mesme

VITI SHKOLLOR 2003 - 2004

Bularat	73
Dervician	68
Shkolla Pedagogjike	67
Kryqi i Nderuar - Gjirokastrë	85
Shuma	293

Tabela 3

Numri i nxënësve greke në rrethin e Sarandës, Gjirokastrës dhe Delbinës

Numri i nxën.	Gjirokastrë	Delvinë	Sarandë	Shuma
1991-1992	2137	2108	2189	6437
1999-2000	959	195	616	1770
2000-2001	861	285	538	1564

Tabela 4

Numri i nxënësve greke në rrethin e Sarandës në shkollat tetëvjeçare (Fillore)

VITI SHKOLLOR 2003-2004

Sarandë	201 nga të cilët	13 në kopësht
Livadhja	80 dhe	35 në shk. mesme
Kulluricë	6	
Qesarat	8	
Sminec	7	
Karoq	3	
Dermish	26	
Dhivër	17 dhe	21 në kopësht
Tserkovicë	6	
Leshnicë e Sipërme	3	
Aliko	24	
Pllakë	8	
Çukë	19	
Shuma	408	

Tabela 5

Numri i nxënësve greke në rrethin e Delvinës në shkollat tetëvjeçare

VITI SHKOLLOR 2003-2004

Delvinë	45
Bistricë	11
Dhrovjan	2
Mesopotam	56
Kranë	3
Finiq	22
Karahaxh	4
Livinë	15
Vrion	4
Lefterohor	2
Shuma	164

FEDERATA PANEPIROTE E AMERIKËS

Rezolutë në Asamblenë e Përgjithshme të Helenizmit të Mërguar

Selanik dhjetor 2006

Siç jeni në dijeni Federata Panepirote e Amerikes përbën organizatën e shkallës së tretë të Epirotëve të Diasporës, organizatë e cila përbën krenari për Helenizmin Homogjen të Amerikës së Veriut. Pjesë e rëndësishme të veprimtarisë së saj përbën Helenizmi Vorioepirot, përderisa shumë anëtar e kanë prejardhjen nga ky vend. Në këtë mënyrë jemi shumë të ndjeshëm, siç besojmë edhe çdo Grek, për sa i përket dhënies i të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri.

Zhvillimet e fundit në marrëdhëniet greko-shqiptare sjellin në pah gjëndjen e Grekëve vorioepirote në vendin fqinj dhe veçanërisht çështje të rëndësishme nga të cilat për ne më të rëndësishëm janë:

1. Mbas vitit 1991 dhe ndryshimet në rregjimin e Shqipërisë, numri i pjestarëve të minoritetit grek u zvogëlua, përderisa një pjesë e madhe të Grekëve emigroi apo u detyrua të emigronte në Greqi. Problem i cili është i një rëndësie qëndrore dhe duhet të lëvizim për ndryshimin e gjëndjes, duke trajtuar në veçanti çështje që u takojnë si në Greqi ashtu edhe në Shqipëri (nënshtetësi e dyfishtë, pensionet etj).

2. Arsimimi i pjestarëve të minoritetit grek përbën një problem parësor, si për shkak se pala shqiptare mohon arsimimin grek jashtë zonave minoritare të përcaktuara arbitrarisht, ashtu edhe për shkak se librat shqip për nxënësit me kombësi greke

përmbajnë citime nacionaliste. Në veçanti në konventat që u referohet arsimit ndërmjet të dy vendeve, ekzistojnë vendime për mbështetjen të gjuhës greke si gjuhë e dytë nëpër shkolla ku ekzistojnë premiset, të cilat përputhen me nenin 14 të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike të Këshillit të Evropës. Ky nen thotë se “në zona në të cilat personat u përkasin minoriteteve, banojnë tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm, në qoftë se ekziston një kërkesë e mjaftueshme, duhet të bëhen përpjekje në mënyrë që personat që i takojnë minoritetit të kenë kushtet e përshtatshme për mësimin e gjuhës së tyre amtare”. Është fakt se para dhe pas ratifikimit të Konventës Kuadër pjestare të Minoritetit Grek kanë depozituar kërkesa, por këto kërkesa nuk janë miratuar (Përmet, Himarë).

3. Liria fetare ku ushtrohet lirshëm ose kufizohet sipas dëshirës së organëve shtetërore.

4. Dhënia e pasurive private, publike dhe fetare atyre që u takon po vonon ndërsa në shumë raste nuk është realizuar akoma, pavarësisht nga vendimet gjyqsore.

5. Dihet se ekonomia e Minoritetit Grek mbështetet tek bujqësia, blektoria dhe tregtia. Vjedhjet e kafshëve, orendive, kërcenimet ndaj afaristëve Grek nuk lejojnë zhvillimin e sektorit të ekonomisë në këtë zonë, pavarësisht nga ndihma e deklaruar të shtetit grek ndaj Shqipërisë (p.sh. Plani Grek për Rimëkëmbjen e Ballkanit, etj.).

6. Shtrehtërimi i kujtesës historike, të gjeografisë (toponime shqiptare në greqisht të cilat nuk janë ndruar akoma), të traditës kulturore, shtrëhtërimi i realitetit të sotëm, me zbatimin e masave kufizuese, fallsifikimi i fakteve etj. vazhdon dhe forcohet pavarësisht nga angazhimi i vëndit fqinj për zbatimin e konventave përkatëse (p.sh. Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike të Këshillit të Evropës). Rëndësi të veçantë ka rregjistrimi i popullsisë, ku deri sot nuk rregjistrohet identiteti etnik, duke

fallsifikuar kështu të dhënat në zonat ku jeton minoriteti grek. Bile, më 2001, për arsye të cilat akoma Shqipëria nuk ka sqaruar tek Organizmat Ndërkombëtare, të cilët financuan rregjistrimin, nuk u përfshi në fletën e rregjistrimit kombësia dhe feja. Për këto arsye Minoriteti Grek bojkotoi këtë rregjistrim.

7. Hapësira e Vorio Epirit përbën një vënd të shenjtë flijimi të të parëve tanë dhe në përgjithësi të të gjithë Grekëve, të cilët ranë duke i rezistuar përparimit të fashizmit italian ndaj vendit tonë. Konfliktet e brëndshme dhe Lufta e Ftohtë nuk lejuan që shteti grek të mbledh kockat e bashkatdhetarëve tanë të rënë, të ushtarëve Greke dhe për këtë arsye të ekzistojë një problem human dhe politik, i cili u rishfaq rishtas me provokimet shqiptare. Kështu duhet të zgjidhet një problem human i cili për shumë vjetë preokupon të afërmit e ushtarëve Greke, duke e paraqitur këtë problem tek pala shqiptare në mënyrë që të bëhet e qartë se problemi i mblëdhjes së ështrave nuk është një shkëmbim ekonomik, por një problem politik dhe human, tregues i një vullneti të mirë ndaj palës greke, e cila këtu e dy dhjetvjeçare mbështet me shumë mënyra vendin fqinj. Kështu, duke marrë shkas nga incidenti i fundit në Shqipëri dhe provokimet e forcave vendore të rendit gjatë procesit të zhvarrimit të ligjshëm të ështrave të ushtarëve greke, kërkojmë që të bëhet një rekomandim i rreptë palës shqiptare me qëllim që të kuptojë se bashkëpunimi i saj është DETYRIM NDERKOMBETAR dhe jo çështje diskutimi. Mbledhja e ështrave të ushtarëve Greke është një problem i dekadave të shkuara, në të cilat ekzistonte ballafaqim dhe jo i sotëm ku bashkëpunimi midis shteteve zgjidh menjëherë probleme të tilla.

8. Mos realizimi nga pala shqiptare e angazhimeve për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve për Grekët, si dhe terrorizmi ekzistojnë dhe forcohen. Brënda klimës nacionaliste që zhvillohet

në Shqipëri, një sërë veprimesh të qeverisë shqiptare u drejtuan kundër minoritetit grek. Synim i këtyre veprimeve është dëbimi përfundimtar i popullsisë greke, në të njëjtën kohë me kërkesat shqiptare për vënien e shenjës së barazimit midis emigrantëve shqiptarë në vendin tonë dhe minoritetit grek dhe daljes në pah të problemit të Çamëve nga organizata nacionaliste të shtetit fqinj.

9. Greqia me pëlqimin e saj të datës 12 qershor në Luksemburg, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, i cili me kushte i hap Shqipërisë perspektivën për anëtarësim, tregoi se ka qëllime të mira. Nga kjo si dhe nga perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO besojmë se perspektiva evropatlantike e Shqipërisë nuk duhet të konsiderohet se do të ketë që më përpara përfundim pozitiv, përderisa Greqia do të duhet që të ftojë Shqipërinë të plotësoj të gjitha kushtet, ndërmjet të cilave përfshihet edhe **respektimi i plotë dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit etnik grek**, duke theksuar se përparimi në bisedimet si dhe afrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe NATO do të kushtëzohet nga aftësia e saj tu përgjigjet angazhimeve që ka marrë.

HISTORIKU I FEDERATËS PANEPIROTE TË AMERIKËS

Ilia Bexios

Me kënaqësi të veçantë i përgjigjem kërkesës së Shoqatës “Bashkimi” të Worcester, të skruaj historikun e Federatës sonë me rastin e Kongresit të 35-të Panerirotë që mbledhet sivjet në qytetin e tyre.

Nga libri i të pahuarit Vasil Plaçika «Kujtime Panepirote», sikurse edhe nga libri i Niko Llolit «Epirote ne Amerikë» marr disa informata për historikun e krijimit dhe të aktivitetit të Federatës Panerirote deri në vitin 1955, dmth, vitin që mbërrita dhe unë në Amerikë dhe morra pjesë aktive në organizatë. Kjo më jep mundësinë të plotësoj këtë historik panepirot gjer më sot me të dhëna që disponoj në arkivin tim.

* * *

Filloj me referimin e V. Plaçikas lidhur me krijimin e Federatës Panepirote të Amerikës, e cila, me kalimin e kohës (sikurse do të lexoni më poshtë) u riemërtua «Federata Panepirote e Amerikës dhe e Kanadasë» edhe më vonë «Federata Panepirote e Amerikës, Kanadasë dhe Australisë».

Me inisiativën e organizatave epirote të Nju Jorkut, Filadelfias dhe Gusterit dhe pas shumë shkëmbim mendimesh, u vendos thirrja e një Kongresi Panepirot në një vilë të Northboros, një qytet i vogël afër Gusterit, më 19-21 korrik 1942.

Kjo mbledhje panepirote do të mbetet si një ngjarje historike në kronikat e Epirotizmit të Amerikës. Grumbullimi i madh i Epirotëve nga të gjitha anët e Amerikës, entuziazmi, dashuria,

gëzimi dhe manifestimet e larmishme e atyre tri ditëve do të mbeten të paharuara tek ata që morren pjesë në këtë katekizim epirotas.

Të dy gazetat e përditshme greke në Nju Jork, si edhe shumë të tjera, dërguan përfaqësues dhe i kushtuan rëndësi të madhe kësaj ngjarjeje historike.

Frymëzuesi i tërë programit ishte Athinagora i Madh, i cili i dha shkëlqim dhe madhësi këtij vëllazërimit të paparë të Epirotëve. Kryepeshkopi propozon që të blihet kjo vilë e një vlerë të madhe, në një peizazh magjeps dhe të përdoret si një vatër simpoziumesh të epirotëve duke e cilësuar «Vatër Panepirote», si një qendër kulturore dhe arsimore dhe të strehojë bujarinë dhe historinë epirote. Blerja u realizua me anën e një ofert të parë, prej një mijë dollarësh të vëllezërve Kristo dhe Ioani Curo. Por, për fat të keq, prona u rishit se mirëmbajtja e tij kërkonte shpenzime të mëdha, duke përgenjështuar kështu ëndërrën e Athinagorit të Madh.

Nga libri i Niko Llolit janë marrë këto informata:

«Pikat kryesore të aktivitetit kombëtar të Federatës Panepirote të Amerikës që nga krijimi i saj në muajin korrik 1942 deri në 1946, një katërvjecar kritik për kombin, me kryetar Dr. Fotio Qirici, mund të përmbliidhen si më poshtë:

Veprimi i parë i Federatës që protesta e fuqishme për stampimin e pullave poste përkujtimore në Amerikë, përveç atyre që u stampuan nga qeveria amerikane për të nderuar Greqinë dhe vendet e tjera aleatë, të cilat luftuan dhe reagues kundër Boshtit. Dërgimi i një delegacioni në Shën Frangjisko (San Francisco), për nentralizimin e propagantës shpigrare, gjatë Konferencës themeluese të Kombëve të bashkuara.

Botimi i rregullt i një buletim në gjuhën angleze për të ndikuar në opinionin publik të Amerikës dhe të vendeve të tjera në favor të çështjes vorioepirote. Përpilimi i raporteve informuese dhe protesta drejtuar Këshillit të Ministrave të

Jashtëm të Amerikës, Anglisë, Francës dhe Ruisë.

Raporte informuese dhe protesta drejtuar Kongresit të Paqes, në menyre që Shqipëria të mos konsiderohet «vend i koalicionit», por shtet armik, aleat i Boshtit. Protesta analoge iu drejtuan dhe Këshillit të Sigurimit, me qëllim që Shqipëria të mos aprovohet si anëtar i Lidhjes së Kombëve Paqedashëse. Raporte komunikuese dhe intervista për shtypin amerikan, biseda radiofonike dhe leksione rreth çështjes Vorioepirote dhe bashkëbisedime me shumë Senatorë dhe njerëz të tjerë të politikës amerikane. Botimi i broshurave agjitative për etapat e ndryshme të çështjes të Vorio Epirit nga zoterinjtë F. Qirici dhe N. Kasaveti. Gjithashtu, zhvillimi i veprimeve të koordinuara dhe i bashkëpunimeve për t' u adoptuar nga senati Amerikan një rezolutë në favor të çështjes Vorioepirote, e njohur si “Resolution S 82” nga senatori i Floridës S. Pepper.

Rezoluta (RESOLUTION S 82) e senatit Amerikan përmend këto: “Vendos se Senati e kupton plotësisht se Vorio Epiri (duke përfshirë dhe qytetin e Korçës) dhe 12 ishujt e detit Egje, të njohur si Dodekanisa, ku mbizotëron, popullsi e pastër greke, të tjersohen nga Konferenca e Paqes në Greqi dhe të inkuadrohen në tokat e saj.

Në vazhdim, gjatë kësaj periudhe, Federata Panepirote e Amerikës bashkëpunoi dhe ndihmoi Delegacionin Vorioepirot, i cili erdhi në Amerikë me në krye Metropolitin e paharueshëm të Gjirokastrës Pandlejmonin. Ndihmoi ekonomikisht emigrantët dhe jetimet e Vorio Epirit që ishin strehuar në Greqi. Krijoi një komitet për të vajtur në Paris, në Konferencën e Paqes. Realizoi bashkëbisedime të sukseshme dhe mbledhje të udhëheqjes dhe të funksionarëve t lartë të Federatës me burra shteti të Amerikës, me Senatorë dhe personalitete të tjera panamerikane dhe shumë të tjera.

Në vazhdim Niko Lloli, u referohet viteve të para të aktivitetit të Federatës Panepirote të Amerikës për dy arsye: «Së pari,

sepse qysh atëherë ky modeli i aktivitetit përsëritet vazhdimisht pothuajse në të njëjtën formë, por jo me të njëjtin intensitet. Dhe së dyti, sepse ky aktivitet, duke prekur çështjen kombëtare, nuk është e mundur të publikohet në të gjitha drejtimet. Por dhe sepse nuk arritëm të mbledhim materialin e domosdoshëm, të cilin ia disponojmë historianit të së ardhmes».

Pa rivendikuar sigurisht titullin e «historianit të së ardhmes», për të cilin bën fjalë Niko Lloli në fund të shkrimit të tij, unë vazhdoj që nga viti 1955 deri më sot historikun e aktivitetit të Federatës Panerirote, të paktën siç e jetova dhe kontribuova 50 vjet, duke kërkuar paraprakisht, falje për cilëndo mangësi apo mungesë në këtë drejtim.

Në muajin maj te vitit 1955 mbërrita si emigrant në Nju Jork. S' kisha njohur akoma atëherë udhëheqësit e organizatave Epirote të asaj kohe, por u informova se ekziston në Amerikë një Federatë Epirote dhe se në 14-18 korrik (dy muaj më vonë) përgatit Kongresin e 9-të në qytetin Ditroi. Ishte kongresi i vetëm i federatës në të cilin nuk mora pjesë, sepse emigrant i ri atëherë, nuk kisha mundësitë dhe njohjet e nevojshme.

Kryetar në atë kohë qe Himarioti Konstandinos Dhimas. Ai ishte zjedhur për herë të parë në Nju Jork më 1953. Pas zjedhjes së tij pati mundësi të sigurojë me qira një zyrë luksoze në qendër të Nju Jorkut, 42 Rrugë dhe Brodway dhe mori si sekretar të ndjerin Kosta Xova - student atëherë në Universitet Columbia Ai njeri i talentuar në penë, e intensifikoi aktivitetin dhe funksionizmin e zyrës së organizatës.

Kosta Dhima e aktivizoi Federatën duke organizuar shoqata epirote në qytete, por sidomos duke propaganduar kudo çështjen Vorioepirote. Kështu ai, në atë verë, rizgjedhet për një dyvjeçar akoma, në Kongresin e Ditroit.

Në dy vitet e fundit që kryesonte Dhima unë dhe disa të rinj të tjerë të moshës sime –veçanërisht në Nju Jork– patëm mundësinë të njiheshim me prijësit e asaj kohe dhe t' i ndihmonim

në punën e tyre, por me kalimin e kohës të fitonim dhe në një fare eksperience për t' i zëvendësuar në të ardhmen.

Në Kongresin e Cikagos në 1957 Kosta Dhima u zëvendësua nga Pandeli Sepi, nga Korça. Banues definitiv i Cikagos, ai i shërbeu Federatës dhe e mbajti organizatën për një katërvjeçar të bashkuar, duke evituar grindjet e brëndshme që dëmtojnë rëndë organizatat baskëkombëse. Afarist serioz por dhe drejtues aktiv, fitoi respektin dhe ndërimin të të gjithëve. Atëherë sekretar i Federatës qe doktori Vasilis Fotos nga Poliçani i Vorio Epirit, banues dhe ai në Cikago, i cili u zjodh për herë të parë, pas dy dyvjeçëve të Pandeli Sepi, Kryetar i organizatës, në korrik të vitit 1961.

Doktori V. Fotos dallohet në aktivitetin dhe përpjekjet e Federatës. Fakti që ai e kryesoi organizatën shtatë dyvjeçare, tregon se ishte më i dalluari midis nesh, që e zëvendësuan më vonë.

Aktiviteti i doktorit konsiston kryesisht në kontaktet që kishte me burrat e shtetit të Greqisë në atë kohë në udhëtimet e shumta, duke i përballuar vetë shpenzimet e shumta për marrëdhënie publike, me qëllim që çështja Vorioepirote të mbahet e gjallë dhe të përbëjë një rivendikim kombëtar të Greqisë.

Në Cikago, ku ushtronte mjekësinë, ndihmoi shumë njerëz të varfër me vizitat e tij mjekësore falas. Ai solli në Amerikë, duke dhënë garanci personale, me qindra emigrantë ekonomike nga V. Epiri dhe u interesua shumë qe t' i punësojë. Vasilis Fotos ishte ai që filloi paradën greke në qytetin e tij, e cila paradë më vonë u ligjerua dhe festohet çdo vit. Do të shkruaja më shumë për aktivitetin, e doktorit V. Fotu, por nuk kam mundësi për hollesi të shumta.

Amerikës dhe e Kanadasë

Në kongresin e 16-të të Federatës që u bë në Nju Jork nga

dt, 9-14 korrik 1969, për shkak të pjesëmarrjes të shumë përfaqesuesve të shoqatave Epirote nga Kanadaja - të cilët shprehën dëshirën e tyre të inkuadrohen, në Federatë - komiteti i statutit propozon ndërrimin e emrit të Federatës nga POA në POAK (Federata Panepirote e Amerikës dhe e Kanadasë). Propozimi u aprovua unanimisht.

Në këtë kongres doktori V. Fotos mbyll periudhën e tij te katër zgjedhore si kryetar i Federatës Panepirote dhe Kongresi i 16-të (9-14 korrik 1969) zgjedh kryetar Konstadino Filidhi nga Concord, N.H, i cili në Kongresin e 17-të, në korrik të vitit 1971, në Janinë, zgjidhet përsëri për herë të dytë, por gjatë kësaj periudhe, për arsye vdekjeje, e zëvendëson doktori Mihalis Cokas (nënkryetar) nga Filadelfia.

Pas dy periudhave zgjedhore të doktorit V. Fotu (1973-1975 dhe 1975-1976) Federatën e drejton një brez më i ri: Minela Xhelo, Ilia Bexio, Vas. Miqeli dhe Dhim. Cumbano, duke filluar nga Kongresi i 20-të të Federatës Panepirote në Detroit (13-18 korrik 1977). Doktorin V. Foto e zëvendëson Minela Xhelo, i cili në periudhën e tij të parë trevjeçare u preokupua më shumë me degët e Federatës, me vizita personale në selitë e tyre. U referohem aktiviteteve të tij lidhur me çështjen kombëtare, duke cituar fragmente të fjalimeve të tij në Kongresin e vitit 1980 në Uashington, si dhe të vitit 1982 në Filadelfia.

«Duhej që çështjen Vorioepirote ta bënim të njohur në një opinion publik më të gjerë. Pas shumë kontakteve dhe mbledhjeve, me ndihmën e bashkëatdhetarit të shquar, nëpunësit të lartë të Ministrisë së Jashtme të Amerikës, z. Sekallaridhi, i dërguan një telegram delegacionit amerikan, Komitetit të Drejtave të Njeriut të OKB-ës, që ishte mbledhur në Gjenevë. Me anën e këtij telegrami kërkonim nga delegacioni amerikan të denoncojë shkeljet e të drejtave të grekëve të Vorioepirit nga regjimi komunist i Shqipërisë. Përfaqësuesi amerikan e ngriti

këtë problem në konferencën e Kombëve të Bashkuara në Gjenevë. Dhe për herë të parë u preokupua ky organizëm me problemin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të grekëve në Shqipëri. Në të njëjtën kohë u interesua dhe Amnistia Ndërkombëtare».

«Në fund të vitit 1979 Parlamenti Grek formuloi një projektligj me dy nene. Neni i parë bënte fjalë për normalizimin e marrëdhënieve midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe heqjen e ligjit të gjendjes së luftës midis dy vendeve fqinjë. Neni i dytë i referohej preokupimit lidhur me problemin e pasurive të Vorioepirotëve në Greqinë një kohë që poseduesit ishin mbllokuar në Shqipëri. Këtë projektligj e kundërshtuam me telegrame të derguara në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, kërkuam të anulohet çdo bisedim derisa të interesuarit të informohen dhe të shprehin pikëpamjet e tyre. Në këtë telegramë theksonim, se vendimet e nxituara, pa mendimin e të interesuarve në të kaluarën, demtuan rëndë çështjen Vorioepirote».

«Në fund të muajit shkurt 1980 vizitova Greqinë dhe pata takime me Kryepeshkopin Serafim, Kryetarin e KEBA-së me të cilin biseduam që përpykjet tona në Greqi të intensifikohen. E informova, gjithashtu për aktivitetin e Federatës sonë».

«Gjithashtu, po në këtë kohë, të prëmtën më 28 shkurti më priti Presidenti i Republikës z. Caco, i cili u interesua jashtëzakonisht për aktivitetin e Federatës sonë. Ai ishte i informuar mirë për çështjen Vorioepirote. Biseduam lidhur me projektligjin dhe i shpjegova arësyet për të cilat e kundërshtojmë heqjen e këtij ligji. Në këtë takim më shoqeronte Sekretari i KEBA-së z. Camberis. Pasi na degjoi me vëmendje, na kërkoi memorandum dhe deklaroi kategorikisht, se ai si President i Republikës, nuk kishte ndërmend të firmoste një projektligj të tillë».

«Në muajin mars, u takova me Ministrin e Mbrojtjes z. Averof. Edhe në këtë takim merrte pjesë z. Camberis, si edhe

z. Sokratidhis, kryetar i shoqatës Selasforos dhe anëtar i KEBA-së. Bashkëbisedimi vazhdoi një orë e gjysëm dhe e trajtuam hollësisht çështjen Vorioepirote, si edhe tema të tjera lidhur me aktivitetin e Federatës në Amerikë dhe në Kanada. Për sa i përket projektligjit na deklaroi kategorikisht dhe ai se do të reagojë dhe se do të kërkoj takim Karamanli - Rali, që t'ua bëj të qarta pikpamjet e tij, gjë që e kreu».

«Te mërkuren, dt. 5 marsi, erdha në kontakt me zotin Moliviati, i cili qe këshilltar i z. Karamanlis për çështje të jashtme. Pata një bisedë interesante me të. Për sa i përket projektligjit, duke ditur se unë do të shkoja të takoja z. Rali, Ministrin e Jashtëm atëherë, më tha se me të thënat e këtij të fundit, do të mbeteshim të kënaqur».

«Në konsultë me z. Rali ishin të pranishëm zoterinjtë Camberis dhe Sokratidhis. Pasi i vura në dukje ndikimet negative që do të ketë miratimi i projektligjit në moralin e vëllëzërve tanë Vorioepirote, z. Rali u shpreh se e konsidëron të pa arësyeshme dhe se është diçka që s' është bërë ndonjëherë në kronikat diplomatike për të patur marrëdhënie diplomatike me një vend dhe që të ndodhemi njëkohësisht në gjëndje lufte».

«Më në fund na deklaroi se me që ne kemi kundërshtime serioze, ai nuk ka asnjë qëllim të vijë në përplasje me ne dhe se do ta tërheqë projektligjin. Në pasditen, po te asaj dite me telefonoi në hotel z. Averof dhe më pyeti në se jam i kënaqur nga përfundimi. Iu përgjigja pozitivisht dhe e falenderova».

«Të martën, më 11 mars, dhashë një intervistë në hotel «Bretania e Madhe», ku u parfaqësuan pothuajse të gjitha gazetat e Athinës, si edhe kanalet televizore. Në këtë intervistë përmenda aktivitetin e Federatës sonë, kontributin tonë lidhur me çështjet e Helenizmit të Amerikës, përkrahjen dhe ndihmën tonë në të gjitha çështjet kombëtare të Greqisë».

«Pas një muaj, afërsisht, u ndodha përsëri në Athinë, në 19 maj. U takova edhe një herë me z. Averof, në një periudhe

qe z. Zoti Ralis ishte bërë Kryeministër. Në këtë takim me shoqëronte profesori z. Stavru. Biseduam përsëri për problemin e V. Epirit dhe na tha se në deklaratat programatike, të cilat do të bënte qeveria ato ditë ekzistonte një paragraf lidhur me marrëdhëniet e mira që kishim me Shqipërinë. Zoti Averof nuk qe dakort me këtë paragraf dhe na tha se u morrën vesh të theksojnë me forcë interesimin për Minoritetin Grek. Më në fund e hoqën këtë paragraf dhe nuk përmendën asgjë për Shqipërinë ose për marrëdhëniet greko-shqiptare. Bile nuk thanë asnjë fjalë për shtetet e tjera ballkanike».

«Kur takova z. Micotaqi disa ditë me vonë, i cili sapo kishte marrë përsipër Ministrinë e Jashtme, më siguroi dhe ai për ato që më kishte thënë z. Averof dhe se kërkoi të ndryshojë paragrafin lidhur me Shqipërinë, por ai preferoi të mos bëj asgjë, sepse ishte i ri në Ministrinë e Jashtme. «Nuk jam preokupuar me çështjen tuaj dhe mund të bie në ndonje faj dhe të mos mund te përballoj asnjë problem, prandaj nuk përmend asgjë lidhur me marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë».

Në vazhdim të aktivitetëve të tij z. Xhelo i referohet çështjes, për të cilën shumë kuadro të Federatës Panepirote kishin mendime të kundërta.

«Biseduam lidhur me çështjen e nënshtetësisë për Vorioepirotët në Greqi. Me relacionet tona drejtuar Ministrinë të Brendshme z. Strato, Z. Averof, si edhe Kryeministrin z. Rali kërkua t' u jepet e drejta e shtetësisë Vorioepirotëve që banojnë në Greqi dhe deri tani kane nënshtetësi shqiptare».

Në verë të vitit 1983 Federata Panepirote –me kryetarë Ilia Bexio– në bashkëpunim me organizatat vorioepirote të Greqisë, vendos të sjellë çështjen e Vorio Epirit (veçanërisht shkeljen e të drejtave të njeriut) në OKB në Gjenevë.

Në përpjekjet tona shquhet Greqja e mirënjohur dhe dinamike Dr. Erika Dai, e përmendur për aktivitetin e saj,

njohuritë dhe interesimin e saj për të drejtat e popujve të shtypur të botës. Komiteti i të Drejtave të Njeriut të OKB-së ka njerëz me viltete të domosdoshme dhe zgjedhja e tyre bëhet me votim të drejtpërdrejtë të shtetëve anëtarë.

Me iniciativën e të ndjerit Stefan Kallu, me origjinë vorioepirote, u krijua një celulë nga ekspertë të veçantë në Gjenevë, me të cilët përgatitëm apelimin tonë në Komitetin e të Drejtave të Njeriut të OKB-ës. Në këtë periudhë u konsiderua e domosdoshme një mbledhje midis bashkëpunëtorëve tanë në Gjenevë, të KEBA - së dhe të POAK-s. Mbledhja u bë në Zvicër dhe atje përcaktuam bashkërisht një aktivitet të ri për arritjen e qëllimit, dmth. pranimin e apelimit apo të ankesës sonë nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut të OKB-s. Federata Panepirote s' ishte i afirmuar si «Organizatë Qeveritare» dhe nuk kishte të drejtë të merrte pjesë në mbledhjet e Komitetit të të Drejtave të Njeriut në OKB.

Për fat të mirë me kërkesë të Kryetarit Ilia Bexio, i cili qe anëtar i Këshillit të Kryepeshkopatës, Kryepeshkopi i Amerikës Iakovos e autorizoi të përfaqësojë në OKB Kryepeshkopatën e Amerikës e cila qe e afirmuar «Organizatë jo-Qeveritare» (Non Governmental Organization).

Në fillim të gushtit 1983, denoncimi ynë u diskutua në grupin e punës në të cilin kaloi dhe u propozua si çështje në rendin e ditës dhe mandej në nënkomision që përbëhej nga 17 shtete. U miratua nga nënkomisioni dhe më në fund iu dha Komisionit të madh të 43 vëndeve, në shkurt të vitit 1984.

Protestat e Federatës vazhdojnë në çdo drejtim.

Më 25 Janar 1984 Federata me ndihmën e deputetëve amerikanë BENJAMIN ROSENTHAL, GUS YATRON dhe PAUL SARBANES arriti të sjellë çështjen tonë në komisionin e të drejtave të njeriut të Kongresit Amerikan, me praninë e Mitropolitit të paharruar të Dropullit, Pogonit dhe Konicës Sevastianu.

Këto kontakte vazhduan, njëkohësisht, në Senat me ndihmën e mikut personal të kryetarit të Federatës, senatorit fillogrek THOMAS EAGLETON.

Në të njëjtën kohë, me ndihmën e Dr. Dai, POAKA më 11 maj 1984, krijoi «International Federation for the Protection of the rights of Ethnic Religions, Linguistic and other Minorities», një «Organizatë jo - Qeveritare» të afirmuar nga OKB. Me të dy këto organizata Federata dhe kuadrot e saj, kryetarët e mëparshëm Menelao Xhelo, Ilia Bexio, Vas. Miqeli dhe Dh. Cumbano denonconte herë pas here Shqipërinë në OKB para Nënkomisionit për Parandalimin e Diskriminimeve dhe Mbrojtjen e Minoriteteve. Bile në një udhëtim në Gjenevë merrte pjesë dhe Dhim. Papas, anëtar i këshillit të «International Federation».

Nuk do të ishte ekzagjërime të themi se federata solli për herë të parë çështjen e të drejtave të njeriut në OKB. Ghithmonë me ndihmën e Dr. Dai paraqiste dhe denoncimet e njohura për shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut të Minoritetit Grek kundër Shqipërisë. Kështu Shqipëria u shënua në «tabelen e zezë» të vëndeve që shkelin sistematikisht të drejtat e njeriut të minoriteteve.

POAK emërtohet POAKA

Në Kongresin e 23-të Panepirot të Nju Jorkut (27-30 qershor 1984) mori pjesë dhe Kryetari i Federatës Panepirote të Australisë Petros Petranis, i cili u komunikoi kongresistëve dëshirën e Epirotëve të Australisë, të inkuadrohen në POAK. Kryetari i Federatës deklaroi se ekzistonte mendimi që të bashkohen POAK dhe Federata e Australisë. Epirotët e Australisë adaptuan idenë dhe propozimin do ta komunikoj z. Petranis personalisht, i cili ndodhej në atë kongres. Zoti Petranis lexon procesverbalin e vendimit të Plenumit të Federatesës të Australisë, vendim i cili aprovohet dhe duartokritet.

Propozohet që Federata Panepirote e Amerikës dhe e Kanadasë të zgjerohet e të zyhillohet në Australi. Propozimi pranohet unanimitisht. Kështu POAK u emërtua POAKA (Federata Panepirote e Amerikës, Kanadasë dhe Australisë). Në po atë kongres kryetari i POAKA-s propozoi shfuqëzimin e titullit të vjetëruar dhe zëvendësimin e tij me titullin «Konsull», titull që u jepej kuadrove të larta dhe anëtarëve të këshillave administrative, ku dhe u miratua unanimitisht nga Plenumi.

Heqja e ligjit të luftës

Në atë periudhë, në qershor 1984, filluam bisedimet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë për heqjen e ligjit të luftës midis dy vendeve. Lidhur me këtë temë bisedojnë Ministri i Punëve të Jashtme atëherë (President i Republikës së Greqisë) Karollos Papulias dhe zëvendës Ministri i Jashtëm i Shqipërisë M. Kapllani.

Në një telegram personal që Ilia Bexio i dërgon Ministrin, bashkëatdhetarit tonë, kërkon të informohet me ç' kushte bëhet heqja e gjëndjes së luftës. Përgjigja ishte se nuk biseduam lidhur me kushte me z. Kapllani dhe se interesat e Greqisë nuk preken. «Po të doni, vazhdon z. Papulias, të mësoni më shumë, ejani në Athinë të bisedojmë».

Federata konsideroi se nuk mund të ruaj privilegjin e informimit për çështjen kombëtare, por duhej në të njëjtën kohë të informohen dhe organizatat e Greqisë dhe veçanërisht Komiteti Qëndror i Luftës Vorioepirote. Me aprovimin e z. Papulia për një mbledhje panepirote në Ministrinë e Jashtme, kryetari i POAK-ës kishte një bisedë telefonike me Kryepeshkopin e Athinës dhe ghithë Greqisë Serafim, kryetarin e KEBA-së të jetë në krye të delegacionit Panepirot në takimin me Ministrin Karollo Papulia.

Më 30 gusht 1984 u bë takimi në Ministrinë e Punëve të Jashtme me pjesëmarrjen e disa kuadrove të Federatës

Panepirote, Bexio, Xhelo, Stavro, Qirani, të KEBA-së me praninë personale të kryetarit të saj Kryepeshkopit Serafim, sekretarit Jani Camberi, kryetarit të shoqatës V. Epirote Kosta Jiga dhe përfaqësuesit të organizatave vorioepirote të Greqisë Stefano Kallo nga Gjeneva.

Në këtë takim i u tha qartë z. Papulias se organizatat epirote të Greqisë dhe të Amerikës kundërshtojnë heqjen e ligjit të «gjendjes së luftës» me Shqipërinë, tezat e patundura të organizatave epirote detyruan qeverinë (sipas mendimit tonë) të vendos temën për një vit «në raft ».

Një vit më vonë, në verë të vitit 1985 rikthehet përsëri tema dhe atëherë kryetari dhe sekretari i përgjithshëm i Federatës Ilias Bexios dhe Vas. Miquelis, u detyruan të vizitojnë përsëri Athinën ku kishin takim me Presidentin e Republikës z. Kristo Sarxetaqi, si dhe me Kryeministrin Andrea Papandreu në shtëpinë e tij ku i paraqiten çështjen e heqjes së ligjit të gjëndjes së luftës dhe se kjo heqje përbën «pllakë varri» në V. Epir. Deklarata e Kryeministrit në federatë ishte se «Kryeministri i Greqisë nuk është gati për asnjë veprim përfundimtar dhe se para se të merret një vendim i çfarëdoshëm do të informohen Vorioepirotët që janë drejtpërdrejt të interesuar». Pasdite delegacioni i Federatës u takua me Ministrin e Punëve të Jashtme z. Papulias, i cili u deklaroi edhe një herë se vendimi i qeverisë greke është i përvokueshëm dhe se heqja e «gjendjes së luftës» do të bëhet patjetër. Atëherë delegacioni i Federatës vendosi t' i thotë «sekretin» se në një takim të njëjtën ditë me Kryeministrin i siguroi se qeveria e tij «nuk ishte gati për cilindo veprim përfundimtar», kurse z. Papulias deklaroi se tema konsiderohet e mbaruar, sepse «në parandalim të kryetarit çdo autoritet pushon». Kështu shfuqizimi i ligjit u anulua për një vit akoma. Në muajin prill të vitit 1986 Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm deklarojnë përsëri zyrtarisht se kanë marrë vendim të formës së prerë

të shfuqizojnë ligjin e « gjendjes së luftës» në muajin maj.

Përsëri alarm dhe udhëtim «vetëtim» (me 2 maj 1986) kryetari dhe arkëtari i Federatës Ilias Bexios dhe Vas. Miqelis në Athinë. Kësaj here z. Papulias, megjithëse tregon një pritje më të ngrohtë dhe miqësor ndaj kuadrove të Federatës, megjithatë përgjigja ishte negative dhe dekurajuese dhe nuk linte afat kohe për ndonjë ndryshim ose qoftë anulim të vendimit qeveritar. Deklarata përfundimtare e Ministrit: «Një ditë do të më kërkoni ndjesë për kundërdhëniet që keni dhe për atë që më akuzoni».

Në një vizitë të shkurtër në sthëpinë e Kryeministrit Andrea Papandreu në Kastri në mbrëmje të së njëjtës dite, kryetari dhe arkëtari i Federatës Panepirote nuk mbetën të kënaqur nga të thenat e tij: «Qeveria do te bëj ç' është e mundur për mirëqënien e Minoritetit Grek në Shqipëri». Kurse në takimin e tyre të mëparshëm (gusht 1985) Kryeministri kishte premtuar se qeveria nuk do të bëjë asnjë veprim lidhur me gjendjen e luftës, ne qoftë se nuk do të informohen më parë të interesuarit e drejtpërdrejtë.

Mohimi i Federatës Panepirote si edhe të organizatave vorioepirote të Greqisë në shfuqizimin e ligjit të gjendjes së luftës me Shqipërinë dukej diçka e pallogjikshme për ata që nuk e njihnin temën, megjithatë organizatat tona në thelb ishin të kunderta vetem ne shfuqizimin e ligjit pa kushte. Ne kërkonim nenshkrimin e traktatit të paqes midis të dy vendeve dhe para së gjithash vendosjen e plotë të të drejtave të njeriut të popullit Vorioepirot në Shqipëri.

Pak ditë më vonë, më 15 maj 1986, u bë në hotel «Karavel», mbledhje e madhe me pjesëmarrjen e të gjitha shoqatave epirote të Greqisë dhe të POAKA-sku u formulua një rezolutë, e cila i u dërgua qeverisë.

Lufta jonë u përkrah shume nga i paharuari Kryepeshkopi i Amerikës Iakovos. Ai i dërgoi z. Papulias këtë telegram:

“Bota Epirote e Amerikës dhe e Kanadasë dhe gjithë Homogjenet e Amerikës, konsiderojnë si tradhëti i të drejtave etnike heqjen e gjendjes së luftës ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë siç ajo duket. Dëshira e të gjithëve është të bëhet traktat paqeje me kushte me qellim që të mbrohen të drejtat e njeriut të Grekëve Vorioepirote, të siguruara nëpërmjet traktateve të vjetra ndërkombëtare. Në qoftë se nuk do të respektohen të drejtat e Vorioepirotëve, të mbahet gjëndja e luftës deri në realizimin e të drejtave të tyre të drejta”.

* * *

Në shkurt të vitit 1987 me rastin e festës të autonomisë së V. Epirit dhe të çlirimit të Janinës, në një udhëtim privat në Australi të kryetarit të POAKA-s Vas. Miqeli, të ish kryetarit Ilia Bexio, të nënkryetarit Dhim. Cumbanu (kandidat për kryetar) dhe të bashkëshortëve të tyre, vizituan edhe sillogjet Epirote si dhe Federatën Panepirote të Australisë, e cila tashmë është bërë anëtarë e POAKA-s. Vizita filloi nga qyteti i Sidneit, ku i gjithë Këshilli Drejtues të sillogut Epirot me kryetar Kosta Jotaqi priten vizitorët në aerodrom. Pasoj në të njëjtën darkë pritje dhe darkë për nder të tyre me pjesëmarrjen e shumë Epirotëve të qytetit. Ditën tjetër u bë mbledhje e përgjithshme e të gjithë anëtarëve të sillogut, ku kryetari i POAKA-s si dhe ata që e shoqëronin përshëndetën mbledhjen dhe komentuan veprimtarinë e POAKA-s për çështjen Vorioepirote.

Në vazhdim të udhetimit të tyre vizituan seksionet Epirote si dhe Federatën e Melburnit ku përsëri u pritën shumë ngrohtë nga bashkëkombasit e tyre të qytetit me në krye Sotir Papazisi dhe Petro Petrani-kryetar dhe sekretar i pergj. i Federatës Panepirote.

Përfaqësuesit e POAKA-s me rastin e dy përvjetorëve historike, 17 dhe 21 shkurtit, morrën pjesë në dhoksologjinë e zakonshme, në fund të së cilës u mbajtë një kumtesë nga ish

kryetari Ilia Bexio me temë “Heqja e gjendjes së luftës dhe marrëdhëniet me Shqipërinë”. Në dhoksologji si dhe në mbajtjen e kumtesës ishin të pranishëm Ambasadori i Greqisë z. Xhaferi dhe Konsulli I Përgjithshëm z. Manollopullos. Në të njëjtën darkë Shoqata Panepirote e Melburnit shtroi një darkë për nder të tyre në ndërtesën pronë të organizatës.

* * *

Më 28 gusht 1987, me njoftimin përsëri të Qeverisë përfundimisht do të bëhet heqja e gjendjes së luftës, organizatat Epirote në Greqi organizuan një tubim shumë të madh panhelenik në hyrje të Korpusit qëndror të Universitetit të Athinës, ku morrën pjesë me mijëra veta, me në krye Mitropolitin e Konicës Sevastiano. POAKA u përfaqësua nga kryetari Vas. Miqeli, sekretarin Foti Galici, Ilia Bexio, Dhim. Cumbano, Menelao Xhelo, Thoma Karathano, Nikolao Kaçi dhe Kosta Veca.

Fjalimi i Vasili Mikelit para mijëra vetave u shoqërua me duartrokitje të vazhdueshme, sa që Mitropoliti i Dropullit me shaka I tha «Më latë në hije, z. Mikeli». Në konferencën e shtypit që pasoi në të njëjtën darkë për gazetaret dhe korrespondentët e gazetave greke, kryetari i organizatës Panepirote deklaroi se «që nga sot organizata jonë gjendet në gjendje lufte me Qeverinë greke».

Në fund të vitit 1987 International Federation u shkëput nga organizata Panepirote dhe u pavarësua, kështu që organizata Panepirote u detyrua ti drejtohet “MINORITY RIGHTS GROUP” në Londër në mënyrë që të vazhdojë veprimtarinë e saj në OKB në bashkëpunim dhe lidhje kurdoherë me Kryepeshkopatën e Amerikës.

U referohem materialeve të Kongresit të 25-të Panepirot, ku kryetari I atëhershëm Vasilis Mikelis përmend arritjet kur që në drejtimin e Organizatës:

«Në janar të vitit 1988 filluam bisedimet me organizatën prestigjioze MINORITY RIGHTS GROUP, e cila e ka selinë në Londër. Kërkesa që parashtruar në këtë organizatë ishte që të na autorizonte që duke përfaqësuar këtë organizatë, të degjohet përsëri zëri ynë në Komisionin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Mbas kontakteve të para me këtë organizatë, ne drejtuesit e së cilës çështja Vorioepirote që e njohur dhe pati një përballje të favorshme në sajë të përpjekjeve të vazhdueshme të mikeshës sonë të madhe dhe nënës së V. Epirit, Dr. Erika Dai, me vizitën tonë në Londër arritëm të marrim këtë autorizim nga MINORITY RIGHTS GROUP, që ta përfaqësonim në Mbledhjen e 44-të të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, në Gjenevë.

Në këtë pikë ndjehem i detyruar të përmend dhe të lavdëroj veprën e madhe shoqërore të kësaj mikeshës sonë në Komisionin e të Drejtave të Njeriut, për zvogëlimin e dhimbjes tek të gjithë popujt e robëruar të botës, pa përjashtuar edhe Vorioepirotëve. Një Greke e denje, që vertëton në praktikë se kultura greke, identiteti grek janë të gërshetuara me frymën humane. I takon asaj kategorie të pionierëve të panjohur të paqes ndërkombëtare, sepse respektimi i të Drejtave të Njeriut është kusht baze për Paqen Ndërkombëtare, sipas Aktit Final të Helsinkit.

Problemi më i rëndësishëm që na shqetësoi shumë ishte se çfarë kërkesë do të paraqisnim në Komisionin e të Drejtave të Njeriut. Vendosëm të kërkojmë atë që kishim dhe na e kishin mohuar, RIVENDOSJEN E AUTONOMISË TEK VORIO EPIRI».

Në po atë javë Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse të Anglisë Thiatiron z. Methodhios kishte thirrur në Londër kongres ndërkombëtar të Grekëve të Diasporës në të cilin ishte ftuar edhe Federata Panepirote. Në udhëtimin privat, Epirotet e Amerikës I përfaqësoi çifti Vas. Miqeli dhe Ilias Bexios. Dhe vazhdon Mikeli në raportin e tij:

“Kongresin e grave Greke të Diasporës nderuan me pjesmartjen e tyre delegacione organizatash nga e gjithë bota, udhëheqës politike dhe fetare, përfaqësues qeverish, gazetarë dhe shumë njerëz, ndërmjet të cilëve edhe shumë Grekë zotërues anijesh.

Më shumë se 1.000 gra Greke kishin ardhur nga çdo cep të Tokës, e vetmja mungesë ishte Gruaja skllave Vorioepirote. Në emër të saj përshëndeti gratë Greke të Diasporës zonja Iulia Bexiu, e cila përhapri drithma emocionuese kur përmendi nënën Vorioepirote që mungonte”.

Kur mbaroi fjalën e saj, të gjithë të pranishmit duartrokisnin pa pushim të çuar në këmbë. Gazetat e Athinës shkruan komente shumë lavderuese për nënën Vorioepirote. Madje kritikuan përfaqësuesin e qeverisë greke në kongres se ishte i vetmi që nuk duartrokiti.

Ditën tjetër u dha darka zyrtare, ku kryetari Vasilis Miqelis u ul në tavolinën e autoritetëve dhe u dha fjala. Kur mbaroi fjalën e tij, entuziazmi i të pranishmeve ishte kaq i madh, sa që nuk pushonin së duartrokitur në shënjë solidariteti për luftën që zhvillojnë Epirotet e Amerikës.

* * *

Duke u rikthyer tek çështja e autonomisë Vasilis Miqelis vazhdon në këtë mënyrë raportin e tij:

“Eshtë e vërtetë që mbas një pritjeje tremujore dhe me ndihmën kurdoherë të çmuar të Dr. Erika Dai, e cila arriti të na siguronte preferimin e duhur, u përfshiva në listën e folesve të 4 marsit 1988. Para komisionit ndërkombëtar në Gjenevë dhe pasi denoncova edhe një herë tjetër shkeljen sistematike dhe brutale të të drejtave të njeriut të vëllezërve tanë Greke të Vorio Epirit dhe zhdukjen e elementit Greke të krishterë nga rregjimi I turpshëm I shoqërisë ndërkombëtare, parashtruaam kërkesën tonë:

«RIVENDOSJE TE AUTONOMISE TEK VORIO EPIRI»

«Nje kërkesë rrufe-kështu e karakterizuan korrespondentët e huaj-sepse ndryshonte rrënjësisht nga kërkesat tona të shkuara, por edhe nga kërkesat e dhjetëra folësve ne atë asamble. E reja e kërkesës shkaktoi interes të madh tek përfaqësuesit e shtet[ve, të cilët mbas përfundimit të fjalimit tim, kërkonin të mesonim më shumë hollësi për problemin tonë kombëtar. Bile shumë oratorë më kërkuan që të përfshijë në fjalën time edhe problemin e tyre. Pyeta veten, pse gjithë këto vite nuk mund të angazhoheshim edhe në këtë drejtim

Të dashur bashkatdhetarë, dita e 4 marsit 1988, me krenari ju them se përbën piknisje në rrugën e Organizatës Panepirote, megjithë ngjarjen diziluzionuese që pasoi atë sukses tonin. Një ngjarje që na shkaktoi indinjatë dhe hidherim, ishte kjo: Komisioni i të Drejtave të Njeriut është i detyruar që vendimet që merr ti dërgojë për votim në Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të OKB-së. Më 27 maj 1988, vendimi i Komisionit të të Drejtave të Njeriut erdhi për diskutim në asamblenë e ECOSOC dhe ndërsa ëe stadin e parë, në Komisionin Funkcional, u votua me 13 vota pro dhe 10 kundër, gjatë diskutimit në ECOSOC, kur shtetet u thirrën me emër të votonin, morri 11 vota pro, 13 kundër dhe 29 abstenime. Ndërmjet shtetëve që deklaruan abstenim ishte edhe Greqia».

* * *

Në Kongresin e 25-të të Federatës Panepirote 22-25 qershor 1988, kryetar zgjidhet Dhimitrios Cumbanos.

Në këtë fazë bashkëpunimi i POAKA-s me Qeverinë Greke ishte ndërprerë mbas deklarimit të kryeministrit Andrea Papandreu se do të ndërmarrë heqjen e gjëndjes së luftës me Shqipërinë. Siç shkruan në raportin e tij kryetari Dhimitris Cumbanos: «*trajtimi i çështjes kombëtare ndaloj nga ana politike tek gjërat e kryera të një qeverie qendrimi i së cilës*

në pushtet ishte i dyshimtë për shkak të zgjedhjeve të ardhshme dhe vazhdon: Me të dhënat e tanishme mendova se OKBja ishte e vetmja fushë luftimi që POAKA, në asnjë mënyrë nuk duhej ta linte, sepse vendimet e ardhshme të saj do të ishin vendimtare për rrugën e çështjes Vorioepirote».

Ne gusht të vitit 1988, delegacioni i POAKA-s (Cumbanos-Bexios-Mikelis) me ndërhyrje të re në OKB risolli çështjen e AUTONOMISE, duke denoncuar njëkohësisht Shqipërinë për shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut të Vorioepirotëve. Më 18 gusht zonja Erika Dai, si anëtare e Nënkomisionit të Ekspertëve, analizoi çështjen e Autonomisë dhe rivendosjen e saj.

Kështu, më 1 shtator, Nënkomisioni për Parandalimin e Diskriminimeve dhe Mbrojtjen e Minoritetëve të OKB-së, me vendimin e tij numër 15/1988, njohu zyrtarisht shkeljen brutale të të drejtave të njeriut nga qeveria shqiptare.

Në shkurt të vitit 1990, me një akoma ndërhyrje të Organizatës Panepirote në Komisionin e të Drejtave të Njeriut, i bëmë thirrje Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, që të mos pranojë ftesën e qeverisë shqiptare dhe të anulojë vizitën e tij në Shqipëri, deri sa të vendosen në mënyrë të plotë të drejtat e njeriut dhe liritë baze tek ky vend.

Pavarësisht nga përpjekjet tona, Komisioni i të Drejtave të Njeriut ra dakort për vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm, por në raportin e saj theksoi se gjatë vizitës së tij atje, të kërkojë nga Shqiptarët një program konkret për sa i përket të drejtave të njeriut. Në një komunikim që pata me zyrën e z. De Kuejar morrëm garancinë se Sekretari I Përgjithshëm është shumë i informuar për gjëndjen ekzistuese në Shqipëri.

Në dhjetor të vitit 1989, deklaratat e ministrit të atëhershme të punëve të jashtme, z. Andoni Samaras ngritën furtunë në ujërat e ndenjura të jetës politike greke, kur urroi që vëllezerit tanë Vorioepirote të festojnë në liri Krishtlindjet, si populli

rumun. Një deklaratë që çoi partitë politike të Greqisë në ballafaqime të pafundshme. Nga e gjithë kjo procedurë, konkludoi edhe diçka mjaft e dobishme për çështjen tonë. Çështja Vorioepirote u bë epiqendra e interesit pangrek.

Përballë këtij shansi, këshilli drejtues i POAKA-s vendosi të dërgojë në Athinë një grup, me qëllim kryesor që të takojë zotin Samara dhe udhëheqësin e Demokracisë së Re dhe kryeministër z. Micotaqis. Kryetarin Dhim. Cumbano shoqëruan në Athinë ish kryetarët Ilias Bexios dhe Vasilis Miqelis.

Të ënjten, më 4 janar 1990, u realizua takimi i përcaktuar që më parë i grupit zyrtar të POAKA-s me ministrin e Jashtëm z. Zamara. Gjatë këtij takimi u konstatua përputhje e plotë e mendimeve për sa i përket promodhimit të çështjes Vorioepirote dhe marrëm premtimin për bashkëpunim.

Në Athinë kishte ardhur edhe një grup Vorioepirotësh me emrin “VEPRIMI VORIOEPIROT”, të cilët u përpiqën të realizojnë takime me udhëheqësit politikë të Greqisë, që vepronin në mënyrë plotësisht të pavarur nga POAKA, dhe që të gjithë ishin anëtarë sillogjesh, të inkuadruar tek Federata Panepirote.

Të martën më 9 janar 1990, në mëngjes, u realizua diskutim shumorësh në zyrat e SFEVA, nën kujdesin e Mitropolitit të Dropullit, Pogonit dhe Konicës Sevastianos. Më së fundi, mbas një diskutimi të stuhishëm dhe në një atmosferë të tentosur, u ra dakort që takimi me z. Micotaqis të bëhet me pjesmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të Epirotëve të Amerikës dhe të Greqisë, me në krye Mitropolitin Sevastiano.

Zotin Micotaqis përshëndetën Mitropoliti Sevastianos, kryetari i POAKA-s Dhim. Cumbanos dhe kryetari i Federatës Panepirote Dhimitris Papas. Mbas mbarimit të bisedës, z. Micotaqis thirri në sallën e pritjes gazetaret dhe grupet e kanaleve televizive dhe deklaroi se partia e tij ngre në mënyrë zyrtare problemin e të Drejtave të Njeriut për Vorioepirotet

dhe i bëri ftesë qeverisë që të kërkojë nga Shqipëria respektimin e tyre të plotë.

Mbas takimit që patëm me z. Micotaqis, vetëm delegacioni I POAKA-s, Cumbanos, Bexios, Mikelis dhe Kolos, u takua nga Presidenti i Republikës z. Kristos Sarxetaqis. Në bisedën që zgjati një orë e njëzet minuta, z. Sarxetaqis përsëriti edhe një herë, se çështja e Vorio Epirit dhe e Grekëve të robëruar është diëka që do ta shqetesojë kurdoherë, deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Të mërkurën, më 10 janar 1990, delegacioni ynë dha konferencë shtypi në hotelin Hilton. Kjo konferencë shtypi u dha të njëjtën ditë në emisionet e lajmeve të ERT dhe të kanaleve të tjera publike dhe private, si dhe në të gjitha gazetat ditën e nesërme.

Të enjtën, më 11 janar 1990, ishte programuar nga Sinodi i Shenjtë, me bekimet e Kryepeshkopit Serafim, miting në hyrje të korpusit qendror të Univertitetit të Athinës dhe marshim përpara Parlamentit dhe Ambasadës Shqiptare.

Mitingu arriti një sukses të madh dhe në të e morrën fjalën me rradhë kryetari I POAKA-s Dhim. Cumbanos, kryetari i Veprimit Vorioepirot Dhim. Papas, kryetari I SFEVA-s, kryetari i sillogut Sellasforos dhe u mbyll me fjalimin e zjarhtë të Sevastianoit, fjalim i cili theu zemrat e të gjithë të pranishmeve. Vazhdoi marshimi para Parlamentit dhe Ambasadës Shqiptare, në derën e së cilës u ngjit një peticion.

Po atë natë kryetari Dhim. Cumbanos dhe Ilias Bexios u takuan me kryetarin e PASOK-ut Andreas Papandreu (atëherë nuk ishte kryeministër), tek i cili parashtruan ankesat që kishin Epirotët e Diasporës në lidhje me trajtimin e çështjes Kombëtare Vorioepirote nga qeveritë e tij, dhe sidomos heqjen e gjëndjes së luftës, me një vendim Ministror të jashtligjshëm dhe antikushtetues.

Nga ana e tij Papandreu përsëriti zotimet e tij të zakonshme

se do të bëjë ç' është e mundur për mbrojtjen e të drejtave të Grekëve te Vorio Epirit.

* * *

Më 28-30 qershor u mbajtë në Nju Jork Kongresi i 26-të Panepirot, ku kryetar u zgjodhë Simos Dhimas. Një vit më vonë dha doreheqje, dhe për këtë arsye u mbajt në mënyrë të jashtzakonshme Kongresi i 27-të në Cikago (29 qershor deri 2 korrik 1991), ku zgjidhet për herë të fundit doktori Vasilis Fotos, I cili udhëhoqi edhe nje dyvjecar tjetër.

Në vazhdim të veprimtarive të POAKA-s në Kongresin Amerikan, në Senat dhe në Organizatën e Kombëve të Bashkuara në Gjenevë, në shtator të vitit 1991, Kryepeshkopata e Amerikës u përfaqësua nga Ilia Bexio (anëtar i Këshillit të Kryepeshkopatës) në Konferencën e OSBE-së, e cila për herë të parë mbas rrënies së rregjimit komunist, u mbajtë në Moskë.

I gjithë delegacioni grek në OKB, znj. Erika Dai dhe ish kryetari i POAKA-s, u bënë një grup, veprimet e së cilës kordinonte përfaqësuesi i përhershëm i Greqisë në Gjenevë z. Janis Bukauris.

Në çdo pjesmarrje të tyre në komisionin e të drejtave të njeriut në OKB, përfaqësuesit e POAKA-s nën udheheqjen e znj. Dai, nuk pushuan kurrë të informojnë shtetet anëtarë të OKB-së edhe problemin e Qipros edhe shkeljen e të drejtave të njeriut të popullit të saj nga Atilla.

Por nuk do desha të mbyll kapitullin “Fotos” pa përmendur se kaluan shumë vite që të njohim të gjithë ne Epirotet e Amerikës se doktori V. Fotos la pas një epokë, sepse përbeu një përjashtim në veprimtarinë dhe në luftën Kombëtare të Organizatës Panepirote. Si tregues respekti dhe njohje të shërbimit të tij shumëvjecar, Kongresi i 33-të i Floridas më 2003 e shpalli kryetar nderi të organizatës.

Në shenjë mirënjohjeje ndaj kontributit të Dr. Erika Dai

në Organizatën Panepirote dhe përpjekjet e saj, në po këtë kongres Organizata e shpalli anëtar nderi të Këshillit Drejtues.

* * *

Në qershor të vitit 1993 në Torondo të Kanadasë u zgjodh kryetar Nikos Gaxojanis (Nick Gage) nga Juster i Masahusetit.

Në Vorio Epir atë kohë, pavarësisht nga fakti se Shqipëria u çlirua nga diktati i Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë, Grekët terrorizoheshin nga forcat qeveritare të sigurisë dhe hiqen nga vendet publike në ushtri, gjykata dhe administrata publike. Si rrjedhojë i kësaj përpjekjeje dhe i diskriminimeve detyroheshin të lënë shtëpitë e tyre duke kërkuar strehim në Greqi. Në Shqipëri në pranverë të vitit 1992 u zgjodh për herë të parë qeveri demokratike me kryetar Sali Berishën. Pavarësisht nga kjo shtypja ndaj Minoritetit Grek i cili qendroi në Shqipëri nuk u ndalua. Sali Berisha ktheu vëmendjen e tij në Amerikë duke u përpjekur të siguronte mbështetjen e State Department ndaj vendit të tij.

Në një udhëtim të tij në Amerikë në qershor të vitit 1992, organizata “APPEAL OF CONCIENCE FOUNDATION” organizoi në Nju Jork drekë për nder të tij dhe ftoi të gjithë udheheqjet e kishave, ndërmjet të cilave edhe Kryepeshkopatën e Amerikës. Kryepeshkopi i atëhershëm Jakovos, i ngarkoi përfaqësimin e Kryepeshkopatës Edes. Milto Efthimiu dhe ish kryetarin e POAKA-s Ilia Bexio (me cilësinë e anëtarit të Këshillit të Kryepeshkopatës). Në fjalën e tij mbas përfundimit të drekës Berisha ngriti çështjen e autonomisë së Kosovës, gjë që i dha rastin z. Ilia Bexios ti përmendi të drejtën e Vorioepiroteve për autonomi të atdheut të tyre. Përgjigja e tij ishte se në Shqipëri ekzistojnë vetëm 50.000 Grek dhe rrjedhimisht nuk lind çështje autonomie. U pasua debat ndërmjet tyre, dhe nga kjo Berisha deklaroi se do të bëjë “rregjistrim” të popullsisë në mënyrë që të përcaktohet numri i saktë i Minoritetit Grek.

Në vazhdim të udhëtimit të tij në Amerikë Berisha do të shkonte në Boston i ftuar nga departamenti juridik i BOSTON UNIVERSITY ku do ti jepej Titulli i Didakturës Doctoratë, por korporatat Epirote të Bostonit më në krye Niko Gaxojanis, anuluan këtë ceremoni me akuzën se shkel të drejtat e njeriut të Minoritetit Grek në vendin e tij.

Pjesa më e keqe e veprimtarisë të Sali Berishës kundër minoritetit grek ishte në vitin 1994, kur policia e fshehtë u fut dhe kontrolloi rreth 700 shtëpi Vorioepirotësh, shkatërroi zyrat e organizatës politike OMONIA dhe arrestoi pesë kuadro drejtuese të saj me akuzën e tradhëtisë.

Kryetari i atëhershëm i POAKA-s Nikos Gaxojanis, në menyre që të lironte të pesë të arrestuarit të OMONIAS, ndër morri një kampanjë për njohjen e opinionit ndërkombëtar me artikuj në shtypin Amerikan dhe Evropian, duke ushtruar kritikë në qeverinë e Sali Berishës, dhe kështu shkaktoi interesin e shumë organizatave humanitare, që të dërgonin vëzhgues në gjyqin e pesë drejtuesve të OMONIAS. Në gjyq (15 gusht 1994) shumë interes treguan edhe mjaftë kuadro organizatash Epirote të Greqisë. Vullnetarisht morri përsipër mbrojtjen e pesë të arrestuarve avokati Dhimitris Kafkas nga Bostoni, i cili bëri një punë të shkëlqyer, meqenë se ishte i ri në moshë. Më së fundi të pesë Vorioepirotët u lanë të lirë mbas nëntë muajsh burgimi.

Vëzhguesit e huaj në gjyqin e të pestëve të OMONIAS me raportet e tyre në shtypin nderkombëtar krijuan një klimë negative në Qeverinë Amerikane në Uashington për qeverinë e Berishës dhe atij personalisht. Me takimet që pati kryetari i Organizatës Panepirote në Shtëpinë e Bardhë u ndërpre ndihma ekonomike e Amerikës dhe u detyrua Sali Berisha të bëjë zgjedhje në Shqipëri, në të cilat humbi qeverinë. Në mesazhin e tij drejtuar popullit shqiptar Berisha deklaroi se mossuksesi i tij në zgjedhjet kishte të bënte me Organizatën

Panepirote të Amerikës dhe veçanërisht me kryetarin e saj Nick Gage (Gaxojanis). Qeveria e re e Shqipërisë vendosi të ndryshojë politikën ndaj Minoritetit Grek, bile duke emëruar shumë Grek në mjaftë vende qeveritare.

Organizata Panepirote, nëpërmjet fondit të bursave dhe fondit të luftës kombëtare dha gjatë periudhës ku kryesonte Gaxojanis 575.000 dollare për bursa, meremetime kishash, rrugë dhe ndihmë familjeve të varfëra. Më në fund vetë Berisha në opozitë ndryshoi sjellje ndaj minoritetit Grek dhe kështu, kur erdhi prapë në pushtet caktoi mjaftë ministra Vorioepirote në qeverinë e tij. Por këtë ndihmë të Organizatës Panepirote nuk e çmuan udhëheqësit e minoritetit dhe si rrjedhojë është që aktualisht mbajnë njëfare distancë nga organizatat Epirote të Greqisë dhe sidomos Amerikës.

Në Kongresin e 30-të Panepirot, 19-23 shkurt 1997 në Florida, kryetar i POAKA-s u zgjodh Kristos Qirkos, i cili qendroi për dy dyvjecare deri më 7 korrik 2001. Kristos Qirkos u mundua me shumë mundim të grumbullojë disa para nga znj Sofia Kallu, Organizatën Panepirote, fondi i luftës kombëtare si dhe shuma të konsiderueshme të vetë atij, të cilat i dha për ndërtim rruge në Vorio Epir për lidhjen e tetë fshatrave të Pogonit të Siperme të Vorio Epirit. Po kështu, shoqëroi në Vorio Epir z. Andrea Athens, kryetar të përgjithshëm të SAE, i cili dha mjaftë para për krijimin e një klinike në fshatin Jergucat.

Në korrik të vitit 2001 në Nju Jork rizgjidhet kryetar Ilias Bexios, në kryesinë e tij POAKA i rikthehet emrit të saj të parë POA, Federata Panepirote e Amerikës, në mënyrë që Federatat e Kanadasë dhe të Australisë, tani të pavarura, të futen në Organizatën e re Ndërkombëtare të Epirotëve të Diasporës “WORLD COUNCIL OF EPIROTES ABROAD”, në krijimin e së cilës pa tjetër që kontribuoi Federata Panepirote e Amerikës.

Në shkurt të vitit 2003 në Florida kryetar u zgjodh Panajotis

Silis, i cili bashkë me kuadro të tjerë të POA-s organizuan në Janinë një mbledhje të madhe me pjesmarrjen si të botës politike, ashtu edhe të pushtetit vendor me temë zhvillimin e Epirit.

Së fundi, në mars të vitit 2005, mbas tre kongrese të sukseshme në Florida nën udhëheqjen e Mihalit Servos, Epirotet e zgjodhën kryetar të POA-s. Anëtarë të rinj futën në Këshillin e Mihalit Servos dhe veprimtari të reja-veçanërisht për historinë dhe ekspozimin e Epirit të lirë. Me dhurime Epirotësh dhe miqsh nga Amerika vendosi në sheshin qendror të Janinës statujën e Olimpiadës-nënës së Aleksandrit të Madh, nga ku vete sheshi qendror morri edhe emrin e Olimpisë.

Me kërkesë të POA-s drejtuar Ministrisë kompetente, aeroporti i Janinës morri emrin “Mbreti Pirros” ku vendosi edhe statujën e Mbretit Pirro, dhuratë e vetë Mihalit Servos. Po kështu statuja e Mbretit Pirro u vendos edhe në sheshin qendror të Janinës, dhurate e vetë z. Servos. Edhe akoma një statujë të “Nënës Pogonase” vendosi në Pogonianinë, dhuratë e të paharruarit Kristos Plaçikas. Nuk ndalet me statujat Mihalit Servos. Në përpjekjen e tij të lë diçka edhe në fshatin e tij për nder të vozapunuesve të Sopikut në Vorio Epir, ngriti një vozë të madhe prej bronxi, dhuratë e Anastasia Gjinopullu.

Gjatë periudhës që udhëheq POA-n kontribuoi energjikisht në krijimin të Këshillit Botëror të Epirotëve të Diasporës dhe së fundi ndihmon në botimin e librit të profesorit të sociologjisë z. Theofani Malqidhi të Universitetit të Thrakës “Kthim në Historinë e Vorio Epirit dhe të Minoritetit Grek”.

Do të ishte mangësi e madhe të mbyll veprimtarinë e deritanishme historike të Federatës Panepirote të Amerikës pa përmendur kontributin e çmuar patriotik edhe të shumë kuadrove të vyer, që i shërbyen organizatës në pozita të ndryshme të këshillave respektive.

Filloj nga ata dhuruesit Epirotë që ndruan jetë Fotio Qirici,

Vangjeli Kocidha, Spiro Cigo dhe pa tjetër Mihali Anagnostopullo nga Konica, nga pasuria e të cilit Federata Panepirote merr çdo vit shuma të konsiderueshme për programin e bursave të organizatës sonë. Kryetarët e Federatës Panepirote që ndruan jetë janë përfshirë në listën bashkëngjitur. Kuadro të tjerë që ndruan jetë janë: nga Nju Jorku Andreas Mellos, Nik. Kasavetis, Kristos Basios, Kristos Mastoras, Mihalis Manos, Kristos Miqelis, Andreas Kolos dhe Vasilios Llukas. Nga Juster Andreas Godhimis, Theodoros Sigas dhe Vasilis Ikonomu, nga Bostoni Mihalis Nikas, nga Kanadaja Kristoforos Qirkos dhe Kostas Stripelis, nga Sikago Jeorjios Kumbis dhe Aleksandros Llazakis, nga St. Luis Ilias Ciopos dhe nga Uashington D.C. Dimitrios Zois.

Nga ata që shërbyen dhe shërbejnë edhe sot në vende ku në Këshillat Drejtuese respektive janë: nga Nju Jorku Janis Camberis-pensionist në Greqi, doktori Mattheos Papageorgjiu, Fotis Galicis (sekr. i përgjithshëm deri sot), Andonis Karasis (ne vazhdimesi arketar), Spiros Dherdhemezis, Kristos Xelios, Janis Kabesis, Kristos Kosovicas, Athina Ksinogalu, Eva Kandli, Irimi Cuka, Kristos Karasas. Dhimitrios Vasos, Dhimitris Dralos dhe Manolis Licis, vëllezërit Qiqi dhe vëllezërit Ifanti. Nga Juster Nikos Xumbas, Aris Felis, Ekaterini Siga dhe Fotis Gantias. Nga Bostoni edh. Alqivjadhis Kalivas, Basilis Qiranis, Janis Ramos, Ilias Pocis dhe Jorgos Bracis. Nga Cikago Nikos Vajnikos, Kristos Panos, Evdhoksia Kubi, Miltos Vajnikos dhe Dhim. Vajnikos, nga Cikago Janis Antoniu dhe Nikolaos Aidhonis. Nga Ditroit Thomas Karathanos, Dhimitrios Papas dhe Nikos Kacis (në vazhdimësi arkëtar). Nga Filadelfia Telis Mumas, Pavllos Kotrocios dhe Kostas Zidhros, nga Klivenald doktori Spiros Qirkos, nga St. Louis Vasilis Copos, nga Kanadaja Apostolos Qefallas dhe Rita Apostolidhu.

Do të desha të përmend edhe shumë të tjerë bashkëkombas të nderuar, që i shërbyen organizatës sonë, por nuk më lejon

vendi. Do të përfundoj me anëtarët e Këshillit Drejtues që shërbejnë sot nën kryesimin e kryetarit Mihalios Servos dhe nuk u përmendën në këtë shënim historik timin Irini Fotu, Mattheos Panajotu, Eleonora Mihopullu, Aleks. Pallas, Taqis Fotos dhe Kostas Ganas.

Duke përfunduar, i urroj Federatës Panepirote të Amerikës të vazhdojë për shumë vjet veprimtarinë e saj patriotike dhe me pjesmarrjen e brezit të ri të shkruaj një histori të re.

Kongrese dhe kryetarë të Federatës Panepirote të Amerikës që nga krijimi i saj

1.	19-21	korrik	1942	Northboro mA	Fotios Qiricis
2.	5-7	shtator	1943	Nju Jork	Kristos Curos
3.	3-6	shtator	1944	Ditroit	Kristos Curos
4.	28-30	shtator	1945	Nju Jork	Fotios Qiricis
5.	7-9	korrik	1947	Uashington	Athanasios Kocis
6.	27-29	korrik	1949	Filadhelfia	Athanasios Kocis
7.	15-18	korrik	1951	Concord,NH	Arh.Vas. Lokis- Evang Kocidas
8.	29 nent-2 dhjet		1953	Nju Jork	Konstandinos Dhimas
9.	14-18	korrik	1955	Ditroit	Konstandinos Dhimas
10.	18-22	korrik	1957	Cikago	Pandelis Siepis
11.	23-27	korrik	1959	Klivelandë	Pandelis Siepis
12.	5-11	korrik	1961	Boston	Vasilios Fotos
13.	2-7	korrik	1963	Nju Jork	Vasilios Fotos
14.	30 qersh-4	korrik	1965	Ditroit	Vasilios Fotos
15.	6-10	gusht	1967	Ioanina	Vasilios Fotos
16.	9-14	korrik	1969	Nju Jork	Konstandinos Filidhis
17.	18-25	korrik	1971	Ioannina	Kon. Filidhis- Mix. Cokas
18.	22-27	korrik	1973	Montreal	Vasilios Fotos
19.	23-28	korrik	1975	Cikago	Vasilios Fotos
20.	13-18	korrik	1977	Ditroit (3 vjet)	Men. Xelios
21.	19-22	qershor	1980	Uashington (2 vjet)	Men. Xelios
22.	26-29	qershor	1982	Filadhelfia	Ilias Bexios
23.	27-30	qershor	1984	Nju Jork	Ilias Bexios
24.	25-29	qershor	1986	Boston	Vasilios Mikelis
25.	22-25	qershor	1988	Qyteti Atlantik	Dhim. Cumbanos
26.	28-30	qershor	1980	Nju Jork	Simos Dhimas
27.	29 qersh-2	korrik	1991	Cikago	Vasilios Fotos

28.	24-27	qershor	1993	Torondo	Nik. Gaxojanis
29.	14-18	qershor	1995	Uashington	Nik. Gaxojanis
30.	19-22	shkurt	1997	Florida	Kristos Qirkos
31.	30 qersh-3	korrik	1999	San Francisko	Kristos Qirkos
32.	5-8	korrik	2001	Nju Jork	Ilias Bexios
33.	19-23	shkurt	2003	Florida	Panajiotis Silis
34.	2-6	mars	2005	Florida	Mihalis Servos

**KËSHILLI DREJTUES TË FEDERATËS PANEPIROTE
TË AMERIKËS**

Mihalis Servos

Kryetar

Kristos Karasas

Nënkryzetar

Fotios Galicis

Sekretar i përgjithshëm

Dhimitrios Dhralios

Arkëtar

Irini Fotu

Ndihmës sekretar

ANËTARË KESHILLI

Taqis Fotos

Antonios Karasis

Iatros Spiros Qirkos

Eleonora Mihopullu

Aleksandros Pallas

Mattheos Panajiotu

ZËVENDËSIT

Anastasia Dhraliu

Kostas Gantias

GUVERNATORËT

Jeorjia Mici

Kristos Panos

Ilias Pocis

Irini Cuka

Kostas Zidhros

ISH KRYETARËT

Iatros Vasilios Fotos

Iatros Mihalis Cokas

Menelaos Xhelios

Ilias Bexios

Vasilios Miqelis

Dhimitrios Cumbanos

Simos Dhimas

Nikolaos Gaxojanis

Kristos Qirkos

Panajiotis Silis

Pirros Mbreti i Epirit
(318 - 272 p.k)

Me ndjenjën e krenarisë epirote, me respekt të veçantë dhe gëzim të madh, dua të falenderoj nga zëmra të gjitha sa kontribuan për botimin e librit. Autorin, Sociolog, Ekonomist, Etnolog dhe Anëtar i Shquar i Komunitetit Universitar z. Theofani Malqidhi. Z. Ilia Bexio për Historikun e Federatës Panepirote të Amerikës. Federatat Anëtare, Këshillin Drejtues, Guvernatorët, ish Kryetarët dhe Kryetarin e Komisionit Kulturor të Federatës Panepirote të Amerikës z. Kristo Karassa.

Me respekt

Mihalís Servos

Kryetari

I SHOQATËS PANEPIROTE
TË AMERIKËS

THEOFANIS MALQIDHIS është profesor i Shkencave Shoqërore dhe Politike dhe jep lëndën e politikës bashkëkthore, shoqërisë dhe ekonomisë së Ballkanit dhe të Detit të Zi, në Departamentin e Gjuhës, Filologjisë dhe Kulturës së Vendeve të Detit të Zi në Universitetin Demokriteion të Thrakës.

Veprat më kryesore të tij janë

- Politika e Greqisë dhe e Turqisë për Thrakën, pas hyrjes së tyre në NATO
- Ekonomia dhe shoqëria në zonën e Detit të Zi
- Evropa e Bashkuar dhe vendet e Detit të Zi
- Politika, ekonomia dhe shoqëria në Rusinë bashkëkohore
- Dimensione kombëtare dhe ndërkombëtare të çështjes së Greqëve të vendeve të Detit të Zi
- Pamje të çështjes etnike shqiptare
- Marrëdhëniet Greko-Shqiptare

Gjithashtu ka korrektuar vëllimet me bashkëautorësi: “Aspects of Southeastern Europe and the Black Sea After the Cold War” dhe “Ndryshimi i identitetit kolegjital të Pomakëve” (së bashku me N. Kokka).

Dua të falendëroj me mamus krenarisë epirote, me nder dhe gëzim të veçantë gjitha ata që kontribuan per botimin e ketij libri. Dua të falendëroj Shkrimtarin, Sociologun, Ekonomistin, Etnologun dhe anëtarin ezdjedhur të Universitetit z. Theofani Malkidi, Ilia Bexio për historikun e POA-s, anëtarët, këshillin drejtues, qeveritarët, ish kryetarët dhe kryetarin e Këshillit Kulturor të POA-s z. Kristo Karasa.

Me nder

Mihalis Servos

Kryetari

I Federatës Panepirote të Amerikës